16. Katzenbach JR, Smith DK. 1993. The Wisdom of Teams: Creating the High-Performance Organization. Cambridge, MA: Harvard Business School Press.

SUMMARY

MANAGEMENT DEVELOPMENT IN HEALTH INSTITUTIONS

Zymrete Ibraimi Jakupi¹, Makfirete Ibraimi², Sasho Merxhanovski², Snezhana Lazarevska³

¹Parliament of RM, State School of medicine “Pançe Karagjozov” Skopje, Macedonia

²Primary school „Mustafa Kemal Atatürk“ Gostivar,

³Center for Physio and Kineziterapija "Lasers Med”, Skopje, Macedonia

Development manager concept is broader and has more to do with developing the whole personality. Aims: To investigate the development of managers in public health institutions. The data built on scientific basis should create the ground for the improvement of the existing situation, in order to develop and institutionalize a successful leadership in PHI. Material and methods: The research was conducted from 01.06-31.08. 2009 in 10 PHI “University Clinics” - Skopje. The instrument used is a questionnaire survey of 12 specially closed questions, adapted for the subjects of research of the 10 directors. The survey is combined and the descriptive causal method is used (description of the cause). Overview of documentation and information during communication with the perceived context, results are processed with standard statistical percentage. Results: The majority of directors give importance to the personal development in managing, they regularly attend various managerial courses, attend conferences, congresses, symposiums and seminars; Organize collaboration with other institutions, collaborate and communicate with employees. They are in details familiar with the qualities of the employees and they know their skills, needs and affinities. Only some of them are neglectful and uninterested. Conclusion: The interest of many ardent directors to develop management to perfection encourages us to a more

prosperous future in this profile of management; that is why these directors should be promoted as an example of successful management. We need an urgent transfer of the knowledge in order to get close to the modern western trend so that a successful management of the leadership is developed.

Key words: Development management, directors, professionalism

MEDICUS

PUNIM BURIMOR SHKENCOR / ORIGINAL SCIENTIFIC PAPER
MJEKËSI E PËRGJITHSHME

**FREKUENCA E INFEKSIONEVE TË RRUGËVE TË POSHTME RESPIRATORE
TEK FËMIJËT E MOSHAVE 0-14 VJEÇ NË REGJIONIN E STRUGËS**

Valvita Reçi^{1,2}, Defrime Reçi³

¹Spitali i Përgjithshëm, Reparti i Pediatriisë, Strugë, Maqedoni

²USHT, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Tetovë, Maqedoni



Valvita Reçi, mjeke, asistente
6334 Veleshtë, Strugë, Maqedoni
Tel.: 075 504 958
e-mail: valvitareci@hotmail.com

REZYME: Infeksionet akute të rrugëve të poshtme respiratore janë shkaku kryesor i morbiditetit të fëmijët në mbarë botën, veçanërisht pneumonia si dhe paraqesin problem madhor shëndetësor, sidomos në vendet në zhvillim. **Qëllimi i studimit:** Të analizojmë frekuencën e infeksioneve të rrugëve të poshtme respiratore tek fëmijët e moshave 0-14 vjeç në regjionin e Strugës. **Materiali dhe metodat:** Në studim janë analizuar pacientët e pranuar në Repartin e Pediatriisë, në Spitalin e Përgjithshëm në Strugë, në periudhën Tetor 2010–Shtator 2011. **Rezultatet:** Nga gjithsej 2778 pacientë, me infeksione të rrugëve respiratore kanë qenë 1467 ose 52,8%. Prej tyre 648 ose 44,17% kanë qenë me infeksione të rrugëve të sipërme dhe 819 ose 55,82% me infeksione të rrugëve të poshtme respiratore. Me laringjit kanë qenë 51 ose 6,22%, me bronkit 550 ose 67,15%, me bronkiolit 25 ose 3,05%, me bronkopneumoni 191 ose 23,32% dhe 2 ose 0,24% me astmë bronhiale. Infeksionet e rrugëve të poshtme respiratore më shpesh janë shfaqur në Dhjetor (54%), Mars (41,7%), Janar (37,7%) dhe Nëntor (40,5%). **Përfundimi:** Grup-mosha më e prekur ka qenë prej 1-5 vjet. Më të shpeshta kanë qenë në stinën e dimrit dhe në pranverën e hershme

Fjalë kyç: Laringjiti, bronkiti, bronkioliti, bronkopneumonia

Medicus 2012, Vol. XVII (1):

HYRJE

Infeksionet e rrugëve respiratore te fëmijët janë një ndër patologjitë më të shpeshta që i hasim në praktikën tonë të përditshme. Ata më së shumti prekin moshën nën 5 vjeçare, ndërsa me rritjen e fëmijëve forcohet edhe imuniteti i organizmit ndaj këtyre infeksioneve dhe këto patologji bëhen më të rralla. Shumica e fëmijëve zhvillojnë 3-8 ftohje të zakonshme brenda vitit që mund të shoqërohen me infeksione të rrugëve të sipërme ose të poshtme respiratore (12). Shpeshtësia e këtyre infeksioneve është më e madhe te fëmijët parashkollorë dhe tek ata që i ekspozohen ambienteve me duhan (10). Shkak më i shpeshtë i paraqitjes të infeksioneve respiratore te fëmijët është mungesa e zhvillimit të imunitetit specifik ndaj shkaktarëve të veçantë të latantët dhe fëmijët parashkollorë (9). Infeksioneve të rrugëve të poshtme respiratore në shumicën e rasteve u paraprijnë ftohjet ose infeksionet e rrugëve të sipërme respiratore që në përqindje më të madhe i shkaktajnë viruset, sidomos te latantët dhe fëmijët parashkollorë ndërsa me rritjen e fëmijëve rritet incidenca e infeksioneve bakteriale (9).

Infeksionet akute të traktit të poshtëm respirator shkaktajnë morbiditet dhe mortalitet në masë të konsiderueshme te fëmijët, sidomos në vendet më pak të zhvilluara (1). Si faktorë predispozues për shpeshtësinë e këtyre infeksioneve në vendet akoma në zhvillim janë përkrahur varfëria, të ardhurat e kufizuara të familjes, ndotja e ajrit, malnutricioni, pesha e ulët e lindjes, mungesa e gjdhënies si dhe menaxhimi i vonuar shëndetësor (2, 3, 10). Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë 20% e vdekjeve te fëmijët nën 5 vjet janë për shkak të infeksioneve të rrugëve të poshtme respiratore dhe 90 % e tyre shkaktohen nga pneumonia (4, 7). Viruset janë shkaktarët më të shpeshtë të infeksioneve të rrugëve të poshtme respiratore te latantët dhe fëmijët e vegjël dhe paraqesin problem madhor shëndetësor. Infeksionet e natyrës bakteriale zakonisht janë sekondare, i shoqërojnë infeksionet virale të traktit të sipërm ose të poshtëm respirator. Në një studim, 23% e fëmijëve me pneumoni kanë pasur infeksion të përzier edhe viral edhe bakterial (6).

QËLLIMI I PUNIMIT

Qëllimi i këtij qëndron në analizën e frekuencës së infeksioneve të rrugëve të poshtme respiratore te fëmijët e grup-moshës 0-14 vjeç në periudhën Tetor 2010 - Shtator 2011, të cilët janë trajtuar në Repartin e Pediatriisë pranë Spitalit të Përgjithshëm në Strugë.

MATERIALI DHE METODAT


Në studimin janë përfshirë të gjithë fëmijët e pranuar në Repartin e Pediatriisë gjatë periudhës Tetor 2010 - Shtator 2011 duke shfrytëzuar historitë e sëmundjeve, analizat hematologjike, biokimike dhe radiologjike. Pacientët i kemi ndarë në tri grup-mosha dhe atë: në grupin e parë grup-moshën prej 0-1 vjeç, në grupin e dytë grup-moshën prej 1-5 vjeç dhe në grupin e tretë grup-moshën mbi 5 vjet, sipas gjinisë dhe sipas sezonave vjetore. Diagnostikimi është bërë në bazë të pasqyrës klinike, analizave laboratorike dhe radiologjike.

REZULTATET

Në repartin tonë janë paraqitur gjithsej 2778 pacientë, nga të cilët me infeksione të rrugëve respiratore kanë qenë 1467 ose 52,8%. Prej tyre, 648 ose 44,17% kanë qenë me infeksione të rrugëve të sipërme dhe 819 ose 55,82% me infeksione të rrugëve të poshtme respiratore.


Grafiku 1.

Frekuenca e infeksioneve respiratore



Grafiku 2.

Frekuenca e infeksioneve të rrugëve të poshtme respiratore



Grafiku 3.

Struktura e pacientëve sipas moshës





Tabela 1.

Frekuenca e analizave laboratorike dhe radiologjike

Ndryshimet laboratoriko - radiologjike	Përqindja
Leukocitozë me granulocitozë	60,6 %
Leukocitozë me limfocitozë	27,7 %
Vlera normale e pasqyrës së gjakut	14,5 %
SE i shpejtuar	47,1 %
Ndryshimet radiologjike në mushkëri	46,2 %


Grafiku 4.

Frekuenca e sëmundjeve shoqëruese



Grafiku 5.

Frekuenca e infeksioneve respiratore sipas muajve



Grafiku 6.

Frekuenca e infeksioneve të rrugëve të poshtme respiratore




Tabela 2.

Frekuenca e llojit të infeksioneve të rrugëve të poshtme të frymëmarrjes

	Muajt	Sëmundjet			
		Laringit	Bronhit	Bronhiolit	Bronhopneumoni
2010	Tetor	1.9%	25.4%	0%	11.7%
	Nëntor	3%	22%	2.5%	13%
	Dhjetor	5.5%	26%	2.5%	19.5%
2011	Janar	1.16%	25.2%	1.1%	10.1%
	Shkurt	0.9%	20.5%	0.9%	10.5%
	Mars	1.9%	31.4%	1.1%	7%

Prill	3.3%	25.5%	1.1%	5.5%
Maj	1%	16.9%	1%	3.5%
Qershor	0.6%	23.6%	0.6%	3.9%
Korrik	0.6%	15.6%	0.6%	2.6%
Gusht	0.2%	8.9%	0%	1.7%
Shtator	3.2%	10.5%	0%	1.4%

DISKUTIMI

Infeksionet e traktit të poshtëm respirator sipas OBSH paraqesin inflamacion të rrugëve respiratore nën plikat vokale të laringut, duke përfshirë mukozën e trakesë, bronkeve dhe indin mushkëror (7). Për sa i përket përfshirjes ose jo të parenkimës të mushkërive, këto infeksione mund t'i ndajmë në infeksione që përfshijnë parenkimën e mushkërive ku bën pjesë pneumonia dhe infeksione që nuk përfshijnë parenkimën e mushkërive ku bëjnë pjesë bronkiti akut, bronkitit kronik dhe bronkioliti (11).

Sa më i vogël të jetë fëmija aq më e madhe është mundësia që disa sëmundje të përhapen mjaft shpejt nëpër rrugët respiratore, kjo për shkak të dy arsyeve: së pari, gjatësia e rrugëve respiratore te fëmijët është shumë më e vogël sesa te të rriturit, dhe së dyti, rezistenca e organizmit të fëmijëve ndaj infeksioneve është shumë më e vogël (9). Në kushte fiziologjike ngushtimi i lumenit të bronkeve në ekspirium është shumë më i madh sesa te të rriturit, që ndihmohet nga fijet elastike më pak të zhvilluara përreth alveolave, prandaj ngushtimi i lumenit të bronkeve që ndodh gjatë inflamacionit të mukozës mund të shkaktojë mbylljen e lumenit për 75% te latantët kurse te fëmijët më të rritur deri në 20% (9). Nga kjo shohim edhe frekuencën më të madhe të paraqitjes të këtyre infeksioneve te latantët që në studimin tonë kanë përfshirë 30,4%, te fëmijët e moshës 1-5 vjet me 49,9% dhe përfshirjen më të vogël te fëmijët mbi moshën 5 vjet me 19,6%.

Reth 60% e fëmijëve të hospitalizuar me infeksione të traktit të poshtëm respirator kanë etiologji bakteriale, ndërsa reth 45 % me etiologji virale dhe 23% me etiologji të përzier virale-bakteriale (5, 6). Ndër shkaktarët më të shpeshtë bakterial janë *S. Pneumoniae*, *H. Influenzae*, *S. Aureus*, *K. Pneumoniae*, *Enterobakteriet*, etj., kurse ndër shkaktarët më të shpeshtë viral janë RSV, virusi i influencës, i parainfluencës, adenoviruset, hMPV, etj. (5). Sipas një studimi te fëmijët e moshës nën 3 vjet dominojnë infeksionet respiratore të natyrës virale, kurse te fëmijët e moshës mbi 3 vjet dominojnë infeksionet bakteriale (11).

Në aspektin klinik këto infeksione manifestohen me temperaturë të rritur, me kollë, takipne, frymëmarrja të vështirësuar, etj. por simptomet mund të jenë edhe jospesifike si psh. temperaturë subfebrile, predominim i simptomëve digjестive, etj. (11).

Në vendet në zhvillim identifikimi etiologjik i infeksioneve të traktit të poshtëm respirator është i vështirësuar dhe jorutinor, prandaj OBSH rekomandon që diagnostikimi i këtyre infeksioneve të bazohet në parametrat klinike dhe laboratorike (pasqyra e gjakut, SE) (1, 10).

Në studimin tonë diagnostikimi i këtyre infeksioneve është bërë në bazë të pasqyrës klinike, ekzaminimit objektiv, analizave laboratorike dhe radiologjike. Në pasqyrën e gjakut kemi fituar këto rezultate: leukocitozë me granulocitozë në 60,6% dhe leukocitozë me limfocitozë 27,7% të rasteve. Eritrosedimentacioni ka qenë i shpejtuar në 47,1 % të rasteve kurse ndryshime në mushkëri në radiografinë e kafazit të kraharorit kemi hasur në 46,2%.

Në këtë periudhë të përfshirë në studim, kanë mbizotëruar infeksionet e rrugëve të poshtme respiratore me 55,8%, ku përqindjen më të madhe e ka zënë bronkiti me 67,1%, pastaj bronkopneumonia me 23,3%, laringjiti me 6,2% dhe bronkioliti me 3,05%.

Gjithashtu, në studimin tonë kemi vërejtur shoqërimin e këtyre infeksioneve me infeksione të rrugëve të sipërme respiratore dhe sëmundje tjera. Nga 550 ose 67,1% raste me bronkit, 22,9% e tyre kanë qenë të shoqëruara me komponentën obstruktive, 27,6% me nazofaringjit, 21,4% me tonsillofaringjit, 10,3% me laringjit, 4,18% me anemi ferodeficitare dhe 8,5% kanë fituar enterokolite. Nga 191 ose 23,3% raste bronkopneumoni, 33,5% e tyre kanë qenë të shoqëruara me komponentën obstruktive, 36,1% me tonsillofaringjite, 6,2% me anemi ferodeficitare, 5,7% me enterokolite.

Për sa i përket shpërndarjes së këtyre infeksioneve sipas muajve brenda periudhës së përfshirë njëvjeçare, numri më i madh ka qenë në muajin Mars (73,2%), pastaj Dhjetor (61,5%), Shkurt (60,2%) dhe Janar (59,9%). Infeksionet e rrugëve të poshtme respiratore kanë mbizotëruar në muajin Dhjetor (54%), Mars (41,7%), Janar (37,7%) dhe Nëntor (40,5%). Ndër të cilat bronkopneumonitë më të shpeshta kanë qenë në muajin Dhjetor me 19,5%, Nëntor 13%, Tetor 11,7% dhe Shkurt 10,5%. Bronkitet më të shpeshta kanë qenë në muajin Mars me 31,4%, Dhjetor me 26% dhe Prill me 25,5%; laringjitet në muajin Dhjetor 5,5%, dhe Prill 3,3% dhe bronkiolitet në muajin Nëntor–Dhjetor me 2,5%.

PËRFUNDIM

Nga ky studim shohim se grup-mosha më e prekur e fëmijëve me infeksione të rrugëve të poshtme respiratore ka qenë prej 1-5 vjet. Më të shpeshta kanë qenë në stinën e dimrit dhe në pranverën e hershme. Shumica e tyre kanë qenë pasojë e infeksioneve të rrugëve të sipërme respiratore, shpeshherë të mjekuara në mënyrë joadekuate. Mjekimi në kohë dhe në mënyrë adekuate i ftohjeve të zakonshme sezonale apo të infeksioneve të rrugëve të sipërme të frymëmarrjes ka rëndësi të madhe në parandalimin e infeksioneve të rrugëve të poshtme respiratore.

Diagnostikimi dhe trajtimi adekuat i këtyre infeksioneve i administruar nga kujdesi primar shëndetësor, sidomos në zonat rurale, është pjesë e strategjisë shëndetësore për të parandaluar morbiditetin dhe mortalitetin. Në fund, është e rëndësishme që vendet e zhvilluara të mbështesin ekonomikisht sistemin shëndetësor të vendeve në zhvillim dhe të sigurojnë studime shkencore që do të jenë fitimprurëse për popullsinë e tyre (10).

LITERATURA

1. Clinical management of acute respiratory infections in children: a WHO Memorandum. Bulletin of the World Health Organization, 59: 707-7 16
2. Harari M, Shann F, Spooner V, Meisner S, Carney M, Decampo J. Clinical signs of pneumonia in children. Lancet 1991;338:928-30.
3. Cardenas VM, Koopman JS, Garrido FJ, Bazua LF, Ibarra JM, Stetler HC. Protective effect of antibiotics on mortality risk from acute respiratory infections in Mexican children. Bulletin of the Pan American Health Organization 1992;26:109-20. 4. http://www.who.int/fch/depts/cah/resp_infections/en/
4. <http://www.patient.co.uk/doctor/LRTI-in-Children.htm>
5. Michelow IC, Olsen K, Lozano J, et al; Epidemiology and clinical characteristics of community-acquired pneumonia in hospitalized children. Pediatrics. 2004 Apr;113(4):701-7. <http://www.ncbi.nlm.nih.gov/pubmed/15060215>
6. http://www.pbs.org/newshour/globalhealth/diseases/lower_resp.html
7. Acute lower respiratory tract infections in children: possible criteria for selection of patients for antibiotic therapy.-Frank Shann, Kate Hart, David Thomas
8. <http://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC2536213/>
9. Udzbenik Pedijatrije – G. Fanconi & Wallgren, Medicinska Knjiga , Beograd-Zagreb
10. Respiratory tract infections in children in developing countries.- Cashat-Cruz M, Morales-Aguirre JJ, Mendoza-Azpiri M
11. http://www.biomerieuxdiagnostics.com/upload/Resp_Infections_Booklet_web.pdf
12. <http://www.aanma.org/faqs/welcome-to-precious-breathers/respiratory-diseases/>

SUMMARY

FREQUENCY OF LOWER RESPIRATORY TRACT INFECTIONS IN CHILDREN AGED 0-14 IN STRUGA REGION

Valvita Reçi^{1,2}, Defrime Reçi³

¹General Hospital, Struga

²State University of Tetovo, Faculty of General Medicine, Tetovo,

³doctor of medicine

Background: Acute respiratory tract infections in children are the main cause of worldwide morbidity, in particular pneumonia and represent a major health problem, especially for developed countries. **Purpose of the study:** Is to see the frequency of lower respiratory tract infections in children aged 0-14 years in Struga region. **Material and methods:** In our study we included all patients admitted to the pediatric department at General Hospital in Struga during one year, from October 2010 - September 2011. **Results:** During this time, 2778 patients were admitted, of whom with respiratory tract infections have been 1467 or 52.8%. Of these, 648 patients or 44.17% were with upper respiratory tract infections and 819 patients or 55.82% with lower respiratory tract infections. In the group with lower respiratory tract infections with laryngitis have been 51 cases or 6.22%, with bronchitis 550 cases or 67.15%, 25 cases or 3.05% with bronchiolitis, 191 cases or 23.32% with bronchopneumonia and 2 cases or 0.24% with asthma bronchialis. Infections of lower respiratory have been more often in December (54%), March (41.7%), January (37.7%) and November (40.5%). **Conclusions:** Most affected age group has been from 1-5 years old. More frequent have been in winter season and in early spring.

Key words: Laryngitis, bronchitis, bronchiolitis, bronchopneumonia

MEDICUS

PUNIM BURIMOR SHKENCOR / ORIGINAL SCIENTIFIC PAPER

FARMACI

ZBULIMI I MBETJEVE TË ANTIBIOTIKËVE– SULFONAMIDIKËVE DHE KOHA E KARRENCËS SË TYRE NË QUMËSH TIN E GJEDHEVE NË R. E KOSOVËS

Zana Sulejmani¹, Agim Shehi², Zehra Hajrulai³, Elida Mata²,
Ardiana Murtezani⁴, Seven Sherifi⁵


¹UP, Fakulteti i Mjekësisë, Dega e Farmacisë, Prishtinë, Kosovë

²UT, Fakulteti i Mjekësisë, Instituti i Shëndetit Publik, Tiranë, Shqipëri

³Universiteti i Shkupit, Fakulteti i Mjekësisë Veterinare, Shkup, Maqedoni

⁴QKUK, Klinika e Mjekësisë Fizikale dhe e Rehabilitimit, Prishtinë, Kosovë

⁵Kompania Farmaceutike “Importimi Medicinal Kosovar, IMK”, Prishtinë, Kosovë.



Zana Sulejmani, farmacistë, asistent
Bulevardi Bill Klinton, Bl 3, Hyrja 3, Nr 28, Prishtinë
Tel: 038/223-384 mob: 049/230-231
e-mail: z.sulejmani@yahoo.com

REZYME: Hyrja: Sulfonamidet, të njohura zakonisht si sulfa preparate, janë përdorur gjerësisht në mjekimin e sëmundjeve bakterore te bagëtitë qumështdhënëse. Ato kanë një spektër të gjerë veprimi bakterostatik te organizmat gram pozitive dhe te ato gram negative. Sulfonamidet përdoren edhe në Kosovë në mënyrë rutinore, për shkak të administrimit të tyre të lehtë dhe kostos së ulët. Por, nga përdorimi i tyre i madh te gjedhet qumështore, ekziston mundësia e mbetjes të këtyre antibiotikëve në qumësht, dhe kjo mund të shkaktojë efekte të padëshirueshme te njerëzit, siç janë reaksionet alergjike, madje edhe ato toksike te personat e

ndjeshëm ndaj tyre, si dhe mund të rritë numrin e baktereve patogjene rezistente ndaj këtyre antibiotikëve – antimikrobikëve. **Qëllimi:** Qëllimi kryesor i këtij studimi është zbulimi i mbetjeve të sulfonamideve në qumësht dhe përcaktimi i kohës së karrencës pas përdorimit të tyre te gjedhet. **Materiali dhe metodat:** Mostrat e qumështit janë marrë nga ato gjedhe qumështore, të cilat kanë qenë të mjekuara me antibiotikë sulfonamidësh në një zgjatje kohe më së paku prej dy javësh të fundit. Grumbullimi i këtyre mostrave përfshin gati tërë fermat në territorin e Republikës së Kosovës gjatë periudhës kohore njëvjeçare të vitit 2011. Analizat e tyre laboratorike janë kryer me metodën ekzaminuese Elisa (Elissa Screening Test) në Institutin e Veterinarisë në Shkup. **Rezultatet:** Nga 127 mostra të qumështit të analizuar me metodën ekzaminuese Elisa, 24 sosh kanë qenë të kontaminuara me mbetje sulfonamidësh. Nga këto 24 mostra, 8 sosh dyshohet të kenë kaluar kufirin maksimal të mbetjeve në vlera ekstreme më të larta sesa që lejohet në bazë të standardeve. Koha e karrencës së tyre është 5-6 ditë. Nga kjo nënkuptojmë se edhe koha e lejimit të konsumit të qumështit zgjat po aq ditë. **Përfundimi:** Nga rezultatet e fituara vijmë në përfundim se gjatë mjekimit të gjedheve me sulfonamide, mbetjet e tyre janë të pranishme në qumësht në një nivel aq të madh sa mund të shkaktojë dëmtime serioze në masat popullore. Nga kjo mund t'u tërhiqet vërejtja autoriteteve tona zyrtare kompetente se duhet t'i shtojnë masat e kontrollit për qumësht të shëndoshë, të pastër dhe cilësor, si dhe të ndalojnë në mënyrën më të rreptë ligjore tregtinë e qumështit të kontaminuar me mbetje antibiotikësh.

Fjalë kyç: Qumësht, antibiotik, sulfonamide, mbetje, karrencë

Medicus 2012, Vol. XVII (1):

HYRJE

Qumështi është ushqimi kryesor, i pazëvendësueshëm në dietën e njeriut dhe si i tillë ai duhet të jetë shumë i pastër, i pakontaminuar nga mikroorganizmat e ndryshme shtazore, nga mbetjet e medikamenteve, nga lëndët kimike, antibiotikët, pesticidet dhe lëndët e tjera radioaktive.

Qumështi ka një përdorim të gjerë në masë, por edhe një mundësi të madhe të ndotjes shumë lehtë nga papastërtitë e shumta, duke u bërë kështu një burim i favorshëm për shfaqjen, rritjen dhe përhapjen e mikroorganizmave të ndryshëm, të baktereve patogjene, të cilat nëpërmjet tij kalojnë nga kafshët e sëmura te njerëzit dhe kështu shkaktojnë te ta një varg sëmundjesh të dëmshme për shëndetin e konsumatorit dhe të atij publik.


Në Kosovë mendohet të jenë mbi 150.000 lopë qumështore apo 52% e fondit total të gjedheve. Gjedhet janë bartësit kryesorë të prodhimtarisë së qumështit. Prodhimtaria vjetore e qumështit sillet rreth 381.896 litra, ndërsa konsumi i qumështit për kokë banori është mbi 170 litra qumësht për vit (1). Qumështi i prodhuar përdoret kryesisht në industrinë e përpunimit dhe të përfitimit të nënprodukteve të tij, si dhe për shitje në treg. Pjesa më e madhe e fermave të prodhimit të qumështit bashkëpunojnë me fabrikat e përpunimit të tij, por një pjesë e tyre e nxjerrin këtë produkt drejt për drejt në treg, pa bërë asnjë përpunim të tij industrial.

Derisa mjekimi dhe shërimi i gjedheve qumështore është i domosdoshëm për t'i mbajtur ato në jetë, dhënia e antibiotikëve te këto bagëti qumështdhënëse është e pashmangshme. Vlerësimet e deritashme dhe të dhënat paraprake nga strukturat veterinarë, tregojnë se përdorimi i medikamenteve ka qenë i madh te një numër fermash për prodhimin e qumështit në vendin tonë. Mund të themi lirisht se rreth 80% e sasisë totale të barnave që u jipen bagëtive qumështore janë antibiotikë, duke përfshirë këtu grupin e sulfonamideve, betalaktamëve dhe tetraciklinave të përdorura si terapi kryesore më vete ose të kombinuara njëra me tjetrën si terapi ndihmëse.

Sulfonamidet janë një ndër grupet më të vjetra të agjentëve antimikrobikë, të cilat njihen edhe me emrin sulfadropa. Ato janë përdorur që nga zbulimi i tyre më vitin 1929 nga Gerhard Domaku, ndërsa janë regjistruar për herë të parë në Australi më 1940. Sulfonamidet përdoren gjerësisht në mjekimin e sëmundjeve bakterore te bagëtitë qumështdhënëse. Ato kanë një spektër të gjerë veprimi, kryesisht bakterostatik, duke ndikuar në organizmat gram pozitive, gram negative dhe në disa protozoa, si eimeria dhe isospora spp (2).

Pavarësisht nga zbulimi dhe aplikimi i gjerë i antibiotikëve të tjerë, siç është edhe penicilina, prapëseprapë sulfonamidet po vazhdojnë të përdoren me të madhe në shumë vende të botës, duke përfshirë këtu edhe shtetin e Kosovës, për shkak të kostos së ulët dhe mënyrës së lehtë të dhënies së tyre.

Vështruar nga përmbajtja kimike, sulfonamidet janë amide të acidit p-aminobenzensulfonik dhe N₁-derivate të sulfanilamidit. Zëvendësuesi në pozitën N₁ mund të dallojë, meqë ndikon në gjysmëjetën plazmatike të barit.



Struktura bazë e sulfonamideve

Gjysmëjeta e sulfonamideve me veprim të shkurtër vazhdon 6 orë, me veprim të mesëm 12 orë, ndërsa ajo me veprim të gjatë shkon deri 9 ditë. Sulfonamidet që treten shpejt, shpërndahen lehtë në të gjitha indet dhe lëngjet trupore, duke u përfshirë këtu edhe në lëngun cerebrospinal dhe qarkullimin fetal. Këto deri 90 % krijojnë lidhje me proteinat plazmatike, ndërsa koncentrimi maksimal i tyre shihet pas 3-6 orësh. Ato metabolizohen në mëlçi dhe pastaj mënjahohen nëpërmjet filtrimit glomerular (3).

Përdorimi i këtyre antibiotikëve në mjekësinë veterinarë është mjaft i përhapur. Përveç përdorimit të tyre për kontrollim dhe shërim të sëmundjeve të kafshëve ushqimdhënëse, ato përdoren veçanërisht edhe si preparate shtesë në ushqim, duke i marrë në formë të aditivëve ushqimorë me rrugë orale (4). Lidhur me këtë, vlen të theksojmë se konsumi i sulfonamideve për një kohë të gjatë mund të ketë efekt nxitës në rritjen dhe zhvillimin e muskujve të kafshëve, duke i dalluar ata nga trashëgimtarët e tyre kryesisht për qëllime komerciale.

Përdorimi pa ndonjë kriter të caktuar, si dhe mbidozimi i antibiotikëve – sulfonamidikëve për mjekimin e sëmundjeve të lopëve qumështore mund të jetë mjaft i rrezikshëm për popullin dhe mbarë njerëzimin. Sikurse te njerëzit e gjinisë femërore, ashtu edhe te gjedhet, këta antibiotikë mund të ekskretohen përmes qumështit. Në këtë mënyrë sulfonamidet dhe metabolitët e tyre, gjatë mjeljes mund të depërtojnë dhe të përzihen në qumështin e paraparë për treg. Këto medikamente në plazmën e gjakut lidhen për proteinat dhe kështu mund të kalojnë nga gjaku në qumësht. Nga antibiotikët e përmendur më lart, afër 75% e tyre lidhen për serumit e gjakut në një nivel mbi 50% (5).

Disa efekte patologjike që mund të paraqiten si rezultat i mbetjeve të sulfonamideve:

- a) Transferimi i rezistencës së bakteve ndaj antibiotikëve te njerëzit;
- b) Efektet imunopatologjike;
- c) Efektet kancerogjene të shkaktuara nga disa sulfonamide;
- ç) Mutacioni i përhershëm i gjeneve;
- d) Helmimi i mëlçisë;
- dh) Reaksionet alergjike (6).

Përdorimi i tepruar i këtyre antibiotikëve te kafshët, jo vetëm që shton rrezikun e zhvillimit të bakteve rezistente, por, ka edhe efekt kancerogjen, siç është vërtetuar te disa sulfonamide, dhe ky fakt na bën të dyshojmë në sigurinë e ushqimit. Nga vlerësimet e bëra është konstatuar se rreth 5% e njerëzve të sëmurë e të mjekuar me sulfonamide kanë pasur efekte të padëshiruara nga këto barna (7). Si rezultat i këtyre provave ka dalë se prania e mbetjeve sulfonamidike në ushqim është konsideruar si e dëmshme për konsumatorët, duke pasur parasysh se ata mund të shkaktojnë reaksione alergjike në personat e ndjeshëm, si dhe rritje në numrin e bakteve patogjene rezistente ndaj antibiotikëve (8).

Shkak tjetër kryesor i rezistencës ndaj këtyre medikamenteve është ajo se kafshët ushqehen me sulfonamide dozash të ulëta dhe periudhë të shkurtër mjekimi për shërimin e sëmundjeve. Po qe se lopëve qumështore u jepen sulfonamide, koncentrimet e tyre të ulëta do

të mbeten në qumësht edhe për një kohë shumë më të gjatë, dhe kjo ka pasoja për shëndetin publik të një popullate (9).

Me qëllim që të mbrohet shëndeti i konsumatorëve nga rreziqet e mbetjeve të antibiotikëve në qumësht, në shumë vende të botës, si: Evropë, SHBA, Kanada etj, është përcaktuar me ligj kufiri maksimal i mbetjeve (kmm), i cili për sulfonamidet në qumësht dhe mish ka vlerë 100 µg/kg (10).

QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E STUDIMIT

Qëllimi kryesor i këtij studimi është zbulimi i mbetjeve të antibiotikëve, sulfamidikëve në qumësht.

Objektivat e studimit janë:

1. përcaktimi i kohës së karrencës pas përdorimit të tyre te gjedhet dhe
2. koha e paraparë për lejimin e konsumit të qumështit dhe bulmetrave të tij pas dhënies së antibiotikut te gjedhet qumështore.

MATERIALI DHE METODAT

Për grumbullimin e mostrave të qumështit nga lopët e sëmura dhe të mjekuara me barna farmaceutike antibiotikësh janë vizituar mbi 80% të fermave blegtorale të gjedheve qumështore në mbarë territorin e Kosovës brenda periudhës kohore njëvjeçare të vitit 2011.

Mostrat e qumështit janë mbledhur në dy sezona të vitit: gjatë stinës së dimrit dhe asaj të verës. Brenda vitit të paraparë 2011 janë mbledhur gjithsej 127 mostra të qumështit të papërpunuar: 39 sosh gjatë stinës së dimrit dhe 86 prej tyre gjatë kohës verore.

Mostrat janë marrë vetëm nga ato lopë të mjekuara me antibiotikë, duke llogaritur kohën e kaluar më së shumti deri dy javë nga data e dhënies së këtyre barnave farmaceutike gjedhit të sëmurë. Kërkimi dhe mbledhja e mostrave të qumështit është bërë në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke ia lënë krejt rastit të gjetjes së lopëve të sëmura.

Nëpërmjet një pyetëtori është identifikuar skema e mjekimit të lopëve qumështore, doza dhe lloji i barit, si dhe zgjatja kohore e dhënies së tyre. Mostrat janë futur në shishe speciale të plastikës prej një litërshë, të cilat menjëherë janë vendosur në termos dore, ku janë ruajtur brenda ditës në akull prej një temperature të ulët nën - 0 °C. Pastaj shisheet janë zhvendosur nga termosi në një friz me temperature -20 °C dhe aty janë ruajtur në gjendje të ngrirë derisa janë dërguar në laboratorët e Institutit të Veterinarisë në Shkup, ku u janë shtruar analizave të tyre me anë të metodës ekzaminuese Elisa.

Metoda Elisa është një ndër metodat analitike më të shpejta dhe më të besueshme në zbulimin e pranisë së sulfonamideve. Ky test përdoret si një metodë ekzaminuese për praninë e mbetjeve të këtyre antibiotikëve dhe jep rezultate në zgjatje kohe prej 1 deri 2 orë, duke mos përfshirë këtu përgatitjen e mostrës dhe të standardeve. Mënyra e përgatitjes së mostrave të qumështit të papërpunuar bëhet sipas procedurës së rekomanduar nga prodhuesi i paketimit ELISA (Europroxima, 5101SULM1). Në çdo seri të 40 mostrave që aplikohen në një pllakë mikrotitre është zbatuar kontrolli i kualitetit të mënyrës së ekstraktionit. Nëse për kryerjen e testit përdoren pusetat e dyfishta, atëherë ky test ka aftësi të analizojë 40 mostra, përndryshe mund të ekzaminohen në të njëjtën kohë 80 mostra. Absorbanca (thellësia optike) lexohet menjëherë me anë të Elisa BDSL imunoskan lexuesit në filtër prej 450 nm.

Për përgatitjen e mostrave të qumështit të papërpunuar janë përdorur këta reagjentë:

- a) etilacetati p.a., prodhuesi Merck, Gjermani,
- b) *iso*-oktani, prodhuesi Merck, Gjermani,
- c) kloroformi, prodhuesi Merck, Gjermani,
- ç) përzierja e *iso*-oktanit dhe kloroformit në raport 2:3 V/V,
- d) acidi klorhidrik 0,1 mol/dm³, prodhuesi Merck, Gjermani,
- dh) PBS-ja e përgatitur me tretjen e përzierjes së 0,77 g Na₂HPO₄ + 1,88 g KH₂PO₄ + 8,94 g NaCl në një litër ujë të destiluar dhe i përshtatur me pH prej 7,4±0,2 dhe
- e) standardi i sulfamerazinës, prodhuesi Sigma-Aldrich, ku përgatitet tretja elementare me koncentrim prej 1 mg/ml që ruhet në temperaturë prej -20°C.

Për të vlerësuar metodën ekzaminuese Elisa për analizën e sulfonamideve në qumësht është e domosdoshme të përcaktohen disa parametra në bazë të kritereve të parashtruara konform kërkesave dhe rekomandimeve nga Rregullorja e Direktivës nr. 96/23/EC (11). Parametrat që duhet të përcaktohen janë: a) selektiviteti, b) preciziteti (saktësia), c) riprodhueshmëria, ç) limiti i detektimit dhe d) aftësia për detektim (CC β) (12).

Të gjithë këta parametra janë përcaktuar përmes disa formulave dhe rezultatet e tyre përfundimtare janë paraqitur në tabelën e mëposhtme (13)

Llogaritja e rezultateve

Rezultatet llogariten në programin Eksell. Absorbanca e lexuar shndërrohet në përqindje (%) të dendësisë optike në raport me standardin zero B₀ dhe në bazë të vijës së kalibrimit që është e caktuar në çdo seri të tretjeve standarde dhe e ka këtë formulë: $y = a * \ln X + b$, ku

y – sinjal i lexuar i shprehur me % të dendësisë optike,

X – përqëndrimi i substancës dhe

a dhe b – koeficientë (12).

Në çdo seri të mostrave të analizuar vlera e R² duhet të jetë më së paku 0,98.

Limiti i detektimit (Limit of Detection, LOD) përcaktohet përmes formulës:

$$\text{LOD} = X_{\text{mesatare}} + 3\text{SD}.$$

Ndërkaq, limiti i detektimit të përcaktuar me metodën Elisa për mbetjet e sulfonamideve në qumësht është 13,3 µg/kg.

REZULTATET


1. Koha e marrjes së medikamenteve para analizimit të mostrës/ditë + niveli i mbetjeve të sulfamidikëve:

Vërehet një trend linear statistikiqsh të rëndësishëm që me kalimin e ditëve ulet edhe niveli i sulfamidikëve ($\chi^2 = 62.3$; $p < 0.01$).


2. Krahasimi i nivelit të mbetjeve të sulfamidikëve sipas kohës së marrjes së medikamenteve (në fillim të kohës dhe në mes të kohës):

Ditët	Niveli i mbetjeve të sulfamidikëve
Mesatare (SD)	Mesatare (SD)
(min-max)	(min-max)
1.7 (1.5) (1 - 4)	141.5 (9.1) (129.2 – 149.2)
5.0 (3.9) (1 – 14)	9.3 (4.9) (6.1 – 21.7)
5.6 (3.9) (1 – 17)	2.8 (1.1) (1.1 – 5.9)

Parametrat	Totali i sulfonamideve
Kurba e kalibrimit	$Y = -21,758 \ln(x) + 40,88$
Koeficienti i regresionit	0,9926
Nivelet e përqendrimit	0,125-5,0 ng/mL
IC ₅₀ (përqëndrimi i lidhjes së barit 50%)	0,75 ng/mL
Limiti i detektimit (LOD)	13,3 µg/kg
Aftësia e detektimit (CCβ)	54,8 µg/kg
Ripërsëritja a përsëritshmëria	7,39 %
Riprodhueshmëria	8,82 %
Rimbulimi	97,51 %



3. Krahasimi i nivelit të sulfamidikëve sipas kohës së marrjes së medikamenteve:



Nga tabelat dhe grafiqet e paraqitura më sipër mund të vërehet qartë se në ditët e para pas dhënies së sulfonamideve, niveli i mbetjeve të tyre është i lartë, dhe ky vazhdon edhe gjatë ditëve në vijim. Nga mesi i kohës së dhënies së këtyre medikamenteve, niveli i tyre ulet ndjeshëm, ndërsa në ditët e fundit pas dhënies së këtyre antibiotikëve, niveli i mbetjeve të tyre është i pallogaritshëm.

DISKUTIMI

Mbetjet e medikamenteve në qumësht dhe te nënproduktet e tij janë një ndër problematikat e sigurisë ushqimore në shëndetin publik, meqë ato mund të shkaktojnë dëmtime serioze në popullatë.

Nga 127 mostra të qumështit të papërpunuar, 24 prej tyre kanë qenë të kontaminuara me mbetje sulfonamidësh. Ndërkaq, kufirin maksimal të lejuar ose limitin e detektimit (LOD) me mbetje sulfonamidësh dyshohet ta kenë kaluar 8 mostra. Nga studimi rezulton se mbi 20% e sasisë totale të mostrave të qumështit të papërpunuar të analizuar me metodën ekzaminuese Elisa përmbajnë mbetje të këtyre medikamenteve, ndërsa afër 10% e tyre kanë kaluar kufirin maksimal të mbetjeve.

Po ashtu nga këto rezultate të fituara me metodën Elisa vërtetohet se koha e karrencës së sulfonamideve në organizmin e lopës qumështore është mbi 5 – 6 ditë. Njëkohësisht kjo tregon edhe kohën e paraparë për lejimin e konsumit të qumështit dhe bulmetrave të tij pas dhënies së antibiotikut te lopët qumështore.

Më vitin 1991 në Gjermani Sandersi me disa bashkautorë hulumtuan rreth 3000 mostra të qumështit dhe me këtë rast kanë dëshmuar prezencën e sulfonamideve te 1.1 % të mostrave.

Po ashtu në Gjermani më 2007, në një hulumtim tjetër të bërë nga Kresi me disa bashkautorë sipas suazave të programit për identifikim të mostrave pozitive të qumështit në 1.6 % të rasteve është vërtetuar prezenca e mbetjeve të sulfonamideve.

Një hulumtim tjetër i bërë në Holandë më vitin 2000 nga Abjeani me disa bashkautorë, duke përdorur metodën ekzaminuese cilësore, kanë dëshmuar se prej 1100 mostrave të analizuar, 9 sosh ose 0.81 % kanë qenë të kontaminuara me mbetje sulfonamidësh.

Për dallim nga këto hulumtime, disa të dhëna të tjera të publikuara nga Tansakuli më vitin 2008 tregojnë se në SHBA më 1998 prevalenca e mbetjeve të sulfonamideve në qumështin e papërpunuar ka qenë 40-70 %.

Një studim tjetër i kryer nga Tolentinoja me disa bashkautorë më 2005 në Meksikë me anë të metodës ekzaminuese tregoi se numri i mostrave të detektuara me mbetje sulfonamidësh arrinte deri 51.3% të numrit total të mostrave të analizuar.

Për dallim nga këto të dhëna të lartpërmendura, te të cilat është dëshmuar prevalencë relativisht e rritur e sulfonamideve, sipas hulumtimeve të bëra në Belgjikë më vitin 2006, Rejbrok me disa bashkautorë vërtetuan prezencën e sulfonamideve te 0.05 % e numrit total të mostrave të analizuara. Po ky autor një vit më vonë më 2007 në një studim tjetër nuk ka mundur të detektojë ansnjë mbetje sulfonamidesh në mostrat e analizuara të qumështit të papërpunuar.

PËRFUNDIMI

Studimi i mbetjeve të antibiotikëve në qumësht dhe mundësia e përmirësimit të kësaj gjendjeje ka rëndësi të madhe në rend të parë për shëndetin publik të vendit tonë, Kosovës, dhe në rend të dytë për të gjitha ndërmarrjet dhe industrinë e përpunimit të qumështit dhe të bulmetrave të tij.

Kosova sot po ngrihet si një shtet shteti i ri modern me të gjitha veprimtaritë e saj ekonomike, industriale, bujqësore, blegtorale, shëndetësore dhe për ndërtimin e saj të gjithanshëm ajo ka nevojë për ndihmë financiare, materiale dhe profesionale – shkencore nga vendet më të zhvilluara të rajonit dhe të botës. Mbi të gjitha Kosova ka nevojë për ushqime të shëndosha, të sigurta, të pastra dhe cilësore, në radhë të parë të atyre me origjinë shtazore.

Duke ngritur këto probleme duhet tërhequr vëmendjen në shkallë institucionale të autoriteteve tona zyrtare kompetente që t'i shtojnë masat e kontrollit për qumësht të shëndoshë, të pastër dhe cilësor, si dhe të ndalojnë në mënyrën më të rreptë ligjore tregtinë e qumështit të kontaminuar me mbetje antibiotikësh. Po kështu edhe fabrikat e grumbullimit dhe të përpunimit të qumështit duhet ta rritin vigjilencën e tyre dhe të mos pranojnë qumësht të kontaminuar me mbetje antibiotikësh.

Duke ngritur kështu cilësinë dhe sigurinë e ushqimeve tona në përgjithësi dhe të qumështit në veçanti Kosova mund t'u konkurojë me sukses mallrave të huaja ushqimore dhe ta kthejë besimin e qytetarëve tanë te ushqimet tona vendore.

LITERATURA

1. MBPZHR, Analiza e Sektorit të Blegtorisë në Kosovë, DPB, 2009. Projekti për R&I, Prishtinë 2009.
2. Carol A. Gonzalez and Karyn M. Usher. *Determination of Sulfonamides in Milk Using Solid-Phase Extraction and Liquid Chromatography-Tandem Mass Spectrometry*. Department of Chemistry West Chester University, PA 19383 USA. Agilent Technologies, Inc., 2009. Printed in the USA, March 11, 2009. 5990-3713EN.
3. Schwarz S, Chaslus-Dancla E. 2001. Use of antimicrobials in veterinary medicine and mechanisms of resistance. *Veterinary Research* 32. Fq.201–225.
4. Long AR, Hsieh LC, Malbrough MS, Short CR, Barker SA. 1990. Multiresidue method for the determination of sulphonamides in pork tissue. *Journal of Agriculture and Food Chemistry* 38. Fq.423–426.
5. Sandholm M. A critical view on antibacterial mastitis therapy. In: *The bovine udder and mastitis*. Sandholm M., Honkanen-Buzalski T., Kaartinen L., Pyörälä S. (eds). University of Helsinki, Faculty of Veterinary Medicine, Helsinki, Finland 1995. Fq.169-186.
6. Nisha A.R. Assistant Professor. *Antibiotic Residues - A Global Health Hazard*. Department of Pharmacology and Toxicology College of Veterinary and Animal Sciences, Pookot, Wayanad, Kerala -673576. *Veterinary World*, Vol.1(12). Fq.375-377.
7. Montanaro A. *Sulphonamide allergy*. *Immunology and Allergy Clinics of North America* 1998; 18. Fq.843.
8. Thomson CA, Sporns P. *Direct ELISAs for sulfathiazole in milk and honey with special emphasis on enzyme conjugate preparation*. *J. Food Sci.* 1995; 60. Fq.409-414.
9. Honkanen BT, Reybroeck W. *Antimicrobials. In Residues and Contaminants in Milk and Milk Products*. IDF. Brussels, Belgium 1997. Fq.26-33.
10. Food and Drug Regulation. 1991. Canada Gazette Part II, Table 3, Division 15, Part B. 125: 1478–1480.

11. Council Directive 96/23/EC of 29 April 1996 on measures to monitor certain substances and residues thereof in live animals and animal products and repealing Directives 85/358/EEC and 86/469/EEC and Decisions 89/187/EEC and 91/664/EEC OJ L 125, 23.5.1996, p. 10-32.
12. Community reference laboratories residues (CRLs). Guidelines for the validation of screening methods for residues of veterinary medicines (Initial validation and transfer). 20/1/2010.
13. STOJKOVIĆ D. E. *Analysis of residues of antimicrobial veterinary drugs in raw milk from R. of Macedonia employing various screening and confirmatory methods*. Punim doktorate. University Sts Cyril and Methodius, Faculty of Veterinary Medicine, Skopje 2011.
14. Sanders P., Guillot P., Dagorn M., and Delmas J.M. *Liquid chromatographic determination of chloramphenicol in calf tissues: studies of stability in muscle, kidney, and liver*. J. Assoc. Off. Anal. Chem., 74, 1991.
15. Kress C., Seidler C., Kerp B., Schneider E., Usleber E. *Experiences with an identification and quantification program for inhibitor-positive milk sample*. Anal. Chim. Acta 586, 2007.
16. Abjean J. P., Delepine B., Hurtaud-Pessel D., Juhel-Gaugain M., Roudaut B. *Qualitative or quantitative methods for residue analysis? A strategy for drug residue monitoring*. Proceedings of the EuroResidue IV Conference, 1, 2000. Veldhoven, The Netherlands 8-10 May.
17. Tansakul N. *A sulfadimidine model to evaluate pharmacokinetics and residues at various concentrations in laying hens*, Inaugural Dissertation, Stiftung Tierärztliche Hochschule, Hannover, Germany 2008.
18. Tolentino R.G., Perez M.N., Gonzales D.D., S.L. Vega., Flores G. P. *Determination of the presence of 10 Antimicrobial residues in mexican pasteurized milk*. Interciencia, 3, 2005.
19. Reybroeck W. *Screening for residues of antibiotics and chemotherapeutics in milk and honey*. Punim doktorate. Faculty of Veterinary Medicine, University of Ghent, Belgium 2010.

SUMMARY

DETECTION OF SULFONAMIDE RESIDUES AND THEIR WITHDRAWAL PERIOD IN CATTLE MILK IN R. OF KOSOVO

Zana Sulejmani¹, Agim Shehi², Zehra Hajrulai³, Elida Mata²,
Ardiana Murtezani⁴, Seven Sherifi⁵

¹University of Pristina, Faculty of Medicine, Department of Pharmacy, Prishtina, Kosovo

²University of Tirana, Faculty of Medicine, Institute of Public Health, Tirana, Albania

³University of Skopje, Faculty of Veterinary Medicine, Skopje, Macedonia

⁴UCC, Physical Medicine and Rehabilitation Clinic, Prishtina, Kosovo

⁵Pharmaceuticle Company “Kosovo Medical Importing, KMI” – Pristina, Kosovo

Introduction: Sulfonamides, commonly known as Sulfa Combination Drugs are widely used in the treatment of bacterial diseases in dairy cattle. They have a wide spectrum of bacteriostatic action on gram positive and gram negative organisms. Sulfonamides are used routinely in Kosovo, due to their easy administration and low cost. Moreover, because of their wide use in dairy cattle, there is a possibility of their presence in milk, and this can cause adverse effects in humans, such as allergic reactions, even those toxic for persons sensitive to sulfonamides, and can increase the number of pathogenic bacteria resistant to these antibiotics. **Objectives:** The main purpose of this study is to detect residues of Sulfonamides in milk and determination of withdrawal period after their use in cattle. **Materials and Methods:** Samples of milk were taken from dairy cows, which have been treated with Sulfonamides in period of last two weeks prior sample taking. Collection of these samples includes nearly all the farms in the territory of Kosovo during the period of one year in 2011. The necessary lab tests are conducted with Elissa Screening Test method at the Veterinary Institute in Skopje – Republic of Macedonia. **Results:** In total, 127 milk samples are analyzed with the Elissa Screening Test, 24 of them were contaminated with Sulfonamide residues. Of these 24 samples, 8 of them are suspected of exceeding the maximum residue limit in extreme

value higher than that permitted by the standards. Withdrawal period is 5-6 days. By this we mean that the time of permitting consumption of milk lasts as day. **Conclusion:** From the obtained results we have concluded that after the treatment of cattle with Sulphonamides, their residues are present in milk at the level as great as it can cause serious damage to the population groups. From this our official competent authorities can be warned that must increase the controlling measures for a healthy milk, clean and high quality, and to stop in the strictest legal way the trade of milk contaminated with antibiotic residues.

Key Words: Milk, antibiotic, sulphonamide, residue, withdrawal period

MEDICUS

PUNIM BURIMOR SHKENCOR / ORIGINAL SCIENTIFIC PAPER

NEFROLOGJI

MANIFESTIMET E PERIKARDITIT NË FAZËN E FUNDIT
TE DËMTIMIT TË VESHKËVE DHE PACIENTËT E TRAJTUAR
ME HEMODIALIZË

Lutfi Zylbeari^{1,2}, Elita Zylbeari¹, Zamira Bexheti³, Gazmend Zylbeari³,
Merition Ballazhi², Muhamedin Rushiti³

¹Spitali Klinik, Reparti i Sëmundjeve të Brendshme, Tetovë, Maqedoni

²Fakulteti i Shkencave Mjekësore, USHT, Tetovë, Maqedoni

³“Spitali Special i Nefrologjisë dhe Hemodializës Vita Medical Group“,
Tetovë, Maqedoni



Lutfi Zylbeari, mjek internist nefrolog, docent

Rr. JNA 1-9/45, Tetovë

Tel: 044 330 810

e-mail: drluti@yahoo.com & dr-luti@hotmail.com

REZYME: Qëllimi: Punimi ka për qëllim që të verifikohet dhe dokumentohet ndikimi i insuficiencës renale kronike terminale dhe ndikimi i vetë mjekimit me Hemodializë (HD) në paraqitjen e perikarditit dhe pasojave të tija. Përderisa paraqitja dhe etologjia e llojeve të ndryshme të perikarditit te pacientët me sëmundje të ndryshme (kardiovaskulare, respiratore, infektive, etj) janë dukuri tejet të studjuara dhe përpunuara, manifestimet e perikarditit te pacientët me uremi të trajtuar me HD ende janë objekt studimi dhe etiologjia e tyre është kontroverse, prandaj duhet bërë studime më të mëdhaja dhe me numër më të madh të pacientëve që sa më saktësisht të definohet etiologjia e kësaj dukurie me pasoja vdekjeprurëse për pacientët uremik të trajtuar me HD. **Materiali dhe Metodat :** Në këtë hulumtim klinik prospektiv, observues janë analizuar 90 pacientë të trajtuar me HD në Repartin e Nefrologjisë dhe HD pranë Spitalit Klinik të Tetovës me moshë mesatare prej: 62.40 ± 5.20 vjet, identike për të dy gjinitë. **Rezultatet:** Prej 90 pacientëve të trajtuar me HD, te 30 pacientë (prej të cilëve - 10 ishin të femra dhe 20 meshkuj) u manifestuan simptome të shtrrngimeve dhe dhimbjeve të krahërorit të ngjajshme me ato të anginës pectorale (te një numër i vogël i pacientëve perzistonte edhe temperaturë e lartë e përcjellur me ethe), të gjithë pacientët që manifestuan simptome të perikarditit uremik ishin edhe me mbingarkim voluminoz (ndërmjet seansave të

HD) prej 4000-6000 ml. **Konkluzioni:** Edhe në punimin tonë vërtetohet se te 30 % e rasteve të ekzaminuar dominojnë simptomat e perikarditit uremik, prej të cilëve: te 25% etiologjia e parikardit ishte si pasojë e jotrajtimit adekuat të HD, mbingarkesës voluminoze ndërmjet seansave të HD (4000- 6000 ml), mos respektimit higjieno-dietetik ndërmjet seansave të HD, ndërprerjes së parakoshme të seansës së HD, mospërdorimit të terapisë antihipertonike apo diuretike (te 10% e pacientëve të cilët ishin me frekuencë të HD dy herë në javë nga katër orë me diurezë ende të ruajtur), ndërsa te 5% e pacientëve perikarditi ishte si pasojë e infeksioneve të ndryshme.

Fjalë kyç: Perikarditi uremik, Insuficiencë Renale Kronike Terminale (IRKT), Hemodializa (HD).

Medicus 2012, Vol. XVII (1):

HYRJE

Një ndër çregullimet më të shpeshta te pacientët me Insuficiencë Renale Kronike Terminale (IRKT) numërohet edhe perikarditi uremik, i cili si zakonisht manifestohet me një simptomatologji të një perikarditi akut uremik, ndërsa rallëherë edhe si perikardit konstriktiv kronik me efuzione perikardiale (1, 2). Perikarditi është një inflamacion i cipës seroze të zemrës dhe rrënjëve të enëve të mëdhaja të gjakut. Perikarditi uremik shkaktohet nga insuficienca renale qoftë akute apo kronike nga inflamacioni i cipave visceralë dhe parietalë i shkakuar nga toksinet uremike, çregullimet e metabolismit të azotit (uresë, kretininës) të cilat te pacientët uremik janë tejet të rritura. Këto toksine grumbullohen në sasi prej: 15-50 ml ndërmjet cipave visceralë dhe parietalë duke shkakuar perikardit uremik. Shkencëtari Richard Brigh i pari e përshkroi shoqërimin e perikarditit te pacientët me sëmundje renale në studimin e tij prej 100 rasteve me albuminuri dhe pamjaftueshmëri kronike të veshkëve. Studimet e autopsisë te 37 raste nga grupa e lartëpërmendur treguan prezencë të perikardit ose efuzione perikardiale. Pacientët me IRKT të trajtuar me HD mund të zhvillojnë edhe perikardit uremik konstriktiv (3). Me saktësi ende nuk është gjetur shkaktar definitiv i perikarditit uremik. Një numër i madh i studimeve kanë dokumentuar se paraqitja e perikarditit uremik te pacientët me IRKT të trajtuar me HD është si pasojë e vetë sëmundjes terminale të veshkëve dhe trajtimin jo adekuat gjatë seansave të HD, mos eliminimi adekuat të lëngjeve, mbingarkesa volemike me hipertensionin pasues, mbingarkesa e tepërt e peshës trupore ndërmjet intervaleve të hemodializës. Disa autor supozojnë se perikarditi uremik paraqitet si pasojë e një inflamacion që vjen nga mbajtja e toksineve uremike në organizëm. Vetë pamjaftueshmëria kronike e veshkave është konsideruar si një gjendje vaskulopatike pasi ajo e përshpejton atherosklerozën dukuri e shpeshtë te këto pacientë. Një e treta e pacientëve uremik zhvillojnë insuficiencë kardiakë kongestive si pasojë e trajtimit jo adekuat të HD. Mbijetesa dy vjeçare nuk është më shumë se 33% në krahasim me 80% tek pacientët pa insuficiencë kardiakë kongestive. *Perikarditi uremik* është një dukuri e shpeshtë dhe e rëndë që paraqitet te pacientët me IRKT dhe ato të trajtuar me HD. Perikarditi uremik më parë ishte një ndërlikim i shpeshtë dhe i rëndë me pasoja të larta vdekjeprurëse te pacientët me IRKT të trajtuar me HD. Me parë perikarditi hasej deri në 50%-65% të gjendjeve uremike, përveç kësaj jeta e tyre pas zbulimit të perikarditit nuk zgjatej më shumë se 10-30 ditë. Sot ai është një ndërlikim i rallë, dhe modalitetet e reja dhe të sofistikuar të HD si dhe përdorimi i membranave biokompatibile dukshëm e kanë përmirësuar paraqitjen dhe prognozën e perikarditit uremik. Ky problem akoma është i lidhur me morbiditetin signifkiant dhe mortalitetin e rastit. Mirëpo, rrallë herë pikërisht gjatë trajtimit me hemodializë (HD), shfaqet një formë e perikarditit hemoragjik që është një ndërlikim tejet i rëndë me pasoja vdekjepruese. Përgjithësisht perikarditi uremik vazhdon të jetë një problem klinik i rëndësishëm i reparteve të hemodializës (HD). Në disa pacientë në dializë mund të ndodhin episode rekurente të perikarditit. Shkaku i perikarditit uremik mendohet se ka në bazë një inflamacion aseptik, që vjen nga mbajtja përbërësve urinare. Kjo ndodh si pasojë e dializës së pamjaftueshme. Por perikarditi uremik mund të zhvillohet edhe

si komplikacion i shpeshtë i infeksioneve virale pëshkak të imunitetit të dobësura të favorizuar edhe nga anemia renale të këto pacientë.

QËLLIMI I PUNIMIT

Qëllim i punimit ishte që të verifikohet dhe dokumentohet ndikimi i IRKT dhe ndikimi i HD në paraqitjen e perikarditit dhe pasojave të saja. Propozimi i masave më bashkëkohore mjekuese dhe terapeutike të perikarditit uremik të pacientët me pamjaftueshmëri kronike renale terminale dhe pacientët uremik të trajtuar me HD.

MATERIALI DHE METODA

Si material pune u shfrytëzuan 90 (N⁰=90) pacientët e trajtuar me HD kronike përsëritëse në Repartin e Nefrologjisë dhe Hemodializës pranë Spitalit Klinik të Tetovës. Prej 90 pacientëve vetëm të 30 pacientë (prej të cilëve 15 ishin femra, ndërsa 20 meshkuj, moshë mesatare prej: 62.40 ± 5.20 vjet, ishte identike për të dy gjinitë) u manifestuan simptoma të shtrëngimeve dhe dhimbjeve të krahërorit të ngjajshme me ato të anginës pectorale, të disa pacientë perzistonte edhe temperaturë e lartë e përcjellur edhe me ethe, të gjithë pacientët ishin edhe me mbingarkim voluminoz ndërmjet seansave të HD prej 4000-6000ml. Të gjithë pacientët e ekzaminuar ishin të trajtuar me HD bikarbonate me frekuencë prej tre herë në javë nga 4 orë, përveç 13 pacientëve (8 meshkuj dhe 5 femra të cilët frekuenca e HD ishte dy herë në javë nga katër orë (seansat e HD kryeshin ditën e Hënë dhe ditën e Premte) përsëritëse të vlerave tolerante të produkteve degraduese të azotit (uresë dhe kreatinimisë dhe diurezës ende të ruajtur). Si metodë pune shfrytëzuan elektrokardiogramin (EKG), ehokardiografia kolor doppler 3D dhe rentgengrafia si dhe pasqyra klinike..

REZULTATET

Pas një trajtimi intenzivë duke përdorur edhe metodën e ultrafiltracionit si dhe intensifikim e hemodializave frekvente duke e shtuar edhe frekuencën e hemodializës prej tre herë në javë në 4 apo 5 seansa të hemodializës me kohëzgjatje prej 5 orësh në interval prej një muaji si dhe respektimin dhe kufizimin e lartë të mbingarkesës voluminoze arritëm që pas një muaji manifestimet e perikarditit uremik të tërhiqen. Te një numër i vogël i pacientëve dhe pas një trajtimi adekuat të seansave të hemodializës dhe preferimit të HD të çrregullta më intenzive (të shtuara edhe dy hemodializa, jashta orarit dhe frekuencës normale të HD prej 3x4 orë) si dhe ultrafiltracionit të favorizuar si dhe me rënje të peshës trupore, shkarkim nga mbingarkimi voluminoz u arritë një efekt tejet i volitshëm dhe tërheqje e të gjitha simptomave të perikarditit uremik të verifikuara edhe me anë të EKG edhe me ndihmën e ultrasonografisë 3D. Pacientët e ekzaminuar të cilët kishin manifestime të perikarditit me origjinë virale apo infektive përveç hemodializave frekvente janë trajtuar edhe me antibiotikë, antireumatik josteroid si dhe me kortikosteroidë me çka u arritë një efekt tejet i lartë me përmirësim të gjendjes së përgjithshme dhe tërheqje të gjitha simptomave që e përcjellin perikarditin uremik.

DISKUTIMI

Perikardi është një qese fibrotike e pavaskularizuar e cila mbeshetjell zemrën. Është e përbërë prej dy shtresave: Shtresa seroze dhe fibrotike perikardiale. Shtresa seroze gjithashtu është e ndarë në dy pjesë, perikardiumi parietal i cili bashkohet ngushtë me perikardiumin fibroz si dhe perikardiumin visceral e cila është pjesë e epikardit. Ndërmjet perikardit parietal dhe visceral ka një zbrastirë e hollë potenciale e cila përmbanë 20-300 ccm fluid seroz e cila mbush zbrastirën e njohur si hapsira perikardiale (4). Shkaqet më të shpeshta të perikarditit konstruktiv (45-55%) janë idiopatike ose me etiologji virale (Coxsaki B, adenoviruset, gripi, operacionet kardiake (37%), disa shkaqe tjera mirëpo më pak të zakonshme janë sëmundjet e indit lidhor (artriti rheumatoid dhe lupus erythematodes systemicus, TBC, shkaqet tjera janë infeksionet qelbëzuese, histoplazmozat dhe vetë IRKT dhe HD. Te

pacientët me IRKT të trajtuar me HD etiologjia themelore e perikarditit konstruktiv është vetë hemodializa. Studime të shumëta kanë verifikuar dhe dokumentuar një korrelacion të lartë ndërmjet perikarditit konstruktiv dhe dëmtimit kronik të veshkëve në fazat e fundit duke konsideruar se trajtimi me HD dhe vete IRK është etiologjia e kësaj sëmundje. Perikarditi konstruktiv është një sëmundje e rallë që kryesisht manifestohet me dështim të zembrës së djathtë të percjellur me hipotension, ascit, presion të rritur të venës jugulare, effuzion pleural, hepatomegali dhe kolaps cirkulator (5, 6, 7). Pasqyra klinike e perikarditit uremik paraqitet me dhimbje me intesitet të ndryshëm, e cila lehtësohet kur pacienti është i ulur ose përkulur përpara. Shenjat klinike të perikarditit të pacientët me sëmundje renale terminale (ESRD të trajtuar me hemodializë kronike përsëritëse dëmtimi i veshkëve janë të ngjashme me shenja të vërejtura nga shkaktarë të tjerë. Shumica e pacientëve ankohen se kanë temperaturë dhe dhimbje pleurale në gjoks, inteziteti i të cilëve është shumë i ndryshueshëm (1). Dhimbja lokalizohet në regjionin perikardial dhe mund të ngjajë me dhimbjet e anginës pectorale. Kur zhvillohen efuzione masive perikardiale mund të shfaqet edhe dispneja dhe insuficiencia kardiake. Shpesh perikarditit uremik shoqërohet me ethe, dhe temperaturë të lartë. Rëndësi të vëçantë ka ekzaminimi auskultator në regjionin e zembrës pasi vë në dukje zhurmat e fërkimit perikardial që janë sipërfaqësore. Këto zhurma josistolike dhe diastolike dhe kanë shfaqje dhe mënyrë tipikë tre përbërëse të paraqitjes së tyre. Kur shtohen efuzionet perikardiale (likuidi) zhurmat e fërkimit perikardial shpeshëher zhduken. Efuzionet e mëdha të fletëve të perikarditit shkaktojnë tendosje të venave jugulare(shenja e Kussmaul-t) dhe mund të zhvillohet pulsi paradoksal (ulje të presionit sistolik në inspirim). Mirëpo, megjithatë ekzistojnë fakte të dokumentuara se të gjithë pacientët me sëmundje renale terminale (IRKT) të trajtuar me hemodializë kronike përsëritëse me perikardit mund të mos manifestojnë simptome klinike. Në rastet e dyshimit për perikardit fillimisht duhet bërë ekokardiografi e cila në mënyrë të kuart i ve në pah efuzionet perikardiale. Madje edhe kur fillohet mjekimi, ekokardiografia përsëritet disa herë për të parë efektin e mjekimit. Përveç ekokardiografisë duhet bërë edhe teleradiografia e toraksit dhe EKG. Mungesa e kongestionit pulmonar me gjithë zmadhimin e zembrës, i dallon efuzionet perikardiale nga insuficiencia kardiake kongestive, por kur efuzionet janë shumë më të mëdha, mund të kompromitet mbushja e ventrikulit të majtë dhe kjo mund të çojë në kongestion pulmonal. EKG-ja tregon ngritjen të S-T dhe ndryshim të dhëmbit T. Kur ka efuzion perikardial të shprehur, voltazhi i segmentit QRS është i ulët dhe mund të ketë variacione të ndryshme të aksit të zembrës nga rrahja në rrahje. Perikarditi uremik mund të japë dy ndërlikime serioze: Tamponadën e zembrës ose perikarditin restriktiv subakut. Tamponada kardiake që në fillim paraqitet me disa shenja alarmuese si hipotensioni i kombinuar me ngushtimin e presionit të pulsit. Tamponada mund të zhvillohet gradualisht, por mund të jetë edhe e menjëherëshme si pasojë e hemoperikardiumit dhe të kërkojë ndërhyrje të menjëherëshme kirurgjikale. Mund të paraqiten shenjat e tamponadës së zembrës, pjesërisht te pacientët me akumulim të shpejtë të lëngut perikardial. Zakonisht, dëgjohej një fërkim i perikardit, mirëpo është afat shkurtë. Sidoqoftë, prevalenca e lartë e dëmtimeve autonome te kjo popullatë e pacientëve mund ta pengojnë vrojtimin normal të rritjes së frekuencës së zembrës (8). Për më tepër, gjatë egzaminimeve fizike, disa pacientë me perikardit uremik prezentohen pa simptome ose rezultate sugjестive (dhimbje në gjoks apo fërkim perikardial (9). Ultrasonografia kardiake i zbulon efuzionet perikardiale në të paktën e 50% -65% të rasteve. Mund të vërehet një efuzion pleural shoqërues, i cili zakonisht është eksudativ, këto pra rezultate që përputhen me serozitin e gjeneralizuar (10, 11, 12, 13.) Perikarditi te pacientët me IRKT manifestohet si perikardit akut apo uremik ose perikardit i dializës dhe në rastet e rralla manifestohet si perikardit konstruktiv. Shkaqet e perikarditit uremik dhe atijë nga dializa ende mbeten të pasigurta. Manifestimet klinike dhe laboratorike të perikarditit akut si efuzioni perikardial, tamponada e zembrës dhe perikarditi konstruktiv te pacientët me dështim renal kronik janë të ngjashme me simptomet e manifestuara te pacientët jo uremik me përjashtim të dhimbjes së gjoksit që paraqitet rrallë herë te pacientët me IRKT dhe ato të trajtuar me hemodializë (14, 15, 16). Intervenimet terapeutike si dhe intensiteti i shtuar i seansave të HD mund dukshëm dhe në mënyrë efikase ta pengojnë dhe përmirësoje gjendjen e perikardit uremik me çka edhe do të zvogëlohet morbiditeti dhe mortaliteti te kjo grupë pacientësh (17,18). Si pasojë më e

vonshme e perikarditit mundë të jetë edhe kalcifikimi i fletëve të perikardit. Manifestime të tjera kardiovaskulare që mund të shfaqen gjatë IRK janë: Sëmundja iskemike e zemrës, kardiomiopatia uremike, aritmi ekstrasistolike, fibrilacion ventrikular e në rastet e rënda ndërprerja kardiake. Janë të përshkruara dy format të perikarditit te pacientët me dëmtim të veshkëve: Perikarditi uremik paraqitet si rezultat i inflamacionit të membranës viscerale dhe parietale të qeses së perikardit. Ekzistonë një korrelacion i lartë pozitiv ndërmjet paraqitjes së perikarditit me rritjen e sasisë së azotemisë (azoti në formë të uresë në gjak (BUN), që është zakonisht >60mg/dL), megjithëse patogjeneza ende nuk është mirë e skjaruar, me përjashtim të rasteve të sëmundjeve imune sistemike (siç është lupusi eritematoz apo sklerodermia). Perikarditi shpeshëherë është vërejtur te pacientët me hemodializë kronike ose dializë peritoneale (19). Si faktorë më të shpeshtë të cilët mund të sjellin deri te perikarditi uremikë numërohen dy faktorë edhe atë: Dializa jo adekuate dhe/ose mbingarkesa me lëngje (20). Është dokumentuar se të dyja format e perikarditit uremik mund të dallohen sipas llojit të efuzionit që është present: Efuzion seros ose efuzion hemoragjik), mirëpo, ndërmjet tyre ka edhe një përputhje statistikore sinjifikante. Ekzaminimet patologjike të perikardit tregojnë adezione tipike ndërmjet membranave perikardiale, të cilat janë më të trasha se zakonisht. Prezenca e fluidit të përgjakur (hemoragjik), është pjesërisht shkak i dëmtimit të shpeshtë të funksionit të trombociteve te pacientët me dëmtimin renal dhe përdorimit të shpeshtë të antikoagulansëve gjatë seansave të HD. Incidenca e perikarditit uremik është në rënje përshkak të hemodializës kualitative, cilësorë, modifikimit të procesit të HD (nga ajo Acetate në hemodializë Bikarbonate, përdorimit të membranave me tocopherol, transplantimit të veshkëve kështu që sipas studimeve më të reja numëri i pacientëve uremik të trajtuar me hemodializë është rreth 20%. Edhe pse involvimet dhe komplikimet perikardiale dhe sëmundjet kardiovaskulare ngelin si shkak më i rëndësishëm i mortalitetit dhe morbiditetit te pacientët me sëmundje renale kronike terminale të trajtuar me hemodializë kronike përsëritëse interesi i ekspertëve të nefrologjisë gjatë viteve të fundit është dukshëm i zvogëluar. Trajtimi i perikarditi uremik fillimisht bazohet në trajtimin dhe kurimin e shkakut primar (qoft ajo akute apo kronike) me antibiotik antireumatik josteroid, kortikosteroide dhe diuretik (te pacientët me uremi akute ndërsa te pacientët me IRKT të trajtuar me HD me anë të hemodializave të shpeshta dhe me kohëzgjatje më të madhe mbi 4-5 orë, dhe metodës së ultrafiltracionit.

KONKLuzionET

Edhe në punimin tonë vërtetuam se te 30% e rasteve të ekzaminuar dominojnë simptomat e perikarditit uremik, prej të cilëve: te 25% etiologjia ishte si pasojë e jotrajtimit adekuat të HD, mbingarkesës voluminoze ndërmjet seansave të HD (4000- 6000 ml), mos respektimit higjieno-dietetik ndërmjet seansave të HD, ndërprerjes së parakoshme të seansës së HD, mospërdorimit të terapisë antihipertonike apo diuretike (te 10% e pacientëve të cilët ishin me frekuencë të HD dy herë në javë nga katër orë me diurezë ende të ruajtur), ndërsa te 5% e pacientëve perikarditi ishte si pasojë e infeksioneve të ndryshme. Fakte që janë në përpuethshmëri edhe me shumë studime tjera të cituara në tekst. Trajtimi dhe mjekimi më primar i kësaj dukurie është mjekimi i faktorëve themelorë (mjekimi adekuat i infeksioneve të ndryshme: antibiotik, antiinflamtor josteroid, kortiko-steroid), trajtimi më efikas i seansave të HD, mosndërprerja e parakoshme e seansës së HD), kufizimi i mbingarkesës voluminoze ndërmjet seansave të HD (1500-2000 ml), respektimi i masave dietetike (moskonzumimi i krypës), llogaritja adekuate e peshë ideale trupore, janë masat më të preferuara në evitimin, pengimin dhe mjekimin e kësaj dukurie te pacientët uremik.

LITERATURA

1. Maisch B, Sefërovic PM, Ristić AD, et al. Leitlinien zur Diagnose und Behandlung von Perikardkrankungen Zusammenfassung; Die Task Force für die Diagnose und Behandlung von Perikardkrankungen der European Society of Cardiology. Eur Heart J 2004; 25:587.

2. Aisch B et al. Guidelines on the diagnosis and management of pericardial diseases executive ; The risk force on the diagnosis and management of pericardial disease of the European Society of Cardiology. Eur Heart J 2004; 25-587.
3. Roman L, Kleynber, Vera M, Kleynberg, Leonid M, Kleynberg, Danny Farahmandian Chronic Constructive Pericarditis in Association with End-Stage Renal Disease.
4. S.C Bertog, S.K. Thambidorai et al. Constrictive pericarditis: etiology and cause-specific survival after pericardiectomy. Journal of the American College of Cardiology . 2004, Vol.43 ,no.8 ,pp.1445-1452,
5. C.B Marcu ,E.Caracciolo, and T.Donohue ,Rapid of pregression of pericardial calcification in a patient with end-stage renal disease,“ Catheterization of Cardiovascular Interventions ,2005 vol.65, no. 1, pp.43-46.
6. M.W Akhter , et al. Constructive pericarditis masquerading as chronic idiopathic pleural effusions; importance of physical examination. Am J of Med.2006 .vol .119,no.7,pp.e1-e4
7. Gunukula SR, Spodick DH. Pericardial Erkrankung bei Nierenpatienten. Semin Nephrol 2001; 21:52.
8. Gunukula SR, Spodick DH. Pericardial Erkrankung bei Nierenpatienten. Semin Nephrol 2001; 21:52.
9. Banerjee A, Davenport A. Der Wandel der Herzbeutel Krankheit bei Patienten mit End-stage renal disease. Hemodial Int 2006; 10:249.
10. Bakirci T, Sasak G, Ozturk S, et al. Pleuraerguss in langfristige Hämodialyse-Patienten. Transplant Proc 2007; 39:889.
11. Tseng JR, Lee MJ, Yen KC, et al. Verlauf und das Ergebnis der Dialyse Perikarditis bei diabetischen Patienten mit Langzeit-Dialyse behandelt. Nierendurchblutung Press Res 2009; 32:17.
12. Iyoda M, Ajiro Y, Sato K, et al. Ein Fall von feuerfesten urämischen pleuropericarditis - erfolgreiche Behandlung mit Kortikosteroiden. Clin Nephrol 2006; 65:290.
13. Shabetai R. Kortikosteroide für wiederkehrende Perikarditis: auf dem Weg zur evidenzbasierten Medizin. Circulation 2008; 118:612.
14. Kleynberg RL, Kleynberg VM, Kleynberg LM, et al. Chronische konstriktive Perikarditis in Verbindung mit end-stage renal disease. Int J Nephrol 2011; 10:1.
15. Viktor Feldman MD, Zamir Dovrish MD, et al Uremic pericarditis ,april 2011 IMAJ;13:256-257.
16. Banerjee A, Davenport A. Changing patterns of pericardial disease in patients with end-stage renal disease . Hemodial Int 2006;10:249.
17. Kleynberg RL, Kleynberg VM, et al. Chronic constrictive pericarditis in association with end-stage renal disease.Int J Nephrol 2011;10:1.
18. Rutsky EA, Rostand SG. Die Behandlung der urämischen Perikarditis und Perikarderguss. Am J Kidney Dis 1987; 10:2.
19. Lundin, AP. Wiederkehrende urämischen Perikarditis: Ein Marker für unzureichende Dialyse. Semin Dial 1990; 3:5.

SUMMARY

MANIFESTATION OF PERICARDITIS IN LAST PHASE OF KIDNEY FAILURE IN TO THE PATIENT TREATED WITH HAEMODIALYSIS

**Lutfi Zylbeari^{1,2}, Elita Zylbeari¹, Zamira Bexheti³, Gazmend Zylbeari³,
Merition Ballazhi², Muhamedin Rushiti³**

¹Clinical Hospital, Tetova, Macedonia

Department of Internal and Haemodialysis, Tetova, Macedonia

²Faculty of Medical Sciences, SUT, Tetova, Macedonia

³Hospital for Nephrology and Haemodialysis “Vita Medical Group“, Tetova, Macedonia

The paper aims to be verified and documented the impact of chronic renal insufficiency terminals and the impact of treatment with Haemodialysis (HD) in presenting pericarditis and its consequences. While the presentation and etiology The paper aims to be verified and documented the impact of chronic renal insufficiency terminals and the impact of treatment with Haemodialysis (HD) in presenting pericarditis and its consequences. While the

presentation and etiology different types of pericarditis in patients with various diseases (cardiovascular, respiratory, infectious, etc.) are highly studied phenomenon and processed perikarditis events in patients treated with HD uremik are still object of study and their etiology is controversial, and should become larger studies with greater numbers of patients to more precisely define this phenomenon with antibacterial drugs ef lethal consequences for patients treated with HD uremic. 5.20 years, identical for both sexes. *Material and Methods:* In this prospective clinical trial, observers were analyzed-90 patients treated with HD and HD unit next to the University Clinical Hospital in Tetovo with average age: 62.40 *Results:* of 90 patients treated with HD, the 30 patients (of whom - 10 were female gender, and gender-20 were mash-filter,) was manifested symptoms of chest pain and contractions similar to those of angina pectoral (to a small number of patients also persisting high fever followed by fever), all patients manifested symptoms were uremic pericarditis voluminous flooding (between the HD sessions) of 4000-6000 ml. *Conclusion:* Even in our thesis confirmed that the 30% of cases examined uremic perikarditis symptoms dominate, of which: to 25% of antibacterial drugs ef pericarditis was due nontreated HD-myth proper, volume overload between the HD sessions (4000 - 6000 ml), do not respect hygiene and diet between the HD sessions, premature cessation of sea-nsës HD antihipertonike abstinence therapy or diuretics (10% of patients who were frequency of twice weekly HD from four diuresis hours still maintain), whereas 5% of the patients was due pericarditis various infections.

Key words: Uremic Pericarditis uremic, End-Stage Renal Disease (ESRD), Haemodialysis (HD).

MEDICUS

PUNIM BURIMOR SHKENCOR / ORIGINAL SCIENTIFIC PAPER

KARDIOLOGJI

PREZENCA E SKLEROKALCIFIKIMEVE AORTALE MUND TË NDIHMOJË NË PARAKALLZIMIN E SËMUNDJES SË ARTERIEVE KORONARE SUBKLINIKE

Nereida Xhabija¹, Iris Allajbeu², Elizama Petrela³, Martina Heba⁴

¹Spitali Amerikan, Departamenti i Kardiologjisë, Tiranë, Shqipëri

²Spitali Amerikan, Departamenti i Radiologjisë, Tiranë, Shqipëri

³Fakulteti i Mjekësisë, Departamenti i Biostatistikës, Tiranë, Shqipëri

⁴QSUT “Nënë Tereza”, Klinika e parë e Kardiologjisë, Tiranë, Shqipëri



Nereida Ulqini Xhabija, mjeke kardiologe

Rr. e Duresit, P 16, hyrja 1, ap 18; kodi postar 1016

Tel: 0684057269

e-mail: nereidaxh@yahoo.fr

REZYME: Sfondi: Lidhja mes sklerokalcifikimit te valvules dhe /ose rrënjës aortale me SAK është provuar tashmë në pacientë me sëmundje ishemike të dyshuar apo të njohur. Por vlera diskriminuese e tij është e panjohur në individët pa SAK të njohur dhe me risk koronar të konsideruar të ulët-mesëm. **Qëllimi:** A është e mundur që prezencja në ekokardiografinë

torakale e sklero-kalcifikimeve aortale të shërbeje për të përcaktuar nëse një individ i konsideruar në risk koronar të ulët-mesëm, të jetë në fakt në risk më të lartë për SAK? **Metoda:** Në një studim prospektiv, tip kohort, u identifikuan të gjithë pacientët që realizuan si angioskaner koronar ashtu dhe ekografi kardiak për arsye të ndryshme klinike. **Rezultatet:** Moshë mesatare e popullatës sonë prej 155 pacientesh (109 burra dhe 46 gra) ishte 57+/-11.28 vjeç. Këto paciente u ndanë në dy grupe: 91(58.7%) në grupin me AVSC prezent dhe 64(41.3%) në grupin pa AVSC, i cili u konsiderua si grup kontrolli. Grupi AVSC(+) pati një prevalencë më të lartë të angioskanerit koronar pozitiv për praninë e SAK krahasuar me grupin e kontrollit (75.8 versus 19%, me $p<0.001$). Kur në analizën e regresionit logjistik u futën të gjithë faktorët e njohur të rrezikut koronar, vetëm prezenca e AVSC dhe moshë rezultuan si faktorë të pavarur të ateriosklerozës koronare. Sensitiviteti, specifikiteti, vlera prediktive pozitive dhe negative e AVSC për të diagnostikuar SAK ishin 85.1%, 70%, 76% dhe 81%. **Konkluzion:** Prezenca e sklerokalcifikimeve aortale mund të ndihmojë në parakallzimin e SAK dhe u duhet shtuar faktorëve tradicionalë të njohur të rrezikut koronar.

Fjalë kyç: Sklerokalcifikimi aortal, sëmundja e arterieve koronare, angioskaneri koronar, ekokardiografia transtorakale

Medicus 2012, Vol. XVII (1):

HYRJE

Është dokumentuar tashmë se Sëmundja Aterosklerotike Kardiovaskulare (SAKV) është shkaku madhor i vdekjes së parakohshme në shumicën e popullsisë së Evropës duke përbërë një problem të madh për shëndetin publik dhe financat (1).

Studimet e mëdha klinike kanë treguar që patologjia që qëndron në bazë të SAKV është arterioskleroza, e cila zhvillohet tinëzisht gjatë një harku kohor shumëvjeçar dhe në kohën kur shfaqen simptomat ajo është zakonisht e përparuar. Për të mënjeluar ndodhi të tilla si: vdekja, infarkti i miokardit (IM) dhe insulti cerebral, është e domosdoshme të parandalohet nisja dhe zhvillimi i procesit ateriosklerotik, i cili fillon shumë kohë më parë se të zhvillohen shfaqjet klinike. Nisur nga kjo, merr rëndësi në praktikën klinike jo vetëm parandalimi dytësor, por kryesisht ai parësor. Sipas vlerësimit të Euro-SCORE (Systematic Coronary Risk Evaluation), Shqipëria përfshihet në hartën e vendeve me rrezik të madh KV (1, 2).

Pavarësisht se në Shqipëri ende nuk kemi studime të mëdha epidemiologjike për prevalencën e SAKV dhe faktorëve të rrezikut KV, dihet që mbi 50% e shqiptarëve sot vdesin nga sëmundjet kardiovaskulare, ndërsa 75% të vdekshmërisë së përgjithshme KV e përbëjnë sëmundjet me bazë ateriosklerotike (2, 3).

Deri tani, koronaro-angiografia vazhdon të mbetet një standard reference për diagnozën dhe trajtimin e SAK, duke mbartur gjithmonë me vete një rrezik jete të vogël, por të qartë. Kështu që seleksionimi i pacientëve për angiografi invazive duhet patjetër që të vazhdojë të përmirësohet, duke favorizuar metodat imazherike (nga më të thjeshtat deri të ato më të avancuarat).

Angioskaneri i zemrës apo CT Angiografia e Arterieve Koronare (CTAK) është metoda më e re imazherike që diagnostikon ateriosklerozën subklinike duke bërë të mundur vizualizimin dhe kuantifikimin e pllakës ateriosklerotike, e cila korrelohet në mënyrë të drejtpërdrejtë me riskun e eventeve kardiakë (18). CTAK është kthyer në një metodë të re diagnostikuese joinvazive për SAK me sensitivitet dhe specifikitet të lartë mbi 90% krahasuar me koronarografinë invazive. Ndryshe nga testet e tjera joinvazive që thjesht sugjerojnë në mënyrë indirekte praninë e sëmundjes së arterieve koronare. Kjo metodë jep informacion të detajuar mbi prezencën e SAK dhe severitetin e saj duke eliminuar ekzaminimet e panevojshme me koronarografi invazive, veçanërisht në individët që klasifikohen me risk të ulët-mesëm për SAK nisur nga faktorët e rrezikut koronar (22, 23).

Vlerësimi i faktorëve tradicionalë të rrezikut, si dhe testet e tjera joinvazive të ishëmisë e kanë përmirësuar ndjeshëm stratifikimin e pacientëve në rrezik për SAK. Por ky lloj stratifikimi sipas faktoreve tradicionale të rrezikut koronar si hipertensioni, diabeti,

herediteti, duhanpirja dhe dislipidemia është deri diku i limituar (19). Nga studimet e mëparshme ka rezultuar që edhe vleresimi i rrezikut sipas Framinghamit është një diskriminues i dobët i “atherosclerotic plaque burden” sidomos në pacientët simptomatike (20). Disa pacientë pa pllaka aterosklerotike evidente në angio-CT koronar mund të marrin terapi si parandalim parësor gjate gjithë jetës së tyre për shkak të përlogaritjes së rrezikut koronar në baze të analizimit të faktorëve tradicionalë, ndërsa disa të tjerë me pllaka të rëndësishme mund të mos trajtohen fare. Kështu që del si detyrë gjetja e markuesve të tjerë potencialë të arterosklerozës që i duhen shtuar faktorëve tradicionalë të rrezikut, me qëllim identifikimin e një nengrupi pacientesh me rrezik të lartë për SAK.

Sklerokalcifikimet multiple kardiake si kalcifikimi i rrënjës aortale (aortic root calcification, ARC), skleroza dhe/ose kalcifikimi I valvulës aortale (AVSC), kalcifikimi i unazës mitrale (Mitral Annular Calcification, MAC), janë gjetje imazherike që mund të diskriminohen lehtësisht nëpërmjet ekokardiografisë së thjeshtë transtorakale apo edhe skanerit kardiak. Vendet e zakonshme të kalcifikimeve kardiake, pas atyre koronare, janë valvula aortale, rrënja e saj dhe unaza mitrale. Prania e depozitave të tilla kalçike në zemër është parë që ka të njëjtën natyrë me arterosklerozën dhe korrelohet gjithashtu fuqishëm me të gjithë faktorët e njohur të rrezikut koronar për SAK (8,16). Nisur nga këto konsiderata teorike, prania e arterosklerozës ekstrakoronare mund të na ndihmojë për një informacion prognozues në lidhje me pacientët me rrezik të lartë për SAK (23).

Një pjesë e studimeve të mëparshme, kanë përdorur ngjarjet kardiovaskulare për të treguar lidhjen që ekziston mes sklerokalcifikimeve kardiake dhe SAK. Kjo mund të çojë në bias të keqklasifikuar dhe konkluzione të pasakta për arsye se një pjesë e madhe e pacienteve të përfshirë konsideroheshin si koronaropatë vetëm pasi të manifestonin pikëmbërritjet klinike si vdekja kardiake dhe infarkti i miokardit (4, 6, 1). Studime të tjera mëvonshme e kanë provuar këtë lidhje edhe në popullata pacientësh, të cilët i janë nënshtruar koronarografisë (5, 8).

Megjithëse këto studime evidentojnë një lidhje (asosacion) mes sklero-kalcifikimeve multiple kardiake dhe procesit aterosklerotik, akoma nuk dihet me siguri nëse këto gjetje imazherike mund të përdoren si markues të sëmundjes së arterieve koronare në individë asimptomatikë me moshë më të re sesa në studimet e kryera më përpara.

Prezenca dhe sinjifikanca e këtyre sklerokalcifikimeve kardiake në popullatën shqiptare nuk është studiuar dhe përcaktuar më përpara. Popullata jonë është një popullatë relativisht e re dhe pothuaj krejtësisht homogjene, dhe sinjifikanca e sklero-kalcifikimeve kardiovaskulare (AVS, ARC dhe MAC) është krejtësisht e panjohur deri më tani. Në qoftë se mund të gjendet një korrelacion i fortë mes sklerokalcifikimeve kardiovaskulare dhe SAK (11), prania e tyre mund të shërbejë si markues i aterosklerozës koronare bashkekzistuese tek shqiptarët.

Pra, do të ishte me interes të vlerësohej nëse prezenca e kalcifikimeve ekstrakoronare ka vlerë diagnostike për të diskriminuar një grup me rrezik më të lartë për SAK në popullsinë shqiptare.

QËLLIMI I STUDIMIT

- Të evidentohet prezenca e sklerokalcifikimeve kardiake multiple (në rrënjën aortale, valvulën e aortës dhe unazën mitrale) në një popullatë me risk koronar të konsideruar i ulët-mesëm.
- 2) Të evidentohet korrelimi i tyre me prezencën e SAK.
- 3) Të përcaktohet sensitiviteti, specifikiteti, vlera prediktive negative (VPN) dhe vlera prediktive pozitive (VPP) e tyre për të diagnostikuar SAK.

METODA

Popullata jonë e studimit përbehej nga pacientë me risk koronar të konsideruar të ulët-mesëm (Euro-Score 0-10%), të cilët iu nënshtruan Angio CT koronare për indikacione të

ndryshme. Të gjithë këtyre pacientëve, pas plotësimit të formularit lidhur me të dhënat klinike u realizua një ekzaminim paraprak, i plotë, me Ekokardiografi doppler dhe pastaj u realizua angio CT koronare. U mor gjithashtu konsensusi nga çdo pacient për përfshirjen e tij në studim.

Kriteret përjashtuese: U përjashtuan pacientët me sëmundje valvulare reumatizmale, portatorët e protezave valvulare, pacientët me stenozë aorte dhe/ose mitrale, pacientët me sëmundje kardiake kongjenitale dhe endokardit bakterial. Gjithashtu u përjashtuan edhe të gjithë pacientët të diagnostikuar me kolagjenoze, mielome multiple, IRK të njohur dhe/ose nivel kreatinemie $>1.5\text{mg/dl}$, ritëm FA, ekzaminim imazherik (eko dhe/ose skaner) teknikisht suboptimale dhe pacientët me SAK të mëparshme të njohur.


Në studimin u përdor skaneri koronar si surrogat angiografik për prezencën e SAK. Kështu angio CT koronar pozitiv për SAK u konsiderua prezenca e çdo pllake aterosklerotike që realizonte një stenozë $>20\%$ në të paktën një nga enët kryesore koronare, përfshire edhe enët e mëdha diagonale dhe marginale. Ndërsa angio CT koronare me parregullsi murore, të cilat nuk realzonin stenozë $>20\%$, u përjashtuan nga studimi për arsye se në këto raste nuk është e drejtë të diagnostikohet SAK pa evidentimin e pllakës me anën e sondës ekografike intravaskulare (IVUS).

Ekzaminimi ekokardiografik u krye në pozicion decubitus lateral i majtë, me anën një aparati ekokardiografik Vivid 7 General Electric. Tek të gjithë pacientët që kryen eko kardiake u morën pamje në 2-D të valvulës aortale në dritaren parasternale long dhe short-axis duke përdorur gain-in e përshtatshëm, si dhe në dritaren apikale me CW për të matur shpejtësinë maksimale transaortale. Gjithashtu u matën edhe funksioni dhe masa e ventrikulit të majtë (VM) dhe u bënë matje të rrënjës aortale, porcionit sino-tubular dhe segmentit post junkcioni. Të gjitha ekokardiogramat u interpretuan pa qenë në dijeni të të dhënave të pacientëve të rezultuara nga angioskaneri.

Prezenca e sklerokalcifikimeve kardiovaskulare u identifikua ve duke përdorur ekokardiografinë transtorakale si më poshtë: ARC (aortic root calcification) u konsiderua prezente kur muri anterior dhe/ose posterior demonstronte echoreflektancë dhe trashësi të shtuar $>2.4\text{mm}$.

AVC (aortic valve calcification) u përkufizua ekogjeneciteti i shtuar dhe trashja fokale e e sigmoideve të aortës, me praninë e ekove dense, por pa krijuar restriksion gjatë lëvizjes së tyre, duke realizuar një shpejtësi transaortale $<2\text{m/s}$. Trashësia e sigmoideve të aortës u përcaktua prej imazheve ekografike të frizuara në end-diastole, të marra qoftë në short-axis, qoftë në long-axis. Në mënyrë që të kategorizohet më mirë, AVC u klasifikua (sipas Tolstrupit), si e lehtë, e moderuar dhe e rëndë në bazë të trashësisë së matur për çdo kuspis të dhënë, respektivisht $2\text{-}4\text{mm}$, $>4\text{mm}$ dhe $>6\text{mm}$. Çdo kuspis i u vu një numër i caktuar nga 0 deri në 4. Grada 0 dhe 1 u klasifikuan si normale, grada 2 si skleroze e lehtë, grada 3 si skleroze e moderuar dhe grada 4, si sklerozë severe. Numri më i lartë për një kuspis të dhënë ka përcaktuar edhe gradën e krejt AVC. Meqenëse është pothuaj e pamundur të dallohet mes një ekoreflektance të shtuar që e ka origjinën nga një strukturë kardiake e calcifikuar apo sklerotike (fibroze dense, pa calcifikim), ne përdorem termin sklerokalcifikim aortal (AVSC) për të treguar praninë e një ose të dyjave së bashku.

Figura 1. Eko transtorakale, short-axis, ku evidentohen sklerokalcifikimi i rrënjës dhe valvulës aortale



MAC (kalcifikimi i unazës mitrale) u gradua si normal, si i lehtë (kur trashësia matet <5mm), e moderuar (5 deri 10mm), ose shumë e kalçifikuar (>10mm).

Faktorët e rrezikut koronar: Faktorët e rrezikut të analizuar në studimin tone ishin: moshë, gjinia, diabeti, hipertensioni, trashëgimia, hiperkolesterolemia dhe duhanpirja.

Diabeti u konsiderua prezent në qoftë se kishte një histori të diabetit, matja e glicemisë esëll ishte >126mg/dl ose kur pacienti ishte duke marrë insulinë dhe/ose një medikament oral hipoglicemik.

Hipertensioni u konsiderua prezent kur matjet e TA ishin me të mëdha se 140/90mmHg ose kur pacienti ishte duke marrë terapi me antihypertensive.

Hiperkolesterolemia u gjykua prezente kur pacienti ishte nën terapi me hipolipemiantë ose kur përqendrimi plazmatik i kolesterolit ishte >200mg/dL.

Duhanpirja u përkufizua si pirja e një gjysmë ose me shumë pakete cigare në ditë, ose >10 paketave në vit .

Si trashëgimi (hereditet) u përcaktua nëse një nga prindërit ose të afërmit kishin pasur SAK përpara moshës 55 vjeç për burrat dhe 65 vjeç për gratë.

U përdor modeli Euro-SCORE për ndarjen në kategoritë e rrezikut 10-vjeçar për ngjarje kardiovaskulare: <5% u konsiderua rrezik i ulët, 5-10% rrezik i mesëm, >10% rrezik i lartë.

Popullata jonë e studimit, sipas këtij modeli të vlerësimit u konsiderua me rrezik koronar të ulët deri në të mesëm (Score 0-10%).

Tek të gjithë pacientët, sëmundja kardiovaskulare (SKV) u përcaktua në baze të të dhënave në kartelë si prezence e sëmundjes së arterieve koronare, karotide, ose sëmundjes së arterieve periferike.

Sëmundja e Arterieve Koronare (SAK) u përkufizua si : >20% ngushtim i diametrit të lumenit në koronarografi ose angio CT koronar, histori e revaskularizimit koronar, eko-stress dobutaminë pozitive për ishemi, çrregullime të kinetikes segmentare (akinezi dhe/ose diskinezi) në eko kardiake ose dhemb Q -patologjik në EKG.

Sëmundje e arterieve karotide u konsiderua prezente nëse në doplerin karotid zbuloheshin pllaka ose kishte stenoza >15%, në rastin e një angiogramë positive ose në rastin e një endarterektomie karotide të dokumentuar.

Sëmundja periferike vasculare u përkufizua kur indeksi anke-brachial ishte <1, në rastin e një angiogramë positive, ten je aneurizme të aortes abdominale, ose histori të një kirurgjie vasculare periferike.

Analiza statistikore: Studimi ishte i tipit kohort, prospektiv dhe dyfish i verbër. Vlerat numerike të vazhdueshme u shprehën në vlera mesatare dhe në deviacionin standart, kurse variablet diskrete u paraqitën në vlerë absolute dhe përqindje. Krahasimi mes variableve të vazhdueshme u bë me testin e Studentit. Testi chi-katror u përdor për të vlerësuar sinjifikancën e diferencës mes variableve dikotomike. Pavarësia e faktoreve të rrezikut dhe sklerokalcifikimeve kardiake u përcaktua nga analiza e regresionit logjistik. Intervali i konfidencës (CI) dhe odds ratio (OD) janë paraqitur për të gjitha variablet. Variablet e mëposhtme si moshë, gjinia, hipertensioni, diabeti, hiperkolesterolemia , duhanpirja dhe historia familjare u përfshinë në analizën multivariate. Më pas, në mënyrë që vlerësohej nëse sklerokalcifikimet kardiake janë një faktor i pavarur për prezencën e SAK , këto variable u

futën veç e veç në analizë. Për të gjitha testet, vlera e P-së më e vogël se 0.05 u konsiderua statistikisht sinjifikante. E gjithë analiza statistikore u realizua nëpërmjet softwerit SPSS (versioni 19)

REZULTATET

Nga nëntori i vitit 2009 deri maj 2011 u përfshinë në studim 220 individë që realizuan e angio-CT koronar me kontrast, të referuar kryesisht nga mjekët kardiologë por edhe mjekët familjeje për arsye të ndryshme klinike. Tek të gjithë, u plotësua paraprakisht, nga një mjek internist, një pyetësor i përpiluar lidhur me të dhënat demografike, klinike dhe laboratorike.

Nga ky grup, 23 prej tyre u gjykuan nga radiologu që nuk kishin realizuar ekzaminime teknike cilësore për të diagnostikuar me siguri prezencën e SAK nëpërmjet skanerit kardial, ndërsa 42 të tjerë u konsideruan me SAK të mëparshme duke riparë të dhënat e tyre klinike, anamnestike dhe laboratorike nga dosjet e arkivuara.

Pjesa e mbetur prej 155 kishte një moshë mesatare 57+/-11.28 vite, nga këto 109(70%) ishin meshkuj dhe 46 (30%) femra.

Nga pyetësorët e mbledhur dhe të dhënat e kartelave rezultoi që: 67% e individëve ishin të diagnostikuar me hipertension, 16% me diabet mellitus, 37% ishin duhanpirës, 41% obez dhe 53% kishin hiperkolesterolemi.

Popullata u nda në dy grupe kryesore: grupi me AVSC (+) dhe grupi AVSC (-).

Grup i studimit, u konsiderua grupi prej 91(58.7%) individësh që kishin prezencë të sklerokalcifikimeve aortale(AVSC +) të dedukuara nëpërmjet ekokardiografisë. Ndërsa 64 (41.3%) individë, të cilët nuk patën sklerokalcifikime aortale prezente, u konsideruan si grupi i kontrollit.

Ndërmjet grupit të studimit dhe atij të kontrollit nuk rezultuan ndryshime sinjifikante për sa i përket moshës dhe gjinisë, pra të dy grupet ishin homogjene.

Gjithashtu nuk pati ndryshime sinjifikante midis dy grupeve edhe për sa u përket faktorëve të tjerë tradicionalë të rrezikut koronar, përveç hipertensionit dhe trashëgimisë që ishin me prevalente në grupin me sklero-kalcifikime prezente, repektivisht 72.5 vs 52.4%, me $p < 0.011$ dhe 33vs18%, me $p = 0.043$.

Prevalenca e kalcifikimit të unazës mitrale (MAC), rezultoi më e lartë në grupin me AVSC (+) se në atë me AVSC (-) (28% vs 3.2%), me $p < 0.001$ (tabela 1)


Tabela 1. Karakteristikat e pacientëve me dhe pa sklero-kalcifikime të valvulës aortale

	AVSC (+) n = 91 (58,7%)	AVSC(-) n = 64 (41,3%)	
Gjinia			
F	28 (30,1)	19 (31,2)	0,936
M	63 (69,2)	44 (69,8)	
SAK	69 (75,8)	12 (19,0)	< 0,001
HTA	66 (72,5)	33 (52,4)	0,011
Diabet	16 (17,6)	5 (7,9)	0,087
Duhan	36 (39,6)	16 (26,2)	0,091
Obezitet	38 (42,2)	25 (39,7)	0,754
Trashëgimia	30 (33,0)	11 (18,0)	0,043
MAC	64 (28,1)	2 (3,2)	< 0,001
Kolesteroli	59 (71,1)	37 (63,8)	0,465
LDL	47 (58,8)	30 (56,6)	0,473
Trigliceride	50 (60,2)	33 (56,9)	0,411

Në grupin e studimit prej 91 pacientësh, 69 prej tyre rezultuan pozitiv për SAK në angio CT koronar, kurse në grupin e kontrollit, vetëm në 12 nga 64 pacientët u diagnostikuan

me SAK . Pra, pacientët me sklerokalcifikime kardiake prezente patën një prevalencë të të larte të SAK sesa ato pa sklerokalcifikime(75.8% vs 19%, me një $p<0.001$). Përmes koeficientit të korrelacionit të Kendal's u pa se kishte një lidhje shumë të fuqishme mes SAK dhe AVSC ($p<0.001$) si dhe mes AVSC dhe MAC ($p<0.001$),grafiku 1.

Grafiku 1. Prevalenca e AVSC në pacientët me dhe pa SAK prezent



Kur kohorti u nda sipas prezences se aterosklerozes, ne gjetem qe 81 paciente kishin semundje te arterieve koronare (SAK) dhe 74 paciente te tjere kishin arterie koronare krejtesisht normale ne CT angio-skaner. Nga grupi prej 81 pacientesh me SAK, 69 prej tyre kishin prezence te sklero-kalcifikimit aortal (AVSC), krahasuar me vetem 22 paciente ne grupin pa SAK (85,2% versus 30.1%, me $p<0.001$). Gjithashtu, hipertensionioni (73.2% vs 53.4%, me $p=0.011$), dilatacioni i rrenjes aortale (23.2% vs 13.7, me $p=0.04$) si dhe calcifikimi i unazes mitrale (23.2% vs 11.3%, me $p=0.055$) u gjeten sinjifikativisht me prevalente ne grupin me SAK.

Nga analiza multivariate, pasi u futën nje nga nje të gjithë faktorët e njohur të rrezikut koronar, rezultoi që vetëm mosha dhe prezenca e sklero-kalcifikimeve aortale ishin parakallzues të pavarur të Sëmundjes së Arterieve Koronare (SAK).

Pra, nga analiza e regresioni logjistik u pa që prezenca e AVSC lidhej fort dhe sinjifikativisht me prezencën e SAK (OR=6.637;95% CI 2,5-7,464; $p<0.001$).

Gjithashtu u pa që edhe mosha kishte lidhje të fortë me praninë e SAK. Për çdo rritje të moshës me 1 vit, rreziku për të pasur SAK rritej me 2.4 herë (CI 0.89-0.99). (shiko tab.2)

Tabela2. Rezultatet e analizës multivariate të lidhjes së SAK me faktorët e tjerë klinikë dhe ekokardiografike.

	OD	CI95 %	p-value
MAC	0,64	0,20 2,06	0,45
AVSC	7,52	2,59 21,86	0,00
mosha (1 vit)	0,95	0,90 1,00	0,03
HTA	2,41	0,88 6,58	0,09
diabet	0,38	0,11 1,37	0,14
duhan	1,23	0,45 3,32	0,69
obezitet	0,59	0,23 1,47	0,26
trashëgimi	0,89	0,32 2,52	0,83
LDL-Kolest	0,89	0,35 2,28	0,81

Pra pacientët me sklerokalcifikime të valvulës aortale prezente kanë rreth pothuaj 7 herë rrezik më të rritur për të pasur SAK se ato pa prezencën e këtyre calcifikimeve.

Prezenca e sklerokalcifikimeve të valvules aortale në 155 pacientët e popullatës sonë e identifikonte praninë e SAK me një sensitivitet prej 85%, specificitet 70%, vlerë prediktive pozitive 76% dhe vlerë prediktive negative 81%.

DISKUTIMI

Në studimin tonë ne gjetëm që subjektet me sklero-kalcifikim të valvulës aortale kishin mundësi më të madhe për të pasur SAK se sa ato pa këto sklero-kalcifikime, edhe pas axhustimit për të gjithë faktorët e njohur të rrezikut, përveç moshës.

Ka një evidencë gjithmonë në rritje nga studimet, që prezenca e sklero- kalcifikimeve vaskulare dhe kardiake multiple, duke u bashkuar edhe me faktorët e tjerë të njohur të rrezikut, mund të shërbejë si paralajmërues i prezencës sinjifikante të sëmundjeve kardiovaskulare (SAKV) (6, 7, 8).

Studime klinike dhe imuno-histologjike tregojnë që këto kalcifikime kardio-vaskulare nuk janë gjetje të thjeshta beninje, por janë pjesë e një procesi të ngjashëm me aterosklerozën dhe shoqërohen me një vdekshmëri dhe sëmundshmëri të rritur sidomos tek moshat e vjetra (4, 16). Ato korrelojnë fuqishëm me të gjithë faktorët e rrezikut për SAKV si: moshë, gjinia, hipertensioni, duhani, hiperlipidemia dhe diabeti, duke qenë sigurisht edhe manifestim i njëkohshëm i saj (5, 6, 8).

AVCS konsiderohet si një proces “atherosclerosis like” që involvon valvulën dhe/ose rrënjën e aortës, kështu që procesi patologjik që ndodh në arteriet koronare mund të identifikohet lehtësisht në të, nëpërmjet metodave joinvazive imazherike (5,9,11). Studime të hershme klinike kanë treguar se prezenca e sklerozës së valvulës aortale shoqërohet me një rritje të rrezikut qoftë për vdekje nga shkaqe kardio-vaskulare, qoftë për një infarkt miokardi të ri (4,16).

Për shembull, Otto dhe bp, në një studim me popullatë mjaft të gjerë, gjeti që prezenca e AVCS shoqërohej me një rritje pothuaj prej 50% të rrezikut për vdekje dhe infarkt miokardi edhe pas axhustimit për moshë, gjini, SAK të njohur dhe faktorë të tjerë klinikë (4).

Mbështetje të mëtejshme për lidhjen që ekziston mes sklerokalcifikimit aortal dhe SAK vjen edhe prej studimeve hispatologjike. Është provuar që lezionet degjenerative të hershme të valvulës aortale kanë disa ngjashmëri me atë të aterosklerozës, përfshirë këtu depozitimim e lipideve dhe infiltrimin qelizor inflamator të makrofageve (13)

Cardiovascular Health Study ishte një studim prospektiv prej 5888 gra dhe burra të konsideruar të shëndoshe, me moshe >65 vjeç, dhe një ndjekje mesatare prej 5 vitesh. Mortaliteti i përgjithshëm dhe ai kardio-vaskular tek subjektet me skleroze të aortës ishte pothuaj dyfishi i subjekteve me valvul aortale normale. Subjektet me skleroze të aortës paraqitën një rrezik të pavarur më të lartë për vdekje nga çdo shkak, si edhe për vdekje kardio-vaskulare edhe pas axhustimit për të gjitha variabellet baze (17). Skleroza e aortës ishte e shoqëruar me një risk relativ për infarkt miokardi prej 1.40(95%CI 1.07-1.83). Pati gjithashtu edhe një prirje për një risk më të rritur për angina pectoris dhe insult (stroke) tek pacientët me evidencë të sklerozës së aortës.

Studime të mëvonshme kanë treguar një lidhje të fortë mes kalcifikimit të valvulës aortale (AVC) të zbuluar me ekokardiografi transtorakale dhe SAK së rëndësishme në pacientë që janë nënshtruar koronarografi (5, 8). Por këto pacientë ndryshonin mjaft nga popullata e studimit tonë për arsye se ato në përgjithësi kishin një risk koronar të konsideruar të lartë. Kështu që është surprizues fakti që rritja e rrezikut që shoqëron sklerokalcifikimet multiple kardiake është e dukshme edhe tek subjektet pa evidence të SAK klinike dhe të konsideruar me rrezik të ulët-mesëm për SAK, siç është popullata jonë e marrë në studim.

Arsyeja pse skleroza e aortës shoqërohet me rritje të ngjarjeve kardio-vaskulare është e panjohur, por mund të shpjegohet duke pasur parasysh që skleroza aortale është një shfaqje objektive e të gjithë formave të sëmundjes kardiovaskulare, veçanërisht asaj koronare (SAK), sepse skleroza e aortës dhe SAKV ndajnë edhe të njëjtët faktorë rreziku dhe të njëjtin mekanizëm.

Kalcifikimi i unazës mitrale (MAC) është gjetur, gjithashtu, si një prediktor i pavarur i stroke dhe një markues i rëndësishëm për aterosklerozën e arterieve karotide(6, 9). Adler dhe

bp. raportuan një korrelim mjaft të rëndësishëm edhe të prezencës së kalcifikimit të unazës mitrale (MAC) me arterosklerozën e sistemit vaskular, kryesisht atij cerebral (6, 14). Në studimin tonë u pa një prevalencë sinjifikativisht më e madhe e MAC-së në grupin me sklerokalcifikime të valvulës aortale prezente, por u gjet vetëm një lidhje e dobët e MAC me praninë e SAK ($p=0.059$; CI 0.172-0.002). Ndersa korrelacioni i MAC me aterosklerozën karotide nuk u studiua, për shkak se nuk ishte objektiv i studimit tonë.

Shumë investigatorë kanë studiuar faktorët e rrezikut koronar dhe shoqërimin e tyre me kalcifikimet kardiake multiple, qoftë aortale, qoftë mitrale. Moshë, seksi, hipertensioni, hiperkolesterolemia, diabeti, indeksi i masës i ulur, duhanpirja veç e veç ose të marra së bashku, kanë treguar që mund të shoqërohen me sklero-kalcifikimet aortale dhe kjo lidhje e tyre varion sipas studimeve (16, 17, 21, 24).

Aronow dhe bp. gjeti një shoqërim mes kalcifikimit aortal dhe HTA, diabetit, hiperkolesterolemisë. në Helsinki Aging Study, HTA, mosha dhe indeksi i masës i ulur ishin të lidhur fuqimisht me prezencën e sklero-kalcifikimeve aortale. Por në shumicën e studimeve kanë qenë veçanërisht mosha dhe hipertensioni që kanë treguar një shoqërim të rëndësishëm me kalcifikimet e lartpërmendura (17, 21, 24).

Në studimin tonë nuk pati dallime statistikisht sinjifikante për sa i përket moshës dhe gjinisë mes grupit të studimit dhe atij të kontrollit, në dallim nga dy studime të tjera, të cilat gjeten një prevalencë më të madhe të seksit femër si dhe moshës <65 vjeç në grupin me AVSC pozitive (5, 26).

Fakti që popullata jonë e studimit kishte një moshë relativisht të re (57 ± 11.28 vite) të bën të arsyetosh që sklerokalcifikimet e gjetura në valvulën aortale nuk mund të shpjegohen me një proces degjenerativ siç ndodh tek të moshuarit. Kjo mbështet hipotezën tonë që të tilla sklerokalcifikime nuk janë gjetje thjesht beninje por duhen konsideruar si një epifenomen i aterosklerozës së gjeneralizuar.

Nuk pati diferencë statistikisht sinjifikante mes grupit AVSC(+) dhe AVSC (-) as për sa i përket faktorëve të tjerë të njohur të rrezikut koronar, përveç hipertensionit dhe trashëgimisë që ishin më të larta në grupin e studimit. Kjo lidhje mes HTA dhe sklerozës aortale është hasur edhe në mjaft studime të tjera duke nënvizuar faktin e ngjashmërisë mes dy proceseve (21, 24).

Pyetjet e kryera, Përgjigjet e sakta, dhe numri i mjekëve me përgjigje të sakta

Nr .	Pyetjet	Përgjigja e saktë	Frekuenca	Frekuenca ne %
1	Nutrienti që ndihmon parandalimin e trombozave	yndyrnat omega-3	40	48,2
2	Nutrient që rrit humbjen e kalciumit në organizem	proteinat	13	15,7
3	Tipi i fibrave që ndikon në uljen e kolesterolit në gjak	fibrat e tretshme	31	37,3
4	Vaji i ullirit përbehet në pjesën më të madhe nga	yndyrna të pangopura mono	30	36,1
5	Krahasuar me yndyrnat e përpunuara yndyrnat e hidrogjenuara përmbajnë	më shumë yndyrna trans	14	16,9

6	Nutrienti me efekt mbrojtës ngaj hipertensionit	kaliumi	74	89,2
7	Nese nje person konsumon 10 tableta multivitamina /dite, cili eshte nutrienti me me pak gjasa per te shkaktuar toksicitet	vitamina E	37	44,6
8	Burimi ushqimor me permbajtje me te larte vitamine B12 eshte	mishi	30	36,1
9	Cila substance rrit nivelin e HDL-ve ne gjak	alkoli	32	38,6
10	Rekomandimet shqiptare per konsumin ditor te yndyrave ne dite jane	nen 30% te energjise ditore	29	34,9
11	Cila kategori ushqimesh besohet te kete efekt parandalues mbi disa lloj kanceresh	frutat dhe perimet	57	68,7
12	Sasia e kalorive ne 1 gram yndyre eshte	9 kkal	48	57,8
13	Cili prej elementeve me poshte nuk eshte nje antioksidant	zinku	46	55,4
14	Alkolistet vuajne zakonisht nga mungesa e ketij nutrienti	vitamina B1	50	60,2
15	Cili eshte nutrienti qe lidhet ngushtesisht me parandalimin e defektit te tubit neural	folatet	26	30,8
16	Dietat e shpejta jane shpesh te suksesshme ne uljen e peshes pasi	humbin uje nga organizmi	22	26,5
17	Ne pergjithesi rekomandimet dietetike kane per qellim	ruajtjen e shendetit publik	54	65,1
18	Rekomandimet shqiptare per perdorimin ditor te kripes se jodizuar jane	≥ se 6 gr kripe te jodizuar / dite	44	53

Pjesa më e madhe e mjekëve (rreth 80% e rasteve) dhanë rreth 7-12 përgjigje të sakta. Për çdo pesë mjek të intervistuar, 1 mjek paraqitet me njohuri shumë të mangëta (2-6 përgjigje të sakta) ndërsa vetëm një mjek arrin të japë 13 përgjigje të sakta nga 18 të tilla.
Figura 3.


Numri i mjekëve sipas numrit të përgjigjeve të sakta të dhëna



Mjekët janë përgjithësisht në dijeni të informacionit lidhur me njohuri bazë si: nutrientët me efekt mbrojtës ndaj hipertensionit (89.2%); veprimin parandalues të frutave - perimeve kundër kancerit (68.7%); mbi antioksidantët (55.4%), rolin e rekomandimeve dietetike në ruajtjen e shëndetit publik (65.1%); vlerën energjetike të yndyrave (57.8%); rekomandimet ushqimore për popullatën shqiptare për sasinë e përdorimit të kripës së jodizuar (53%), etj

Figura 4.


Njohuri të mira të mjekëve lidhur me



Por ata reflektojnë njohuri të pakta në tema të tjera të rëndësishme si: relacionin mes marrjes së tepërt proteinike dhe humbjes së kalciumit (15.7%); ndryshimin mes yndyrnave të paperpunuara dhe yndyrnave të hidrogjenuara (16.9%); rënies drastike në peshë nga dietat e shpejta si pasojë e uljes së ujit nga organizmi (26.5%); rolin shumë të rëndësishëm të folateve në parandalimin e defekteve të lindura të tubit neural (30.8%); llojin e fibrave dietetike të dobishme në uljen e kolesterolit në gjak (37.3%); rolin e alkoolit në rritjen e HDL-ve në gjak (38.6%); apo cilet nutrientë ndihmojnë në parandalimin e trombozës (48.2%).

Figura 5.


Njohuritë e pakta të mjekëve në lidhje me



Rreth 88% e mjekëve mendojnë se kanë njohuri të pakta në fushën e ushqyerjes, ndërsa vetëm 12% e tyre pohojnë për njohuri shumë të mira.

Figura 6.

Njohuritë e mjekëve në fushën e ushqyerjes




Vihet re një boshllëk i madh përsa i përket aktiviteteve lidhur me përditësimin e njohurive për ushqyerje të shëndetshme. Kjo korrespondon edhe me të dhënat e raportuara më lart lidhur me autostimën e mjekëve mbi njohuritë e tyre në këtë fushë.

Megjithatë harku i kohës për pyetjen është shumë i gjatë (10 vjet) vetëm 15.7% e mjekëve pohojnë të kenë marrë pjesë në një kurs trajnimi mbi ushqyerjen gjatë kësaj periudhe.

Figura 7.

Pjesëmarrja e vet-raportuar e mjekëve në kurse trajnimi mbi ushqyerjen



PËFUNDIME

- Mjekët e familjes në Tiranë nuk kanë njohuritë e nevojshme për vlerësimin dhe ndërhyrjet dietetike për problemet e ndryshme të lidhura me nutricionin në praktikën klinike.
- Këto rezultate mbështesin nevojën që mjekët kanë, për më shumë trajnim në fushën e ushqyerjes si dhe theksojnë domosdoshmërinë e përmirësimit të kurrikulës së Ushqyerjes në Fakultetin e Mjekësisë dhe Fakultetin e Infermierisë si në nivel Universitar edhe atë Pasuniversitar.

Mirënjohje: Për të gjithë ata mjekë që, nëpërmjet kohës që na kushtuan dhe bashkëpunimit të tyre në plotësimin e pyetësorit nutricional, bënë të mundur realizimin e këtij studimi.

BIBLIOGRAFIA

1. Norman J. Temple, Survey of Nutrition Knowledge of Canadian Physicians Ph Athabasca University, Alberta, CANADA Journal of the American College of Nutrition, Vol. 18, No. 1, 26–29 (1999).
2. Khalid S. Al-Numair Nutrition Knowledge of Primary Care Physicians in Saudi Arabia Pakistan Journal of Nutrition 3 (6): 344-347, 2004
3. Heywood P, Wootton SA: Nutritional knowledge and attitudes towards nutrition education in medical students at Southampton, University Medical School. (Abstract). Proc Nutr Soc 51:67A, 1992.
4. Mlodinow, S.G. and E. Barrett-Connor, 1989. Physicians Nutritional and medical students knowledge of nutrition. Acad.Med., 64: 105-106.
5. Temple, N.J., 1999. Survey of Nutrition knowledge of Canadian physicians. J. Am. Coll. Nutr., 18: 26-29.
6. Kushner RF: Barriers to providing nutrition counselling by physicians: survey of primary care practitioners. Prev Med 24:546–552, 1995.

SUMMARY

NUTRITION KNOWLEDGE OF PRIMARY CARE PHYSICIANS IN TIRANA, ALBANIA

Jolanda Hyska¹, Arben Luzati¹, Entela Bushi¹, Julinda Bizhga (Hroni)²

¹Instituti i Shëndetit Publik “Hulo Hajdëri“, Tiranë, Shqipëri
Departamenti Mjedisi dhe Shëndeti ,Tiranë, Shqipëri

²Poliklinika e Lagjes Nr.1, Konsultori i Femijës, Tiranë, Shqipëri

Objectives: Previous reports have indicated that physicians generally have little training in nutrition and a poor knowledge of the subject especially on the diet counseling particularly in patients with chronic non-communicable diseases. A survey was carried out to determine the nutrition knowledge of physicians working in Primary Health care Centers in Tirana. **Methods:** A questionnaire adapted from the Temple 1999, consisting of 18 multiple choice questions on nutrition knowledge, is used to assess knowledge of family doctors, working at the Primary health care centers. **Results:** Completed questionnaires were received from 58.4% (83 of 142 eligible physicians). The average correct response was 45.8%. 88% of physicians reported that they have little knowledge in the field of nutrition, while only 15.7% of them claim to have participated in training courses on nutrition during the last 10 years.

Conclusions: Family physicians in Tirana does not have the knowledge necessary for evaluation and dietary interventions for various problems related to nutrition in clinical practice. These results support other data that physicians need more training in the field of nutrition.

Key words: Nutrition knowledges , family physicians, Tirana

MEDICUS

PUNIM BURIMOR SHKENCOR / ORIGINAL SCIENTIFIC PAPER

SHËNDETËSI PUBLIKE

ZHURMA NGA TRAFIKU RRUGOR DHE ÇRREGULLIMET E GJUMIT, NË 15 STACIONET E MONITORIMIT TË QYTETIT TË TIRANËS

Arta Ago¹, Ylli Sarolli², Agim Shehi¹, Jolanda Hyska¹

¹Instituti i Shendetit Publik “ Hulo Hajderi” Tiranë, Shqipëri
Departamenti Mjedisi dhe Shëndeti, Tiranë, Shqipëri

²Fakulteti i Mjekesise, Departamenti i Shëndetit Publik, Tiranë, Shqipëri



Arta Ago, mjeke e shendetit publik
Rr. ”Aleksander Moisiu”, 80, Tiranë, Shqipëri
e-mail: artaago@yahoo.com

REZYME: **Hyrje:** Zhurma nga trafiku rrugor, e cila është vazhdimisht duke u rritur, është konsideruar të jetë një problem i rëndësishëm i shëndetit mjedisor. **Qëllimi:** Qëllimi i studimit ishte të vlerësohej shkalla e çrregullimeve të gjumit, lidhur me zhurmat e trafikut rrugor, në zonat rezidenciale të komunitetit urban të qytetit të Tiranës. **Materiali dhe metoda:** Ky studim u krye nga Mars 2008 – Janar 2009 dhe ishte i tipit transversal. Metoda e kampionimit ishte ajo e kampionimit të stratifikuar në klastera. Për gjithë territorin e qytetit të Tiranës u përzgjedhën 15 klastera (në 15 pikat e monitorimit) dhe për çdo klastër 20 familje. Studimi u bazua në një pyetësor i cili ishte anonim. Për hedhjen dhe përpunimin e të dhënave u përdorën programet kompjuterike Exel- 2007 dhe SPSS 16. **Rezultatet:** Në studim morën pjesë 275 familje, ku në të cilat banonin 1105 individë. Rezultatet treguan se, 50.1% e popullatës urbane të qytetit të Tiranës deklarojnë se kanë çrregullime të gjumit, të shkaktuara nga zhurmat e trafikut rrugor. Çrregullimet e gjumit janë sinjifikante me përgjigjet e popullatës urbane të qytetit të Tiranës, e cila është e ekspozuar nga trafiku rrugor, në nivele zhurmash të larta 74.9 dB(A) për ditën dhe 67.7 dB(A) për natën. **Përfundimi:** Studimi ynë tregoi se burimi kryesor i çrregullimeve të gjumit ishte zhurma nga trafiku rrugor.

Fjalë bosht: Çrregullime të gjumit, trafik rrugor, dBA

Medicus 2012, Vol. XVII (1):

HYRJE

Ndotja akustike është duke u rritur gjithnjë e më shumë dhe duke u shfaqur si një rrezik mjedisor “i dukshëm”. Efektet e zhurmave grumbullohen tek individit si ngjarje zhurme, me efekte negative në dëgjim, psikikë dhe mënyrën e jetesës.

Ndotja zanore është veçanërisht e rëndë në vendet në zhvillim. Ajo i detyrohet kryesisht trafikut rrugor dhe në zonat më dense të trafikut rrugor nivelet e presionit akustik gjatë 24 orëve mund të arrijnë 75-80 dB(A) (11)

Ndryshe nga shumë probleme të tjera të mjedisit, ndotja nga zhurma vazhdon të evoluojë dhe krijojë një numër ankesash në rritje të asaj pjese të individëve që janë të ekspozuar. Rritja e ndotjes zanore është e pasuportueshme sepse ajo ka efekte negative mbi shëndetin, në të njëjtën kohë direkte dhe të grumbulluara.

Në Bashkimin Europian rreth 40% e popullsisë janë të ekspozuar ndaj zhurmave të trafikut urban, ku vlera e presionit akustik është mbi 55 dB(A) gjatë ditës. Gjatë natës, mbi 30 % e popullsisë janë të ekspozuar në nivele akustike që i kalojnë 55 dB(A), që përfshin gjumin e tyre.(11) Kjo paraqitje nuk është e njëjtë kudo në Europë. Në disa vende, më shumë se gjysma e popullsisë është e ekspozuar dhe në disa vende të tjera më pak se 10%. Kur niveli i zhurmave është rreth 65 dBA, gjumi fillon të bëhet problem shqetësues dhe shumica e popullatës fillon të bezdiset.(4) Në këtë rast, zhurma në komunitet, bëhet një problem shëndetësor i vërtetë.

Edhe në vendin tonë, zhurma është një nga rreziqet mjedisore, që vazhdon të evoluojë dhe mund të krijojë probleme tek ajo pjesë e personave që janë të ekspozuar.

Veçanërisht, ndotja nga trafiku rrugor është bërë problematik dhe mjaft shqetësues.

ISHP realizon monitorimin e zhurmave urbane në qendrat urbane, sipas metodologjisë së përcaktuar nga OBSH. Në të gjitha qytetet rezulton nivel i lartë zhurme nga trafiku rrugor.

Qyteti me nivel zhurmash më të lartë është Tirana, e cila ka 15 pika të monitorimit të zhurmave urbane. Në të gjitha pikat e monitorimit kanë rezultuar nivele të larta zhurmash që variojnë nga 64.9 dB(A) – 74.9 dB(A) gjatë ditës, ku vlera normë është 55 dB(A) dhe nivele zhurmash nga 49.6 dB(A) - 67.7dB(A) gjatë natës, ku vlera normë është 35 dB(A) (tab.1 dhe tab.2).

Tabela1. LAeq/D^a dhe LAeq/N□ , për të gjitha stacionet e monitorimit të qytetit të Tiranës, nga viti 2005-2008.

Pikate Monitorimit	2005		2006		2007		2008	
	LAeq/ D	LAeq/ N	LAeq/ D	LAeq/ N	LAeq/ D	LAeq/ N	LAeq/ D	LAeq/ N
Skënderbeu	69,8	61,9	72	57,0	69	56,0	71,8	61,5
Partizani i Panjohur	73,1	58,9	71	55,0	69	54,0	70,4	59,1
Stacioni i Trenit	73,3	58,4	74	54,0	70	55,0	72,2	61,4
Laprakë	73,8	60,2	73	58,0	72	57,0	74,4	63,6
Kryq. 21 Dhjetori	71,9	64,6	74	65,0	74	65,0	70,6	65,9
Kryq. Vasil Shanto	72,3	63,2	74	63,0	74	63,0	71,9	67,7
Ish Blloku (B.A.)	71,4	61,2	70	62,0	70	62,0	64,9	59,3
Pall. Kongreseve	66,3	51,1	68	55,0	68	55,0	65,3	56,9
Rr Elbasanit	71,6	60,7	71	61,0	71	61,0	74,9	64,7
Kryq. Farmacia 10	72,3	56,6	73	60,0	73	60,0	71,4	58,1
Kryq Drejtori Policisë	66,3	49,6	69	54,0	74	54,0	- □	-
Përb Stad. Dinamo	68,4	57,2	69	56,0	71	55,0	-	-
Shkollë Bashkuar	70,1	64,4	72	57,0	72	57,0	-	-
Shkolla 11 Janari	69,7	61,6	70	54,0	73	58,0	-	-
Kryq Selvia	72,2	72,2	71	57,0	71	56,0	-	-

Shënim:^a LAeq/D është niveli i vazhduar ekuivalent i presionit akustik të ponderuar (A0) gjatë ditës.

- LAeq/N është niveli i vazhduar ekuivalent i presionit akustik të ponderuar (A0 gjatë natës.
- Në vitin 2008 në 5 pika monitorimi nuk është kryer monitorimi për shkaqe financiare.

Duke parë këtë situatë, ishte e domosdoshme dhe e nevojshme të realizohej një studim për ndikimin e këtyre niveleve në popullatën e ekspozuar.

QËLLIMI

Studimi kishte për qëllim : vlerësimin e shkallës së çrregullimeve të gjumit në popullatën e qytetit të Tiranës, nga zhurmat e trafikut rrugor.

MATERIALI DHE METODA E PUNËS

Përcaktimi i prevalencës së çrregullimeve të gjumit së popullatës, nga zhurmat e trafikut rrugor, kërkoi realizimin e një studimi transversal të një kampioni përfaqësues të popullatës së Tiranës. Studimi u krye në periudhën Mars 2008-Janar 2009.

Metoda e kampionimit e përdorur ishte ajo e kampionimit të stratifikuar në klastera. Në qytetin e Tiranës jetojnë rreth 556 mijë banorë (3)- INSTAT. Në studim u përfshinë 300 familje. Për gjithë territorin e qytetit të Tiranës janë zgjedhur 15 klastra (në 15 pikat e monitorimit) dhe për çdo klaster 20 familje. Përzgjedhja e 20 familjeve u bë pranë kryqëzimeve dhe të shpërndara në 4 drejtimet. Në çdo drejtim u përzgjedhën 4 familje, në mënyrë të rastësishme me strukturë dhe kushte jetese banimi heterogjene.

Stacioni i monitorimit “Skënderbeu” nuk u mor në konsideratë, pasi përreth saj nuk ka apartamente banimi. Pra, pjesëmarrja paraprake ishte 280 familje ose 93%. Nga 280 familjet, 5 prej tyre nuk pranuan të merrnin pjesë në studimin tonë, për arsye subjektive nga ana e tyre. Pra, në studim u përfshinë 275 familje duke marrë një përqindje faktike 91% dhe numri final i kampionimit konsistoi në 275 familje. Pyetësori u plotësua nga 1 person i familjes së përzgjedhur, me moshë mbi 18 vjeç (i aftë për tu përgjigjur pyetjeve të pyetësorit). Mbledhja e informacionit u bë me anë të intervistave të strukturuar më parë, ku intervistuesi i drejtonte pyetjet intervistuesëve dhe plotësonte pyetësorët. Në plotësimin e pyetësorit u ruajt anonimat i individit.

Pjesa e parë e pyetësorit përmbante informacionin mbi të dhënat social-demografike (moshë, gjinia, arsimi, punësimi, periudha e banimit), tipi i apartamentit dhe numri i anëtarëve të familjes. *Pjesa e dytë* përmbante të dhënat mbi burimet e zhurmave nga mjedisi i jashtëm i banesës. *Pjesa e tretë* përmbante të dhëna mbi burimet e zhurmave nga mjedisi i brendshëm i banesës. *Pjesa e katërt* përmbante pyetje lidhur me problemet e çrregullimit të gjumit (vështirësi në zënie e gjumit, koha e nevojshme për të zënë gjumi, përdorimin e pilulave për gjumë,etj). *Pjesa e pestë* përmbante pyetje mbi njohuritë e banorëve mbi zhurmat dhe efektet në shëndet (përgjigjet te hapura).

Për hedhjen dhe përpunimin e të dhënave u përdorën programet kompjuterike Exel- 2007 dhe SPSS 16.

REZULTATET

Në studim morën pjesë 275 familje, në të cilat banojnë 1105 individë gjithsej.

Tabela 2. Përqindja e raportuar, e shpërndarë në grupe të ndryshme

		Numri	Përqindja %
Gjinia	Mashkull	100	36.3
	Femër	175	63.6
Mosha	18-30 vjeç	51	18.5

	30-50 vjeç	169	61.4
	mbi 50 vjeç	55	20
Arsimimi	8- vjeçare	57	20.7
	E Mesme	160	58.1
	E Lartë	48	17.4
	Pasuniversitare	10	3.6
Punësimi	punësuar	180	65.4
	papunë	95	34.5
Lloji banesës	Shtëpi përdhese	3	1
	Pallat shumëkatësh	272	98.9
Koha e qëndrimit	më pak se 1 vit	1	0.3
	1-5 vjet	115	41.8
	më shumë se 5 vjet	159	57.8
Dhomat me dritare nga rruga	Salloni	113	41
	Dhoma e fëmijëve	24	8.7
	Dhoma e gjumit	138	50.1

Në tab. 2 tregohet përqindja e raportimeve nga banorët, e shpërndarë kjo sipas karakteristikave social-demografike (gjinia, moshë, arsimimi, punësimi, koha e qëndrimit në banesë), llojin e banesës dhe dhomat që kanë dritaret nga rruga. Ajo që duhet të përmendet është se, 57.8% e banorëve jetojnë në këto banesa për më shumë se 5 vjet.

Pra, për më shumë se 5 vjet këta banorë janë në ndikimin e vazhdueshëm të niveleve të larta të zhurmave nga trafiku rrugor!


50.1% raportojnë se dritaret e dhomave të gjumit si dhe 41% dritaret e sallonit, i kanë me pamje nga rruga, variabla këto që ndikojnë në çrregullimin e gjumit.

Rezultatet në lidhje me zhurmat nga burimet e jashtme dhe të brendshme të banesës.

Nga studimi rezultoi se 69.8% e banorëve deklaruan se niveli i zhurmave në rrugë është “shumë i lartë” dhe 47.6% deklaruan se niveli i zhurmave brenda në shtëpitë e tyre ishte “i lartë” dhe 45.4% “mesatar” (Graf.1).

Pra, siç shihet, banorët jetojnë në nivele zhurmash të larta çdo ditë dhe në mënyrë të vazhdueshme.


Graf.1. Frekuencat relative të përgjigjeve subjektive të banorëve, në lidhje me nivelin e zhurmave në rrugë dhe në shtëpi (%).



Nëse do të referohemi variablit “*tipi i burimit*”, duket qartë se, përqindjen më të lartë të ndikimit në bezdisjen e popullatës, e zënë makinat me 56.3% si dhe boritë e makinave me 28%. Duhet theksuar se 2.9% e banorëve, ndodhen nën ndikimin e zhurmave të shkaktuar nga diskotekat/pub-et, por nëse do ta shqyrtonim në veçanti pikën e monitorimit “Ish Blloku” 45 % e


banorëve janë nën ndikimin e zhurmave të shkaktuara nga ky tip burimi, e cila ndikon ndjeshëm në parametrat e gjumit (Graf.2).

Graf. 2. Frekuencat relative të përgjigjeve subjektive, në lidhje me tipin e burimit të zhurmave jashtë banesës (%).




Nga përgjigjet subjektive të banorëve, rezultoi se 49.5% e tyre ndjenin zhurma brenda banesës së tyre. Burimi kryesor i zhurmave brenda banesës ishte 29.8% nga trafiku, 16.4% nga pajisjet shtëpiake (gjeneratori, kondicioneri, ventilatori) dhe 3.3% vinin nga fqinjët (muzika e lartë, e folur me zë të lartë, punë të ndryshme). Në këtë rast ia vlen të theksohet që edhe zhurma me frekuencë të ulët, shkaktuar p.sh. nga sistemet e ventilimit, mund të dëmtojë qetësinë dhe gjumin në nivele akustike të ulta. (Graf.3.)

Graf.3. Frekuencat relative të përgjigjeve subjektive, në lidhje me tipin e burimit të zhurmave brenda banesës (%).



Në Graf.4. do të vëmë re se 52.3% deklarojnë se niveli më i lartë i zhurmave nga trafiku rrugor është në mëngjes, ndërkohë që këto nivele zhurme bëhen më bezdisëse dhe më shqetësuese në darkë (këtë e deklarojnë 50.1% e banorëve).


Graf.4. Frekuencat relative të përgjigjeve subjektive, përsa i përket ndikimit të zhurmave në vartësi të periudhës së kohës (%).



Rezultatet e studimit në lidhje me çrregullimet e gjumit.


Studimi ynë tregoi se, 50.1 % e banorëve kanë çrregullime të gjumit, e cila është rrjedhojë e rëndësishme e zhurmave në mjedis, veçanërisht të trafikut rrugor. Me rritjen e ndotjes akustike natën, rritet probabiliteti i të qenit zgjuar, pra rritet probabiliteti i çrregullimeve të gjumit. Kjo është sinjifikante për popullatën urbane të qytetit të Tiranës, e cila është e ekspozuar në nivele zhurmash mbi 35 dB(A) LAeq natën (Graf.5).

Graf.5. Frekuencat relative të përgjigjeve subjektive, përsa i përket çrregullimit të gjumit (%)




Siç shihet nga Graf.6, nga totali i banorëve që deklarojnë çrregullime të gjumit, 45% e tyre deklarojnë se këto çrregullime vijnë “shpeshherë” nga trafiku rrugor dhe 26.5% deklarojnë se trafiku rrugor është “ndonjëherë “ shkak i çrregullimeve të gjumit. Pra, në të dy rastet faktori kryesor i çrregullimeve të gjumit është trafiku rrugor.

Graf.6. Frekuencat relative të përgjigjeve subjektive, përsa i përket prishjes së gjumit nga trafiku rrugor (%).




Nga përgjigjet relative të banorëve rezultoi se 55.6% e tyre kanë vështirësi për ti zënë gjumi, shpeshherë kjo nga trafiku rrugor. (Graf.7).

Graf.7. Frekuencat relative të përgjigjeve subjektive, në lidhje me vështirësinë që kanë banorët për ti zënë gjumi në fillim të tij (%).




Një parametër i rëndësishëm i çrregullimit të gjumit është dhe koha që i duhet banorit për ta zënë gjumi përsëri , pasi i është prishur më parë. 60% e tyre deklarojnë se u duhet një periudhë kohe prej 30-60 minutash për t’i zënë gjumi përsëri, kohë e cila ndikon ndjeshëm në një funksionim më të mirë fiziologjik dhe mendor të popullatës. Jo më pak të rëndësishme janë dhe pasojat e ditës në vazhdim si : një lodhje të madhe, ndjenjën e nervozizmit dhe eficiencë të reduktuar. (Graf.8.

Graf.8. Frekuencat relative të përgjigjeve subjektive, përsa i takon kohës që i duhet banorit për ta zënë gjumi pasi atij i është prishur faza e parë e tij (kjo për shkak të trafikut) (%).



Një koficient i lartë korrelacioni ($p < 0.01$) u gjet midis përdorimit të pilulave të gjumit dhe shkallës së nervozizmit nga banorët. Nervozizëm deklaruan 49% e banorëve, nga të cilët 41.1 % janë përdorues të pilulave të gjumit (**Graf. 9**). Rezultatet e studimeve mbi zhurmat në mjedis dhe efektet e tyre në shëndetin mendor nuk janë plotësisht të përfunduara. Megjithatë, studimet mbi përdorimin e drogave të tilla si: pilulat gjumëvënëse, mbi simptomat psikiatrike si dhe numëri i shtrimeve në spitalet psikiatrike, tregojnë që zhurma në mjedis ka efekte negative mbi shëndetin mendor. (8), (9)


Graf.9. Frekuencat relative të përgjigjeve subjektive, në lidhje me përdorimin e pilulave për t'i zënë gjumi dhe shkallës së nervozizmit të banorëve (%).



Rezultatet e studimit mbi informacionin që kanë banorët, në lidhje me matjet e zhurmave në qytetin/zonën e tyre dhe efektet mbi shëndet.


Një aspekt i rëndësishëm, që duhet përmendur, është dhe informacioni që kanë banorët në lidhje me variablat “ a bëhen matje zhurmash në qytetin/zonën tuaj“ ; nga ku rezultoi se 76.3% nuk kishin informacionin në se bëhen matje në qytetin e tyre dhe 97% deklaruan se nuk dinin në se bëhen matje në zonën e tyre. (Graf.10).

Graf.10. Frekuencat relative të përgjigjeve subjektive, mbi informacionin që kanë banorët, përse i takon matjeve të nivelit të zhurmave, në qytetin/ zonën e tyre (%).



Në Graf.11. shihet qartë se 78.5 % e banorëve, nuk kishin informacion mbi efektet dhe dëmtimet që shkaktojnë zhurmat në popullatë . Fakte këto që lënë hapësirë për hartimin e paketave të informimit dhe edukimit mbi efektet negative që shkaktojnë zhurmat në popullatë.

Graf.11. Frekuencat relative të përgjigjeve subjektive, mbi informacionin që kanë banorët, për ekektet dhe dëmtimet që shkaktojnë zhurmat (%).



Përmes analizës së regresionit Tab.3 u gjet se ka lidhje sinjifikante mes: “a keni çrregullime të gjumit?” dhe “a mendoni se këto çrregullime ju vijnë nga zhurmat?”(P=0,001), “a keni çrregullime të gjumit?” dhe “koha e nevojshme për t’ju zënë gjumi pas prishjes së tij” (P=0,002), “a keni çrregullime të gjumit?” dhe “a përdorni pilula për t’ju zënë gjumi?” (P=0,007), “a keni çrregullime të gjumit?” dhe “a keni rritje të nervozizmit?” (P=0,04) , “a keni çrregullime të gjumit?” dhe “a ndiheni i lodhur pas gjumit?” (P=0.05).

Tabela 3. Variabli i varur : “a keni çrregullime të gjumit?”

	Koeficienti I pastandartizuar		Koeficienti standartizua	t	Vlera p	Intervali besimit 95%	
	B	Std. Error	Beta			Kufiri poshtëm	Kufiri I sipëm
(Konstant)	-.616	.215		-2.866	.004	-1.039	-.193
fillimisht a të zë gjumi me vështirësi?	.202	.050	.209	4.044	.000	.104	.300
sa kohë u nevojitet për tju zënë gjumi pas prishjes së tij?	.115	.037	.161	3.157	.002	.043	.188
a mendoni se këto çrregullime ju vijnë nga zhurmat?	.182	.022	.399	8.234	.001	.139	.226
a ndiheni i lodhur pas gjumit?	.095	.050	.124	1.898	.050	-.004	.194
a flini(dremisni) në orë të tjera gjatë ditës/	.092	.057	.084	1.607	.109	-.021	.205
a përdorni pilula për tju zënë gjumi?	.123	.045	.163	2.739	.007	.035	.211
a keni rritje të nervozizmit?	.110	.053	.109	2.065	.040	.005	.216

DISKUTIME

Të dhënat tona evidentojnë se 50.1% e popullatës urbane të qytetit të Tiranës, deklarojnë se kanë çrregullime të gjumit, të shkaktuara nga zhurmat e trafikut rrugor. U gjet një lidhje sinjifikante të këtij indikatorit, me disa faktorë influencues të mundshëm si: zënia me vështirësi e gjumit, prishja e gjumit nga trafiku rrugor, koha e nevojshme e zënies përsëri të gjumit dhe përdorimi i pilulave të gjumit. Respektivisht, me prevalencë 55.6%, 52.8%, 60% e banorëve deklarojnë se u nevojitet një kohë prej 30-60 min. për t’i zënë gjumi dhe 41.4% përdorin pilula për gjumë.

Në këtë studim u konstatua se, 50.1 % e dritareve të dhomës së gjumit dhe 41% e dritareve të sallonit ishin të orientuara nga rruga. Orientimi i dritareve të dhomës së gjumit dhe dritareve të sallonit, përbënte një faktor të rëndësishëm në vlerësimin e çrregullimeve të gjumit në popullatë.

56.3% deklarojnë se burimi më shqetësues i zhurmave të jashtme është trafiku rrugor dhe 29 % deklarojnë se burimi më shqetësues i zhurmave nga brenda banesës janë përsëri zhurmat e trafikut rrugor. Jo më pak të rëndësishme janë edhe burimet e tjera.

PËRFUNDIME

Studimi ynë tregoi se, çrregullimet e gjumit janë sinjifikante me përgjigjet e popullatës urbane të qytetit të Tiranës, e cila është e ekspozuar nga trafiku rrugor, në nivele zhurmash të larta deri 74.9 dB(A) për ditën dhe deri 67.7 dB(A) për natën.

Burimi kryesor i çrregullimeve të gjumit është zhurma nga trafiku rrugor (1),(10),(11). Mosdërprerja e gjumit është e njohur si kushti paraprak për funksionimin e mirë fiziologjik dhe mendor të individëve të shëndetshëm.(5),(6). Kur çrregullimi i gjumit bëhet kronik, pasojat janë në gjëndjen shpirtërore; ulje në performancë, në lexim, në përqëndrim dhe kujtesë. (11), (12) Gjithashtu kjo lloj zhurme shkakton jo vetëm efektet primare që përmëndëm më lart, por dhe në efektet sekondare gjatë ditës si: një lodhje të madhe, ndjenjë nervozizmi dhe eficiencë të reduktuar. (2),(7),(11). Informacioni që kanë banorët, nëse bëhen matje në qytetin/zonën e tyre dhe mbi efektet negative që shkaktojnë zhurmat në shëndetin e popullatës, është shumë i kufizuar. Kjo duhet të shërbejë për më tej në hartimin e paketave të informimit dhe edukimit mbi efektet negative që shkaktojnë zhurmat në popullatë.

BIBLIOGRAFIA

1. Berglund B. Lindvall T. (1995) Community Noise. Archives of the Center for Sensory Research. Stockholm University and Karolinska Institutet, Stockholm
2. Cohen S. After effects of stress on human performance and social behavior: A review of research and theory. *Psychological Bulletin* 1980; 88: 82-108.
3. INSTAT, Institute of Statistics. <http://www.instat.gov.al>
4. Miedema HME, Vos H. 1998. Exposure-response relationships for transportation noise. *J. Acoust. Soc. Am.* 104(6):3432-3445.
5. Ohrstrom E., Rylander R. (1990) Sleep disturbance by road traffic noise- a laboratory study on number of noise events. *J. Sound Vibr.* 143:93-101.
6. Ouis D. (1999) Exposure to nocturnal road traffic noise: Sleep disturbance and its after effects. *Noise & Health* 4: 11-36.
7. Stansfeld S. A., Sharp D. S., Gallacher J., Babisch W. (1993) Road traffic noise, noise sensitivity and psychological disorder, *Psychological Medicine* 23: 977-985
8. Sarolli Y. Një studim mbi nivelet e zhurmave në repartet e kovaçanës së një ndërmarrje në qytetin e Tiranës. 1999, Nr.4, fq.111.
9. Sarolli Y. Të dhëna mbi ekzaminimin audiometrik të punonjësve në një ndërmarrje të qytetit të Tiranës. 1983, Nr.4, fq. 7-11.
10. Thompson S. 1996. Non-auditory health effects of noise: updated review. In: Hill FA, Lawrence R, editors. *InterNoise 96. Proceedings of the 25th International Congress on Noise Control Engineering*, Liverpool 1996. St. Albans: Institute of Acoustics. p 2177-2182.
11. WHO.2000.Guidelines for community noise. Berglund B, Lindvall T, Schwela DH, editors. Geneva: World Health Organization.
12. World Health Organization (2001) Occupational and Community Noise. WHO-OMS, <http://www.who.int.inf-fs/en/fact258.html> (accessed on 10/01/2004)

SUMMARY

THE ROAD TRAFFIC NOISE AND THE SLEEP DISTURBANCES, IN 15 MONITORING STATIONS TO CYTI OF TIRANA

Arta Ago¹, Ylli Sarolli², Agim Shehi¹, Jolanda Hyska¹

¹Institute of Public Health "Hulo Hajderi" Tirana, Albania
Department "Environment and Health", Tirana, Albania

²Faculty of Medicine, Department of Public Health, Tirana, Albania

Introduction: *The road traffic noise, which is steadily increasing is considered to be an important environmental health problem. Aim of the study was estimated the degree of sleep disturbances related to road traffic noise in residential settings in urban community of the city Tirana. Methods:* *This study carry out from March 2008 - January 2009 and was of the transversal case. Method of sample was that the stratified clusters sample. For all the territory of the city of Tirana were selected 15 clusters (in 15 monitoring stations) and for the each cluster were 20 households. The study was based*

on a questionnaire, which was anonymous. For entry and processing of data were used the computer skills programs Excel-2007 and SPSS 16. **Results:** In this study participated 275 families, in which lived 1105 individuals. The results showed that 50.1% of urban population of Tirana pronounced sleep disturbance caused by road traffic noise. The sleep disturbances was the significant with the responses of urban population of the city of Tirana, which is expose of the road traffic with the noise rates 74.9 dB(A) of day and 67.7 dB(A) of night. **Conclusion:** Our study showed that the main source of the sleep disturbance is road traffic noise.

Key words: Road traffic, sleep disturbance, monitoring station, dB(A)

MEDICUS

PUNIM BURIMOR SHKENCOR / ORIGINAL SCIENTIFIC PAPER
SHËNDETËSI PUBLIKE

**NJË STUDIM MULTIKULTUROR I ADOLESHENTËVE – BMI, IMAZHI TRUPOR
DHE MIRËQENIA PSIKOLOGJIKE**

Enkelejda Shkurti¹, Anita Sujoldzic², Amelia De Lucia³

¹Fakulteti i Infermierisë, Tiranë, Shqipëri

²Instituti i Kërkimit Antropologjik, Zagreb, Kroaci

³Universiteti i Barit, Itali



Enkelejda Shkurti, specialiste e shendetit publik, pedagoge
Rr. “Perlat Rexhepi”, Pallati: Komani, Shk 2, Ap 4, Tiranë
Tel: 00672058790

e-mail: lidiashkurti@yahoo.com

REZYME: Ndryshimet fizike, psikologjike dhe sociale qe ndeshen gjate adoleshencës nxjerrin në pah stilin e dietës. Ndryshimet fizike që kanë të bëjnë me rritjen e shpejtë i rrisin kërkesat ushqimore të adoleshentëve. Nga ana tjetër, shoqëria kërkon ndryshime në të gjitha aspektet e mënyrës së jetesës. Nëse adoleshentët do të kenë nje paraqitje fizike te ndryshme nga modeli tyre ideal, kjo do të çojë në një nënvlerësim te vetvetes dhe dobësi shëndetsore. Ky artikull paraqet disa rezultate te nje studimi krahasues ndërkombëtar mbi rrezikun dhe faktoret mbrojtës te shëndetit dhe mirëqenies se adoleshentëve lidhur me BMI, sjelljen e te ushqyerit, imazhin trupor dhe lidhjen e tyre me mirëqenien psikosociale (stresin somatik, ankthin, depresionin, kënaqësinë nga jeta dhe vetëvlerësimin). Ndryshimet grup-specifike te adoleshentëve shqiptarë dhe boshnjakë janë vënë re brenda situatave te ndryshme social-kulturore në gjashtë vendeve evropiane, nga te cilat 2 antare te BE: Austria dhe Italia dhe katër vende ne tranzicion politik dhe socio-ekonomik (Kroacia, Bosnja, Shqipëria dhe Kosova). Në studim u përfshinë 2000 adoleshentë nga mosha 15 deri në 18 vjeç. Studimi tregoi një lidhje te fortë midis BMI (indeksit te mases trupore) dhe pakënaqësisë trupore, midis pamjes dhe kënaqësive së të ngrënit, si dhe pasojat e pamjes mbi të gjithë treguesit e shëndetit psikosocial. Duke pasur parasysh ndryshimet gjinore, në të gjitha vendet, rezultatet e përfuara tregojnë ndryshime kuptimplota ndërmjet kulturave të ndryshme lidhur me gjendjen social-ekonomike.

Fjalë kyç: Adoleshent, ndryshim kulturor, BMI (tregues i masës trupore), imazh trupor, mirëqenie psikosociale

Medicus 2012, Vol. XVII (1):

HYRJE

Ndryshimet fizike, sociale dhe psikosociale që ndodhin gjatë adoleshencës influencojnë dukshëm edhe zakonet e ushqyerjes (1). Rritja e shpejtë varet nga ushqimi i përshtatshëm, që përcaktohet edhe nga te pasurit e sasive të mjaftueshme të ushqimit (2). Duke u nisur nga idealet shoqërore dhe kulturore të elegancës dhe dietës që mbizotërojnë në shoqërinë moderne, shumë vajza adoleshente madje dhe në peshë normale, ndihen të pakënaqura me formën e tyre, gjë që mund të ndikojë në shëndetin e tyre fizik dhe psikologjik (3). Në kulturën perëndimore eleganca përfaqëson kompetencën, suksesin, kontrollin kurse obeziteti paraqet të qenit dembel, braktisjen si dhe mungesën e vetkontrollit (2). Gjatë adoleshencës, në studimet e mëparshme, vajzat që e perceptonin veten si jo tërheqëse kishin rezultate më të ulta të vetëvlerësimit, sesa ato që ishin më të kënaqura me pamjen e tyre. Një lidhje pozitive midis sjelljes së të ushqyerit dhe një funksionimi të shqetësuar psikologjik është vënë re në këtë rast (3). Ndjenja e kënaqësisë me pamjen e jashtme vepron si një faktor mbrojtës për mirëqenien psikologjike, kurse pakënaqësia trupore mund të ndikojë seriozisht shëndetin, duke zvogëluar kënaqësinë për jetën dhe vetëvlerësimin. Rritja e stresit psikologjik duke përfshirë dhe pasojat somatike si ankthin dhe depresionin i detyrohet sfidave të shoqërimit midis emigrantëve në procesin e ndryshimit kulturor.

Hipoteza e përgjithshme e këtij studimi, është se situata social kulturore dhe kushtet ekonomike në vende të ndryshme që përfaqësojnë tërësinë e modelit të shëndetit, me shkallë të ndryshme të ngjashmërisë kulturore dhe gjuhësore do të influencojë procesin e përshtatjes së refugjatëve adoleshentë, bazuar në shëndetin si dhe mirëqenien e tyre psikosociale (8, 9). Studimi vë në kontrast dy grupe të ndryshme kulturore të adoleshentëve shqiptarë dhe boshnjakë në vendet e tyre të origjinës dhe si emigrantë në vendet pritëse në Kroaci, Austri dhe Itali. Grupet japin jo vetëm ndryshime të kombësive dhe të kulturave të origjinës, por dhe shkallë të ndryshme të ngjashmërisë kulturore në shoqëritë pritëse.

QËLLIMI I STUDIMIT

Objektivi i këtij studimi lidhet me zbulimin e pasojave të së kaluarës në vende të ndryshme dhe të procesit të ndryshimit të kulturës në treguesin e masës trupore, në pamjen e jashtme dhe në sjelljen e të ushqyerit, si dhe analizen e lidhjes midis të ushqyerit, pamjes trupore dhe përshtatjes psikosociale të adoleshentit.

METODOLOGJIA

Informacioni mbi peshën dhe gjatësinë e çdo pjesëmarrësi në studim u përftua përmes pyetjes: Sa i gjatë jeni pa këpucë? dhe Sa peshoni pa rroba? Gjatësia dhe pesha e raportuar u përdorën për të llogaritur BMI (indeksin e masës trupore). Vlerat moshë-specifike në percentile, të përdorura për të përcaktuar nënushqyerjen e adoleshentëve gjenden në percentilin 5, kurse ato me rrezik për obezitet gjenden mbi percentilin 85, sipas rekomandimeve të OBSH.

Dy kërkesa vlerësuan pamjen trupore: A mendoni se trupi juaj është...? Opsionet e përgjigjeve ishin: Shumë i dobët, pak i dobët, normal, pak i shëndoshë dhe shumë i shëndoshë. Dy përgjigjet e fundit shërbyen si tregues i pakënaqësisë për peshën trupore. Kontrolli i peshës u bë në një shkallë nga 1 (humbje ose fitim i peshës) në 3 (nuk po bëj asgjë në lidhje me peshën time). Pyetja pasardhëse maste dëshirën e individit për të ndryshuar diçka në peshën e tij. Rezultatet e dy pyetjeve mblidhen për të nxjerrë mesataren dhe për të përfutur një rezultat dikotomik: 1 (të pakënaqur me pamjen trupore) dhe 2 (të kënaqur). Indeksi i stresit psikologjik u mat përmes treguesve të simptomave të ankthit, të sjelljes depresive dhe të ankesave somatike bazuar në listën e simptomave të Hopkins dhe në RADS-shkalla Reynolds e depresionit të adoleshentëve. Në këtë studim variablet e ankthit, të depresionit dhe të

simptomave somatike u përdorën si variable të ndara. Vetëvlerësimi u mat duke përdorur një shkallë nga 1 (nuk jam fare dakord) në 4 (jam shumë dakord) (14). Shkalla e kënaqësisë me jetën mat gjykimin e ndërgjegjshëm të një individi për jetën e tij mbi bazën e kritereve personale.

Si variable demografike shërbyen moshë, gjinia dhe gjendja social-ekonomike.

Tabela 1.

Karakteristikat demografike të mostres sipas grupit

	Kosova	Shqipëria	shqiptarët në Itali	Bosnja	boshnjakët në Kroaci	Totale
438	320	318	359	301		
Mesatarja e moshës	16.3	17.2	17.3	17.3	17.0	
Femra	249(56.8%)	202(63.13%)	174(54.7%)	217(60.4%)	164(54.4%)	
Meshkuj	189(43.15%)	118(36.18%)	144(45.28%)	142(39.55%)	137(45.51%)	
Punësimi i prindërve						
Të papunë	1.14%	2.5%	0.31%	9.19%	8.97%	
Shtëpiakë	5.25%	1.13%	2.20%	65.36%	10.63%	
Në pension	22.15%	21.88%	16.67%	10.86%	23.26%	
Te punësuar	23.25%	33.75%	40.88%	2.21%	30.23%	
me kohë të plotë						

Metoda e mostrës me grupe u përdor si më e përshtatshme për këtë lloj studimi transversal. U shfrytëzuan pyetorë që iu shpërndanë nxënësve të shkollave të mesme gjatë kohës së shkollës.

Popullata target përfshiu 1934 adoleshentë (1108 vajza dhe 826 djem), midis moshës 15 dhe 18 vjeç në 2007, ku u futën adoleshentët e Kosovës, të Shqipërisë, emigrantët shqiptarë në Itali, boshnjakët në Bosnjë dhe emigrantët në Kroaci. Karakteristikat demografike të mostrës të ndara sipas grupeve të adoleshentëve jepen në tabelën e mësipërme. Nga analiza sipas grupeve rezultoi se kosovarët ishin më të rinj se shokët e tyre në Shqipëri dhe në Itali. Kurse përsa i përket punësimit prindëror, prinderit e adoleshentëve boshnjakë kishin në mënyrë sinjifikante nivelin më të ulët të punësimit me kohë të plotë (2.23%),

REZULTATET

Ndryshimet midis grupeve specifike të adoleshentëve sipas gjendjes social-ekonomike, indeksit të masës trupore, kënaqësisë trupore, dietës, stresit psikologjik dhe mirëqenies u vlerësuan me metodën Ancova me moshën si kovariat. Ato jepen në tabelën e mëposhtme:

Rezultatet e analizës Ancova

Tabela 1.

Shqiptarët

Variabël	Kosova	Shqipëria	Shqiptarët në Itali	GrupiF(19.86)	GjiniaF(60.35)
Gjendja socio-ek	2.21	2.06	1.91	197.46	
BMI	2.03	2.05	2.11	9.0	28.34
Kënaq e pamjes trupore	1.71	1.52	1.56	20.64	60.67
Dieta	2.24	2.24	2.21		12.65
Simptomat somatike	1.51	1.79	1.76	39.68	82.54
Depresioni	1.83	2.02	2.0	13.38	100.12
Kënaqësia e jetes	3.00	2.41	2.62	84.37	10.65
Vetëvlerësimi	2.95	3.00	2.95		3.89

Tabela 2.

Boshnjakë

Variablet	Kosova	Shqipëria	Shqiptarët ne Itali	GrupiF(19.86)	GjiniaF(60.35)
Gjendja socio-ek	2.21	2.06	1.91	197.46	
BMI	2.03	2.05	2.11	9.0	28.34
Kënaq e pamjes trupore	1.71	1.52	1.56	20.64	60.67
Dieta	2.24	2.24	2.21		12.65
Simptomat somatike	1.51	1.79	1.76	39.68	82.54
Depresioni	1.83	2.02	2.0	13.38	100.12
Kënaqësia e jetes	3.00	2.41	2.62	84.37	10.65
Vetvlerësimi	2.95	3.00	2.95		3.89

Grupet e shqiptarëve ndryshonin në mënyrë kuptimplote nga njëri-tjetri në të gjithë analizën e variableve përveç dietës dhe vetvlerësimit. Krahasimet post-hoc (gabimit logjik) treguan se kosovarët kishin rezultate më të larta sinjifikante krahasuar me dy grupet e tjera, përsa i përket gjendjes social-ekonomike e matur përmes punësimit te prindërve dhe mirëqenies se tyre. Kosovarët gjithashtu shfaqën vlerat më të ulta të BMI dhe të gjitha simptomat e stresit psikologjik, ndërkohë që kishin vlerat më të larta në mënyrë sinjifikante të kënaqësisë trupore dhe të kënaqësisë për jetën, në përgjithësi. Nga ana tjetër shqiptarët ne Itali, kishin vlera më të larta të BMI sesa dy grupet e tjera, kurse shqiptarët ne Shqipëri kishin vlera më të larta të stresit psikologjik sesa dy grupet e tjera.

Boshnjakët në Bosnjë-Hercegovinë kishin gjendjen më të ulët social-ekonomike nga grupet e tjera lidhur me edukimin e prindërve, me punësimin dhe të ardhurat e prindërve. Ata raportonin gjithashtu një nivel më të lartë të depresionit dhe nivelin më të ulët të kënaqësisë për jetën krahasuar me grupet e tjera.

Efekti i gjinisë u zbulua për të gjithë variablet si te shqiptarët ashtu dhe te boshnjakët. Vajzat raportuan kënaqësi më të ulët trupore, më tepër dieta, si dhe më shumë simptoma depressive, ankthi dhe somatike sesa djemtë, kurse këta të fundit kishin vlera te BMI më të larta, dhe vetvlerësim më të madh sesa vajzat.

Indeksi i masës trupore

Përgjithësisht, u gjetën ndryshime statistikore sinjifikante nëpërmjet analizës së regresionit midis shqiptarëve dhe boshnjakëve për të dy sekset në peshë dhe gjatësi të standartizuara për moshë dhe gjendje socialekonomike. Vajzat dhe djemtë shqiptarë kanë gjatësi më të vogël se bashkmoshatarët e tyre boshnjakë ($M = 164.19$ kundrejt 167.26 për vajzat dhe 173.33 kundrejt 178.00 për djemtë). Përsa i përket gjatësisë vajzat shqiptare në Shqipëri janë më të shkurtra se ato kosovare, ndërsa për meshkujt nuk u gjetën ndryshime sinjifikante midis shqiptarëve dhe boshnjakëve.

Bazuar në të dhënat e OBSH, rezultatet tregojnë se në përgjithësi 91-95 % e vajzave, dhe 81-92 % e djemve në studim janë në intervalin e vlerave normale të BMI. Ka një ndryshim evident përsa i takon gjinisë dhe djemtë janë me rrezik më të lartë për nënpeshë apo mbipeshë. Për të dyja sekset shqiptarët ne Shqipëri dhe Kosovë janë me rrezik më të lartë për nënpeshë krahasuar me shqiptarët ne Itali, po e njëjta gjë ndodh me boshnjakët e Bosnjës krahasuar me boshnjakët e Kroacisë.

Kënaqësia me trupin

Në lidhje me kënaqësinë trupore ka ndryshime të qarta lidhur me gjininë. Vajzat me shumë sesa djemtë raportojnë pakënaqësi me peshën e tyre trupore. Ndryshimi më sinjifikant statistikor për matjen e përbërë të kënaqësisë trupore u gjet në Kosovë me nivelin më të lartë të kënaqësisë trupore krahasuar me të gjithë grupet e tjera.

Në total, 64% e vajzave dhe 67% e djemve në studim, duken të kënaqur me pamjen e jashtme, më të kënaqur me imazhin trupor janë vajzat (80%) dhe djemtë (86%) në Kosovë, të ndjekur nga adoleshentët në Itali (60-63%), kurse me pak të kënaqur janë ata në Shqipëri (52 %-59 %). Kënaqësia më e madhe e pamjes trupore u gjet në Bosnjë (69 %-74 %) sesa në Kroaci (58%-62%).

Rezultatet reflektojnë pasojat e ndryshme kulturore dhe të stilit të jetës si dhe presione të ndryshme sociale, ekonomike dhe kulturore në këto vende.

Dieta

Të mbajturit e dietës konsiderohet si sjellje me rrezik kur ajo shoqërohet me pasoja negative fizike dhe psikologjike. Dietat dhe kontrolli i peshës tregojnë ndryshime të dukshme gjinore me nivele më të larta të vajzave sesa të djemve. Përqindja e atyre që mbajnë dietë është 49 % për vajzat dhe 38 % për djemtë që përpiqen të bien apo të shtojnë në peshë, 34 % e vajzave dhe 40% e djemve përpiqen të mbajnë peshën e tyre, ndërsa 17 % e vajzave dhe 22 % e djemve nuk e kontrollojnë fare peshën e tyre.

Korrelacioni i përfutur midis indeksit të masës trupore, dietave dhe kënaqësisë trupore së bashku me indikatorët e mirëqenies psikologjike tregon rëndësinë e pamjes së jashtme. BMI është e lidhur në mënyrë sinjifikante me kontrollin e peshës, me imazhin negativ trupor dhe stresin somatik të vajzave dhe vetëm me kënaqësinë trupore të djemve. Kontrolli i peshës është i lidhur në mënyrë pozitive me stresin somatik, ankthin dhe depresionin dhe mënyrë negative me indikatorët e mirëqenies, por vetëm të vajzave.

Nga analiza e regresionit të shumfishtë e kryer për grupet shqiptare dhe boshnjake në mënyrë të ndarë për të përcaktuar efektet e BMI, të imazhit trupor dhe të dietës mbi stresin psikologjik dhe mirëqenien. Sipas analizës së kryer vihet re se sjellja e dietës nuk është një përcaktues kuptimplotë i shëndetit psikologjik. Megjithatë, kënaqësia trupore dhe gjinia ndikojnë në mënyrë të dukshme variablet e shëndetit psikologjik. Perceptimi i të qenit mbipeshë dhe pakënaqësia me përmasën trupore më tepër se pesha aktuale duket të jetë një hallkë e fuqishme pas stresit psikologjik në të gjitha grupet e analizuar.

Ndërkohë që kënaqësia trupore është përcaktuesi i vetëm evident për të gjithë grupet e boshnjakëve, të shqiptarët BMI aktuale përfaqëson një përcaktues shtesë të stresit somatik dhe ankthit.

Përsa i përket rezultateve grup-specifike, efekte evidente pozitive u vunë re për adoleshentët në Shqipëri në lidhje me stresin somatik dhe ankthin. Kështu, vlera më të ulta të kënaqësisë trupore të perceptuar dhe vlera më të larta të BMI lidhen me stresin somatik dhe ankthin në Shqipëri, por jo tek adoleshentët kosovare apo shqiptarë në Itali.

KONKLUZION

Gjetjet e këtij studimi pohojnë se BMI, kënaqësia e imazhit trupor dhe sjellja e dietës ndryshojnë në bazë të grupeve etnike (shqiptarët dhe boshnjakët), duke variuar brenda këtyre grupeve në situata specifike. Ato konfirmojnë rezultatet e studimeve të tjera ndërkombëtare duke treguar se përqindja e vajzave dhe djemve mbipeshë ndryshon shumë sipas vendeve (3%-34%) në adoleshencë. Prevalenca është më e lartë në Kanada, Amerikë dhe Angli dhe disa vende të Evropës Jugore si: Greqia, Italia dhe Spanja. Vendet skandinave dhe ato të Evropës Qendrore kanë një përqindje më të ulët të mbipeshës të adoleshentët. Rezultatet tona tregojnë një prevalencë më të lartë për mbipeshë dhe obezitet të djemve. Përjashtim bëjnë adoleshentët në Kosovë dhe Bosnjë, ku si djemtë dhe vajzat japin rezultate identike të vlerave të mbipeshës.

Lidhja midis kënaqësisë trupore dhe shoqërimit të saj negativ me indikatorët e stresit psikologjik si dhe shoqërimit pozitiv me mirëqenien psikologjike është vendosur nga rezultatet e përfutura në të dyja seksat, megjithëse efektet janë më sinjifikative të vajzave.

Ndryshimet gjinore janë të dukshme në mënyrën sesi adoleshentet femra dhe meshkuj e vlerësojnë trupin e tyre. Vajzat prirën ta shohin trupin e tyre si një mjet tërheqjeje kundrejt të tjerëve, kurse djemtë e perceptojnë si një mjet veprimi efektiv në mjedisin e jashtëm. Rezultatet e studimit pohojnë se pakënaqësia me peshën trupore, dietën dhe sjelljen e kontrollit të peshës janë të zakonshme tek adoleshentët sidomos te vajzat.

Ndryshimet e dukshme sipas gjinisë të evidentuara nga analiza e grupeve ilustrojnë rëndësinë e gjinisë në kërkim dhe në promovim shëndetsor.

Gjetjet e këtij studimi kanë pasojë mbi shëndetin psikologjik të adoleshentëve si presioni i kulturës që mbizotëron në vendet e industrializuara për të pasur një formë trupore ideale.

Programet e promovimit shëndetsor duhet të marrin në konsideratë jo vetëm faktorët e zhvillimit por dhe ata socialë dhe kulturorë që kontribuojnë në peshën trupore dhe në problemet që lidhen me pasojat serioze për shëndetin.

REFERENCES

1. Sujoldzic A, De Lucia A, Rudan V, Szivovic L, Searching for identity in a changing world. (Croatian Anthropological Society, Zagreb, 2005).
2. Ckrebilin L, Sujoldzic A, Coll. Antropol. 27 (2003) 471.
3. HBSC: Health Behaviour in School-aged Children: a World Health Organization collaborative cross-national study. Edinburgh, Child and Adolescent Health Research Unit, University of Edinburgh, 2002. Available from: <http://www.hbsc.org/publications.html>, accessed 27 November 2006.
4. Koff E, Rierdan J, Journal of Adolescent Health, 12 (1991) 307.
5. Kilpatrick M, Ohannessian C, Bartholomew JB, Journal of School Health, 69 (1999) 148.
6. Neumark-Sztainer D, Story M, Toporoff E, Heimes JH, Resnick MD, Blum RV, J. Adolesc. Health, 20 (1997) 450.
7. O'Dea JA, Australian Journal of Nutrition and Dietetics, 52 (1995) 56.
8. Rutter M, J. Adolesc. Health, 14 (1993) 626
9. Bronfenbrenner U, The ecology of human development: Experiments by nature and design. (Harvard University Press, Cambridge, 1979).
10. Cle TJ, BMJ, 320 (2000) 1.
11. Mollica RF, Wychak G, De Marneffed D, Khuon F, American Journal of Psychiatry, 144 (1987) 497.
12. Mouanoutoua B, Journal of Personality Assessment, 64 (1995) 2.
13. Reynolds WM, Reynolds Adolescent Depression Scale: Professional manual. (Odessa, FL: Psychological Assessment Resources, 1987).

SUMMARY

A MULTICULTURAL STUDY OF ADOLESCENTS – BMI, BODY IMAGE AND PSYCHOLOGICAL WELL-BEING

Enkelejda Shkurti¹, Anita Sujoldzic², Amelia De Lucia³

¹Faculty of Nursing, Tirana, Albania

²Institute of Anthropological Research, Zagreb, Croatia

³Bari University, Italy

Physical, psychological and social changes that are noticed during adolescence can markedly affect dietary habits and nutritional health. Physical changes including fast growth place extra nutritional requirements on adolescents, while culture and society require adjustments in all of the aspects of daily living, including psychosocial well-being. Adolescents become focused on the physical appearance and any deviation from the ideal figure can result in negative dieting behavior, social withdrawal, poor self-esteem and increased health vulnerability. The paper presents some of the results of an international comparative study on risk and protective factors of adolescent health and well being,

related to BMI, dieting behavior and body image and their relationship to psychosocial well-being (somatic stress, depression, life satisfaction and self-esteem). Inside an ecological cultural framework, it looks at group-specific differences of Albanian and Bosnian adolescents within different socio-cultural contexts across six European countries: two EU members (Italy and Austria) and four communities in the state of socioeconomic and political transition (Croatia, Bosnia and Herzegovina, Albania and Kosovo). The survey collected data from 2000 adolescents between 15 and 18 years of age. The study demonstrated a strong relationship between BMI and body dissatisfaction, between body image and dietary habits and strong effects of body image on all indicators of psychosocial health. In addition to expected marked gender differences in all countries, the obtained results indicate significant intra-cultural variations related to socioeconomic status as well as considerable intercultural variations due to variable influence specific social and cultural contexts.

Key words: Adolescents, acculturation, BMI, body image, psychological well-being

MEDICUS


PUNIM BURIMOR SHKENCOR / ORIGINAL SCIENTIFIC PAPER

MJEKËSI SPORTIVE

**SJELLJA NË LIDHJE ME SHËNDETIN E TË RINJVE 11, 13 DHE 15 VJEÇ
NË RRETHIN E KURBINIT, SHQIPËRI.**

Aida Shehu¹, Dhimitraq Stratobërdha¹

¹Departamenti i Sporteve, Tiranë, Shqipëri
Universiteti i Sporteve të Tiranës, Shqipëri



Aida Shehu, pedagoge, docent
Rr. Kongresi Manastirit 46/9, Tiranë, Shqipëri
Tel: **0674091402**
e-mail aida-1964@hotmail.com

REZYME: Grupi target i studimit janë të rinjtë e moshës shkollore 11, 13 dhe 15 vjeç në total 86 (42 meshkuj dhe femra 44) dhe studjohen aspekte të ndryshme të shëndetit. Instrumenti i studimit ishte një pyetësor standard fokusuar në aktivitetin fizik, sjelljen sedentare, zakonet e ushqyerjes dhe imazhin e trupit. Të dhënat tona tregojnë se djemtë raportojnë të jenë fizikisht aktive, mbi një orë në ditë, më shumë se vajzat. Të rinjtë tanë kalojnë një kohë të gjatë përpara televizionit, kompjuterit dhe duke bërë detyrat e shtëpisë, djemtë më shumë se vajzat, për të gjitha grupmoshat. Të dhënat tregojnë se 70-75% e djemve dhe vajzave të moshës 13-15 vjeç nuk hanë mëngjes. Të rinjtë tanë, sidomos vajzat e moshës 13-15 vjeç, ndjehen të pakënaqur me peshën e trupit të tyre. Ka dallime të qarta gjinore në mbajtjen e dietës dhe kontrollin e peshës.

Fjalë kyç: Aktiviteti fizik, sjellja sedentare, të ushqyerit
Medicus 2012, Vol. XVII (1):

HYRJE

Studimi i sjelljeve me risk për shëndetin është i lidhur ngushtë me parandalimin e sëmundjeve kronike (kardiovaskulare, diabet, astëm, kancer, sëmundje të mëlçisë, sëmundjeve infektive (HIV/SIDA, IST), mbipeshë e obeziteti, aksidentet rrugore, etj.(1). Është evidentuar që sjelljet riskante për shëndetin janë kontribuesit kryesorë të shkaqeve të vdekjeve, paaftësisë së përkohshme apo të përhershme dhe problemeve sociale tek të rinjtë në Shqipëri ashtu sikurse në vende të tjera të Europës, SHBA, etj.

Në Evropë shumica e vendeve të saj tashmë kanë bërëurvejimin e sjelljeve riskante të të rinjve për shëndetin (2) ato janë pjesë e programit Evropian të këtij studimi që quhet Health Behaviour in School-aged Children (HBSC), Sjellja e Fëmijëve të Moshës Shkollore ndaj Shëndetit, ku Shqipëria u përfshi më 2007 (3). Pikërisht duke njohur këto fakte u krijua nxitja për këtë studim, në rrethin e Kurbinit me qëllim njohjen e sjelljes lidhur me shëndetin tek të rinjtë 11, 13 dhe 15 vjeç.

QËLLIMI I PUNIMIT

Studimi i sjelljeve riskante tek të rinjtë (rrethi Kurbinit, Shqipëri), kishte për qëllim: përcaktimin e prevalences së sjelljeve riskante, përcaktimin e bashkëveprimit midis tyre, grumbullimin e të dhënave në nivel lokal (rrethi Kurbinit), grumbullimin e të dhënave sipas kategorive të të rinjve (4).

MATERIALI DHE METODA

Metodologjia kryesore e përdorur për realizimin e këtij studimi është ajo e intervistës, me anë të pyetsorëve të strukturuar, të hartuar posaçërisht për këtë qëllim (3).

Në pyetsor u përcaktuan disa seksione të lidhura me sjellje të rrezikshme për shëndetin; ushqyerjen, aktivitetin fizik, jetën sedentare.

Pyetsori ishte i bazuar në pyetjet e bëra nga programi Evropian HBSC, në mënyrë që të ishte i krahasueshëm me studimet e kësaj natyre, të bëra në vendin tonë dhe në vende të tjera të Evropës (2).

Për zgjedhjen e mostrës, u përcaktuan me short 3 shkolla, Mamurras 1, Mamurras 2 dhe Fushë Mamurras. Mostra e përzgjedhur ishte përfaqësuese dhe u bë në mënyrë të rastësishme, pra u përdor metoda e mostrës së thjeshtë të rastësishme. Të dhënat e përfutuara nga pyetsorët u hodhen dhe analizuan në programin SPSS,.

Materiali, nxënësit që u morën në studim ishin gjithësej 86, nga të cilët 42 meshkuj (M) dhe 44 femra (F), nga të cilët 24 të moshës 11 vjeç, 37 të moshës 13 vjeç dhe 25 të moshës 15 vjeç (Tabela 1).

Tabela 1.

Numri i nxënësve të marë në studim, sipas moshës e gjinisë.

	M	F	Gj
11 vj.	13	11	24
13 vj.	18	19	37
15 vj.	11	14	25

Pyetsorët u plotësuan ne praninë e infermierit dhe mësuesve, pasi ishin dhënë edhe sqarimet përkatëse.

REZULTATET DHE ANALIZA E TYRE

Më poshtë po japim rezultatet e studimit dhe analizën e të dhënave, të cilat janë paraqitur në tabela e grafikë, për të kuptuar sa më qartë problemet që kanë të rinjtë e rrethit të Kurbinit me njohuritë, qëndrimin dhe sjelljet ndaj shëndetit. Të dhënat janë paraqitur sipas grup moshave dhe gjinisë, dhe gjithësej (Gj) (të dy gjinitë së bashku, por të ndarë në grupmosha). Për të bërë krahasimin e të dhënave tona, me të dhënat e vendeve të tjera Evropiane, në kollonën HBSC është paraqitur mesatarja e vendeve Evropiane dhe pas saj edhe kufijtë e shpërndarjes së madhësisë së problemit në vende të ndryshme (2). Të dhënat për Shqipërinë në rang vendi për të tre grupmoshat së bashku jepen poshtë tabelave dhe grafikëve (3).

Aktiviteti fizik

Tabela 2.

Aktiv për një orë dhe më tepër

	M	F	Gj	HBSC
11 vj.	84.60%	90.90%	87.50%	95.90%
13 vj.	100%	84.20%	91.80%	96.10%
15 vj.	100%	92.80%	96%	96.50%

Duke iu referuar të dhënave për aktivitet fizik (Tabela 2), nga pohimet e nxënësve, vëmë re se ata ndjehen aktiv po aq sa edhe Evropianët në të gjitha moshat, por më **pak aktivë janë meshkujt e moshës 11 vjeç dhe femrat** në të tre grupmoshat, gjë e lidhur kjo me zakonet në familje, ku më të vegjëlit dhe femrat qëndrojnë më shumë kohë pranë familjes.


Sjellja sedentare

Tabela 3.

Shikoj television mbi 4 orë gjatë ditëve të javës

	M	F	Gj	HBSC	
11 vj.	30.70%	54.50%	42%	24.30%	6.5–49.7
13 vj.	50%	57.80%	54.00%	28.80%	12.2–51.0
15 vj.	81.80%	92.80%	88.00%	25.60%	14.4–42.3

Grafiku 1.



Në rang vendi Shqipëria 58% për të tre grupmoshat së bashku (3).

Të rinjtë tanë shpenzojnë kohë të gjatë duke parë programe televizive, çka i bën ata inaktivë dhe kjo gjë vjen duke u rritur me rritjen e moshës. Tek 15 vjeçarët meshkuj e femra shprehet edhe më dukshëm në krahasim me të dhënat në Evropë, (Tabela 3 e Grafiku 1) janë 88% e tyre që e raportojnë (2, 4, 5). Kjo shpjegohet edhe me kushtet e një qyteti të vogël ku mungojnë mundësitë e kalimit të kohës së lirë në mënyrë aktive dhe me grupe të organizuara.

Tabela 4.

Shikoj television mbi 4 orë gjatë të shtunave dhe të dielave

	M	F	Gj	HBSC	
11 vj.	46.10%	54.50%	50.00%	39.20%	18.8–65.8
13 vj.	72.20%	57.80%	64.80%	48.70%	30.5–74.4
15 vj.	81.80%	71.40%	76%	47.80%	28.4–68.6

E njejta pamje është edhe për fund javë, kur femijët nuk janë në shkollë. Ata paraqesin po të njejtën mënyrë sjellje, (Tabela 4), duke shpenzuar një kohë të gjatë para televizionit, 76% e tyre, ndërsa të dhënat HBSC janë më të ulta, çka lidhet edhe me kulturën e weekend-it, që egziston prej kohësh në vendet e tjera.

A keni kompjuter


Të dhënat tregojnë se tashmë në rrethin tonë, në familje është futur kultura e kompjuterit dhe prindërit gjithënjë e më tepër kujdesen për të zhvilluar fëmijët e tyre, rreth 50% e familjeve kanë kompjutera në shtëpi. Vite më parë kompjuteri në rrethin tonë ishte një luks (6).

Tabela 5.

Përdor kompjuter më shumë se 3 orë në ditë gjatë ditëve të javës

	M	F	Gj	HBSC	
11 vj.	15.30%	9.00%	12.50%	11.70%	4.9–31.0
13 vj.	22.20%	5.20%	13.50%	14.80%	6.2–31.6
15 vj.	36.30%	21.40%	28%	15.30%	8.8–24.5

Grafiku 2.



Shqipëria 19% për të tre grupmoshat së bashku (3).

Por edhe pse kanë kompjutera në shtëpi, ato nuk shfrytëzohen njëjloj në të gjitha moshat. Shikojmë (Tabela 5 e Grafiku 2) që më tepër fillon të shfrytëzohet mbi 3 orë në **moshat e rritura 15 vjeç (M)** 36.3% dhe (Gj) 28%, pra me tepri në krahasim me HBSC.

Tabela 6.

Përdor kompjuter më shumë se 3 orë në ditë gjatë të shtunave dhe të djelave

	M	F	Gj	HBSC	
11 vj.	23.00%	18.10%	20.80%	19.70%	10.2–36.2
13 vj.	27.70%	5.20%	16.20%	26.50%	11.2–40.0
15 vj.	45.40%	21.40%	32.00%	27.20%	12.5–37.6


E njejta pamje (Tabela 6) për ditët e fundjavës. Ashtu si edhe ditët e javës ata kanë të njejtën sjellje mbi 3 orë pranë kompjuterit dhe po **ashtu 15 vjecarët (M)** e teprojnë këtë veprim, 45.4% e tyre, kur vendet e Evropës japin të dhëna shumë më të ulta 27.20%.

Tabela 7.

Bëj detyrat e shtëpisë më shumë se 3 orë në ditë gjatë ditëve të javës

	M	F	Gj	HBSC	
11 vj.	69.20%	63.60%	66.60%	15.10%	2.0–54.9
13 vj.	61.10%	89.40%	75.60%	20.10%	1.7–66.4
15 vj.	72.70%	78.50%	76.00%	21.70%	1.8–58.9

Grafiku 3.



Shqipëria 76% për të tre grupmoshat së bashku (3).

Fëmijët tanë raportojnë shifra shumë të rritura (Gj), 76% e tyre harxhojnë mbi 3 orë në ditë për detyrat e shtëpisë (Tabela 7 e Grafiku 3).

Të gjitha moshat në krahasim me Evropianët (21.7%) harxhojnë mbi 3 orë kohë duke kryer detyrat e shtëpisë gjatë javës. Ndoshta kjo është e lidhur me faktin se në Evropë fëmijët kthehen në shtëpi me detyra të bëra qysh në shkollë pasdite (pas dreke).

Tabela 8.

Bëj detyrat e shtëpisë më shumë se 3 orë gjatë të shtunave dhe të djelave

	M	F	Gj	HBSC	
11 vj.	53.80%	54.50%	54.10%	13.70%	1.1–45.6
13 vj.	55.50%	68.40%	62.10%	19.90%	1.8–59.0
15 vj.	72.70%	85.70%	80.00%	24.40%	2.8–57.9

Edhe në ditët e fund javës e njejta situatë në lidhje me detyrat e shtëpisë (Tabela 8), dhe e krahasuar me HBSC shifrat janë të larta, 80 % e fëmijve tanë raportojnë të harxhojnë mbi 3 orë. Ndoshta kjo është e lidhur me kulturën e weekend-it në Evropë. Fëmijët nuk bëjnë detyra në fund javë.

Shikojmë që fëmijët tanë kalojnë kohë të gjatë duke parë televizion dhe duke bërë detyrat e shtëpisë. Kjo hedh poshtë faktin e të qenit të tyre aktiv, aq sa duhet për këto mosha, apo krahasuar me bashkëmoshatarët e tyre Evropianë.


Zakonet e të ushqyerit

Tabela 9.

Ha mëngjez çdo ditë para se të shkoj në shkollë

	M	F	Gj	HBSC	
11 vj.	61.50%	63.60%	62.50%	71%	43.6–89.5
13 vj.	33.30%	26.30%	29.70%	62.50%	36.1–79.3
15 vj.	18.10%	28.50%	24.00%	57.60%	33.9–74.5

Grafiku 4.



Shqipëria 35% për të tre grupmoshat së bashku (3).

Zakoni i ngrënjes së mëngjezit është i një rëndësie të veçantë për shëndetin e fëmijës dhe (Tabela 9 e Grafiku 4) vetëm në **moshat 11 vjeç** tek ne shikojmë, si për meshkuj 61.5% edhe për femra 63.6%, që kujdesen po aq sa edhe Evropianët 71%.

Në moshë të tjera **13 dhe 15 vjeç** kjo shifër bie respektivisht 29.70% dhe 24.00%.

Kjo shpjegohet me faktin që deri në moshën 11 vjeç fëmijët kanë vartësi më të madhe nga familja dhe kjo e fundit kujdeset më shumë për të vegjëlit.


Mbi pesha

Tabela 10.

Vlerësoj vehten të shëndoshë, mbi peshë

	M	F	Gj	HBSC	
11 vj.	0.00%	0.00%	0.00%	24.80%	9.2–35.5
13 vj.	16.60%	26.60%	21.60%	30.20%	9.5–42.1
15 vj.	9.00%	14.20%	12.00%	31.90%	10.2–43.0

Grafiku 5.



Shqipëria 15% për të tre grupmoshat së bashku (3).


Vlerësimi I peshës nga vetë fëmijët (Tabela 10 e Grafiku 5) jep shifra të kënaqshme në krahasim me HBSC, kjo është më e dukshme tek meshkujt, ata janë të kënaqur me peshën e tyre. **Femrat** duken që janë më të kujdesshme dhe të reagojnë ndaj peshës qysh në moshën **13 vjeç**, 26.6% e tyre. Ato kërkojnë të kontrollojnë peshën e tyre.

Tabela 11.

Mbaj dietë që të bie në peshë

	M	F	Gj	HBSC	
11 vj.	15.30%	0.00%	8.30%	10.50%	4.7–23.9
13 vj.	5.50%	15.70%	10.80%	13.40%	6.0–26.6
15 vj.	18.10%	35.70%	28.00%	15.10%	8.4–26.6

Grafiku 6.



Çeshtja e mbajtjes së dietës, e lidhur kjo edhe me çka thamë më parë, është e shprehur tek **femrat** (Tabela 11 e Grafiku 6) dhe sidomos **pas moshës 13 vjeç**, 35.7% tentojnë të mbajnë dietë, shifrat që janë më të larta se HBSC 15.1%.

PERFUNDIME DHE REKOMANDIME

Duke analizuar rezultatet e studimit dalim ne konkluzionin qe:

Jeta sedentare është një problem I madh për të rinjtë tanë. Ata shpenzojnë një kohë të gjatë para televizionit, kompiuterit dhe duke bërë detyrat e shtëpisë.

Duke asociuar sedentaritetin me të qenit aktiv, hidhet poshtë vetëraportimi i fëmijëve tane që raportojnë se janë aktiv më shumë se një ore.

Edhe në rrethin tonë (Kurbini, zona suburbane dhe rurale) ka filluar të vihet re mënyra e gabuar e ushqyerjes, sidomos në moshën 13 dhe 15 vjeç, mosngrënje e mëngjezit.

Vajzat janë më të kujdesshme ndaj peshës së tyre dhe tentojnë të mbajnë dietë, por në mënyrë të gabuar duke mos ngrënë mëngjez dhe pa i kushtuar vemendje aktivitetit fizik.

Të rritet më tej në mënyrë të programuar, puna për edukimin shëndetësor të të rinjve ne shkolla, e sidomos për ceshtjet e ushqyerjes dhe aktivitetit fizik. Ajo të nxisë të rinjtë drejt sjelljeve të shëndetshme.

Të bashkëpunohet arsimtarët, familjarët dhe pushteti lokal, për të krijuar mundësinë e kalimit të kohës së lirë të të rinjve në mënyrë të organizuar dhe përfituese për shëndetin e tyre.

REFERENCAT

1. Currie C et al., eds. *Health and health behaviour among young people*. Copenhagen, WHO Regional Office for Europe, 2002 (Health Policy for Children and Adolescents, No. 1; <http://www.who.dk/document/e67880.pdf>, accessed 20 January 2004).
2. HBSC. *Inequality in young people's health*. Copenhagen, WHO Regional Office for Europe, 2008 (Health Policy for Children and Adolescents, No. 5): (f 2-8, 185-206).
3. Mihali E, Petrela E. “ *Sjelljet e shëndetëshme në fëmijët e moshës shkollore*” 2009. (HBSC) Shqipëri. (f 18-27, 31-39)
4. *Physical activity and health: a report of the Surgeon General*. Atlanta, GA, Centers for Disease Control and Prevention, U.S. Department of Health and Human Services, National Center for Chronic Disease Prevention and Health Promotion, 1996 (<http://www.cdc.gov/nccdphp/sgr/sgr.htm>, accessed 20 January 2004).
5. King A et al. *The health of youth: a cross-national survey*. Copenhagen, WHO Regional Office for Europe, 1996 (WHO Regional Publications, European Series No. 69; http://www.euro.who.int/InformationSources/Publications/Catalogue/20010911_53, accessed 28 January 2004).
6. Stratobërdha Dh. Leksione “ Shëndeti publik” 2008

SUMMARY

HEALTH BEHAVIOR AMONG YOUNG PEOPLE 11-15 YEARS IN KURBINI, ALBANIA

Aida Shehu¹, Dhimitraq Stratobërdha¹

¹Department of Sports, Tirana, Albania

University of Sports in Tirana, Albania

The target population of the study comprises young people attending school, aged 11, 13 and 15 years (Kurbini district) in total 86 (male 42 and female 44) and covers different aspects of health. The study instrument was a standard questionnaire focused on: physical activity, sedentary behavior, eating habits and body image. Our data show that boys report being physically active for at least an hour a day more than girls. Our young people spend a long time in front of television, computer and doing school homework, and more boys than girls, for all age groups. The data shows that 70-75% of boys and girls aged 13-15 years, skip breakfast. Our young people, particularly girls aged 13-15 years, feel fat and dissatisfied with their bodies. Dieting and weight control behavior show clear gender differences.

Key words: Physical activity, sedentary behavior, dieting


PUNIM BURIMOR SHKENCOR / ORIGINAL SCIENTIFIC PAPER
VETERINË

**PRANIA E ENTEROBAKTEREVE (SALMONELLA SPP. DHE E. COLI) NË
 SHPENDË DHE NDJESHMËRIA E TYRE NDAJ ANTIBIOTIKËVE**

Jonida Boci¹, Pranvera Çabeli², Jasemin Bejleri²

¹Instituti Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare, Tiranë, Shqipëri

²Fakulteti Mjeksisë Veterinare, Universiteti Bujqësor, Tiranë, Shqipëri



Jonida Boci, MA

Rruga Aleksander Moisiu, nr. 10

Tiranë, Shqipëri

Tel: +355-4- 2364283

e-mail: jonaboci@yahoo.com

PËRMBLEDHJE: *Ndryshimi i ndjeshmërisë së shtameve ndaj antibiotikëve ka sjellë kohët e fundit probleme në luftimin e sëmundjeve të shkaktuara nga enterobakteriacet, sidomos ndaj kolibacilozave. Qëllimi i këtij studimi fokusohet në vlerësimin e pranisë së enterobakterieve (Salmonella spp. dhe E. Coli) në shpendë si dhe ndjeshmëria e tyre ndaj antibiotikëve. Të dhënat e këtij studimi treguan kurba jo të qëndrueshme të ndjeshmërisë së antibiotikëve me veprim të shpejtë që i perkasin grupeve të quinoloneve, të cilët kanë pësuar rënie të ndjeshmërisë ndaj izolateve. Gjithashtu, një pjesë e shtameve që ju nënshtruan testit biokimik, rezultuan të pa identifikuar. Ky fakt tregon që kemi të bëjmë me shtame të reja që kanë pësuar mutacione nga veprimi i antibiotikëve, gjë e cila çon në uljen e ndjeshmërisë së tyre. Përdorimi i antibiotikëve duhet të bëhet në bazë të standarteve dhe udhëzuesve të caktuar nga Bashkimi Evropian dhe ato në nivel kombëtar. Përdorimi i tyre në kafshë duhet të specifikohet sipas llojit të specieve, efektshmërisë së tij dhe mbi të gjitha në rastet e luftimit të infeksioneve duhet bërë bazuar në provën e antibiogramës.*

Fjalë kyç: *Antibiotikët, shpendë, infeksione, salmonella spp., e. Coli*

Medicus 2012, Vol. XVII (1):

HYRJE

Që nga koha e zbulimit të antibiotikut të parë e në vazhdim një numër i madh antibiokësh me veti të ndryshme antibakteriale dhe farmako-kinetike, kanë bërë të mundur ndryshimin rrënjësor në prognozën e sëmundjeve infektive tek humanët dhe kafshët, si në parandalimin ashtu dhe trajtimin e tyre. Falë këtij zhvillimi infeksionet nuk janë më “kërcënuesit” e zakonshëm të jetës dhe sukcesi në trajtimin e tyre përbën një nga arritjet më të mëdha në mjeksinë terapeutike si atë humane ashtu dhe atë veterinare (1).

Edhe pse progres shumë i madh është bërë në parandalimin dhe trajtimin e shumë sëmundjeve bakteriale, çrrënjësja apo eliminimi i tyre duket se është akoma shumë larg, pasi infeksionet në vetvete gjejnë forma dhe mjete të ndryshme për të vazhduar agresionin e tyre (1). Nga ana tjetër mikroorganizmat janë bërë shumë më rezistentë ndaj antibiotikëve, ndërsa infeksionet shkaktohen jo vetëm nga bakteriet patogjenë por dhe nga ato saprofitë (3, 4, 5). Këtu kanë ndikuar dhe një numër të tjerë faktorësh, si psh përdorimi pa kriter i antibiotikëve, rritja e frekuencës së sëmundjeve imunodeficitare etj. (1).

Në praktikën e përdorimit të antibiotikëve, si në fushën humane ashtu dhe në atë veterinare, pas një farë kohe përdorimi fillon shfaqja e shtameve rezistente ndaj antibiotikëve (6).

Fenomeni i rezistencës bakteriale kërkon një kujdes të veçantë nga specialistët e fushave përkatëse, jo vetëm në njohjen e plotë të mekanizmave të veprimit të antibiotikëve e cila ndihmon në ndërtimin e skemës së mjekimit dhe llojit të antibiotikut që do të përdoret, por dhe për faktin se rezistenca mund të jetë ekstra-kromozomike, d.m.th, e transferuar nëpërmjet mikrobeve rezistente nga kafsha tek njeriu (6).

Qëllimi i këtij studimi fokusohet në vlerësimin e pranisë së enterobakterieve (*Salmonella* spp. dhe *E. Coli*) në shpendë si dhe ndjeshmëria e tyre ndaj antibiotikëve. Përmes gjetjeve të këtij studimi tentohet të jepet një pasqyrë mbi rezistencën e antibiotikëve në përdorimin veterinar, por në të njëjtën kohë këto rezultate mund të jenë të vlefshme dhe për mjeksinë humane për të patur një panoramë më të plotë mbi rezistencën e antibiotikëve dhe rrezikun e transferimit të saj nga kafshët tek njerëzit.

QËLLIMI I STUDIMIT

Qëllimi kryesor i këtij studimi është identifikimi dhe izolimi i *E. coli*, *Salmonella* spp. dhe *Enterobakter* spp. në shpendë (komplekse industriale dhe shpendet e oborrit) dhe përqindja që zënë ato ndaj infeksioneve të tjera.

Përmes këtij procesi do të vlerësohet:

- Ndjeshmëria e *E. Coli*, *Salmonella* spp. dhe *Enterobakter* spp. të izoluara ndaj antibiotikëve.
- Përcaktimi i antibiotikëve më të efektshëm në luftën kundër infeksioneve të shkaktuara nga *E. Coli*, *Salmonella* spp. dhe *Enterobakter* spp.
- Shkaqet e rezistencës së antibiotikëve ndaj këtyre dy infeksioneve.

MATERIALI DHE METODA

Gjatë periudhës 5-vjecare të studimit (2006-2010) u kontrolluan për izolimin e gjinive të familjes enterobakteriace 2.310 krerë shpendë, ku u përfshinë shpendë për prodhim vezësh, shpendë për prodhim mishi, gjela deti dhe zogj gjela deti.

Po brenda të njëjtës periudhë, për të provuar ndjeshmërinë e gjinive të familjes enterobakteriace, ju nënshtruan provës së antibiogramës 374 izolate, ku u përdorën sipas disponibilitetit dhe nevojave praktike për mjekim antibiotikët e mëposhtëm me provën e antibiogramës: *Chloramphenikol*, *Norfloxacin*, *Enrofloxacin*, *Doxycycline*, *Tetracycline*, *Oxytetracycline*, *ColistinSulfa*, *Amoxycillin*, *Neomycin*, *Flumequin*, *Trimethoprim Sulfat*, *Linko- Spektin* dhe *Furazolidon*.

Metodika e kryerjes së antibiogramave ka qenë e zakonshme. Në terren ushqyes të ngurte të shtruar në pllake Petri, inokulohet në mënyrë sterile 1 ml kulturë mikrobike e kultivuar për 4-5 orë në inkubator me temperaturë 37°C. Pasi laget mirë terreni ushqyes nga kultura mikrobike, mbi të vendosen disqet e antibiotikëve dhe pastaj bëhet inkubimi në temperaturë 37°C për 24 orë.

Në rastet kur kultura mikrobike është e ndjeshme ndaj antibiotikut në zonën rreth diskut të antibiotikut krijohet një zonë frenimi e pastër (nuk kemi rritje të mikrobit). Diametri i zonës së pastruar tregon nivelin e ndjeshmerisë së mikrobit dhe kjo përcaktohet nga firma që ka prodhuar disqet e antibiotikëve.

Sipas këtij diametri ndjeshmëria klasifikohet:

- Ndjeshmëri e plotë, e shprehur me 4 kryqe +++++
- Ndjeshmëri mesatare, e shprehur me 3 kryqe +++

- Ndjeshmëri e dobët e shprehur me 2 kryqe ++
- E pandjeshme, e shprehur me shenjën -


REZULTATET

Grafiku 1 përmbledh numrin e izolateve të veçuara për çdo vit sipas gjinive përkatëse (E. Coli, Salmonella spp. dhe Enterobakter spp.).

Të dhënat e tabelës së mësipërme tregojnë se për të pesë vitet e marra së bashku, nga tre gjinitë kryesore të izoluar, vendin e parë e zë gjinia *E. Coli* (64.6%), e ndjekur nga *Salmonella spp.* (16.3%) dhe në vend të tretë renditet *Enterobakter spp.* (8.13%).

Grafiku 1:

Numri i shtameve në provë i ndarë sipas viteve




Ndjeshmëria e *E. coli*, *Salmonella spp.* dhe *Enterobakter spp.* ndaj antibiotikëve

Të 374 izolatet e marra gjatë periudhës së studimit ju nënshtruan provës së antibiogramës për të vlerësuar ndjeshmërinë e tyre ndaj antibiotikëve.

Rezultatet në Grafikon 2 tregojnë ndjeshmërinë ndaj antibiotikëve të tre gjinive kryesore të marra në studim. Për antibiotikët me përqindje ndjeshmërie nën 20% (*E. coli*) apo ato nën 10% (*Salmonella spp.* dhe *Enterobakter spp.*) nuk janë marr në konsideratë në këtë studim.

Grafiku 2

Ndjeshmëria e *E. coli*, *Salmonella spp.* dhe *Enterobakter spp.* ndaj antibiotikëve



\Siç vihet re, izolatet që u perkasin të tre gjinive kanë qenë më të ndjeshëm kryesisht ndaj Linko-Spectinës, Colistinës, Norfloxacinës dhe Furazolidonit. Por në përgjithësi, edhe ndaj këtyre antibiotikëve përqindja e ndjeshmërisë nuk është e lartë.

Ndjeshmëria e izolateve të fituara sipas llojit, moshës dhe shfrytëzimit ekonomik

Nga të dhënat statistikore të mbledhura në këtë studim nuk ka diferenca domethënëse midis ndjeshmërisë së izolateve (*E. Coli*, *Salmonela spp.* dhe *Enterobakterie spp.*) të vecuara nga zogjtë e pulat për prodhim për vezë dhe zogjtë e pulat me drejtim për prodhim mishi.

Ndjeshmëria e izolateve të fituara nga familja enterobakteriace në shpendët e oborrit ndaj antibiotikëve.

Ndjeshmëria ndaj antibiotikëve e izolateve të tre gjinive pasqyrohet në Tabelën 1:

Tabela 1:

Ndjeshmëria e antibiotikëve ndaj izolateve të marra nga shpendët e familjarëve për periudhën 2006 – 2010

<i>E. coli</i>		<i>Salmonela spp.</i>		<i>Enterobaker spp.</i>	
Antibiotiket	%	Antibiotiket	%	Antibiotiket	%
Linko-Spectin	79	Colistin	62	Colistin	43
Norfloxacin	35	Enrofloxacin	50	Enrofloxacin	28
ColistinSulfat	32	Linko-Spectin	44	Linko-Spectin	21
Enrofloxacin	25	Trimethosulfat	44	Doxycycline	21
Flumequin	25	Norfloxacin	31		
Chloramphenicol	24	Doxycycline	25		

Rezultatet e mësipërme tregojnë se për *E.coli* antibiotiku më i ndjeshëm është Linko-Spectina (79%). Ndërsa ndjeshmëria e antibiotikëve të tjerë në këte grup pëson një rënie të ndjeshme, që varion nga 35% për Norfloxacinën e deri ne 24% per Chloramphenicolin. Përsa i përket *Salmonella spp.*, antibiotiku më i ndjeshëm rezulton të jetë Colistina (62%) e ndjekur nga Enrofloxacina (50%), e më pas me Linko-Spectinën (44%) e deri tek Doxycyclina (25%). Edhe në grupin tjetër (*Enterobakter spp.*), Colistina zë vendin e parë (43%) mes antibiotikëve të tjerë, e ndjekur nga Enrofloxacina, Linko-Spectina e Doxycyclina. Nga të dhënat e fituara gjatë periudhës 5 vjeçare të studimit për ndjeshmërinë e gjinisë enterobakteriace ndaj antibiotikëve, në rreth 97% të rezultateve i përkasin komplekseve industriale. Pjesa tjetër i përket rezultateve të marra nga shpendët e oborrit.

Krahasimi i ndjeshërisë së antibiotikëve ndaj izolateve të marra nga komplekset industriale dhe shpendëve të oborrit paraqitet në tabelën 4:

Tabela 4:

Ndjeshmëria e antibiotikëve ndaj izolateve të marra nga komplekset industriale dhe shpendëve

Antibiotiket	Komplekse Industriale			Shpende te oborrit		
	E. Coli	Salmonela spp.	Enterobakter spp.	E. Coli	Salmonela spp.	Enterobakter spp.
Linko-spektin	63	41	5	79	44	21
Colystin	47	29	15	32	62	43
Norfloxacin	63	21	11	35	31	7
Enrofloxacin	23	26	3	26	50	28
Flumequine	26	23	4	26	6	0
Neomycine	29	17	15	15	6	0
Trimethosulfa	26	23	3	11	44	0
Furazolidon	38	0	0	20	6	14
Chloramphenicol	13	31	5	23	0	7
Amoxycyline	16	0	0	9	0	14

Siç mund të vihet re dhe nga të dhënat e pasqyruar në Tabelën 4, antibiotikët më të ndjeshëm ndaj izolateve të *E. Coli* që i përkasin komplekseve industriale janë: *Norfloxacina* (nr: 63), *Colistina* (nr: 47), *Neomycina* (nr: 29), *Trimethosulfa* (26) dhe *Furazolidoni* (38).

Ndërsa në shpendët e oborrit, antibiotikët më të ndjeshëm janë: *Linko-Spectina* (nr: 79), *Enrofloxacina* (nr: 26) dhe *Chloramphenicoli* (nr: 23).

Antibiotikët më të ndjeshëm ndaj izolateve të *Salmonela spp.* që i përkasin komplekseve industriale janë: *Flumequina* (nr: 26) dhe *Neomycina* (nr: 29). Ndërsa në shpendët e oborrit, antibiotikët më të ndjeshëm ndaj izolateve janë: *Coistina* (nr: 62), *Enrofloxacina* (nr: 50), *LlinkoSpektina* (nr. 44) dhe *Trimethosulfa* (nr. 44) dhe *Norfloxacina* (nr: 31).

Antibiotiku i ndjeshëm ndaj izolateve të *Enterobakter spp.* që i përkasin komplekseve industriale në krahasim me shpendët e oborrit është *Norfloxacina* me 11 izolate. Ndërsa ndjeshmëria e antibiotikëve, si: *Enrofloxacina* (nr: 28) dhe *Linko-Spectina* (nr: 21) është më e madhe në izolatet e fituara në shpendët e oborrit në krahasim me komplekset industriale.

KONKLUZIONE

Përdorimi me maturi dhe korrektësi i antibiotikëve gjithmonë ka qenë një temë e debatueshme dhe përcaktimi i udhëzuesve të përdorimit të antibiotikëve si në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar ka qenë i vështirë dhe pse jo i pamundur deri më sot. Këtu kanë ndikuar shumë faktor, të tillë si prevalenca apo tendenca e sëmundshmërisë, të cilat ndryshojnë nga një vend në tjetrin; cilësia dhe kostoja e antibiotikëve, abuzimi i tregtuesve si dhe mos kuptimi sa më i plotë i mekanizmit rezistencës së antibiotikëve dhe impakti i saj në shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve.

Ky studimi u fokusua në vlerësimin e ndjeshmërisë së antibiotikëve me veprim të shpejtë ndaj infeksioneve të shkaktuara nga izolatet e gjinive të familjes enterobakteriace. Nga të dhënat e përfituara gjatë pesë viteve, u vërejt se antibiotikët me veprim të shpejtë që i përkasin grupit të quinoloneve, si psh : *Enrofloxacina*, *Norfloxacina* etj, kanë një rënie të ndjeshmërisë ndaj izolateve. Gjithashtu, u vërejtën kurba jo të qëndrueshme të ndjeshmërisë së antibiotikëve me veprim të shpejtë që i përkasin grupeve të quinoloneve, të cilët kanë pësuar rënie të ndjeshmërisë ndaj izolateve, si psh: *Chloramphenicoli*, *Norfloxacina* apo *Enrofloxacina* – të cilët gjatë periudhës 5- vjeçare të studimit kanë pësuar rënie të ndjeshme të ndjeshmërisë së tyre.

Ndërsa për antibiotikët me veprim të ngadaltë (që përthithen nga zorrët e holla), si psh: *Colistina*, *Neomycina* vihet re një rritje e ndjeshmërisë së tyre ndër vite. Luhatjet e ndjeshmërisë së antibiotikëve ndikojnë në parandalimin e infeksioneve, por nuk bëjnë të mundur luftimin e plotë të tyre.

Të dhënat e mbledhura sipas viteve tregojnë se përqindjet e ndjeshmërisë së shtameve në provë ndaj antibiotikëve kanë patur lekundje, pra nuk ka patur ndonjë kurbe të rregullt me ulje dhe ngritje.

Ky fenomen mund të rezultojë nga fakti se:

- Shtamet në vetvete mund të kenë ndjeshmëri të ndryshme gjenetike, të lindur apo të fituar;
- Vet shtamet pësojnë mutacione nga veprimi i shpeshtë i antibiotikëve;
- Në vendin tonë hyjnë vazhdimisht shpendë të cilët mbartin me vete shtame me ndjeshmëri të ndryshme ndaj antibiotikëve;
- Përdorimi në komplekset tona me kriter apo pa kriter i antibiotikëve, në doza profilaktike dhe kurative, të cilat në kontakt të vazhdueshëm me enterobakteriacet ndryshojnë ndjeshmërinë ndaj tyre;
- Një element tjetër i rëndësishëm që u vërejt gjatë këtij studimi ishte fakti që një pjesë e shtameve që ju nënshtruan testit biokimik, rezultuan të pa identifikuar. Ky fakt tregon që kemi të bëjme me shtame të reja që kanë pësuar mutacione nga veprimi i antibiotikëve, gjë e cila con në uljen e ndjeshmërisë së tyre.

Ndryshimi i ndjeshmërisë së shtameve ndaj antibiotikëve ka sjellë kohët e fundit probleme në luftimin e sëmundjeve të shkaktuara nga enterobakteriacet, sidomos ndaj kolibacilozave.

Përdorimi pa kriter i antibiotikëve pa ju nënshtruar më parë provës së antibiogramës shpje në virulentimin e mikrobeve jo patogjen të cilët janë rezistent ndaj pjesës më të madhe të antibiotikëve dhe

pengon luftimin e infeksionit. Nga ana tjetër, përdorimi i antibiotikëve të kombinuar (si psh : Keproceryl) për parandalimin e infeksioneve të mundshme, çon në uljen e efikasitetit të forcës vepruese të tyre në rastet kur kemi të bëjmë me shfaqjen e infeksionit.

Për të qenë në gjendje të vlerësojmë riskun e përdorimit të antibiotikëve me kriter në shëndetin e kafshëve, nevojitet më shumë informacion mbi sasinë dhe llojin e antibiotikut që do të përdoret. Të dhënat, mbi sasinë e antibiotikëve të përdorur për të nxitur rritjen e peshës në kafshë, parandalimin dhe luftimin e infeksioneve, duhet të bëhet në bazë të standarteve dhe udhëzuesve të caktuara nga BE-ja dhe ato në nivel kombëtar. Gjithashtu, përdorimi i antibiotikeve në kafshë duhet të specifikohet sipas llojit të specieve, efektshmërisë së tij dhe mbi të gjitha në rastet e luftimit të infeksioneve duhet bërë bazuar në provën e antibiogramës.

Në fakt më shumë të dhëna dhe studime të mirëfillta duhen për të kuptuar plotësisht rrezikun që vjen nga përdorimi i antibiotikëve në mënyrë që të hartoheshin dhe zbatoheshin strategji efektive për menaxhimin dhe mirëpërdorimin e tyre.

REKOMANDIME

Nga rezultatet dhe gjetjet e fituara nga ky studim, por bazuar dhe në praktikën botërore veterinare, më poshtë po paraqisim disa rekomandime që duhet të merren parasysh në praktikën veterinare:

- ✓ Zgjedhja e antibiotikëve duhet të bëhet mbështetur vetëm mbi kriteret shkencore të përzgjedhjes së tyre në laboratorët përkatës. Ky proces jo vetëm ndihmon në rritjen e efektit terapeutik, por në të njëjtën kohë minimizon antibiotiko-rezistencën.
- ✓ Kur përzgjidhet një antibiotik duhet patur parasysh; doza, rruga e administrimit, kohëzgjatja e veprimit të tij në organizëm, efektet farmakokinetike (ku rëndësi ka gjysmëjeta biologjike), sensibiliteti i kafshës dhe mbetjet e antibiotikut në produkt etj.
- ✓ Përdorimi i antibiotikëve duhet të bëhet sipas një zgjedhje të përcaktuar :
 - a. Grupi parë : antibiotikët që kanë një efekt të mirë por me spektër të ngushtë veprimi dhe që paraqesin një risk të ulët në shfaqjen e rezistencës si p.sh : Trimethoprimsulpha, Flumequin, Amoxycilin, Tetracyclin apo Sulphoquinoxalina ;
 - b. Grupi dytë : antibiotikët që kanë një efekt shumë të mirë dhe spektër të gjerë veprimi, por paraqesin risk të lartë në krijimin e rezistencës si ; Enrofloxacin, Difloxacin, Linc-Spectrina, etj ;
 - c. Grupi i tretë : kombinimi i antibiotikëve të grupit të parë dhe të dytë kur nuk japin efekt. Në këtë rast rekomandohet kombinimi i antibiotikëve.
- ✓ Për të kufizuar rastet e mutacioneve në ndjeshmërinë e shtameve ndaj antibiotikëve, në rastet e infeksioneve të përsëritura të bëhet ndërrimi i antibiotikut, por gjithnjë sipas antibiogramës dhe të kontrollohet vazhdimisht rezistenca e bakterieve ndaj antibiotikëve. Të evitohet ose të pakësohet përdorimi i tyre në maksimum në racionet ushqimore për qëllime auksinike.
- ✓ Mbajtja e të dhënave të sakta mbi përdorimin e antibiotikëve: kjo masë duhet të zbatohet jo vetëm në fermat apo komplekset industriale por dhe në tufat familjare. Për çdo trajtim me antibiotikë duhet të mbahen të dhëna të sakta dhe të plota mbi përdorimin e tij për secilën kafshë/tufë. Kjo do të ndihmonte shumë mjekun veterinar për trajtimin me efikasitet të infeksioneve të tjera në të ardhmen.
- ✓ Për të përcaktuar lidhjen ndërmjet shfaqjes dhe trendit në rezistencën dhe përdorimin e antibiotikëve është e rëndësishme që të dhënat mbi sasinë e antibiotikëve të përdorur të jenë specifikisht të kalkuluar për ato kafshë tek të cilat janë marrë të dhënat mbi rezistencën.
- ✓ Vendosija e udhëzuesve specifik për trajtimin me antibiotikë të sëmundjeve, kjo në varësi të llojit të kafshës dhe zonës/fermës/kompleksit ku ato mbarësohen.

LITERATURA

1. Levy, S.B., B. Marshall., S. Schluederberg., D. Rowse and J. Davies, 1988. High frequency of antimicrobial resistance in human fecal flora. *Antimicrob Agents Chemother*, 32: 1801-1806.
2. Barnes, H.J. and W.B. Gross, 1997. Colibacillosis. In: Gross, W. B. (Ed.), *Diseases of Poultry*. Iowa State University Press, Ames Iowa, pp: 131- 141.
3. Bower, C.K. and M.A. Daeschel, 1999. Resistance Health and Medical Research Council responses of microorganisms in food environments. *Int. J. Food Microbiol.*, 50: 33-44.
4. Catry, B., H. Laevens, L.A. Devriese, G. Opsomer and A. De Kruif, 2003. Antimicrobial resistance in livestock. *J. Vet. Pharmacol. Therapy.*, 26: 81- 93.
5. Gould, I.M., 2008. The epidemiology of antibiotic resistance. *Int. J. Antimicrob. Agents*, doi:10.1016/j.ijantimicag. (In press, accessed 15 Sept. 2008).
6. Van der Bogaard, A.E. and E.E. Stobberingh, 1999. Antibiotic usage in animals: impact on bacterial resistance and public health. *Drugs.*, 58: 589- 607.
7. Randall, L.P., A.M. Ridley, S.W. Cooles, M. Sharma, A.R. Sayers and L. Pumbwe, 2003. Prevalence of multiple antibiotic resistances in 443 *Campylobacter* spp. isolated from humans and animals. *J. Antimicrob. Chemothera*, 52: 507-510.

SUMMARY

THE PRESENCE OF ENTEROBACTERES (SALMONELLA SPP. AND E. COLI) IN POULTRY AND THEIR SENSIBILITY TOWARDS ANTIBIOTICS

Jonida Boci¹, Pranvera Çabeli², Jasemin Bejleri²

¹Institute of Food and Veterinary Safety, Tirana, Albania

²Faculty of Veterinary Medicine, Agriculture University, Tirana, Albania

Changes in strain's sensitivity to antibiotics have recently led to problems in combating diseases caused by enterobacters, especially against colibacillosis. The purpose of this study focuses on assessing the presence enterobacters (Salmonella spp. and E. coli) in poultry and their sensitivity to antibiotics. Findings from the study showed no consistent curve of sensitivity of rapid-acting antibiotics belonging to the quinolone group, whose sensitivity to the isolates decreased. In addition, some strains that underwent the biochemistry test resulted as "unidentified strains". This fact shows that we are dealing with new strains that have undergone mutations on the action of antibiotics, which leads to the reduction of their sensitivity. Therefore, the use of antibiotics should be based on specific standards and guidelines from the European Union and national level. Their use in animals should be specified according to species, its effectiveness and, above all based on proof of antibiogram test.

Key words: Antibiotics, poultry, infections, salmonella spp., E. coli

MEDICUS

PUNIM PROFESIONAL / PROFESIONAL PAPER

GASTROENTERO-HEPATOLOGJI

MANIFESTIMET KLINIKE DHE BOKIMIKE NË KOLANGIOKARCINOMË

Albana Duni¹, Floreta Kurti², Valdete Malaj¹, Esmeralda Runa¹

QSUT "Nënë Tereza", Fakulteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri

¹Poliklinika e Specialiteteve Nr.3, Tiranë, Shqipëri

²Fakulteti i Infermierise, Universiteti i Tiranës, Shqipëri



Albana Duni, mjeke, gastroenterohepatologe
Poliklinika e Specialiteteve Nr.3
Rr. "Qemal Stafa" 1, Tiranë, Shqipëri
Tel: +3555682144554
e-mail: albanaduni@yahoo.com

REZYME: *Hyrje:* Kolangiokarcinoma është tumor i rrugëve biliare me letalitet të lartë, për shkak të prezantimit në një stad të avancuar lokal. Ajo bëhet simptomatike kur tumori bllokon sistemin e drenimit biliar, duke na dhënë një tablo kliniko-biokimike obstruktive. **Qëllimi:** Të nxjerrë në pah të dhënat kliniko-biokimike që shprehin obstrukcionin biliar malinj, në mënyrë që patologjia të zbulohet në një stad të hershëm e të trajtueshëm. **Të sëmuret dhe metodat:** Për këtë studim deskriptiv u shfrytëzuan të dhënat e marra në klinikën Gastroenterologji-Hepatologji QSUT "Nënë Tereza", në periudhën Janar 2004 - Tetor 2007. Janë përfshirë në studim kartelat klinike të 32 pacientëve: 17 meshkuj, (53%) dhe 15 femra, (47%), me moshë mesatare 64.3 vjeç, nga ku u kërkuan: moshë, gjinia, ankesat, historia e sëmundjes, të dhënat klinike, biokimike. Përpunimi statistikor u realizua me paketën SPSS 12.0 dhe sinjifikanca midis variaveleve diskrete u evidentua me testin Hi-katror. **Rezultatet:** Si pasojë e retensionit në gjak të të gjitha substancave, që normalisht do të ekskretoheshin me bilë, konstatuam një tablo kliniko-biokimike me: 1) hiperbilirubinemi dhe ikter në 94% të rasteve; 2) rritje paralele e GGT (90.6%) dhe ALP (100%); 3) prurit në 24 pacientë ose 75%; 4) feçe akolike/hypokolike në 72%; 5) urinim me ngjyrë të errët në 75% të rasteve; 6) prani e dhimbjes në 56% të rasteve ; 7) manifestime sistemike të malinjitetit në 97% të pacientëve. Ndër patologjitë shoqëruese më të shpeshta u evidentuan diabeti (22%), kalkuloza (22%), kisti i koledokut (9,3%) dhe angiokoliti (9,3%). Këto patologji përbëjnë faktorë risku në kolangiokarcinomë. **Përfundime:** Të dhënat kliniko-biokimike të obstrukcionit biliar, orientojnë drejt patologjisë malinje hepatobiliare, në qoftë se është e pranishme dhimbja abdominale dhe humbja e peshës. Popullatat në risk duhen identifikuar në mënyrë që tu ofrohen strategji preventive ose trajtim i hershëm profilaktik.

Fjalë kyç: Kolangikarcinoma, obstrukcion malinj biliar
Medicus 2012, Vol. XVII (1):

HYRJE

Simptomat e përbashkëta klinike në kolangiokarcinome përfshijnë pruritin (66%), dhimbjen abdominale (30-50%), humbje peshe (30-50%), dhe temperaturë (20%). Simptoma të tjera të lidhura me obstrukcionin biliar përfshijnë urinim me ngjyrë të errët dhe feçe akolike.

Ekzaminimet laboratorike sugjerojnë obstrukcionin biliar, me ngritje të bilirubinës totale dhe direkte, fosfatazës alkaline, 5-nukleotidazës, dhe gama-glutamyl-transferazës. Dy gjetjet e fundit konfirmojnë origjinën hepatobiliare të rritjes së fosfatazës alkaline. Niveli i aminotransferazave fillimisht mund të jetë normal por obstrukcioni kronik biliar shpesh çon në disfunkcion hepatic.

QËLLIMI I STUDIMIT

1. Të nxjerrë në pah të dhënat kliniko-biokimike që shprehin obstrukcionin biliar malinj, në mënyrë që patologjia të zbulohet në stad të hershëm dhe të trajtueshëm.

2. Të evidentojë korrelacionet e mundshme midis faktorëve të riskut dhe patologjisë malinje të traktit biliar.

MATERIALI DHE METODA

Për këtë studim deskriptiv u shfrytëzuan të dhënat e marra nga kartelat klinike të pacientëve me kolangiokarcinome, në Klinikën Universitare të Gastro-Hepatologjisë QSUT “Nënë Tereza”, në periudhën Janar 2004 -Tetor 2007. U kërkuan këto të dhëna: moshë, gjinia, ankesat, periudha e shtrimit, historia e sëmundjes, shenjat klinike, të dhënat e laboratorit. Në momentin e shtrimit janë marrë këto ekzaminime: bilirubina, ASAT, ALAT, GGT, ALP, hemoglobina, albumina, eritrosedimenti, leukocitet, glicemia, proteina totale. Janë bërë tre matje të bilirubinës me qëllim që të vlerësonim karakterin e ikterit. Gjithashtu janë marrë në konsideratë lipidograma dhe njëri nga markuesit tumoralë (CEA, alfa-feto proteina, CA 19-9). Të dhënat e mbledhura janë hedhur në një tabelë excel, nga ku është nxjerrë analiza statistikore. Të dhënat e vazhdueshme u paraqitën në vlerë mesatare dhe në devijacion standard. Të dhënat diskrete u paraqitën në vlerë absolute dhe në përqindje.

Për paraqitjen e të dhënave u përdorën tabela të thjeshta dhe të përbëra dhe grafikë të tipit Bar-diagram.

Sinjifikanca mes variableve diskrete u evidentua përmes përdorimit të testit Hi-katror.

Për analizën e të dhënave u përdor paketa statistikore SPSS 12.0.

REZULTATET DHE DISKUTIMI

Tabela 1. Statistika deskriptive


	N	Minimum	Maximum	Mesatare	SD
Moshë (vjet)	32	40.00	83.00	64.3125	11.68522
Historia (muaj)	32	50	12.00	2.1156	2.09656
F. alkaline (U/l)	32	109.00	2200.00	740.6875	497.28712
GGT (U/l)	32	74.00	2608.00	522.0938	447.65744
Bilir.1 (mg/dl)	32	2.60	13.00	5.4156	2.09486
Bilir. 2 (mg/dl)	28	2.00	13.00	5.5071	2.62889
Bilir.3 (mg/dl)	32	2.00	34.00	13.0250	8.43801
AST (U/l)	32	23.00	280.00	103.8125	55.87627
ALT (U/l)	32	17.00	235.00	103.0937	52.31379
N. protrombinës (%)	32	50.00	90.00	66.7844	12.41503
Albumina (%)	32	48.00	53.90	50.8625	1.37178
Hb (gr/dl)	32	8.80	14.00	10.8875	1.49251
CEA - Ca19.9 (UI)	32	1.00	2.00	1.3438	.48256
Alfa fetoproteina (UI)	32	1.00	2.00	1.2813	.45680
Kolesteroli (mg/dl)	32	130.00	513.00	260.4687	79.13524
Trigliceridet (mg/dl)	32	90.00	299.00	178.1250	48.42470
Glicemia (mg/dl)	32	78.00	324.00	138.4687	63.95461
Sedimenti (mm/h)	32	10.00	56.00	42.0938	9.98502
Prot. Totale gr/dl	32	6.30	7.60	7.0688	.39630
Leukocitet (mm/h)	32	2700.00	20200.00	7065.6250	3654.92239

Tabela 1 paraqet të dhënat e vazhduara në vlerë mesatare dhe deviacion standart. Moshë mesatare e pacientëve me kolangiokarcinomë është 64 vjeç, dhe një histori sëmundjeje mesatarisht 2 muaj. Parametrat biokimikë të obstrukcionit biliar konstatohen të larta (bilirubina, ALP, GGT). Aminotranferazat (ASAT, ALAT) konstatohen lehtësisht të rritura, që reflekton më shumë dëmtimin kronik të rrugëve biliare sesa patologjinë në fjalë. Ndër markuesit specifikë tumoralë u panë CA 19-9, CEA, dhe alfa-feto proteina ku del që, sensitiviteti dhe specificiteti i këtyre markuesve është i ulët për kolangiokarcinomën (me përjashtim të CA 19-9) (3, 4). Ndërsa albumina, proteina totale, sedimenti dhe hemoglobina, janë marrë në konsideratë për të vlerësuar markuesit sistemikë jo specifikë të malinjitetit, ku siç shihet paraqesin alterim. Leukocitoza u vu re në ato raste ku ishte i pranishëm kolangiti (3). Lipidograma dhe glicemia u morën në konsideratë për të vlerësuar çrregullimet metabolike.

Grafiku 1 tregon modelin obstruktiv me rritje të: bilirubinës, GGT, ALP (6). Nivelet serike të bilirubinës (kryesisht pigmenti i konjuguar) u gjenden të larta në 30 pacientë (94%) nga 32 që u përfshinë në studim, ALP u gjet e rritur në të 32 rastet (100%), dhe GGT u gjet e rritur në 29 pacientë (90,6%).

Mekanizmi i rritjes së ALP në kolestazë është kompleks. Vetë rritja e sintezës hepatike mund të jetë një shkak. Një rritje paralele e GGT konfirmon që burimi i rritjes së ALP është me origjinë hepatobiliare. Megjithatë, këto ekzaminime nuk kanë vlerë për diagnozën diferenciale pasi, patologji të tjera të shoqëruara me kolestazë, pavarësisht nga natyra e saj, shoqërohen me ikter dhe rritje të ALP.

Grafiku 1. Alterimet e bilirubinës, GGT, ALP



Glicemia, proteinat totale, albumina, kolesteroli dhe trigliceridet u panë të alteruar përkatësisht: glicemia në 7 pacientë (21,8%), proteinat totale të alteruara në 12 pacientë (37,5%), albumina e alteruar në 20 pacientë (62,5%), kolesteroli i alteruar në 21 pacientë (37,5%), trigliceridet të alteruara në 17 pacientë (53,1%). Çrregullimet lipidike reflektojnë rritjen e sintezës hepatike në kolestazë, regurgitacionin e kolesterolit biliar dhe lecitinës në qarkullim, dhe reduktimin e aktivitetit plazmatik të LCAT. Gjithashtu në kolestazë është konstatuar një lipoproteinë anormale X shumë e pasur në kolesterol të lirë dhe lecitinë. Por, çrregullimet lipidike dhe glucidike mund të atribuohen edhe faktit, që gjendje të tilla si obeziteti, hiperlipidemia dhe diabeti përshkruhen si shoqëruese në kanceret e traktit biliar (1, 2). Alterimet në proteina totale dhe albuminës i dedikohen patologjisë malinje.

Grafiku 2. Çrregullimet metabolike në kolangiokarcinomë





Tabela 2 paraqet frekuencën e kolangiokarcinomës sipas gjinisë (5, 6). Nga 32 raste me kolangiokarcinomë, 15 ishin femra ose 46.9%, dhe 17 raste ose 53.1% ishin meshkuj.

Tabela 2. Frekuenca e kolangiokarcinomes sipas gjinise

	Frekuenca	Përqindja
Femra	15	46.9
Meshkuj	17	53.1
Total	32	100.0

Vihet re një predominim i lehtë i meshkujve me kolangiokarcinomë në krahasim me femrat.

Grafiku 3. Frekuenca e kolangiokarcinomës sipas gjinisë



Në tabelën 3 shihet shpërndarja e kolangiokarcinomës sipas seksit në vite. Në vitin 2004 ka një predominim të lehtë të femrave, në vitin 2005, 2006, 2007 predominim i lehtë i meshkujve, por pa ndonjë ndryshim statistikor të rëndësishëm ($p = 0,769$).

Tabela 3. Shpërndarja e kolangiokarcinomës sipas seksit në vite

		Viti				Total
		2004	2005	2006	2007	
Gjinia	f	5	4	3	3	15
	m	3	5	4	5	17
Total		8	9	7	8	32


Për të gjithë pacientët janë vlerësuar të dhënat klinike që shprehin obstruksionin biliar si: ikteri, feçe akolike, urinim me ngjyrë të errët dhe pruriti (5, 6). Këto të dhëna klinike reflektojnë retensionin në gjak të të gjitha substancave që normalisht ekskretohen në bilë. Prania e ikterit paraqitet në tabelën nr 4. Nga 32 rastet tona, 30 (94%) prej tyre ishin ikterikë.

Tabela 4. Prania e ikterit në kolangiokarcinomë

	IKTER	Frekuenca	Përqindja
	po	30	93.8
	jo	2	6.3
	Total	32	100.0

Grafiku 5 paraqet prezencën e ikterit në 94% të rasteve tona. Mungesa e ikterit në 6% të rasteve shpjegohet me faktin që modeli klinik përcaktohet nga vendlokalizimi i kolangiokarcinomës (7). Në rastet që u shfaqën pa ikter, kolangiokarcinoma rezultoi e lokalizuar në duktuset biliare intrahepatike të njëjës anë.

Grafiku 5. Prania e ikterit në kolangiokarcinomë



Në grafikun nr 6 kemi vlerësuar karakterin e ikterit bazuar në tre matje të bilirubinës. Në 18 (56,2%) raste me kolangikarcinomë ikteri rezultoi intermitent, ndërsa në 14 (43,8%) rastet e tjera ikteri pati karakter progresiv. Ikteri intermitent është karakteristikë për kolangiokarcinomën dhe kjo është një e dhënë klinike e rëndësishme (6).

Grafiku 6. Karakteri i ikterit





Tabela 5 paraqet praninë e feceve akolike/hipokolike që vijnë si pasojë e mungesës së urobilinogenit. Kjo e dhënë klinike u konstatua në rreth 72% të rasteve tona.

Tabela 5. Prania e feceve akolike

Prania e feceve akolike	Frekuenca	Përqindja
po	23	71.9
jo	9	28.1
Total	32	100.0

Grafiku 7. Prania e feceve akolike




Nga tabela 6 shihet prania e urinimit me ngjyrë të errët, që u konstatua në 24 pacientë ose në rreth 75 % të rasteve.

Tabela 6. Prania e urinimit me ngjyrë të errët

Urinitim në ngjyrë të errët	Frekuenca	Përqindja
po	24	75.0
jo	8	25.0
Total	32	100.0

Grafiku 8. Prania e urinimit me ngjyrë të errët



Sic shihet nga grafiku, pjesa më e madhe e pacientëve kishin urinim me ngjyrë të errët për faktin që, një pjesë e bilirubinës së konjuguar në plazëm, dializohet dhe filtrohet nga glomerulat, një pjesë riabsorbohet nga tubulat dhe pjesa që ngelet i jep urinës ngjyrën e errët.


Nga tabela 7 vlerësohet prania e pruritit si një e dhënë tjetër klinike e obstruksionit biliar. Pruriti u konstatua në 24 pacientë ose në 75 % të tyre dhe mungoi në 8 pacientë ose në 25 % të tyre.

Tabela 7. Frekuenca e pruritit

Prurit	Frekuenca	Përqindja
po	24	75.0
jo	8	25.0
Total	32	100.0

Nga grafiku 9 shihet që pruriti është një e dhënë e rëndësishme klinike e ikterit mekanik. Ai lidhet probabilisht me nivelin e lartë të kriprave biliare dhe të përbërësve të tjerë. Zhdukja e pruritit, kur qelizat hepatike bëhen jo funksionale, tregon që agjenti përgjegjës ndoshta prodhohet nga hepari.

Grafiku 9. Prania e pruritit në kolangiokarcinomë




Për të gjithë pacientët tanë është vlerësuar prania ose jo e dhimbjes. Rezulton se nga 32 (100%) pacientë, dhimbja ishte e pranishme në 18 prej tyre ose në 56.3%.

Tabela 8. Prania e dhimbjes në kolangiokarcinomë


Dhimbja	Frekuenca	Përqindja
po	18	56.3
jo	14	43.8
Total	32	100.0

Shumë patologji malinje manifestohen me dhimbje, prandaj prania ose jo e saj nuk shërben si kriter për të vendosur ose për të përjashtuar diagnozën. Përkundrazi, ekzaminimi i kujdesshëm klinik që konstaton triadën e kolestazës, dhimbjen abdominale dhe humbjen e peshës, të orienton drejt patologjisë malinje hepatobiliare ose pankreatike (6).

Grafiku 10. Prania e dhimbjes në kolangiokarcinomë



Grafiku 11. Frekuenca e patologjive shoqëruese në kolangiokarcinomë



PËRFUNDIME

- Të dhënat kliniko-biokimike të obstruksionit biliar (ikter, prurit, urinim me ngjyrë të errët, feçe akolike/hipokolike, GGT, ALP, bilirubina në vlera të larta) orientojnë drejt patologjise malinje hepato-biliare, në qoftë se është e pranishme dhimbja abdominale dhe humbja peshës. Në punimin tone këto manifestime u konstatuan në 97% të rasteve.
- Ndër patologjitë shoqëruese më të shpeshta u evidentuan diabeti (22%), kalkuloza (22%), kisti i koledokut (9,3%) dhe angiokoliti (9,3%). Këto patologji përbëjnë faktorë risku në kolangiokarcinomë.

REFERENCA

- 1) Shaib, YH, El-Serag, HB, Davila, JA, et al. Risk factors of intrahepatic cholangiocarcinoma in the United States: A case-control study. *Gastroenterology* 2005; 128:620.
- 2) Bergquist, A, Glaumann, H, Persson, B, Broome, U. Risk factors and clinical presentation of hepatobiliary carcinoma in patients with primary sclerosing cholangitis: a case-control study. *Hepatology* 1998; 27:311.
- 3) Hultcrantz, R, Olsson, R, Danielsson, A, et al. A 3-year prospective study on serum tumor markers used for detecting cholangiocarcinoma in patients with primary sclerosing cholangitis. *J Hepatol* 1999; 30:669.
Analizuam vlerat e amilazës dhe lipazës në PA. Amilazemia u gjet e rritur në 33 pacientë (60.00%) dhe lipazemia në 42 pacientë (76.63%). Hiperamilazemia nuk është specifike për PA sepse ajo rritet në shumë patologji me origjinë ekstrapankreatike (16). Vlerat e amilazemisë më shumë se trefishi i normës zakonisht janë me origjinë pankreatike (17). Sensitiviteti i lipazemisë është i ngjajshëm me atë të amilazemisë rreth 85-100% (18). Lipazemia është më sensitive krahasuar me amilazeminë sepse origjina e saj është pankreatike. Ajo rritet ditën e parë dhe mbetet e lartë më gjatë se amilazemia (19).

Nga 55 të sëmurë me PA, 46 të sëmurë (83.63%) kishin vlera të rritura të PCR-së. Ajo që u vu re është se pacientët me vlera të PCR më shumë se 150 mg/dl kishin kaluar të gjithë pankreatit të rëndë, me komplikacione lokale e sistemike. PCR është një proteinë e fazës akute e përdorur gjerësisht, sensitiviteti i të cilës shkon nga 60-100% (për vlera më të mëdha se 100 -150Mg/dl) dhe specifikitet 75-100% (20).

Të gjithë pacientëve u është marrë gjak për Htc dhe u vu re se vlera mesatare e Htc për të sëmurët me PA të lehtë ishte 41% dhe për pacientët me PA të rëndë ishte 44%. Htc më shumë se 44% u gjet në 7 pacientë (12.72%). Pacientët me Htc më shumë se 44% kishin kaluar të gjithë PA të rëndë. Vlerat e larta të hematokritit në shtrim, ose mos rënia e tij 24 orë pas rrehidimit është shënjë e

hemokoncentrimin si pasojë e humbjes së likideve retroperitoneale, pra një tregues i sëmundjes së rëndë (21). Pacientëve iu mat peshja dhe gjatësia në shtrim, dhe u llogarit BMI (body mass index) për secilin prej tyre. Pacientët u ndanë në dy grupe; 21 pacientë (38.18%) me $BMI \geq 30 \text{ kg/m}^2$ dhe 34 pacientë (61.81%) me $BMI \leq 30 \text{ kg/m}^2$ ($p > 0.05$). Edhe pse statistikisht ky rezultat nuk është sinjifikativ, pesë nga pacientët që kaluan PA të rëndë, ishin të gjithë më $BMI \geq 30$.

PËRFUNDIME

Diagnoza e pankreatitit është një kombinim i të dhënave klinike, imazherike e laboratorike. Vlerësimi sipas kritereve të Ranson është i komplikuar sepse kërkon analizimin e disa të dhënave laboratorike, vlerësimi imazherik i shkallës së dëmtimit të gjëndrës sipas Balthazar është shumë i rëndësishëm, por jo gjithmonë i mundur. Madje, nuk egziston ndonjë korrelacion ndërmjet gravitetit të sëmundjes të vlerësuar sipas Ranson e atij Balthazar.

Vlerësimi i nivelit të enzimave amilazë e lipazë në gjak është kriteri rëndësishëm, edhe pse vlera të larta të amilazës nuk shkojnë paralel me shkallën e dëmtimit të gjëndrës. Lipazemia është ekzaminim më i besueshëm së amilazemia, vlera të lipazemisë më shumë se 3-4 fishi i normës flasin për PA të rëndë.

PCR është një test i thjeshtë dhe shumë i rëndësishëm në diagnozën e PA. Vlerat e PCR mbi 150mg/dl flasin për dëmtim të rëndë inflamator. Htc më shumë se 44% në shtrim flet për pankreatit të rëndë.

Obeziteti konsiderohet si faktor risku në pankreatitin akut. $BMI \geq 30$ është një faktor prognostik për ecurinë drejt pankreatitit të rëndë.

BIBLIOGRAFI

1. Assmus C, Petersen M, Gottesleben F, Druke M, Lankisch P. Epidemiology of acute pancreatitis in a defined German population. *Digestion* 1996;57:A217.
2. Balakrishnan V, Philip M. Cytokines as predictors of severity in acute pancreatitis. *J Gastroenterol Hepatol* 1998;13:1177-1179.
3. Balthazar E. CT diagnosis and staging of acute pancreatitis. *Radiol Clin North Am* 1989;27:19-37. Balthazar E, Freeny P, van Sonnenberg E. Imaging and intervention in acute pancreatitis. *Radiology* 1994;193:297-306.
4. Balthazar E, Robinson D, Megibö A, Ranson J. Acute pancreatitis: value of CT in establishing prognosis. *Radiology* 1990;174:331-336.
5. Bradley III E. A clinically based classification system for acute pancreatitis. Summary of the international symposium on acute pancreatitis, Atlanta, Ga, September 11-13, 1992. *Arch Surg* 1993;128:586-590.
6. Brisinda G, Maria G, Ferrante A, Civello I. Evaluation of prognostic factors in patients with acute pancreatitis. *Hepato-Gastroenterol* 1999;46:1990-1997.
7. Büchler M. Objectification of the severity of acute pancreatitis. *Hepato-Gastroenterol* 1991;38:101-108.
8. Chase C, Barker D, Russell W, Burns P. Serum amylase and lipase in the evaluation of acute abdominal pain. *Am Surg* 1996;62:1028-1033.
9. Clavien P-A, Burgan S, Moossa AR. Serum enzymes and other laboratory tests in acute pancreatitis. *Br J Surg* 1989a; 76:1234-1243
10. Lankisch PG, Schirren CA, Kunze E: Undetected fatal acute pancreatitis: Why is the disease so frequently overlooked?. *Am J Gastroenterol* 1991; 86:322.
11. Ranson JHC, Rifkind RM, Roses DF: Prognostic signs and the role of operative management in acute pancreatitis. *Surg Gynecol Obstet* 1975; 139:69.
12. Steinberg WM, Tenner S: Acute pancreatitis. *N Engl J Med* 1994; 330:1198-1210.
13. Moreau JA, Zinsmeister AR, Melton LJ, et al: Gallstone pancreatitis and the effect of cholecystectomy. *Mayo Clin Proc* 1988; 63:466.
14. Mithofer K, Fernandez-del Castillo C, Frick TW: Acute hypercalcemia causes acute pancreatitis and ectopic trypsinogen activation in the rat. *Gastroenterology* 1995; 109:23.

15. Hanck C, Singer MV: Does acute alcoholic pancreatitis exist without preexisting chronic pancreatitis?. Scand J Gastroenterol 1997; 32:625.
16. Sternby B, O'Brien JF, Zinsmeister AR, et al: What is the best biochemical test to diagnose acute pancreatitis? A prospective clinical study. Mayo Clin Proc 1996; 71:1138.
17. Potts DE, Mass MF, Iseman MD: Syndrome of pancreatic disease, subcutaneous fat necrosis and polyserositis. Am J Med 1975; 58:417.
18. Gullo L: Familial pancreatic hyperenzymemia. Pancreas 2000; 20:158.
19. Gwodz GP, Steinberg WM, Werner M, et al: Comparative evaluation of the diagnosis of acute pancreatitis based on serum and urine enzyme assays. Clin Chim Acta 1990; 187:243.
20. Mayer AD, McMahan MJ, Bowen M, et al: C reactive protein: An aid to assessment and monitoring of acute pancreatitis. J Clin Pathol 1984; 37:207.
21. Brown A, Orav J, Banks PA: Hemoconcentration is an early marker for organ failure and necrotizing pancreatitis. Pancreas 2000; 20:367.

SUMMARY

THE ROLE OF SIMPLE CLINICAL TESTS IN PREDICTING THE SEVERITY OF THE DISEASE IN ACUTE PANCREATITIS

Floreta Kurti^{1,2}, Dorina Osmanaj², Jovan Basho², Ilir Akshia³

¹Service of Gastroenterology & Hepatology, UHC "Mother Theresa" Tirana, Albania

²Department of Biomedical Sciences, Faculty of Nursing, UT, Albania

³Service of Statistics, UHC "Mother Theresa" Tirana, Albania

Introduction. Acute pancreatitis is an acute inflammatory event that originates within the pancreas and is associated with a wide variety of local and systemic complications. A prediction of the course and outcome of the disease would be desirable when patients are first presented at the hospital.

Aim. To evaluate the role of simple clinical tests in predicting the severity of AP. In more detail to evaluate whether diagnosis of AP and severe PA could be improved by using simple tests like CRP, Htc and BMI. **Material & Methods.** The study population consisted of 55 consecutive patients. All the patients were diagnosed with acute pancreatitis with clinical, laboratorical and imaging studies. According to Atlanta classification 6 patients (10.9%) had severe acute pancreatitis and 49 patients (89.09%) suffered mild to moderate pancreatitis. BMI, CRP and Ht values were measured on admission and the third day of hospitalization. **Results.** CRP, Htc values differ in groups of patients with mild acute pancreatitis and severe acute pancreatitis. Patients with severe acute pancreatitis had CRP values more than 150 mg/l, Htc more than 44% and BMI scores more than 30kg/m². **Conclusion.** Simple routine clinical test (BMI, CRP and Htc) are helpful in predicting the development of severe acute pancreatitis. They are effective in predicting severity in acute pancreatitis and can be quickly assessed on admission.

Key words: Acute pancreatitis, severity assessment, prognostic values, CRP, Htc, BMI

MEDICUS

PUNIM PROFESIONAL / PROFESIONAL PAPER

SHËNDETËSI PUBLIKE

RECTO COLITIS ULCEROSA NË RRETHIN E VLORËS

Rezarta Lalo¹, Sotir Vangjeli¹

¹Fakulteti i Shëndetit Publik, Universiteti "Ismail Qemali", Tiranë, Shqipëri



Rezarta Lalo, mjeke
Lagjia: 4 Heronjte
Rr. Selam Musai Nr 10, Vlore, Albania
Tel: 0695668976
e-mail: rezarta_lalo@yahoo.com

REZYME: Në këtë studim, autorët analizuan rreth 176 raste me rektolit ulceroz, në rrethin e Vlorës gjatë periudhës 1998 -2007. Të dhëna klinike dhe instrumentale u përdorën në studim. Niveli i incidencës vjetore së sëmundjes në rrethin e Vlorës ishte 3.52/ 100.000 banorë. Sëmundja e rektolitit ulceroz është më e shpeshtë tek pacientet femra sesa ne pacientët meshkuj, fakt i cili tregohet dhe nga raporti 1.75:1. Faktori i trashëgimise u has ne 7% të rasteve. Autorët, gjithashtu përshkruajnë simpotmat klinike te proktitit (55 %) dhe kolitit (45 %) , komplikacionet dhe semundjet e tjera shoqëruese për secilën grup moshe. Një tjetër aspekt i studimit është të pershkruajë lidhjet me sëmundjet e tjera kryesore.

Fjalë kyç: Recto colitis ulcerosa, Vlorë

Medicus 2012, Vol. XVII (1):

HYRJE

Rektokoliti ulceroz, një patologji inflamatore kronike e shtresave sipërfaqësore të mukozës së kolonit dhe rektumit, shpesh me lokalizim vetëm rektal, i quajtur proktitis dhe shumë rrallë forma të rënda që intereson të gjithë kolonin, pankolitis. Koliti ulceroz si sëmundje me etiologji ende të panjohur, me nivel prevalencë dhe incidencë në shifra të konsiderueshme, në disa vënde edhe në rritje, mbetet një preokupim i përhershëm i gastroenterologjisë. Në 10 vjeçarin e fundit janë konstatuar ndryshime të rëndësishme të shpërndarjes së sëmundjes, në format klinike, lokalizimin e inflamacionit dhe veçanërisht në mbizotërimin e njërit apo tjetrit faktor etiologjik .

QËLLIMI I PUNIMIT

1. Realizimi i këtij punimi ka patur si synim parësor të studiojë epidemiologjinë e sëmundjes në rrethin e Vlorës;
2. Të përcaktojë nivelin e prevalencës së sëmundjes si edhe shpërndarjen e sëmundshmërisë sipas grup moshave.
3. Në këtë kuadër bëhet edhe klasifikimi i sëmundjes sipas lokalizimit, gravitetit dhe formave klinike më shpesh të ndeshura në të sëmurët që janë marrë në studim.
4. Një vend të veçantë zë në punim edhe kuadri klinik i sëmundjes.
5. Rektoliti Ulceroz , duke qene një sëmundje me etiologji të pandriçuar mire në punimin që do te publikojmë sjellim disa të dhëna origjinale të sëmundjeve shoqëruese të kolitit ulçeroz.

MATERIALI DHE METODA

Materiali studimor u bazua në marrjen në analizë të 176 individëve të sëmurë , me forma të ndryshme të kolitit ulceroz të diagnostikuara gjatë periudhës 1998-2007. Diagnoza është vërtetuar mbi

bazën e kompleksit kliniko-anamnestik, ekzaminimit fibrocolonoskopik me ekzaminimin histologjik dhe rektosigmoidoskopik. Në studim janë pranuar vetëm rastet me diagnozë të qartë, duke i përjashtuar rastet e dyshimta, si për mundësinë e një procesi malinj ashtu edhe për tablo klinike jo të qartë e të dyshimtë .

REZULTATET

Pasqyra 1

Struktura e sëmundshmërisë sipas grup-moshave dhe seksit gjatë 1998-2007

Sëmundshmëria sipas grup-moshës									
Nr.	Gjinia	14-20	21-30	31-40	41-50	51-60	61-70	+71	Totali
1	M	3	17	15	6	12	10	1	64
2	F	2	38	32	11	16	11	2	112
3	T	5	55	47	17	28	21	3	176

Pasqyra 2.

Simptomatologjia e kolitit ulceroz.

		Grup-mosha					
Nr.	Simptoma	21-40 %	41-50 %	51-70 %	21-40 %	41-50 %	51-70 %
1	Rectorragji	92	15	21	90.0	88.0	43.0
2	Diarre	86	13	12	84.3	76.5	24.5
3	Dhimbje abdom.	96	17	26	94.0	100.0	53.0
4	Rënie peshe	18	12	44	17.6	70.6	90.0
5	Temperaturë	14	14	3	13.7	82.2	6.0
6	Konstipacion	9	1	28	8.8	5.8	57.0
7	Prekja e kolonit	35	1	47	34.3	5.8	96.0

Pasqyra 3.

Prevalenca e sëmundjeve shoqëruese

Nr.	Sëmundja	21-40	%	41-50	%	51-70	%
1	Hipertonia esenciale	-		12	70.6	18	36.6
2	Astma Bronkiale	-		4	23.5	3	6.0
3	Diabetes Mellitus	-		2	11.7	1	2.0

4	Ulçera G/Duodenale	-		5	30.0	5	10.0
5	Artrit Rheumatoid	-		1	6.0	1	2.0
6	Kolelithiasis.	-		1	6.0	1	2.0

Pasqyra 4.

Prevalenca e ndërlikimeve sipas grup-moshave

Nr	Ndërlikimi	21-40	%	⁴¹⁻⁵⁰	%	51-70 vj	%
1	Anemi hypokrome	92	90	14	82.2	21	43.0
2	Artritis	26	25	11	70.0	32	65.0
3	Polineuritis	-	-	1	6.0	1	2.0

Epidemiologjia

Studimet epidemiologjike në vënde të ndryshme kanë treguar se sëmundja ndeshet më shpesh në vendet e industrializuara, më shpesh në zonat urbane se sa në ato rurale. Personat e prekur nga kjo sëmundje gjithashtu i përkasin klasës me kushte socio-ekonomike të larta (3,6). Në materialin studimor ky fakt konstatohet në shpeshësinë e lartë të sëmundjes në individë që i përkasin klasës intelektuale dhe popullsisë qytetare në 108 persona ose 61.3% të rasteve.

Gjithmonë bazuar në materialin tonë studimor, në rrethin e Vlorës rezultoi një prevalencë e sëmundjes 110/ 100.000 banorë dhe incidencë vjetore rreth 3.52/100.000 raste. Autorë të ndryshëm (1,7,8) flasin për incidenca që shkon deri në 9 raste për 100.000 banorë dhe një prevalencë 40-150 raste për 100.000 banorë. Koliti ulceroz kap çdo moshë. Moshja e shfaqjes së sëmundjes ka rëndësi të dorës së parë, pasi ka të bëjë drejtpërsëdrejti me ecurinë dhe prognozën. Theksojmë se shfaqja e sëmundjes në moshat e reja ka një dekurs klinik më të shprehur dhe shumë herë merr karakter kronik, ndërsa në moshat mbi 60 vjeç vihet re një mortalitet i lartë. Për këtë fakt shprehen edhe shumë autorë që janë marrë me studimin e sëmundjes. (3,5,6).

Ataku i parë i sëmundjes shfaqet në mënyrë bimodiale, me një pikë kulmore në moshat 21-40 vjeç dhe një tjetër, por më pak të shprehur, në 51-70 vjeç. Në materialin studimor janë rreth 102 raste te moshesh 21 -40 vjeç dhe 51-70 jane vetëm 59 raste. Koliti ulceroz prek të dy sekset, me mbizotërim të lehtë të seksit femër, që sipas të dhënave tona kjo sëmundshmëri është gjetur sipas raportit M:F- 1:1.75. Por, ka edhe autorë që e kanë gjetur në përqindje të njëjta në të dy sekset (2,8), siç ka edhe autorë që pranojnë një sëmundshmëri më të lartë tek meshkujt se sa tek femrat. Pa dashur të futemi në një analizë të faktorëve etiologjik që nuk përbën objektin e këtij punimi, por që përbën edhe një prej problemeve ende të pa zgjidhura, konstatojmë se incidenca e lartë e karakterit familjar konsiderohet me vlera njohëse me rëndësi mbasi përbën një faktor riskant të dorës së parë. Sipas të dhënave tona, karakteri familjar i sëmundjes është gjetur në 13 individë të sëmurë ose në rreth 8 % të të sëmurëve tanë. Autorë të ndryshëm pohojnë se karakteri familjar konstatohet në 10-25 % e të sëmurëve (8,9). Duhet pohuar se karakteri familjar kryesisht është tek personat e shkallës së parë, prindër e fëmijë. Aktualisht flitet për një rritje të frekuencës së disa aleleve HLA duke e drejtuar vëmendjen në faktorin gjenetik. Konstatimi i një raporti të ngusht midis profilit HLA dhe artropatisë gjatë sëmundjeve inflamatore intestinale mund të merret si një konfirmim. Kohët e fundit disa autorë (4, 9) konsiderojnë faktor rreziku përdorimin e kontraktivëve oralë. Kjo ka sjellë, sipas tyre, edhe rritjen e rasteve me rektokolit ulceroz në seksin femër. Gjithsesi, ky fakt mbetet për tu studiuar më tej.(9)

DISKUTIM

Sëmundja në përgjithësi fillon me **një seri goditjesh diarreike**, të pazakonta për të sëmurin dhe që shoqërohen më **dhimbje abdominale**, kryesisht në kuadratet e poshtme të tij. Këto dhimbje pasohen

nga **prania e gjakut ne feçe**, që ndryshon nga intensiteti e kohëzgjatja dhe që alternohet nga periudha asimptomatike. Rektorragjia, diarrea dhe dhimbjet abdominale janë mbizotëruese në klinikën e kolitit ulceroz për moshat mbi 40 vjeç. Një fakt interesant është predominimi i kostipacionit, humbja në peshë dhe kapja e kolonit descendens tek moshat mbi 60 vjeç. Duhet të theksojmë se ataket e dhimbjeve janë tejet akute dhe shumë violente. Ky fakt e dramatizon shumë gjendjen dhe rëndon dukshëm anën psikologjike të pacientit, por sëmundja në shumë raste shfaqet edhe në mënyrë insidioze, me tenezma e dhimbje krampiforme, në hipogastër me gjak dhe mukus në feçe. Në këtë rast bëhet kujdes për një diagnozë diferenciale me gastroenteritin akut infeksioz. Në format me interesim të gjerë të mukozës intestinale kemi konstatuar humbje në peshë të të sëmurit, që mesa duket vjen si rezultat i një malabsorbimi që krijohet tek të sëmurët, por edhe nga një humbje e proteinave dhe substancave nutritive, si pasojë e një hiperkatabolizmi. Tek të sëmurët shfaqet temperatura dhe shtimi i eritrosedimentit, takikardia etj. Anemia hipochrome e sideropenike, vjen nga humbja kronike e gjakut dhe është një ndërlikim sistemik më i shpeshtë ekstraintestinal i kolitit ulceroz, atë e kemi konstatuar në rreth 90% të të sëmurëve në moshë të re dhe në 43 % të moshave mbi 50 vjeç. Mucorrea, dhimbjet në kuadratet e poshtme abdominale dhe tenezmat rektale janë simptoma të rëndësishme të sëmundjes dhe duhen vlerësuar në një masë të tillë sa mos ndikojë në një vonesë të diagnozës së sëmundjes. Ndër ndërlikimet ekstraintestinale më të shpeshta, përveç anemisë ferodeficitare kemi ndeshur edhe artritin në rreth ¼ e të sëmurëve tanë.

Kanceri i kolonit, përbën rrezik shumë të lartë për të sëmurët që vuajnë nga koliti ulceroz, si faktor rreziku primar, por duhet të vemë në dukje se duhet të merret në konsideratë kohëzgjatja e sëmundjes dhe përhapja e lezioneve mukozale. Gjithsesi, shumë autorë pohojnë se të sëmurët me këtë sëmundje janë rreth 20 herë më të rrezikuar për kancer të kolonit se popullata e shëndoshë. Në afro 75-80 % e të sëmurëve që bëjnë kancer të kolonit kanë leziona të zgjeruara në gjithë kolonit. Displazia epiteliiale mbi bazën e biopsisë gjatë colonoskopise, është një lezion prekankeroz. Pra, krahas ndërlikimeve “klasike” të njohura si të zakonshme ky ndërlikim duhet vlerësuar veçanërisht në të sëmurë që vuajnë prej vitesh nga koliti ulceroz. Sipas të dhënave tona rrezikohen seriozisht të sëmurët jo vetëm me kohëzgjatje të madhe, por edhe të sëmurët që kanë acarime të përvitshme e që kompromentojnë në vazhdimësi gjendjen e përgjithëshme të të sëmurëve. 3 të sëmurë ishin me mbi 10 vjet vuajtje nga kjo sëmundje. Na tërhoqi pikërisht kjo kohëzgjatje dhe acarimet e përvitshme. Ekzaminimet histologjike të kryera me Nr.4829,7638 dhe 9641 përjashtuan kancerin e kolonit në këta të sëmurë.

Kohët e fundit është hedhur mendimi për një konkomitancë të kolitit ulceroz me gravidancën, duke shkaktuar një prognozë jo të favorshme për nënën dhe fëmijën. Ka edhe autorë që pohojnë, madje se koliti ulceroz përbën një indikacion për një ndërprerje “terapeutike” të shtatzanisë (2). Bazuar në materialin tonë studimor që merret në analizë, shtatzania nuk ka asnjë ndikim negativ e rëndues në kolitin ulceroz veçanërisht gjatë tremujorit të dytë dhe të tretë të shtatzanisë. Duhet vlerësuar edhe fakti që në tremujorin e parë të gravidancës vërehen acarime të shpeshta të sëmundjes si edhe në periudhën postnatale. Recidivat gjatë periudhës së mbaslindjes duhen vlerësuar shumë mbasi ato mund të rrezikojnë seriozisht jetën e nënës.

Lezionet mukozale kryesisht kufizohen në mukozë, nuk kanë tendencë të shkojnë në thellësi, por kanë tendencë të gjakosen (rectorragji) për shkak të shtimit të friabilitetit mukozal. Ndryshimet mukozale interesojnë në mënyrë preferenciale pjesën distale (rektumi) duke u përhapur në sensin caudo-cranial, në mënyrë të vazhdueshme. Kuadri klinik varet nga shkalla e përhapjes së këtyre lezioneve dhe aktiviteti i tyre. Lidhur ngusht me këtë përhapje mund të flasim për dy format e sëmundjes: proktitin ulceroz dhe kolitin ulceroz. Proktiti si variant i kolitit ulceroz ka një lokalizim ekskluziv mbi mukozën rektale. Na duket me vlera të theksojmë se aktualisht konstatohet një shpeshitim i rasteve me proktit ulceroz (14). Në materialin të dy format janë diagnostikuar në shifra relativisht të krahasueshme, përkatësisht 45% colitis ulceroza dhe 55 % proktiti ulceroz. Gjithsesi, duhet pranuar se megjithë kufizimin e lezioneve në mukozën rektale ato shfaqen me klinikë të shprehur dhe rreth 1/3 e rasteve paraqiten edhe mjaft refraktare ndaj mjekimit. Proktiti ulceroz ka patur tendencë përhapje ascendente vetëm në rreth 8 % të rasteve tona. Simptomatologjia e sëmundjes ka prirje individuale, por me një specifike që lidhet me moshën e pacientit kur është shfaqur sëmundja, për dy grup-moshat, 21-40 dhe 51-70 vjeç. Mendohet se kjo specifike lidhet dhe kushtëzohet nga ndryshimet që ndodhin në organizmin e të sëmurëve, kryesisht reaktiviteti

imunologjik. Ulja e reaktivitetit imunologjik në moshat mbi 50 vjeç, ka ndikimin e vet të drejtpërdrejtë mbi karakteristikat klinike të sëmundjes, mbi ecurinë, ndërlikimet e mundshme dhe rezultatet e mjekimit. Sipas materialit tonë studimor, të sëmurët me kolit ulceroz kanë qenë në rreth 29 % të rasteve. Në moshat mbi 50 vjeç mbizotëron proktiti ulceroz me simptomatologji të shkallës së lehtë dhe mesatare. Gjithsesi, rektorragjia, diarreja dhe dhimbjet abdominale, siç kemi theksuar edhe më lart, janë mbizotëruese në simptomatologjinë klinike të sëmundjes për grup-moshat deri 40 vjeç. Kostipacioni alternuar me diarje, humbja në peshë dhe kapja e kolonit descendens ndeshen më shpesh në moshat 51-71+ vjeç .

Përsa i takon sëmundjeve shoqëruese në grup-moshat e reja, deri në 40 vjeç, ato ndeshen më rrallë. Me kalimin e moshës ato shpeshohen duke ndikuar dukshëm në ecurinë dhe prognozën e sëmundjes, duke vështirësuar edhe më tej edhe përkeqësuar rezultatet e mjekimit.

PËRFUNDIME

1. Koliti ulceroz në rrethin e Vlorës ka një nivel incidence prej 3.52 raste për 100.000 banorë.
2. Sëmundja haset në shifra të përafërta midis dy seksëve, me një mbizotërim të lehtë të seksit femër, sipas raportit M:F,1:1.75.
3. Koliti ulceroz shfaqet në mënyrë bimodiale, kryesisht në moshat e dekadës 2-4 dhe dekadës së 6 të jetës.
4. Karakteri familiar i shkallës së parë është gjetur në rreth 8 % të rasteve.
5. Koliti ulceroz ndeshet në dy forma kryesore: proktitis ulceroza (55%) dhe kolitis ulceroza (45 %).
6. Anemia dytësore hipokrome, ferodeficitare është ndërlikimi sistemik më i zakonshëm, në rreth 90 % të rasteve.
7. Sëmundjet shoqëruese janë karakteristikë e moshave mbi 50 vjeç, ato ndikojnë mjaft në ecurinë, ndërlikimet e mundshme, prognozën dhe vështirësojnë mjekimin adekuat të sëmundjes.
8. Koliti ulceroz nuk ka asnjë ndikim negativ në gravidancë gjatë termujorit të dytë e të tretë, por ndikon dëshëm gjatë tremujorit të parë të shtatzanësë dhe periudhën postnatale, duke ndikuar negativisht në mjekimin e sëmundjes dhe duke rrezikuar jetë e nënës në periudhën mbaslindjes.

BIBLIOGRAFIA

1. Andrea J.Singer: Pathophysiology of the gastrointestinal Tract during Pregnancy. Am.J.gastroenterol. 1991;12:1695.
2. Baird D.D et al. Increased risk of preterm birth for women with inflammatory bowel diseases. Gastroenter.2001;987.
3. Toso S et col. Rettocolite ulcerosa. In Malattie dell'apparato Gastrointestinale. Milano,2004, fq.217
4. Kahan S: Medicina Interna. Torino,2007, fq.90
5. Massini R. Medicina Interna, Milano,2005 fq.387
6. Ekbohm A et al. The epidemiology of inflammatory bowel disease. Gastroenterology 2007,100:350.
7. Podolsky DK et.al: Inflammatory bowel disease. N.Engl.J.Med.2008;325:928.
8. Stowe SP et al. An epidemiology study of inflammatory bowel disease in Rochester, New York. Gastroenterol.2000;98:104
9. Iannetti A. Gastroenterologia, .Milano,2010,214.

SUMMARY

RECTO COLITIS ULCEROSA IN VLORA REGION

Rezarta Lalo¹, Sotir Vangjeli¹

¹Faculty of Public Health, University of "Ismail Qemali", Tirana, Albania

Introduction : recto colitis is an inflammatory disease of epithelia of mucosa. The etiology is still unknown. Aim: for our proposal was to study the feature of signs according to age, gender etc among the patients treated in the hospital of Vlorë region during the year 1998-2007. Materials and methods. For

our proposal we studied all the patients treated during the period from 1998 -2007. the diagnosis was based on recto fibro -colon-scope clinical examinations , history of disease etc Results: the incidence of disease was 3.52/100.000 per year, the disease was more common in female than male (1.75F:1 M), the hereditary of diseases was 7% . 55 % of patients reported that have proctitis and 45 % colitis. Conclusion: our results show that incidence of disease is similar to other countries but still the etiology is unknown and more epidemiological studies should be done in the future in order to clarify the etiology of disease.

Key words: Recto colitis ulcerosa, Vlora

MEDICUS

PUNIM PROFESIONAL / PROFESIONAL PAPER

KIRURGJI

LAPAROSCOPIC ANTIREFLUX SURGERY, FOLLOWING REPAIR OF ESOPHAGEAL ATRESIA

Saimir Heta¹, Maria-Grazia Scarpa², Francesca Gobbo², Jurgen Schlee²

¹UHC "Mother Thereza", Pediatric Surgery Clinic, Tirana, Albania

²Burlo Garofolo Pediatric Institute Trieste Italy,
Pediatric Surgery Department, Trieste, Italy



Saimir Heta, mjek kirurg peditär
Str.Hasan Sufa P3 Ap 18 Tirana, Albania
Tel: +355692122827
e-mail: sa.heta@yahoo.com

RESUME: Children after the repair of esophageal atresia often have gastro esophageal reflux (GER). In some children GER by his self is a major cause of complications such as failure to thrive, esophagitis, stricture aspiration pneumonia, and even sudden infant death syndrome. The treatment of these children is a challenge and the surgical aspect is very important now days. In this study we have retrospectively collect data of these children using the files and the G2 server system. From 2005 to 2009 in our department we have treated surgically 81 patients with gastroesophageal reflux. In this group we have 8 patients with esophageal atresia repair on the birth. The indication of surgical treatment of these children was GER and respiratory problems. The procedures have been completed laparoscopically 7 cases with one conversion. The procedure adopted were Nissen (1) floppy Nissen(2) Toupet (3) and Thal (2). In conclusion we believe that laparoscopic fundoplication in this group of children is very feasible and safe.

Key words: Gastro esophageal reflux (GER), esophageal atresia, laparoscopic fundoplication

Medicus 2012, Vol. XVII (1):

BACKGROUND

Children after the repair of esophageal atresia often have gastro esophageal reflux (GER). In some children GER by his self is a major cause of complications such as failure to thrive, esophagitis (by reflux) stricture aspiration pneumonia, and even sudden infant death syndrome. The incidence of gastro esophageal reflux in this patient 30 -50 % is higher than in normal population (1, 2) and the cause may multi factorial, such dysmotility of the distal esophagus injury to the vagus nerve during the surgical procedure, (3) traction on the anastomosis with displacement upward of esophagus with alteration of the angle of His.

The treatment of these children is a challenge and the surgical aspect is very important now days. Some of these children benefit from medicament treatment but 28-41 % (4) are refractory to the medical treatment and need surgery.

AIM OF THE STUDY

The treatment of these children by laparoscopic method is the aim of this study

MATERIALS AND METHODS

In this study we have retrospectively collect data of these children using the files and the G2 server system. From 2005 to 2009 in our department we have treated surgically 81 patients with gastroesophageal reflux. In this group we have 8 patients with esophageal atresia repair on the birth. These children have received medical treatment but the results were not good. The indication of surgical treatment of these children was GER and respiratory problems. One of these children has tracheotomy on the first operation due to tracheostenosis. Histological exam have been done in 5 children and 4 have patterns of esophagitis and one Barret esophagus. All patients have used proton pump inhibitors with discrete results. The diagnostic tools have been used for confirmation of GER like radiological exams (8), endoscopy (8) and biopsy (5)24-hour ph monitoring (2). General anesthesia and orotracheal intubation was used apart of one child with tracheostomia due to tracheostenosis . On the same day, late evening, the children can drink clear liquids. On the next days the children can eat orally. Apart of children with digiunostoma who were supported by this route on the early days. The follow up was every six months.

RESULTS

The procedures have been completed laparoscopically 7 cases with one conversion. The conversion is done at a child 4 months old with type one atresia whose indication were life threaten episode of apnea. The position of cardia very high intra thoracic, ventricle peritoneal shunt and digiunostomy make the laparoscopic way impossible. The mean operation time was 87 min. The hospital stay varied from 1 to 5 days. We have used 5 ports for the laparoscopic procedure. The procedure adopted were Nissen (1) floppy Nissen(2) Toupet (3) and Thal (2). During the operations we have found that 6 of 8 children have intra thoracic cardia one sliding hyatal hernia and only one have intrabdominal location of cardia. In our small series we have two re operation. At one reoperation we have found floppy loose Nissen fundoplication done on a child with a small stomach which make impossible on the first operation doing a Nissen fundoplication. On the other we have found the wrap situated on thoracic cavity with a large hiatal hernia. The mean age of children on the operation was 4.37, mediana 1.46 moda 1(children under 1 year old) will variation from 4 months to 17 years. The other fundoplication (73) have an mean age of 8.56 with mediana 6.5 and moda 14.5.

DISCUSSION

Now days the successful anastomosis for esophageal atresia is a rule so the attention is focused in postoperative morbidity. This morbidity many times is translated in gastro esophageal reflux and its sequels like esophagitis, stricture vomiting failure to thrive and the risk of sudden infant death syndrome. More than 50% of normal neonates show gastroesophageal reflux, which disappear within the first years of life. On the other side on children operated with esophageal atresia gastroesophageal reflux is a rule and arrive in almost 95 % of the children (5). The cause of gastroesophageal reflux is believed to be secondary to the operation of repair of esophageal atresia itself. Tension on the anastomosis with displacement of lower esophageal with alteration of angle of Hiss (6). Damage of vagus will give the same effect too. On the other part many believe that the cause is a primary defect in the motor function of the distal esophagus (3, 7). So now is a wide consensus that many of these children have to be operated for gastroesophageal reflux.

Looking on our experience we believe that laparoscopic approach is a safe and effective procedure. In literature are some reports about use of laparoscopic methods on these children (4). The decision to use laparoscopic procedure is based on many reports now on that emphasize decreased morbidity, hospitalization and lower complication rate (8, 9) which has seen on our series that children. On the first days were able to drink and we don't have any surgical complication on our small patient. The results on these children seem very encouraging but we don't aspect that the result of laparoscopic surgery to be better than in open surgery when we are going to discuss on long term successes. What we have seen intra operatively is interesting because we have seen that 6 of 8 children have an intra thoracic cardia and one sliding hyatal hernia. This confirm that an important part of mechanism of gastro esophageal reflux on this children is a short abdominal esophagus with widen of angel of His due to traction executed on first operation made of esophageal atresia. If we see the age of operation we see that children with esophageal atresia are operated in a smaller age than the other. These because the respiratory symptoms are the main indication in these children.

What is very interesting in our series is the fact that we have two re operation and the procedure used on these was Nissen funduplications on the others we use Toupet (3) and Thal (2). They are many reports about the rate of the reoperation on these children and the procedure used. Which is seen on this series confirm our trend to use more partial fundoplication on these children with the aim that they have to feed orally. Seeing more accurately the 2 reoperation that we have in one we have a girl which is feed by digiunostomia and so the we have used floppy Nissen fundoplication seeing the stoma like a possibility in feeding. She develops after 3 years recurrence and on the operation we found a very loose fundoplication. The second operation was completed laparoscopically without any complication. And the other girl developed intra thoracic slippage of an intact wrap.

Many authors like Curci (10) Kubiak(11) Caniano (12), Wheatley (13) advocated the Nissen fundoplication have high rate of recurrences in children with esophageal atresia so the last write. Due to the high incidence of postoperative dysphagia and recurrent reflux, the transabdominal Nissen fundoplication may not be appropriate in EA patients.

These reports have been confirmed by a experimental electrophysiological study on rats of Melo Filho(14) who have found that Nissen procedures have greater disturbance of the myoelectric activity than on partial fundoplication. These are confirmed on our series when the two operation have been done on child operated with Nissen fundoplication first. Holschneider (15) stated on his extended study that Semifundoplication should be the preferred operative treatment in children with esophageal atresia as this is also a treatment which is very suitable for laparoscopy.

As we see by the table are some authors that give low reoperation rate with Nissen fundoplication. But our perception is that the partial fundoplication (Thal or Toupet) will be the best choice on these children.. We have to emphasize that our decision to apply partial fundoplication is not because of of laparoscopic suitability as Hoschneider (15) mentioned but in the our believe that this is the best way . We have two re operation on these series done by laparoscopy with a very good outcome. On

table we have some studies many of them give a large rate of failures. On these cited study the children are operated on open techniques.

Tab. 1. Recurrence of Nissen funduplications in after the repair esophageal atresia

Study	Year	Nissen	Failures
Curci (10)	1988	14	5
Lindahl (16)	1989	13	5
Kubiak (11)	1999	19	9
Wheatley (13)	1993	21	7
Bergmeijer (17)	2000	26	4
Myers (18)	1990	33	2
Fonkalsrud (19)	1979	9	0

CONCLUSION

In conclusion we believe that laparoscopic fundoplication in this group of children is very feasible and safe.

REFERENCES

1. Bergmeijer JH, Bouquet J, Hazebroek FW: Normal ranges of 24-hour pH-metry established in corrected esophageal atresia. *J Pediatr Gastroenterol Nutr* 1999, 28(2):162-163.
2. Krug E, Bergmeijer JH, Dees J, de Krijger R, Mooi WJ, Hazebroek FW: Gastroesophageal reflux and Barrett's esophagus in adults born with esophageal atresia. *Am J Gastroenterol* 1999, 94(10):2825-2828.
3. Shono T, Suita S, Arima T, Handa N, Ishii K, Hirose R, Sakaguchi T: Motility function of the esophagus before primary anastomosis in esophageal atresia. *J Pediatr Surg* 1993, 28(5):673-676.
4. Esposito C, Langer JC, Schaarschmidt K, Mattioli G, Sauer C, Centonze A, Cigliano B, Settini A, Jasonni V: Laparoscopic antireflux procedures in the management of gastroesophageal reflux following esophageal atresia repair. *J Pediatr Gastroenterol Nutr* 2005, 40(3):349-351.
5. Bergmeijer JH, Hazebroek FW: Prospective medical and surgical treatment of gastroesophageal reflux in esophageal atresia. *J Am Coll Surg* 1998, 187(2):153-157.
6. Jolley SG, Johnson DG, Roberts CC, Herbst JJ, Matlak ME, McCombs A, Christian P: Patterns of gastroesophageal reflux in children following repair of esophageal atresia and distal tracheoesophageal fistula. *J Pediatr Surg* 1980, 15(6):857-862.
7. Orringer MB, Kirsh MM, Sloan H: Long-term esophageal function following repair of esophageal atresia. *Ann Surg* 1977, 186(4):436-443.
8. Rothenberg SS: Experience with 220 consecutive laparoscopic Nissen funduplications in infants and children. *J Pediatr Surg* 1998, 33(2):274-278.
9. Mattioli G, Repetto P, Carlini C, Torre M, Pini Prato A, Mazzola C, Leggio S, Montobbio G, Gandullia P, Barabino A *et al*: Laparoscopic vs open approach for the treatment of gastroesophageal reflux in children. *Surg Endosc* 2002, 16(5):750-752.
10. Curci MR, Dibbins AW: Problems associated with a Nissen fundoplication following tracheoesophageal fistula and esophageal atresia repair. *Arch Surg* 1988, 123(5):618-620.
11. Kubiak R, Spitz L, Kiely EM, Drake D, Pierro A: Effectiveness of fundoplication in early infancy. *J Pediatr Surg* 1999, 34(2):295-299.
12. Caniano DA, Ginn-Pease ME, King DR: The failed antireflux procedure: analysis of risk factors and morbidity. *J Pediatr Surg* 1990, 25(10):1022-1025; discussion 1025-1026.
13. Wheatley MJ, Coran AG, Wesley JR: Efficacy of the Nissen fundoplication in the management of gastroesophageal reflux following esophageal atresia repair. *J Pediatr Surg* 1993, 28(1):53-55.
14. Melo-Filho AA, Vinagre AM, Collares EF, Bustorff-Silva JM: Effect of different types of fundoplication on the gastric emptying of liquids and gastric compliance in rats. *J Pediatr Surg* 2005, 40(10):1551-1556.
15. Holschneider P, Dubbers M, Engelskirchen R, Trompelt J, Holschneider AM: Results of the operative treatment of gastroesophageal reflux in childhood with particular focus on patients with esophageal atresia. *Eur J Pediatr Surg* 2007, 17(3):163-175.

16. Lindahl H, Rintala R, Louhimo I: Failure of the Nissen fundoplication to control gastroesophageal reflux in esophageal atresia patients. *J Pediatr Surg* 1989, 24(10):985-987.
17. Bergmeijer JH, Tibboel D, Hazebroek FW: Nissen fundoplication in the management of gastroesophageal reflux occurring after repair of esophageal atresia. *J Pediatr Surg* 2000, 35(4):573-576.
18. Myers NA, Beasley SW, Auld AW: Secondary esophageal surgery following repair of esophageal atresia with distal tracheoesophageal fistula. *J Pediatr Surg* 1990, 25(7):773-777.
19. Fonkalsrud EW: Gastroesophageal fundoplication for reflux following repair of esophageal atresia. Experience with nine patients. *Arch Surg* 1979, 114(1):48-51.

SUMMARY

TRAJTIMI LAPARASKOPIK I REFLUKSIT GASTROEYOFAGEAL NË FËMIJËT E OPERUAR ME ATREZI EZOFAGU

Saimir Heta¹, Maria-Grazia Scarpa², Francesca Gobbo², Jurgen Schlee²

¹QSU “Nënë Tereza”, Klinika e Kirurgjisë Pediatrike, Tiranë, Shqipëri

²Instituti Pediatrik Burlo Garofolo Trieste, Itali,
Departamenti i Kirurgjisë Pediatrike, Trieste, Itali

Fëmijët e diagnostikuar dhe trajtuar me atrezi ezofageale zhvillojnë shpesh refluks gastroesophageal. Disa nga këta fëmijë kanë komplikacione të shumta nga refluksi gastro esophageal siç janë mosshtimi në peshë, esofagiti, striktura, pneumoni aspirative dhe madje sindromin e vdekjes së menjëhershme. Trajtimi i këtyre fëmijëve është i vështirë dhe kirurgjia zë një vend të veçantë. Në këtë studim në mënyrë retrospektive kemi mbledhur të dhënat në lidhje me këta fëmijë të operuar duke shfrytëzuar sistemin e serverit G2. Nga 2005 -2009 në Departamentin tonë janë trajtuar kirurgjikalisht 81 pacientë për refluks gastroesofageal. Në këtë grup kemi 8 pacientë të cilët janë trajtuar për atresi esofagu në lindje. Indikacionet janë refluksi gastroesofageal dhe problemet respiratore. Procedurat janë kryer me metodën laparoskopike në 7 raste me një konvertim. Teknikat operatore kanë qenë Nissen, Toupet dhe Thal. Si përfundim ne kemi bindjen që fundplikacioni laparoskopik është i sigurtë e mjaftë i vlefshëm.

Fjalë kyç: Refluksi gastroesofageal, atresia esofageale, fundplikacioni laparoskopik



MEDICUS

PUNIM PROFESIONAL / PROFESIONAL PAPER

PSIKIATRI

EVIDENTIMI I PSIKOZAVE TE VETËVRASJET NË TIRANË PËR PERIU DHËN 2001-2006

Pasho Maksuti¹, Vuksan Kola¹, Artan Simaku¹

¹QSU “Nënë Tereza”, Shërbimi Psikiatrik, Tiranë, Shqipëri



Pasho Maksuti, mjek psikiatër
Rr. e Elbasanit Nr. 127, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 692206280
e-mail: pashomaksuti@yahoo.com

REZYME: Hyrje. Termin vetëvrasje e përdorim për të gjithë rastet e vdekjeve të cilat janë pasojë e veprimit direkt apo indirekt, pozitiv apo negativ të vetë viktimit, e cila e di pasojën e veprimit të tillë. Gjithashtu është e njohur se 50 deri 70% e të vetëvrasarëve mbeten pa diagnozë të besueshme ndërsa psikozat përfshihen në vetëvrasje nga 5.8 deri 50%. Tirana është kryeqyteti i Shqipërisë me numër banorësh në rritje, me rreth 20-25% të të gjithë vendit (nga 520 000 në vitin 2001, me 690 000 në vitin 2006). Numri i vëvrasjeve në nivel kombëtar llogaritet me rreth 3 në 100 000 banorë. Për qytetin e Tiranës mungojnë studimet për këtë problematikë. Meqenëse demografia e Tiranës në njëfarë mënyre është pasqyrë e të gjithë vendit, më bën të besoj se epidemiologjia e vetëvrasjeve në Tiranë mund të pasqyrojë edhe epidemiologjinë kombëtare. **Qëllimi i studimit:** Është vlerësimi epidemiologjik i rasteve të vetëvrasjeve në rrethin e Tiranës për periudhën 2001-2006, evidentimi dhe vlerësimi i shkaqeve morbide të vetëvrasjeve, me theks të veçantë mbi frekuencën e psikozave midis individëve që kanë kryer aktin vetëvrasës. **Metoda e studimit dhe materiali i përdorur:** Studimi është retrospektiv me kohort homogjen. Janë përdorur dosjet hetimore të rasteve të dyshuara për vetëvrasje në prokurorinë e rrethit gjyqësor të Tiranës. Janë marrë për bazë të dhënat mjekësore e deklaratat e dëshmitarëve, që gjenden në dosjet përkatës. Nuk përfshihen në studim rastet e pakonfirmuara si vetëvrasje, rastet e dyshimta. Të dhënat janë analizuar me anë të paketës statistikore SPSS 16. Është përdorur testi χ^2 me korreksionin e Yates për krahasimin e proporcioneve dhe regresioni linear për vlerësimin e trendit. Janë konsideruar sinjifikante vlerat e $p \leq 0.05$. Vlerësimet pikësore janë shoqëruar me vlerësimin intervalor 95%CI. Testet statistikore janë të dyanshme. Janë përdorur tabela dhe grafikë për vizualizimin e të dhënave. **Rezultatet dhe përfundimi:** Nga studimi rezulton se në periudhën 2001-2006 në rrethin e Tiranës kanë kryer vetëvrasje 160 persona, nga të cilët 24 raste (15%) kanë qenë psikotikë. Rastet me psikozë përbëjnë 22.6% të totalit të rasteve të identifikuar me çrregullime. Edhe nga rastet e identifikuar me depresion, rezulton përqindje e lartë (66%) që nuk janë trajtuar para aktit vetëvrasës. **Fjalë kyçe:** Epidemiologji, vetëvrasje, çrregullim psikiatrik, psikozë

Medicus 2012, Vol. XVII (1):

HYRJE

Durkheim, autor i njohur i studimit sociologjik mbi vetëvrasjet është munduar të japë definicion më të plotë: “Termin vetëvrasje e përdorim për të gjithë rastet e vdekjeve të cilat janë pasojë e veprimit direkt apo indirekt, pozitiv apo negativ të vetë viktimit, e cila e di pasojën e veprimit të tillë” (Durkheim, 1951). Sipas Ringel, 1953, vetëvrasja nuk është pasojë e reaksioneve direkte ndaj vështirësive jetësore, por akti vetëvrasës është skena e fundit e filluar përpara shumë kohësh, ndoshta që në rininë e personit të vetëvrasarë. Të tjerë autorë, shumicën e personave të vetëvrasarë nuk i quajnë të sëmurë, por njerëz “të lodhur nga jeta” (Thomas, 1977), apo sipas Frankl, 1978, i cili thekson se personat suicidal nuk vuajnë nga sëmundje mendore, por nga kriza e vetëdijes. Freud, hedh teorinë mbi egzistencën e “instiktit të vdekjes” apo “instiktit vetëdestruktiv”. Kulawik, (1977) thotë se Kraepelini ka vlerësuar që çrregullimet psikike të

theksuara mund të gjenden te 30% e të mbijetuarve nga vetëvrasja. Linden thekson se psikozat përfshihen në vetëvrasje nga 5.8 deri 50% (të dhëna në varësi të autorëve të ndryshëm). Gjithashtu është e njohur se 50 deri 70% e të vetëvrasarëve mbeten pa diagnozë të besueshme. Megjithatë zgjidhja nuk është e etiketimi i detyrueshëm i vetëvrasjeve me ndonjë diagnozë por me të paktën si “reaksion jonormal”.

QËLLIMI I STUDIMIT

Është vlerësimi epidemiologjik i rasteve të vetëvrasjes në rrethin e Tiranës për periudhën 2001-2006, të evidentohen dhe vlerësohen shkaqet morbide të vetëvrasjeve, me theks të veçantë mbi frekuencën e psikozave midis individëve që kanë kryer aktin vetëvrasës.


Metoda e studimit dhe materiali i përdorur.

Studimi është retrospektiv me kohort homogjen. Janë përdorur dosjet hetimore të rasteve të dyshuara për vetëvrasje në prokurorinë e rrethit gjyqësor të Tiranës. Janë studjuar të gjitha dosjet hetimore të vetëvrasjeve të konfirmuara përmes ekspertizave mjekoligjore e vlerësimeve juridike, me vendim përfundimtar mbi veprën e kryer. Janë marrë për bazë të dhënat mjekësore e deklaratat e dëshmitarëve, që gjenden në dosjet përkatëse. Si çrregullime psikotike konsiderohen rastet të cilat kanë qenë të diagnostikuara përpara aktit me ndonjë çrregullim psikotik (skizofreni, çrregullim delusional, çrregullim bipolar psikotik, depresion psikotik, çrregullim psikotik shkaktuar nga substancat etj) ose kanë pasur të dhëna të mjaftueshme për të evidentuar simptomatikën psikotike. Janë marrë të dhënat epidemiologjike mbi personat e vetëvrasarë përfshirë edhe mënyrën, periudhën ditore e muajin, respektivisht stinën e aktit vetëvrasës. Nuk përfshihen në studim rastet e pakonfirmuara si vetëvrasje, rastet e dyshimta dhe pa të dhëna të mjaftueshme për psikozë, megjithëse mund të ketë informacione indirekte se kanë qenë psikotikë. Të dhënat janë analizuar me anë të paketës statistikore SPSS 16. Është përdorur testi χ^2 me korreksionin e Yates për krahasimin e proporcioneve dhe regresioni linear për vlerësimin e trendit. Janë konsideruar sinjifikante vlerat e $p \leq 0.05$. Vlerësimet pikësore janë shoqëruar me vlerësimin intervalor 95%CI. Testet statistikore janë të dyanshme. Janë përdorur tabela dhe grafikë për vizualizimin e të dhënave.

REZULTATET


Rrethi i Tiranës në vitin 2001 ka pasur rreth 520 000 banorë ndërsa në vitin 2006 rreth 680 000 banorë. Nga studimi rezulton se në periudhën 2001-2006 në rrethin e Tiranës janë kryer 160 vetëvrasje, që i korrespondojnë një prevalence prej 0.03% (95%CI 0.02 – 0.034), ose 27.4 raste per 100 000 banorë. 53 (33%) prej rasteve janë femra dhe 107 (67%) meshkuj, me ndryshim statistikisht të rëndësishëm ndërmjet tyre ($\chi^2 = 17.5$ $p < 0.01$). Moshë mesatare e individëve është 38,5 vj (± 15.9 SD, rang 12 – 93 vjec).

Fig. 1. Histogrami i moshës së pacientëve



66 (41%) ishin beqarë, 78 (49%) të martuar, 8 (5%) të divorcuar, 6 (4%) të ve dhe për 2 (1%) persona nuk ka informacion. Vërehet mbizotërim i vetëvrasjeve midis beqarëve dhe të martuarve, pa ndryshim statistikisht të rëndësishëm ndërmjet tyre ($\chi^2= 0.8$ $p=0.3$)

Fig. 2. Shpërndarja e rasteve të vetëvrasjeve sipas statusit civil



Vërehet mbizotërim i vetëvrasjeve midis banorëve të zonës urbane me 99 (62%) raste krahasuar me zonën rurale me 61 (38%) raste. Duke marrë në konsideratë numrin e popullatës në zonën rurale dhe urbane, prevalenca në fshat për periudhën 2001-2006 rezulton 37.9 raste/100000 banorë (61/161144) ndërsa në qytet prevalenca rezulton 23.5 raste/100000 banorë (99/421862). Vërehet që në zonën rurale vetëvrasjet janë hasur 1.6 herë më tepër krahasuar me zonën urbane, që është ndryshim statistikisht i rëndësishëm ($\chi^2= 17.5$ $p<0.01$).

Fig. 3. Shpërndarja e rasteve të vetëvrasjeve sipas vendbanimit




Tabela 1. Frekuenca e hasjes së vetëvrasjes sipas viteve dhe karakteristikat socio-demografike të viktimave. N=160.

Rastet	N	%	P
Vitet			<0.01
2001	4	3	
2002	34	21	
2003	9	6	
2004	7	4	
2005	37	23	
2006	69	43	
Gjinia			<0.01
Femra	53	33	
Meshkuj	107	67	
Grupmosha, vite			<0.01

10-19	12	8	
20-29	43	27	
30-39	42	26	
40-49	30	19	
50-59	15	9	
60-69	9	6	
70-79	5	3	
80-89	3	2	
≥90	1	1	
Statusi civil			<0.01
Beqarë	66	41	
Martuar	78	49	
Divorcuar	8	5	
I/e ve	6	4	
Vendbanimi			<0.01
Urban	99	62	
Rural	61	38	
Niveli aresimor			<0.01
8 Vjecare	85	53	
Mesme	64	40	
Lartë	9	6	
Gjendja social-ekonomike			<0.01
E ulët	96	60	
Mesatare	54	34	
E lartë	1	0.6	

Vërehet mbizotërim i vetëvrasjeve në vitin 2006 me 69 (43%) raste, me ndryshim statistikiisht të rëndësishëm me vitet e tjera ($\chi^2 = 118.7$ p<0.01).

Fig. 4. Shpërndarja e vetëvrasjeve sipas viteve. Përqindja ndaj totalit






Fig. 5. Frekuenca e hasjes së vetëvrasjeve në rrethin e Tiranës. Incidenca: raste/100 000 banorë.




Incidenca e vetëvrasjeve në rrethin e Tiranës paraqet rritje nga 0.8 raste/100 000 banorë në vitin 2001 në 10 raste/100 000 banorë në vitin 2006, por trendi nuk është statistikisht i rëndësishëm, (Modeli polinomial i trendit: F-ratio = 1.8, p=0.3).

Fig. 6. Shpërndarja e vetëvrasjeve sipas stinëve




Vërehet ndryshim statistikisht i rëndësishëm i hasjes së vetëvrasjes sipas muajve, me mbizotërim të rasteve në muajt prill dhe shtator, përkatësisht 20 (13%) raste dhe 24 (15%) raste, ($\chi^2 = 22.8$ p<0.01). Në shpërndarjen sipas stinëve, numri më i madh i tyre vërehet në stinën e vjeshtës me 53 (33%) raste, me ndryshim statistikisht të rëndësishëm me stinët tjera ($\chi^2 = 7.9$ p=0.04).

Fig. 7. Shpërndarja e vetëvrasjeve sipas nivelit arsimor




Hospital post-operative management (course and outcome) of the mother: intensive treatment administered (antihypertensive, anticonvulsive, antidiabetic, antibiotics, anticoagulant therapy) and continuous intensive monitoring (blood pressure, blood sugar, fluid balance) until normal parameters achieved. When in stable condition, the mother was transferred to Postnatal ward. No abnormal findings in control laboratory analysis, and fortunately, no postoperative complications. The third postoperative day, the mother left the hospital on her responsibility and demand.

Neonatal parameters:

- Live born male premature baby at the age of 34 gestational weeks;

- Birth weight was 3250 g, and length 49 cm. Gestational age assessment performed by Dubowitz, and estimated that the newborn was Large for gestational age baby (LGA-over 95%);
- Apgar score 4/6;
- Slow response to primary resuscitation;
- Blood gases in umbilical artery: severe hypoxia and mild metabolic acidosis. pH=6,98; pCO₂=108,5 mmHg; BE= - 6,1mmol/l; HCO₃⁻=25,8 mmol/L;
- Neonatal condition afterwards:
 - Severe Respiratory Distress Syndrome;
 - Generalized cyanosis, not improving by hyper oxygenation test, congenital cardiopathy suspected;
 - Generalized edema persistent;
 - Because of the need of interdisciplinary management, the baby was transferred to the Children's Clinic after initial treatment at NICU within Gyn&Obs Clinic;
 - At the Children Hospital, congenital cardiomyopathy confirmed by ultrasound examination;
 - Additional congenital anomaly detected: unilateral renal agenesis;
 - Early neonatal death (72 hours after the birth);
 - No chance for postmortem examination (autopsy), because of parents' refusal.

DISCUSSION AND CONCLUSIONS

This was a fatal outcome for the baby. The mother's condition was improved. Some questions pertaining to the case have aroused in front of us:

- What could be done to prevent such an outcome?
- Which diagnostic tests are the most important for fetal surveillance in complicated pregnancy (both, diabetic and pregnancy induced hypertension)?
- Are other anomalies closely linked to Diabetes in pregnancy?
- Which investigations should have been done for better follow-up of the mother's condition during pregnancy?

Pregnancy is an important event that plays a great role in family stability. A high-risk pregnancy is a pregnancy in which the mother, fetus, or neonate is in jeopardy, and women in this situation require greater attention before, during, and after pregnancy. The most important challenge is early diagnosis; therefore, different authors have proposed several high-risk identification systems. Taking of a thorough history and performing a physical examination of every obstetric patient are the best ways to identify a high-risk patient. Because there are advances in this field for many cases that were formerly considered incurable, the knowledge and skills of the obstetrician should expand to cover the recent modalities in investigation and treatment. Pre-conception counseling is also important. It implies commitment from the physician, obstetrician, neonatologist, non medical personnel, but certainly the woman itself and her environment.

A woman with a high-risk pregnancy will need closer monitoring than the average pregnant woman. Such monitoring may include more frequent visits with the primary caregiver, tests to monitor the medical problem, blood tests to check the levels of medication, serial ultrasound examination, and fetal monitoring. These tests are designed to track the original condition, survey for complications, verify that the fetus is growing adequately, and make decisions regarding whether labor may need to be induced to allow for early delivery of the fetus. Additional tests may help determine the need for changes in medication or additional treatment.

The goal of pregnancy management should be: understanding the magnitude of high-risk pregnancy, its different etiologies, and identification systems, and emphasizing preventable and avoidable causes, recognizing and utilizing basic diagnostic tools, and raising the awareness of maternal-fetal

medicine. All these measures are preconditions for improving the prognosis of high-risk pregnancies and reducing the risks to the newborns as well.

REFERENCES

1. Acker DB, Sachs BP, et al. Risk factors for shoulder dystocia. *Obstetr Gynecol.* 1985; 66: 762-8.
2. Spellacy WN, Miller S, et al. Macrosomia-maternal characteristics and infant complications. *Obstet Gynecol.* 1985; 66: 158-61
3. James M. Roberts, Gail Pearson, Jeff Cutler, Marshal Lindheimer. Summary of the NHLBI Working Group on Research on Hypertension During Pregnancy. *Hypertension.* 2003; 41: 437-445.
4. RCOG Guidelines. The management of severe pre-eclampsia/ eclampsia. Guideline No. 10(A). 3/2006.
5. Sibai BM, Gordon T, et al. Risk factors for preeclampsia in healthy nulliparous women. *Am J Obstet Gynecol.* 1999; 172: 642-8.
6. Jensen DM, Damm P, et al. Pregnancy outcome and pre-pregnancy body mass index in 2459 glucose tolerant Danish women. *Am J Obstet Gynecol.* 2003; 189: 239-44.
7. Watkins ML, Rasmussen SA, et al. Maternal obesity and risk of birth defects. *Pediatrics* 2003; 111: 1152-8.

РЕЗИМЕ

ИСХОД НА НОВОРОДЕНЧЕ ОД МУЛТИРИЗИЧНА БРЕМЕНОСТ

Приказ на случај

Зисовска Елизабета¹, Алексиоска Наташа¹, Алексиоска Ирена¹

¹Универзитетска клиника за гинекологија и акушерство, Скопје, Македонија

Вовед: Високо-ризичната бременост е состојба која ги става мајката, плодот во развој или заедно во нешто повисок ризик од компликации за време или после бременоста и раѓањето. Неповолниот исход може да се должи на несоодветна антенатална грижа, претходни акушерски проблеми, веќе постоечка болест кај мајката или болест предизвикана од самата бременост, близначка бременост или слично. **Целта** на овој труд беше да се презентира еден случај на мултиризична бременост и да се постави дилемата/дискусијата дали нешто повеќе можело да се направи за да се спречи несаканиот исход на новороденчето со обезбедување на подобра антенатална грижа и мониторинг на мајката за време на бременоста. **Материјал и методи:** Презентираниот случај е бремена жена на возраст од 38 години, Г=2, П=1, Аб=1 (втора бременост, прво раѓање и еден спонтан абортус). Во моментот на приемот, анамнестички не се доби датумот на последната менструација; детектирани беа неколку ризик фактори, како дијабет, прееклампсија и обезитет. Лабораториски отстапувања имаше во коагулацијата на крвта и постоење на протеинурија; набрзо после приемот, детектиран беше фетален дистрес. После стабилизација на мајчината состојба, породувањето беше завршено со царски рез. Новороденото дете беше големо за гестациската возраст (хипертрофично), со умерена родилна асфиксија и многу бавен одговор на примарна реанимација, продолжителен тежок респираторен дистрес. Со ултразвук беше потврдено постоење на кардиомиопатија и унилатерална ренална агенезија. После 72 часа од раѓањето новороденчето заврши летално. **Заклучок:** Целта на водењето на бременоста треба да биде: разбирање и рана детекција на тежината на високоризичната бременост, задолжителен интензивен мониторинг пред, за време и после бременоста, потенцирање на превентабилните ризици и оние кои можат да се минимизираат, вклучувајќи ги сите базични и достапни дијагностички методи, за да се подигне свеста за важноста на матернално-феталната медицина.

Клучни зборови: Ризична бременост, новородено, неонатален исход

HISTORIA E ZHVILLIMIT DHE APLIKIMIT TË EKOKARDIOGRAFISË NË PEDIATRI**Ramush Bejqi¹, Hana Bejqi², Ragip Retkoceri¹**¹Njësia Intensive, Klinika e Pediatri, QKUK, Prishtinë, Kosovë

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, Prishtinë, Kosovë



Ramush Bejqi, mjek pediatër

Dardani, Rr. Sadik Zeneli, RB 8/3, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel. 00381 38 553 217

00377 44 120 129

e-mail: rbejqi@hotmail.com

REZYME: *Ekokardiografia nënkupton një grup të metodave diagnostike në ekzaminimin e zezrës së njeriut me ndihmën e ultratingullit. Në afirmimin e përnjëhershëm të kësaj metode diagnostike në kardiologjinë pediatrike kanë kontribuar shumë faktor si: senzibiliteti dhe senzitiviteti i lartë i imazheve të fituara, metoda është joinvazive dhe nuk shkakton dhimbje, mundësia e përsëritjes, përcjelljes dhe vlerësimit të trajtimit, mungesa e efekteve të dokumentuara anësore biologjike, lehtësia e përdorimit të aparaturës dhe mundësia e aplikimit të metodës edhe tek fëmija në shtrat ose inkubator dhe, në fund, përdorimi i gjerë dhe mundësia e pajisjes me aparaturë përkatëse edhe e qendrave të vogla mjekësore (1, 2). Ekogjeniteti i jashtëzakonshëm i strukturave të zezrës së fëmijës mundëson marrje të vendimeve diagnostike të cilat sot janë bazë e intervenimeve kardiokirurgjike pa kateterizim dhe angiokardiografi në mbi 95 % të të gjitha KLZ (1, 3, 4). Ekzaminimi i fëmijës me ekokardiografi dallon në shumë aspekte nga ekzaminimi i të rriturit, posaçërisht të fëmijës së lindur para kohe, fëmijës në kushte të kujdesit në inkubator dhe te gjendet e rënda (fëmija në njësinë intensive i intubuar dhe i rrezikuar vitalisht). Shpesh herë fëmija është i shqetësuar, dispnoik dhe cianotik dhe nuk bashkëpunon gjatë ekzaminimit. Duke qenë se frekuenca e zezrës dhe e frymëmarrjes tek fëmijët janë dukshëm më të larta, dimensionet e strukturave të zezrës janë dukshëm më të vogla, ekzaminimi bëhet shumë më i vështirë, kërkon më shumë kohë dhe durim, kushte të caktuara dhe mundësi të përsosura të aparaturës (1, 5, 6). Zakonisht për këtë ekzaminim nuk përdoret kurrfarë sedacioni, mjafton vetëm shishja me qumësht ose çaj, gjegjësisht durim i mjaftueshëm i mjekut dhe infermieres. Posaçërisht duhet theksuar se sot, përveç përsosshmërisë së aparaturës, është shumë më e rëndësishme dituria dhe shkathhtësia e mjekut pediatër në korelimin e elementeve të pasqyrës klinike, elektrokardiogramit, radiogramit dhe gjetjeve tjera, me të dhëna të fituara me ekokardiografi. Vetëm në këtë mënyrë mjeku mund t'iu shmanget të gjitha kurtheve të keqformimeve të komplikuara dhe artefakteve (3, 5). Në vlerësimin përfundimtar ekokardiografisti duhet t'i merr parasysh të dhënat komplementare të fituara me metodat e ndryshme diagnostike, t'i shmanget eliminimit të konkurrencës dhe mbivlerësimit të ekokardiografisë në vlerësimin e të dhënave. Në këtë mënyrë më së miri mbrohet fëmija i sëmurë - kardiopat nga vendimet e hershme dhe të pabazuara, pas të cilave pason intervenimi kirurgjik nga i cili varet fati i fëmijës. Kombinimi i metodave ekokardiografike për një kohë të shkurtër ka bërë ndryshime historike në diagnostikimin klinik dhe sot mundëson diagnostikim të saktë dhe të mjaftueshëm te 95 % të të gjitha keqformimeve të lindura të zezrës për veprim të mëtejshëm kardiologjik ose kirurgjik (7, 8).*

Fjalët kyç: *Ekokardiografia, kollor – Doppleri, M-mode ekokardiografia, 2D-ekokardiografia*

HYRJE


Fillimi i përdorimit të ultrasonografisë në Kardiologji

Në Austrinë e pasluftës, neurologu K. T. Dussik (9) së bashku me vëllaun e tij, në përpjekje për t'i ekzaminuar strukturat e trurit me ultratinguj, i bëri hapat e parë në aplikimin e ultrasonografisë në Pediatri. Më vonë mjeku gjerman W. D. Keidel, (10) duke e ekzaminuar kraharorin me ultratinguj, i regjistroi në ekranin e aparatit lëvizjet ritmike, të afërta me kontraksionet e zemrës. Duke u nisur nga këto dy zbulime epokale, me 1953 Inge Edler (11) dhe Helmuth Hertz, në Lund të Suedisë, me aparaturë, krahasuar me të sotmën tepër të thjeshtë dhe masive, filluan punën e lodhshme dhe të gjatë me qëllim të prezantimit të strukturave të zemrës me ultratinguj. Në disponim kishin një detektor ultrasonik i cili deri atëherë kishte përdorim në industri, me të cilin i fituan sinjalet e para ultrasonografike transtorakale të strukturave të zemrës. Në fillim ata u përqëndruan vetëm në prezantimin e funksionit dhe ndryshimeve patologjike të valvulës mitrale. Kjo ishte edhe e arsyeshme duke pasur parasysh se para fillimit të aplikimit të angiokardiografisë në fillim të viteve të 50-ta, nuk kishte metodë tjetër të pranueshme dhe që i plotësonte kriteret në diagnostikimin e saktë të ndryshimeve patologjike në valvulën mitrale. Në atë kohë kjo kishte rëndësi të madhe pasi që, para fillimit të aplikimit të punimeve pionire të Lillehei-it në intervenimet kardiokirurgjike në zemër të hapur, të vetmit kandidat për intervenim kirurgjik ishin pacientët me shenja të stenozës mitrale apo me stenozë dhe pamjaftueshmëri mitrale dhe me shkallë të mesme të regurgjitimit (11, 12). Në kardiokirurgji, para fillimit të aplikimit të intervenimeve kirurgjike në zemër të hapur, komisuromia e mbyllur ka qenë metoda e përzgjedhur. Për këtë arsye ishte tepër e nevojshme një metodë e vlerësimit të shkallës së regurgjitimit para intervenimit kirurgjik tek pacientet me kombinim të stenozës dhe regurgjitimit. Aplikimi i ultrasonografisë kardiake, tash e njohur me emrin ekokardiografia, për një kohë të shkurtër është bërë metoda më e saktë në diferencimin dhe përzgjedhjen e pacientëve me indikime për intervenim kardiokirurgjik (13, 37, 38).

M-Mode ekokardiografia (Ekokardiografia njëdimensionale)

Që nga fillimi mjekët Edler dhe Hertz ishin të fokusuar në aplikimin e ultrasonografisë dhe zhvillimin e koncepteve të standardizuara me qëllim të rritjes së kujdesit ndaj pacientëve para dhe pas intervenimit kardiokirurgjik (11, 12) Ata kanë bërë studime të shumta në përcjelljen e pacientëve të cilët është bërë komisuromia mitrale. Oscilimet e fituara me ultratingull, të prezantuara dhe të regjistruara në kohë, kanë mundësuar krijimin e metodës M-mode të ekzaminimit në ekokardiografi, e cila edhe sot, në vitin 2011, është metodë rutinore në ekzaminimin ekokardiografik.

Shumë shpejtë M-mode ekokardiografia është bërë procedurë rutinore dhe bazë e ekzaminimeve diagnostike kurse mjekët, fillimisht në Amerikën Veriore, në Evropë, Kinë dhe Japoni dhe më vonë në tërë botën, kanë filluar hulumtimet në zhvillimin dhe përdorimin e metodave të reja diagnostike, të bazuara në aplikimin e ultratingullit. Adaptimi dhe përdorimi i këtyre metodave si rutinë në punën klinike ka kërkuar nevojën e prodhimit të aparaturës komerciale dhe të pranueshme si në aspektin e lehtësisë së përdorimit ashtu edhe në mundësinë e qasjes financiare në to. Me 1958 Kompania Siemens, atë kohë në Gjermaninë Perendimore, e prodhoi një sensor të ri, të bazuar në ndryshimin e materialit piezoelektrik, ku kuarci është i zëvendësuar me barium titanat dhe i cili u tregua më shumë sensitiv për përdorim në ekokardiografi. Sensori i ri ka mundësuar ekzaminimin e strukturave të zemrës të cilat deri atëherë ishte e pamundur të prezantohen (muret e atriumeve, posaçërisht të fibrilacioni atrial, prezantimi i tumoreve të zemrës, duke përfshirë këtu edhe miksomën atriale) (14).



Skema1. Prezantimi skematik i 2-D (lart) dhe M-mode (poshtë) ekokardiografisë; MT-muri i toraksit, RV-right ventricle, IVS -interventricular septum, KT-korda tendinea, VM-valvula mitrale, VA-valvula aortale, AO-aorta, LA-left atrium, PW-posterior wall)

Edhe në ShBA, si në pjesët tjera të botës në vitet e 60-ta të shekullit të kaluar, aplikimi i ekokardiografisë kryesisht është bazuar në prezantimin e valvulës mitrale dhe ndryshimeve patologjike në të. Disa grupe të hulumtuesve, në qendra të ndryshme, kanë treguar korelim të ngushtë ndërmjet redukimit të shpejtësisë së lëvizjes së fletëzave të valvulës mitrale në diastolë dhe shkallës së stenozës. Në këtë kohë ka lindur idea për formimin e kriterëve për ekzaminime ekokardiografike dhe aplikim klinik të ekokardiografisë, për çka posaçërisht veçohet William L. dhe Winters Jr. nga Universiteti Temple në Florida dhe Harvey Feigenbaum nga Universiteti Indinana (4, 15). Në punimet e veta Feigenbaum me bashkëpunëtorë treguan se ekokardiografia mund të përdoret jo vetëm në prezantimin e valvulës mitrale dhe hapësirave atriale por edhe në ekzaminimin e ventrikujve, posaçërisht kur i ekzaminuari ka edhe efusion perikardial. Gjatë ekzaminimit të efusionit perikardial ata e regjistruan se muri posteriorinferior prezantohet dhe analizohet më lehtë dhe se lëvizjet e murit korespondojnë mirë me ciklin kardiak. Kjo ishte një nxitje e madhe për shumë kardiolog për futjen e ekokardiografisë në ekzaminimin rutinuar të ventrikullit të majtë dhe formimin e standardeve në matjen e trashësisë së mureve, hapësirës së brendshme dhe volumit goditës si dhe për fillimin e përdorimit të ekokardiografisë si metodë të përshtatshme në vlerësimin e funksionit të ventrikullit të majtë.

Përkundër kufizimeve në përdorimin e kësaj metode ekokardiografia njëdimensionale është ende metoda e pa zëvendësueshme në matjen e dimensioneve të strukturave të zemrës. Për aplikim përdoret sonda më një kristal piezoelektrik, si sondë e veçantë ose e inkuorporuar në sondën e kombinuar, e cila dërgon sinjale të gjerësisë disa milimetërshe dhe strukturat e zemrës i dallon vetëm në një dimension, në dimensionin e thellësisë. Gjatë ekzaminimit bëhen prerjet standarde me të cilat ekzaminohen dhe analizohen strukturat e zemrës.

2-D (B-Mode) ose Ekokardiografia dydimensionale

Përkundër rezultateve të para mahnitëse të arritura me ekokardiografinë M-mode, kjo metodë e ekzaminimit nuk ishte e pranueshme për shumicën e klinikistëve. Shumica e tyre nuk e kishin lehtë t'i kuptojnë imazhet e fituara me M-mode dhe të njëjtat t'i imagjinojnë me strukturat tredimensionale të zemrës në hapësirë. Me 1971 Nicolas Bom (14) nga Holanda e prodhoi aparatën e parë me të cilën i prezantoi në monitor imazhet lëvizëse të zemrës në kohë reale dhe shumë shpejt ky sistem gjeti aplikim në prezantimin real të anatomisë dhe funksionit të zemrës. Më vonë, me 1974 Griffith dhe Henry (16) e publikuan metodën e re (metoda e sektorit gjithëpërfshirës) për prezantimin e strukturave të zemrës duke e aplikuar teknikën e eko impulseve dhe duke përdorur sensor të thjeshtë, që më heret ishte në përdorim si M-mode ekokardiografia.

Ekokardiografia dydimensionale i komponon mangësitë e prezantimit me M-mode duke e prezantuar edhe dimensionin e gjerësisë së strukturave të analizuar. Sonda është e konceptuar me disa kristale piezoelektrike, me aktivizim elektronik ose mekanik, prodhon sinjal kontinual me gjerësi disa milimetra. Me kombinimin e prerjeve të ndryshme tomografike fitohen imazhe të “gjalla” të strukturave të zemrës në hapësirë, të definuara në vlerat absolute dhe relative. Pasi që zemra ekzaminohet përmes hapësirave të ngushta interkostale, në kardiologji përdoret prezantimi sektorik, ku me shtrirjen e valëve ultrasonografike fitohet imazhi ekokardiografik në formë të trekëndëshit. Gjatë ekzaminimit bëhet një seri prej përafërsisht 20 prerjeve: gjatësore, tërthore dhe të pjerrta, me të cilat fitohen imazhe të mjaftueshme në prezantimin e zemrës.



Foto 1. Prerja e gjatë transtorakale; LV-left ventricle, RV-right ventricle, Ao-aorta, MV-mitral valve, LA-left atrium

Aplikimi i Ekokardiografisë në prezantimin e Keqformimeve të Lindura të Zemrës (KLZ)

Qysh në vitin 1959 Effert me bashkëpunëtorë i publikoi rezultatet e para ekokardiografike të fëmijëve me keqformime të rënda trashëguese, duke përfshirë këtu defektin interatrial, defektin interventrikular dhe duktusin persistent atrial. Në këtë kohë, me teknologjinë ekzistuese, nuk ka qenë e mundur prezantimi i dimensioneve të defekteve dhe ndryshimeve hemodinamike por ka qenë e mundur dallimi i këtyre fëmijëve prej fëmijëve të shëndoshë. Si pasojë e kësaj, u zhvilluan shumë studime të cilat për objekt hulumtimi kishin popullatën me keqformime të lindura të zemrës (KLZ). Dhjetë vjet më vonë u publikuan shumë punime të cilat propozuan ekokardiografinë si njërin prej metodave themelore në diagnostikimin e kësaj patologjie tejet të komplikuar. Njëri prej entiteteve të prezantuara ishte edhe tetralogjia Fallot. Hapat e ardhshëm kanë qenë të fokusuar në prezantimin e lëvizjeve të valvulës trikuspidale në korelim më anomalitë e përcjellura me shunt. Këto studime kanë treguar se lëvizjet e valvulës mitrale tek fëmijët me defekt në regjionin e fosa ovale dhe shunt të rëndësishëm hemodinamik janë normale kurse lëvizjet e fletëzave të valvulës trikuspidale janë shumë më të shpejta. Njëkohësisht është treguar se shpejtësia e lëvizjeve është në korelim me rritjen e qarkullimit në nivel të valvulës trikuspidale. Tek fëmijët me defekt atrioventrikular të formës ostium primum është regjistruar lëvizja e shpejtuar e të dy AV-valveve. Tek fëmijët me duktus arteriosus persistent dhe me defekt interventrikular dhe shunt majtas-djathtas kardiograma tregon lëvizje të shpejtuara të valvulës mitrale, e cila interpretohet si rritje e qarkullimit përmes kësaj valvule (15, 17, 18).

Në Kongresin e Parë të ultrasonografisë diagnostike në mjekësi, të mbajtur në Vienë me 1969, Nils Rune Lundström, (19) nga Lund i Suedisë, i prezantoi të dhënat e veta ekokardiografike për keqformime të ndryshme të lindura të zemrës. Në punimet e veta ai i prezantoi shenjat e dilatimit të ventrikujve dhe ekokardiogramin karakteristik të defekti interatrial dhe të defekti interventrikular. Më vonë ekokardiografia në mënyrë sinjifikante kontribuoi në diagnostikim e anomalisë Ebstein-it si anomali të izoluar. Lundström me bashkëpunëtor i përshkruan gjetjet tipike të tre pacient të cilët kishin zhvendosje të lartë të fletëzave të malformuara të valvulës trikuspidale. Njëkohësisht është regjistruar mbyllja e vonuar e fletëzave të valvulës trikuspidale, që korrespondonte mirë me kohën e klikut sistolik. Në studimet subsekuente është konfirmuar së këto ndryshime ekzistojnë te shumica e pacientëve me keqformimin e Ebstein-it. Lundström me bashkëpunëtorë përshkruan një numër të madh të keqformimeve

komplekse të lindura të zemrës siç janë sindroma hipoplastike e ventrikulit të majtë, stenoza subaortike, etj. (19, 20).

Të nxitur me këto gjetje, një numër i madh i klinikistëve filluan me aplikimin e gjerë të ekokardiografisë si metodë diagnostike në kardiologji, prej moshave më të hershme, duke përfshirë edhe moshën neonatale. Ekzaminimi ekokardiografik ka mundësuar diagnostikimin e double inlet ventricle, sindromin e hipoplasionit të ventrikulit të majtë dhe shumë keqformime tjera të lindura të zemrës. Në San Francisko, Silverman (21) me bashkëpunëtorë kanë vërejtur se tek fëmijët e lindur para kohe dhe me duktus arterial persistent ekziston dilatim i rëndësishëm i atriumit të majtë. Më vonë kjo gjetje ekokardiografike është bërë njëra prej shtyllave në ekzaminimin ekokardiografik të fëmijëve të lindur para kohe.

Siç diskutuam më herët, diagnostikimi i formave të ndryshme të keqformimeve të zemrës fillimisht është bazuar në lëvizjet e AV-fletëzave me metodën M-mode kurse më vonë është bërë edhe vlerësimi i hapësirave dhe kontraktilitetit të ventrikujve. Dilatimi i ventrikulit të djathtë, i kombinuar me lëvizje abnormale të septumit interventrikular, është gjetje karakteristike të ngarkesa me volum e ventrikullit të djathtë, çka shihet tek lezionet me shunt majtas-djathtas, si defekti interatrial ose defekti interventrikular. Më vonë është vërejtur se ngjitja dhe pozicioni abnormal i AV-fletëzave krijon imazhe karakteristike ekokardiografike për kanalin komplet atrioventrikular.

Me 1974 Sahn (22) me bashkëpunëtorë ka filluar përdorimin e metodave ekokardiografike transtorakale në ekzaminimin e zemrës së fëmijëve në kohë reale. Me pozicionimin e transduserit në tre prerjet standarde janë fituar imazhe: sagjitale, transverse dhe ortogonale të zemrës të cilat kanë mundësuar diagnostikimin real të shumë formave tjera të KLZ. Përdorimi i transduserit me shumë kristale ka mundësuar prezantimin më të detajuar të strukturave anatomike kundrejt përdorimit të metodës M-mode.

Paralelisht, me përparimin e ekokardiografisë, angiokardiografia në vitet 60-ta dhe 70-ta ka luajtur rol të rëndësishëm në diagnostikimin e KLZ. Angiokardiografia ka ofruar imazhe të kualitetit të lartë të shumica e këtyre keqformimeve kurse llogaritjet e volumeve ventrikulare dhe shunteve intrakardiale kanë mundësuar vlerësim dhe përcjellje më kualitative. Pionerët e imazherisë ekokardiografike të KLZ kanë kuptuar se matjet e fituara me ekokardiografi duhet të krahasohen me standardet e arta të cilat i ofron angiokardiografia. Silverman (21, 23) me bashkëpunëtorë kanë treguar se ekziston korelim i ngushtë ndërmjet dimensioneve end-diastolike të ventrikulit të majtë, të fituara me sineangiografi dhe ekokardiografi. Korelim i ngjajshëm është vërejtur edhe në dimensionet end-sistolike dhe ky qëndrim ka mbetur standard i artë në dy dekadat e ardhshme. Në vitin 1997 në Klinikën Cincinnati, një grup i mjekëve, i udhëhequr nga Meyer, (17, 20, 36) treguan mundësinë e ekzaminimit të zemrës së fëmijës, të vendosur në anën e djathtë të kraharorit dhe e përcjellur me keqformime komplekse. Me kombinimin e gjetjes ekokardiografike dhe radiogramës së kraharorit ata treguan mundësinë e diagnostikimit të saktë, pa nevojë të kateterizimit dhe angiografisë. Me këtë ekokardiografia ka dhënë shpresa në diagnostikimin e një numri të madh të keqformimeve komplekse si lidhja diskordante atrio-ventrikulare, dekstrocardia etj. (24, 38).

Sukseset operative të arritura në zemrën e hapur në vitet e 60-ta kanë premtuar mundësinë e intervenimeve paliative të KLZ. Me 1963 në Hospital for Sick Children në Toronto, Mustard e përshkroi i pari procedurën paliative të transponimi i enëve të gjakut TGA (transposition of the great arteries), e diagnostikuar me saktësi me ekokardiografi. Në fakt diagnostikimi i TGA fillimisht është bërë me metodën M-mode, ku u demonstrua pozicioni abnormal i aortës ndaj arteries pulmonare.

Fillimi i aplikimit të Doppler ekokardiografisë në KLZ


Doppler ekokardiografia bazohet në parimet e efekteve të Dopplerit në matjen e shpejtësisë dhe drejtimit të gjakut në zemër dhe enë të gjakut. Fizikani Doppler ishte i pari që vërejtí se, frekuenca e valës së reflektuar të ultratingullit është e ndryshme nga frekuenca e valës së emetuar, kur vala e ultratingulli kthehet nga një objekt i lëvizshëm. Në ekokardiografi sonda ekokardiografike emeton dhe pranon valë kurse objekti i lëvizshëm janë eritrocitet në qarkullimin e gjakut. Aparatura bashkëkohore

ekokardiografike në aspektin teknik lejon përdorimin e tre llojeve të Dopplerit: Doppleri me valë kontinuale, me valë pulsative dhe prezantimin e koduar dydimensional me ngjyrë. (25, 26).

Aparatura ultrasonografike e përdorur në vitet e 60-ta fillimisht ka mundësuar prezantimin e strukturave dhe kontraktilitetit të mureve të zemrës por më vonë, me përparimin e teknologjisë, është krijuar mundësia e prezantimit të qarkullimit të gjakut arterial dhe venoz si dhe ekzaminimi i zemrës së fetusit. Me të njëjtën teknologji është bërë i mundur edhe prezantimi i regurgjitimit në nivel të valvulave. Te mjekët është ngjallur kureshtja e regjistrimit të regurgjitimit mitral dhe trikuspidal tek sëmundjet e lindura dhe të fituara të zemrës si dhe regjistrimi i qarkullimit në arterien pulmonare. Me aplikimin e Doppler ekokardiografisë transtorakale është krijuar mundësia e regjistrimit të sinjalit abnormal të qarkullimit në nivel të defektit interventrikular (DIV). Matja e shpejtësisë maksimale përmes defektit dhe përdorimi i ekuacionit të Bernoulli-it mundëson llogaritjen e presionit i cili ekziston në ventrikuj dhe dallimin e gradientit jo vetëm në nivel të DIV por edhe në nivelin e të gjitha valvulave, diagnostikimin e ngushtimeve në enë të gjakut dhe matjen e jett-it të regurgjitimit në nivel të valvulave. Të gjitha këto matje janë krahasuar me vlerat e matjeve të fituara me kateterizim ku është vërejtur një korelim tejet i ngushtë ndërmjet tyre (27).

Fillimi i aplikimit të Kollor-Dopplerit Duke iu falenderuar përparimeve në teknologjinë ultrasonografike shumë shpejt ka lindur ideja e prezantimit të qarkullimit të gjakut me ngjyrë, varësisht prej drejtimit të qarkullimit, ku si pikë e nisjes është marrë pozicioni i sondës ultrasonografike. Ky zbulim së pari herë është publikuar me 1985 nga Kompania “Aloka” gjë që nxiti mjekët në hulumtimin më të detajuar të stenozeve dhe regurgjitimeve valvulare dhe mundësoi shtrirjen e mëtutjeshme të ekokardiografisë në diagnostikimin e shumë KLZ. Në shumicën e qendrave kardiopediatrike ekokardiografia është bërë metodë e mjaftueshme në diagnostikimin definitiv të keqformimeve edhe më të komplikuar të zemrës si derdhja totale anomale e venave pulmonare ose anomalitë e kombinuara me dextropozicion. Kollor-Doppleri u ka krijuar klinikistëve mundësinë e identifikimit të prejardhjes dhe natyrën e qarkullimit të gjakut edhe te keqformimet më të komplikuar të zemrës të cilat prej lindjes rrezikojnë jetën e fëmijës. Shumë shpejt kollor-Doppleri është bërë pjesë obligative në ekzaminimin e çdo fëmije me KLZ. Kombinimi i ekokardiografisë transtorakale me kollor-Doppler ka ofruar imazhe të cilat në shumë aspekte kanë qenë analoge apo më të sofistikuar se ato të fituara me sineangjiografi. Informatat e fituara me kombinimin e këtyre dy metodave ekokardiografike kanë mundësuar fillimin e intervenimeve kardiokirurgjike në zemër të hapur pa pasur nevojë të kateterizimit diagnostik, posaçërisht tek fëmijët në gjendje të rëndë klinike.

Aplikimi i prerjes katërhapësinore Prej fillimit hulumtuesit në sferën e ultrasonografisë e kanë pasur të qartë se prezantimi i KLZ kërkon disa specifika klinike dhe fizike. Së pari, fëmijët me keqformime të lindura të zemrës kanë mundësinë e zhvillimit të derdhjes totale anomale të venave pulmonare ose lidhjen diskordante atrioventrikulare. Prekordiumi i fëmijës u krijon shpeshherë kufizime fizike metodave ekokardiografike në prezantimin e plotë të ndryshimeve të krijuara në zemër. Për këtë arsye hulumtuesit kanë qenë të detyruar që, përpos ekzaminimit parasternal, të kërkojnë mundësi plotësuese me qëllim të ekzaminimit dhe diagnostikimit adekuat. Ishin hulumtuesit nga San Francisko të parët të cilët filluan ekzaminimin ekokardiografik nga pozicioni i majës së zemrës, duke e bërë prerjen katërhapësinore, e cila sot është prerje standarde në ekzaminimin e zemrës. Kjo prerje mundëson aplikimin e metodave planimetrike në analizën e volumit të ventrikullit të majtë, volumit të atriumit të majtë dhe fraksionin e ejektimit (28, 29).



Skema 2. Prerjet e ndryshme dydimensionale (sipas Tajik); Ao-aorta, RPA-right pulmonary artery, RV-right ventricle, PT-pulmonary trunc, LA-left atrium, RA-right atrium, LV-left ventricle,

Aplikimi i prerjes subkostale Gjatë ekzaminimit ekokardiografik, posaçërisht tek fëmijët me TGA, për shkak të nevojës për intervenim palitaiv të formës së atrioseptostomisë, duhet të bëhet ekzaminimi i detajuar i septumit interatrial. Ekzaminohet dhe vlerësohet ekzistimi i defektit interatrial, pozicioni, dimensionet dhe sasia e gjakut e cila kalon nëpër të. Tek fëmijët e vegjël dhe te të porsalindurit kjo arrihet me qasjen subkostale e cila mundëson fitimin e një dritarje të shkëlqyeshme në prezantimin e septumit interatrial. Qasja subkostale mundëson ekzaminimin e pothuajse të gjitha strukturave të zemrës, duke përfshirë këtu derdhjen e venave sistemike dhe pulmonare, ekzaminimin e valvulave atrioventrikulare, septumit ventrikular dhe lidhjes ventrikulo-arteriale. Mjekët nga Bostoni, të udhëhequr nga Roberta Williams, bënë një manovrim bazik duke e rrotulluar planin e imazherisë ekokardiografike. Ky prezantim mundëson qasje reale anatomike gjë që u bë standard në shumë qendra për prezantimin e imazheve të KLZ por e cila fatkeqësisht ende nuk është pranuar nga klinikistët të cilët punojnë me sëmundje të fituara të zemrës (30, 31, 38).




Foto 2. Prerja subkostale; VCI-vena cava inferior, RA-right atrium, TV-tricuspid valve, RV-right ventricle, RVOT-right ventricle outlet tract, AP-arteria pulmonalis, RPA- LPA right - left pulmonary artery, Ao-aorta, LA-left atrium,

Aplikimi i prerjes suprasternale Klinikistët shpejt e kuptuan se prezantimi i detajuar i morfologjisë së trungut arterial është me rëndësi të veçantë gjatë ekzaminimit të hollësishëm të KLZ dhe qasjes optimale në trajtimin kirurgjik. Për shembull, prezantimi i koarktacionit të aortës dhe keqformimeve tjera të harkut të aortës është tejet i rëndësishëm për arritjen e rezultateve të mira kirurgjikale. Kjo ka qenë arsyeja e fillimit të qasjes suprasternale në prezantimin e këtyre hollësive anatomike. Bazuar në punimet e para të Sniderit, Silvermanit dhe të tjerëve, imazhet e fituara me prerjet suprasternale shpejt u bënë rutinë dhe njëra prej qasjeve obligative në evaluimin e fëmijëve të dyshuar për KLZ. Fatmirësisht, ashtu si edhe tek qasja subkostale, interferenca e mushkërive dhe timusit tek fëmijët e vegjël është më e vogël dhe imazhet e fituara me këtë prerje të trungut arterial dhe venave sistemike janë shumë më kualitative se ato të rriturit (31, 32).

Ekokardiografia transezofageale

Prej fillimit të aplikimit të ekokardiografisë mjekët kanë shqyrtuar mundësinë e ekzaminimit të zemrës me vendosjen e sondës në ezofag. Kjo qasje është inicuar nga Edler dhe Hertz. Në realitet ekokardiografia transezofageale është zhvilluar në disa etapa duke filluar me Dopplerin kontinual, duke vazhduar me M-mode imazherinë dhe në kohë të fundit me imazhet reale 2-D dhe tredimensionale. Fillimisht sonda ka qenë rigjide dhe si pasojë ka pasur kufizime në aplikimin klinik. Nga klinikistët është kuptuar se qasja transezofageale ofron informata të rëndësishme tek fëmijët me KLZ çka ka ndikuar në përparimet e shumta teknike, përfshirë miniaturizimin e sondës, fleksibilitetin dhe transformimin e saj prej monoplane në bi dhe multiplane dhe inkorporimin e kollor-Dopplerit. (33, 34) Sot ekzaminimi transezofageal është i rëndësishëm para dhe pas operimit të disa keqformimeve, si defekti interatrial tek fëmijët e rritur, ku qasja transtorakale është suboptimale. Inkorporimi i kollor-Dopplerit në sondën transezofageale u mundëson kirurgëve regjistrimin e lezioneve reziduale para përfundimit të intervenimit kardiokirurgjik. Fillimisht si sondat transtorakale ashtu edhe ato transezofageale, kanë qenë të mëdha për aplikim tek fëmijët e vegjël kurse më vonë janë prodhuar sonda që mund të përdoren edhe tek fëmijët me masë trupore mbi 2.5 kg (34, 34, 35).

BIBLIOGRAFIA

1. Rice MJ, Seward JB, Hagler DJ i sur. Impact of 2-D echocardiography on the management of distressed newborns in whom cardiac disease is suspected. *Am J Cardiol* 1983; 51: 288-92.
2. Čikeš I. Echocardiography in cardiac interventions. Dordrecht-Boston-London: Kluwer Academic Publishers, 1989.
3. Henry W L, Gardin J M, Ware J H 1980 Echocardiographic measurements in normal subjects from infancy to old age. *Circulation* 62: 1054-1061.
4. Feigenbaum H 1986 Echocardiography, 4th edn. Lea & Febiger, Philadelphia, PA p 624.
5. Tajik A J, Seward J B, Hagler D J et al 1978 Two dimensional real time ultrasonic imaging of the heart and great vessels. *Mayo Clinic Proceedings* 53: 271-303.
6. Huhta J C, Smallhorn J F, Macartney F J et al 1982b Cross-sectional echocardiographic diagnosis of systemic venous return. *British Heart Journal* 48: 388-403.
7. Fabečić-Sabadi V, Kokoš Ž, Lukanović T. Uloga ehokardiografije u smanjenju broja invazivnih kardioloških pretraga. *An Klin Boln »Dr M. Stojanović«* 1987; 26: 263-74.
8. Ritter SB. Transesophageal real-time echocardiography in infants and children with congenital heart disease. *J Am Coll Cardiol* 1991; 18 (2): 569-580.
9. Dussik KT, Dussik F, Wyt L. Auf dem Wege Zur Hyperphonographie des Gehirnes. *Wien Med Wochenschr* 1947; 97: 425-429.
10. Keidel WD. New method of recording changes in volume of the human heart. *Z Kreislaufforsch* 1950; 39: 257- 271.
11. Edler I, Gustafson A, Karlefors T. Ultrasound cardiography. *Acta Med Scand* 1961; 379: 68-82.
12. Edler I, Lindstrom K. The history of echocardiography. *Ultrasound Med Biol* 2004; 30 (12): 1565-1644.
13. Popp RL, Wolfe SB, Hirata T, Feigenbaum H. Estimation of right and left ventricular size by ultrasound. A study of the echoes from the interventricular septum. *Am J Cardiol* 1969; 24 (4): 523-530.
14. Bom N, Lancee CT, Honkoop J, Hugenholtz PG. Ultrasonic viewer for cross-sectional analyses of moving cardiac structures. *Biomed Eng* 1971; 6 (11): 500-503, 505.
15. Feigenbaum H 1986 Echocardiography, 4th edn. Lea & Febiger, Philadelphia, PA p 624.
16. Griffith JM, Henry WL. A sector scanner for real time twodimensional echocardiography. *Circulation* 1974; 49 (6): 1147- 1152.
17. Meyer Ra. Echocardiography. U: Adams FH, Emmanouilides GC, Riemenschneider TA, ur. *Heart Disease in infants, children and adolescents*. Baltimore – Hong Kong – London – Sydney: Williams - Wilkins, 1989: 56 – 81.
18. Tajik AJ, Gau GT, Ritter DG, Ritter DG, Schattenberg TT. Echocardiographic pattern of right ventricular diastolic volume overload in children. *Circulation* 1972; 46 (1): 36-43.

19. Lundstrom NR, Edler I. Ultrasonocardiography in infants and children. *Acta Paediatr Scand* 1971; 60 (2): 117-128.
20. Meyer RA, Stockert J, Kaplan S. Echographic determination of left ventricular volumes in pediatric patients. *Circulation* 1975; 51 (2): 297-303.
21. Silverman NH, Ports TA, Snider AR, Schiller NB, Carlsson E, Heilborn DC. Determination of left ventricular volume in children: echocardiographic and angiographic comparisons. *Circulation* 1980; 62 (3): 548-557.
22. Sahn D J, Allen H D, Goldberg S J et al 1975 Pediatric echocardiography: a review of its clinical utility. *Journal of Pediatrics* 87: 335-352.
23. Silverman N H, Hunter S, Anderson R H et al 1983 Anatomical basis of crosses sectional echocardiography. *British Heart Journal* 50: 421-430.
24. Silverman NH, Schiller NB. Apex echocardiography. A two-dimensional technique for evaluating congenital heart disease. *Circulation* 1978; 57 (3): 503-511.
25. Goldberg S J, Allen H D, Marx G R, Flinn C J 1985 Doppler echocardiography. Lea & Febiger, Philadelphia, PA, p 34.
26. Simpson IA, Sahn DJ, Valdes - Cruz LM i sur. Color Doppler flow mapping in patients with coarctation of the aorta: new observations and improved evaluation with color flow diameter and proximal acceleration as predictors of severity. *Circulation* 1988; 77:736-44.
27. Nishimura R A, Miller F A Jr, Callagan M J et al 1985 Doppler echocardiography: theory, instrumentation, technique, and application. *Mayo Clinic Proceeding* 60: 321-343.
28. Huhta J C, Smallhorn J F, Macartney F J 1982a Two dimensional echocardiographic diagnosis of situs. *British Heart Journal* 48: 97-108.
29. Rigby M L, Anderson R H, Gibson D G et al 1981 Two dimensional echocardiographic categorization of the univentricular heart. Ventricular morphology, type, and mode of atrioventricular connection. *British Heart Journal* 46: 603-612.
30. Henry W L, Gardin J M, Ware J H 1980 Echocardiographic measurements in normal subjects from infancy to old age. *Circulation* 62: 1054-1061.
31. Hanrath P, Schluter M, Langenstein B A et al 1983 Detection of ostium secundum atrial septal defects by transoesophageal cross-sectional echocardiography. *British Heart Journal* 49: 350-358.
32. Silverman NH, Ports TA, Snider AR, Schiller NB, Carlsson E, Heilborn DC. Determination of left ventricular volume in children: echocardiographic and angiographic comparisons. *Circulation* 1980; 62 (3): 548-557.
33. Seward JB, Khandheria BK, Oh JK, Abel MD, Hughes RW Jr, Edwards WD, Nichols BA, Freeman WK, Tajik AJ. Transesophageal echocardiography: technique, anatomic correlations, implementation, and clinical applications. *Mayo Clin Proc* 1988; 63 (7): 649-680.
34. Fyfe D A, Ritter S B, Snider A R et al 1992 Gudelines for transesophageal echocardiography in children. *Journal of American Society of Echocardiography* 5: 640-644.
35. Weintraub R, Shiota T, Elkadi T et al 1992 Transesophageal echocardiography in infants and children with congenital heart disease. *Circulation* 86: 711-722.
36. Silverman NH, Lewis AB, Heymann MA, Rudolph AM. Echocardiographic assessment of ductus arteriosus shunt in premature infants. *Circulation* 1974; 50 (4): 821-825.
37. Čikeš I. Ehokardiografija. U: Medicinska enciklopedija, Drugi dopunski svezak. Zagreb: Jugoslovenski leksikografski zavod »Miroslav Krleža«, 1986: 128-35.
38. Gutgesell H P 1985 Cardiac imaging with ultrasound: rightside up or upside down? *American Journal of Cardiology* 56: 479-480.

SUMMARY

THE HISTORY OF DEVELOPMENT AND USAGE OF ECHOCARDIOGRAPHY IN PEDIATRICS

Ramush Bejiqi¹, Hana Bejiqi², Ragip Retkoceri¹

¹Intensive ward, Clinic of Pediatrics, CUCK, Pristina, Kosovo

²The main Center of Family Medicine, Pristina, Kosovo

Echocardiography is a group of diagnostic methods in examination of the human heart using the ultrasonography. Affirmation of this method contributed many factors: high sensitivity and sensibility of images, it's noninvasive and non hurting method, possibility of follow up and assessment of the treating, absent of biological sides affects, easy to perform with echo machine, also possibility of using this method event when the child is in bed or incubator and, definitively possibility of using this equipment in small medical centers (1, 2). High echogenicity of the heart structures contribute in diagnostic decision which are the base of cardio surgery intervention without catheterization and angiocardiology in more than 95 % of all CHD (1, 3, 4). Echocardiographic examination of the child is different in many aspects the adult examination especially examination of the preterm babies, children in incubator and children in critical condition (child in intensive care unit, intubated and life threatening children). Whereas respiratory and heart frequency are much higher in children, dimension of heart structures are more smaller examination need more avoid and patient, especially condition and excellent machine. Often child is excited, dyspnoic and cyanotic and don't cooperate during the examination. Usually any sedation is not needed during the examination. It's enough having a bottle of milk or tea and patience of doctor and nurses. We have to mention that as well as equipment more important factor is the knowledge and skills of doctors in correlation the clinical data, electrocardiogram, chest x-ray and other data with echocardiographic results. Only in this way doctor can avoid all artefacts of complicated CHD (3. 5). It's the best way to protect sick child from unbiased decision from which depends success and prognosis of surgical intervention. Combination of echocardiographic methods has done historical changes in exact diagnosis of more than 95 % of all CHD without other invasive diagnostic procedures (7.8).

Key Words: Echocardiography, color – Doppler, M-mode echocardiography, 2D-echocardiography

MEDICUS

VËSHTRIM/REVIEW PEDIATRI

PROTEINURIA SI SINJAL I NEFROPATISË

Diamant Shtiza¹, Enkelejda Shkurti², Durim Cela³, Maksim Basho³

¹Departamenti i Pediatrisë, QSU “Nënë Tereza”, Tiranë, Shqipëri

²Fakulteti i Infermierise, Universiteti i Tiranës, Shqipëri

³Departamenti i Imazherisë, QSU “Nënë Tereza”, Tiranë, Shqipëri



Diamant Shtiza, mjek pediatër, nefrolog
Rr. Perlat Rexhepi, Pallati Komani, Sh.2, Ap1, Tiranë, Shqipëri
Tël: +355 6926 70067 & +355 6720 58791
e-mail: diamantshtiza@yahoo.com

REZYME: Prevalenca e proteinurisë në popullatën pediatrike ndryshon në bazë të klinikës. Gjendet në 1 fëmijë në 10 në moshën shkolllore, nëse matët me strishion reaktive (lakmues apo dipstick) dhe arrin një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1+. Nëse ky rezultat duhet konfirmuar në 4 kampionë të ndryshëm, përqindja zbrit në 1 për 1000. Prevalenca shtohet me rritjen e moshës me një pik në adoleshencë, 16 vjeç për meshkujt e 13 vjeç për femrat, me një zbritje graduale në moshën e adultit.

Fjalë kyç: proteinuria, filtrimi glomerular

Medicus 2012, Vol. XVII (1):

Mekanizmat dhe shkaqet e proteinurisë

Sasia e proteinave që gjendet në urinë përcaktohet nga 3 procese: filtrimi glomerular, reabsorbimi dhe sekretimi tubular.

Filtrimi

Likidet, substancat dhe makromolekulat që të arrijnë në urinë duhet të përshkojnë paretin glomerular kapilar të përbërë nga tre shtresa të ndryshme: shtresa qelizore endoteliale, membrana bazale glomerulare dhe shtresa qelizore epiteliale. Aftësia e një substance që të kapërcejë kapilarët glomerularë varet nga përmasat dhe ngarkesa elektrike e saj.

Membrana bazale përfaqëson barrierën kryesore të kalimit të molekulave të mëdha si proteinat. Kjo i detyrohet karakteristikave të saj të përshkueshmërisë dhe pranisë së glikozaminoglikanëve me ngarkesë negative, kryesisht në laminën e ndritshme të membranës bazale dhe të polianionëve që veshin proceset epiteliale podocitare. Që nga çasti që në pH fiziologjik edhe proteinat hematike kanë një ngarkesë negative, kalimi i tyre përmes kapilarëve glomerularë është i bllokuar.

Faktorë të tjerë që ndikojnë në sasinë e proteinave të filtruara janë sipërfaqja kapilare glomerulare, konveksioni e difuzioni, si dhe forma e plasticiteti i molekulës së filtruar.

Çdo modifikim i faktorëve të filtrimit glomerular mund të shkaktojë proteinuri. Shtimi i përmasave të poreve është përgjegjës për një glomerulonefrit akut ose kronik. Në sindromën nefrotike me dëmtime minimale përmasat e poreve mbeten normale, por konstatohet një humbje e ngarkesave anionike glomerulare. Përshkueshmëria e kapilarëve glomerularë mund të ndikohet edhe nga sëmundje që ndryshojnë përbërjen kimike të membranës bazale si në sindromen Alport. Një shtim i fluksit hematik glomerular, që konstatohet në paksimin e masës renale nga nefrektomia ose cikatrizimi, shton lëvizjen transkapilare të molekulave për shkak të konveksionit dhe difuzionit. Shkaqe të tjera të filtrimit glomerular të proteinave jepen në tabelën 1.

Tabela 1. Shkaqet e shtimit të rritjes së filtrimit glomerular të proteinave

Dëmtimi i paretit kapilar glomerular	Pareti kapilar glomerular normal
Glomerulonefrit akut ose kronik	Proteinuri e shkaktuar nga angiotenzina
Sindrom hemolitik-uremik	Proteinuri ortostatike?
Glomeruloskleroza fokale segmentare	Hipertension
Sindrom nefrotik me dëmtime minimale	Shtim i niveleve të proteinave të plazmës (infuzione të plazmës ose albuminës)
Sindromi Alport	
Sindroma të ndryshme të trashëguara	

Reabsorbimi

Në kushte normale vetëm një përqindje e vogël e proteinave që përshkojnë filtrin glomerular shfaqet në urinë. Pjesa më e madhe përthithet me anë të pinocitozes në tubulat e përdredhur proksimalë.

Nga çasti që sasia e proteinave të filtruara është e paksuar, mungesa e reabsorbimit nga ana e tubulave proksimalë provokon një proteinuri të lehtë 1+ e barabartë me 30mg/dl ose mesatare 2+ e barabartë me 100mg/dl.

Gjithashtu, nga çasti që në kushte normale glomeruli pakson kalimin e albuminës e të proteinave të tjera me përmasa të mëdha, proteinuria si pasojë e një defekti reabsorbimi ka të bëjë kryesisht me proteinat me peshë molekulare të ulët. Disa nga sëmundjet më të zakonshme të shoqëruara me ulje të reabsorbimit tubular të proteinave jepen në tabelën 2.

Tabela 2. Etiologjia e proteinurisë me origjinë tubulare

Çrregullimet e transportit	Toksinat tubulare	Demtim iskemik tubular	Nëfritët tubulointërsticiale të fituara	Të ndryshme
Sindrom Fanconi	Aminoglikozidët	Shok hipovolemik	Nefriti intersticial	Uropati nga obstrukcioni
Çistinoza	Penicilinat	Asfiksi	Pielonefriti	Veshka polikistike
Hiperkalçiuuria	6-mercaptopurina	Endotoksinemia		Sëmundje kistike medulare
	Azatioprina			
	Tetraciclina			
	Metale të rënda			
	Hemoglobina ose mioglobina të lira			
	Acidi urik			

Mes tyre më kryesorja është sindroma Fanconi që karakterizohet nga një çrregullim i përgjithshëm i tubulave proksimalë që janë përgjegjës për praninë e proteinave e të substancave të tjera në urinë si glukozja, kaliumi, kalçiumi, fosfori e bikarbonatet. Edhe nekroza tubulare akute me origjinë iskemike ose toksike mund të ndikojë në reabsorbimin tubular proksimal.

Sekretimi

Proteinat mund të arrijnë në urinë gjatë kalimit të saj në rrugët urinare. Disa proteina sekretohen si pasojë e shkëmbimit normal qelizor ose si pasojë e një dëmtimi të indeve, ndërsa të tjera prodhohen nga qeliza të aparatit urinar. Mukoproteina Tamm-Horsfall, një nga përbërësit kryesorë të cilindrave renale, prodhohet me një shpejtësi konstante nga qelizat e pjesës së trashë të ansës Henle. Ajo shtohet gjatë aktivitetit fizik, insuficiencës renale akute, flakjes së transplantit renal dhe gurëve renale.

Ekzaminimet për përcaktimin e origjinës së proteinurisë

Përcaktimi i proteinurisë kryhet me anë të ekzaminimeve sasiore, gjysëm sasiore dhe cilësore.

Strishio reaktive

Metoda më e zakonshme në klinikë është strishio reaktive, që bazohet në ndryshimin e ngjyrës së provokuar nga reaksioni i tetrabromfenolit me aminogrupet proteinike. Me strishion reaktive konstatohet zakonisht albumina, ndërsa proteinat me peshë të vogël molekulare reagojnë ndaj strishiove speciale për proteinat tubulare.

Përcaktimi i proteinave varet nga pH urinar, prandaj urina alkaline do të japë rezultat fals pozitiv. Shkaqe të tjera fals pozitive janë lënia e strishios për një kohë të gjatë e zhytur në urinë, prania e detergjentëve, përbërësit e amoniumit kuaternar, leukocitet ose bakteret. Meqenëse strishio përcakton përqendrimin e proteinave rezultati ndikohet edhe nga vëllimi i urinës. Një urinë shumë e përqendruar mund të rezultojë me vlera të larta proteinash, në të kundërt në urinë shumë të holluar proteinat mund të

mos identifikohen. Përgjithësisht rezultati 1+ ose me shumë në kampion urine me peshë specifike 1015 flasin për një humbje jo normale të proteinave.

Analiza e urinës

Rezultati i strishios duhet konfirmuar me analizë laboratorike duke përdorur urinën e mëngjesit.

Mbledhja në intervale të rregullta

Matja e kujdesshme e ekskretimit të proteinave kërkon një mbledhje të urinës 12 ose 24 orëshe. Mbledhja 24 orë ka si mangësi mungesën e përcaktimit të sasisë së proteinave ditore të sekretuara. Tek të shëndoshët dhe tek pacientët me insuficiencë të lehtë ose mesatare ekskretimi i proteinave është më i madh gjatë ditës, e që shtohet gjatë aktivitetit fizik. Në fëmijët me nefropati të avancuar ndryshimi i proteinave ditore është minimal.

Tek të rriturit një sasi proteinash më pak se 150 mg në 24 orë konsiderohet normal. Tek fëmijët, kjo ndryshon në bazë të gjatësisë trupore e moshës. Kjo mund të korrigjohet në bazë të sipërfaqes trupore siç tregohet në tabelën 3.

Tabela 3. Ekskretimi i proteinave në 24 orë në fëmijët e moshave të ndryshme

Mosha	Përqendrimi i proteinave (mg/L)	Ekskretimi i proteinave (mg/24h)	Ekskretimi i proteinave (mg/24/m ²)
Prematurë (5-30 ditë)	88-845	29 (14-60)	182 (88-377)
Në term	94-455	32 (15-68)	145 (68-309)
2-12 muaj	70-315	38 (17-85)	109 (48-244)
2-4 vjeç	45-217	49 (20-121)	91 (38-223)
4-10 vjeç	50-223	71 (26-194)	85 (31-234)
10-16 vjeç	45-391	83 (29-238)	63 (22-181)

Përgjithësisht një sasi më e vogël se 4 mg/m² /h konsiderohet normale; nga 4-40 mg/m² jo normale; mbi 40 mg/m² konsiderohet e nivelit nefrotik. Këto vlera nuk aplikohen për të porsalindurit: një aftësi e ulët reabsorbimi tubular shpjegon sasinë e madhe të proteinave të ekskretuara në këtë moshë.

Raporti proteinë/kreatininë

Shpesh është e vështirë mbledhja e urinës, sidomos tek fëmijët e vegjël. Një metodë alternative e pranuar është raporti proteinë/kreatininë i matur në një kampion të rastësishëm. Konsiderohen normale vlerat < 0,5 për fëmijët e moshës nga 6 muaj deri 2 vjeç; 0,2-0,25 për fëmijët mbi 2 vjeç dhe < 0,2 për të rriturit.

Meqenëse përqendrimi serik i kreatininës, si dhe ekskretimi i saj urinar, varet nga masa muskulare, raporti proteinë/kreatininë nuk është i besueshëm në gjendjet me kequshqyerje të rëndë. Besueshmëria e saj, është e dyshimtë edhe në fëmijët me funksion të ulët glomerular: në keto raste një sasi e konsiderueshme e kreatininës urinare vjen nga sekretimi tubular dhe jo nga filtrimi glomerular. Në fund, raporti proteinë/kreatininë varet shumë edhe nga aktiviteti fizik si në rastin e proteinurise ortostatike.

Elektroforeza e proteinave

Dëmtimet tubulare shoqërohen me një shtim të ekskretimit të proteinave me peshë molekulare të vogël që identifikohet me anë të elektroforezës së proteinave. Ekzistojnë ekzaminime që masin përqendrimin urinar të mikroproteinave specifike, për shembull mikroglobulina 2.

Anamneza e plotë dhe ekzaminimi objektiv

Vlerësimi i një fëmijë me proteinuri fillon me marrjen e një anamneze të hollësishme dhe kryerjen e ekzaminimit objektiv. Mjeku duhet të vlerësojë praninë e shenjave dhe simptomave që flasin për nefropati. Hipertensioni, edema, vonesa e rritjes dhe nefropatia familjare janë disa tregues.

Ekzaminimi i parë që duhet kryer është analiza e urinës e kryer në një kampion të mëngjesit, që do të bëjë të mundur konfirmimin e pranisë së proteinurisë dhe kërkimin e anomalive urinare shoqëruese (gjak, cilindra etj.) tregues të glomerulopatisë. Pasi konfirmohet proteinuria, duhet kryer analiza e kampionëve të ndryshëm në intervale të ndryshme kohore. Dy kampionë të njëpasnjëshëm prej 12 orësh janë të rëndësishëm për përcaktimin e proteinurisë ortostatike beninje.

Në tabelën 4 paraqitën udhërrëfyesit për mbledhjen e urinës. Nëse kampioni ditor i marrë në ortostatizëm përmban sasi jo normale të proteinave, ndërsa mbledhja e natës në qetësi është pa proteina, ka shumë mundësi që kemi të bëjmë me një proteinuri ortostatike që nuk kërkon ekzaminime të tjera shtesë. Sasi jo normale proteinash në të dy kampionët flasin për nefropati dhe kërkojnë ekzaminime të tjera shtesë. Elektrolitet serike, azotemia dhe kreatinina janë të dobishme për vlerësimin e funksionit renal, ndërsa ekografia renale jep informacion për strukturën e veshkave. Duhet matur komplementemia dhe titri i antistreptolizinave nëse dyshohet për glomerulonefrit postinfektiv.

Tabela 4. Udhërrëfyes për mbledhjen e urinës në intervale të rregullta prej 12 ore

1. Ti kërkohet fëmijës ta zbrazë vezikën para gjumit e të shënohet orari
2. Të mblidhet urina e prodhuar gjatë natës dhe kampioni i parë i mëngjesit. Të shënohet ora e urinës së parë të mëngjesit. Të shkruhet në enë “urina e natës”
3. Të mblidhet e gjithë urina e ditës, përfshi edhe urinën para gjumit. Të shënohet ora e fillimit dhe mbarimit në enë si dhe “urina e ditës”

Përgjithsisht një rezultat pozitiv në një nga ekzaminimet laboratorike fillestare justifikon kërkesën për konsultë tek specialisti nefrolog peditër. Arsye të tjera për vizitë specialisti paraqitën në tabelën 5.


Tabela 5. Kur duhet kërkuar vizita e nefrologut

Proteinuri jo ortostatike persistente
Episode të përsëritura të hematurisë makroskopike
Anamnezë familjare për insuficiencë renale, glomerulonefrit, deficit neurosensorial të dëgjimit, transplant renal
Hematuri dhe proteinuri
Nivele të larta të azotemisë dhe kreatininemisë
Hipertension
Cilindra qelizore
Edema
Simptoma sistematike (dhimbje artikulare, erupsione kutane, artralgi)
Stres ankioz i prindërve

Për të përcaktuar diagnozën, terapinë dhe prognozën specialisti do të kryejë ekzaminime më të hollësishme përfshirë edhe biopsinë e veshkës.

Në figurën 1 pasqyrohet diagrama për vlerësimin e një fëmije me proteinuri asimptomatike.

Figura 1. Vlerësimi i fëmijës me proteinuri asimptomatike



REFERENCAT

1. Adelman RD, Restaino IG, Alon US, Blowey DL: Protëinuria and focal segmental glomerulosclerosis in severely obese adolescents. J Pediatr 2001;138:481-485
2. Chandar J, Abitbol c, Montanë B, Zilleruelo G: Angiotënsin blockade as sole treatment for protëinuric kidney disease in children. Nephrol Dial Transplant 2007;22:1332-1337
3. Hogg RJ, Portman RJ, Millinër D, Lemley KV, Eddy A, Ingelfinger J: Evaluation and management of protëinuria and nephrotic syndrome in children: recommendations from a pediatric nephrology panel established at the National Kidney Foundation conference on protëinuria, albuminuria, risk, assessment, detection, and elimination (PARADE). Pediatrics 2000;105:1242-1249
4. Zelicovic I, Eisenstëin I: Practical Algorithms in Pediatric Nephrology 2008;1:32-34

SUMMARY

PROTEINURIA AS A SIGNAL OF NEPHROPATHY

Diamant Shtiza¹, Enkelejda Shkurti², Durim Cela³, Maksim Basho³

¹Department of Pediatrics, UHC "Mother Tereza", Tirana, Albania

²Faculty of Nursing, University of Tirana, Albania

³Department of Imaging, UHC "Mother Tereza", Tirana, Albania

The prevalence of proteinuria in children depends from the clinic picture. The proteinuria is estimated 1:10 children in the school age, measured by dipstick, when the result is 1+ or more. If we perform 4 different samples, the result of the test is 1:1000 children. The prevalence increase in the older children; reaching the maximum in the adolescence, 16 years for males and 13 years for females; decreasing gradually in adulthood.

Key words: Proteinuria, glomerular filtration rate

TREATMENT OF THE BURNED HAND
- Guideline for young doctors -

Gjorgje Dzokic¹, Smilja Tudzarova-Gjorgova¹, Dika Artan¹, Idriz Orana¹,
Marija Miloshevska- Mijalkovska¹

¹University Clinic for Plastic, Reconstructive and Aesthetic Surgery,
Medical Faculty, UKIM, Skopje, Macedonia



Djordje Dzokic, MD, hirurg, profesor
University Clinic for Plastic, Reconstructive & Aesthetic Surgery
Str. Vodnjanska, Medical faculty, Skopje
Tel: 02 3 14 73 74
e-mail: gjorgjedzokic@yahoo.com

RESUME: *Severe hand burns may leave individuals totally nonfunctional. They may lose their ability to be productive at work or, even worse, may not be able to care for themselves. Therefore, the goal of the management of burns of the hand must be the restoration of optimal function with stable soft-tissue coverage. To properly treat the burned hand, one must first to put the initial diagnosis and understand its pathobiology. If the burn is limited to the hand the patient can be treated as outpatient, but, if the burned hand is part of a larger burn or if both hands are burned that requires hospitalization. In that case, six treatment principles can be outlined for management of the acute hand burn: maintain circulation, do no harm, prevent infection, obtain wound closure, preserve and regain motion; and obtain functional rehabilitation. The goal of treatment of the burned hand is to make the hand functional at the conclusion of treatment.*

Key words: *Burns, hand, surgical principles, treatment*

Medicus 2012, Vol. XVII (1):


INTRODUCTION

Burns of the hands are unique and are categorized as major injuries by the American and International Burn Association. Severe hand burns may leave individuals totally nonfunctional, they may lose their ability to be productive at work or, even worse, may not be able to care for themselves. Therefore, the goal of the management of burns of the hand must be the restoration of optimal function with stable soft-tissue coverage (1).

The initial diagnosis and treatment of the acute hand burn assumes a more important role than attempts to reconstruct the crippled hand. To properly treat the burned hand, one must first understand its pathobiology, this requires a basic understanding of what happens to any tissue exposed to heat, and the

unique problems presented by the specialized anatomy of the hand. This pathobiology can be divided into four phases:

- effects occurring as a direct result of heat itself
- effects secondary to edema
- effects secondary to decreased circulation
- effects secondary to bacterial colonization of the burn wound



Degrees of Intensity of the burned hand (first degree-superficial epidermal burns, second degree-epidermal and dermal burns; third degree- full thickness burns)

Mechanism of injury is usually by direct contact with heating/burning agent resulting in *Contact burns*, or is a result of exposure to heating/burning agent by protecting face with hands in defense position- *Exposure burns*.



Contact burns of the hand (left), Exposure burns of the hand, neck and face(right)

Initial assessment and diagnosis

An early determination must be made in burned hands by observing the resting position. The burned hand may early assume an intrinsic minus position with the metacarpophalangeal joints in extension and the interphalangeal joints in flexion, because this position is the most comfortable and painless for the patient (2).

The first priority for the acutely burned hand is the diagnosis of vascular insufficiency, by Doppler examination and compartment pressure monitoring with a Wick catheter considering all positive and negative effects. The initial assessment of the burn wound is the prime determinant of subsequent treatment. Sensation is unreliable guide in the burned hand, it may reflect ischemia; the temperature of the burning object and the length of contact are still the most useful pieces of information to help with determination of depth (3).

The initial assessment of range of motion will identify prior limitations suggested by the patient. Because progressive edema during the first 24 hours will significantly alter these measurements, it is

important to record the baseline range of motion as soon as possible, before edema becomes the limiting factor.

There are no specific laboratory findings for burns of the hand, but if the hand is a small part of the burn injury, systemic abnormalities may be present and may need to be corrected.



Burned hand II degree(left), burned hand III degree after necrectomia (right)

Surgical principles in treatment of the burned hand

If the burn is limited to the hand and is only the first degree, the patient can be treated symptomatically. Patients with isolated partial and small full-thickness burns usually can be treated as outpatients, very rare to be shortly hospitalized. Hospitalization is usually necessary if both hands are burned.

If the burned hand is part of a larger burn or is an isolated injury that requires hospitalization, six surgical treatment principles can be outlined for management of the acute hand burn: (1) maintain circulation; (2) do not harm (3) prevent infection; (4) obtain wound closure; (5) preserve and/or regain motion; and (6) obtain functional rehabilitation. These principles organized into an algorithm help the surgeon treating the patient with a burned hand to form a plan (3, 4, 5).

Principle 1: Maintain circulation

The circulation can best be maintained by preventing microvascular deterioration and by preventing excess edema. Cooling the burned hand within the first 30 minutes postburn as a first-aid measure has been shown by Raine et al not only to prevent leukocyte sticking, but also actually to increase wound perfusion by maintaining the normal homeostasis between PgE2 and PgF2 and preventing formation of thromboxane. Elevation of the burned hand from the time of injury is of great value, and the elevation need only be above the level of the right atrium (5, 6).



Cooling the burned hand with cold water

Despite cooling and elevation, tight eschars may be present proximal to the burned hand, jeopardizing the circulation to the hand because that the intrinsic musculature of the hand cannot withstand ischemia. Therefore, circulation must be monitored, and if any question of ischemia arises, measures must be instituted to maintain the circulation. Early operative decompression-escharotomy has been accepted as the standard for release of circulatory embarrassment.

An alternative to surgical escharotomy is noninvasive decompression using an enzymatic debriding agent(Travase, Fibrolan, Bromelain, Granugel ointment etc) to cause proteolytic dissolution of the constricting eschar. A thin layer of these agents is applied in a wet dressing for 2-3 hours and the circulation is reassessed; if total release has not been effected, the procedure is repeated. If the burn is old or if the injury is secondary to an electrical burn, surgical escharotomy may become a therapeutic imperative (7).

Principle 2: Do no harm

The admonition, "primum, non nocere"- "first, do no harm"-is never more appropriate than when dealing with treatment of the burned hand. The "zone of stasis" comprised of cells that are initially injured but still viable needs to be preserved if possible. Nothing should be done that will lead to further microvascular deterioration in this zone. Maceration that removes the remaining natural barriers to infection of intact skin should be avoided. The burned hand should be covered with sterile gauze dressing, or hydrofiber or alginate dressing and put in an impervious plastic glove or Gortex glove in order to facilitate further treatment.

Because blister fluid from burned hands contains inflammatory mediators thought to be detrimental to the microcirculation in the zone of stasis, removal of the blister fluid seems justified. This can be done either by debriding the blister or by aspirating the fluid. Zawacki et al have shown that desiccation can further injure the zone of stasis and deepen the burns. Therefore, aspiration leaving the blister epithelium intact is physiologically sound. If the blister is broken, then debridement and prevention of desiccation is indicated (7, 8, 9).



Cleansing the burned hand (left), debridement of the blisters (right)

Principle 3: Prevent infection

Infection in the burned hand can be secondary to several causes. The first, which must always be remembered, is due to Clostridia tetani. Tetanus, which is rare in hand burns, does occur. Because it is totally preventable, tetanus immunoprophylaxis is as essential in management of the burned hand as in any other wound, following recommendation for its application.

The body's normal defense mechanisms against beta hemolytic streptococci are neutralized during the edema phase of the burn wound. Therefore, a specific antistreptococcal drug (penicillin or erythromycin) is recommended during the blister or edema phase. Heggers et al have demonstrated the presence of penicillin in the blister fluid of patients administered the drug, and penicillin penetrates from the systemic circulation into burn eschar (9, 10).

The normal bacterial ecology of the skin is upset by burning. Microorganisms usually residing in sweat glands and hair follicles migrate through the burned skin and multiply. Transient microorganisms normally prevented from achieving bacterial lodgement by the intact cutaneous barrier now are capable of proliferation and invasion. As these multiply, they further compromise the blood supply by perivascular compression. If these bacteria multiply to greater than 100 000 bacteria per gram of tissue, they cause an avascular burn wound sepsis that is not responsive to systemic antibacterials and is best prevented and managed by topical antibacterial creams. The particular antibacterial cream can be chosen for the specific wound by using the agar well technique on a homogenate of a burn wound tissue biopsy. Alternatives to antibacterial creams are antibacterial liquids, hydrofibers, hydrocolloids and alginates dressings.. Silver nitrate in a 0,5% concentration and 5% mafenide solution have been used locally for the burned hand with excellent results (10, 11).



Preventing infection by saline and antibiotic gauze dressing(left), and by alginate dressing (right)

Principle 4: Obtain wound closure

The key to management of the acutely burned hand is to obtain a closed or covered wound with autogenous tissue. In the hand, this tissue must be both pliable and durable to allow full and normal function. Wound closure options for the acute hand burn depend on the depth and degree of the burn and include five basic options:

- ✓ early spontaneous epithelialization within 14 days
- ✓ early excision of nonviable tissue and skin grafting
- ✓ delayed spontaneous healing and epithelialization requiring more than 14 days
- ✓ delayed excision of the burn wound with skin grafting, and
- ✓ excision of deep burns exposing tendons, vessels and nerves and reconstruction with skin flaps.

Wound closure for the superficial partial thickness(I and IIa degrees) burns will be by epithelialization. Because this will occur within two weeks if the diagnosis is correct, the proper treatment is not impede the epithelialization. Dryness and desiccation are known to retard epithelialization. Therefore, water-soluble dressings and creams that allow the wounds not to desiccate, and also Biobrane gloves would appear to be the best choice. Superficial burns of the hand do well. Hypertrophic scarring is absent or minimal (11, 12).



Early spontaneous epithelialisation(left), delayed spontaneous epithelialisation(right)

The majority of hand burns requiring hospitalization are deep dermal burns(IIb degree). The treatment of these burns has been quite controversial, due to similar findings as full thickness burns. However, the development of topical antibacterials allowed bacterial control of the burn wound, and tried on the burned hand, it was recognized that most were deep dermal and not full thickness burns. This fact led to several approaches to the deep partial thickness hand burn (12, 13, 14).

Surgeons who believe that early wound closure is paramount to good hand function think that early tangential or intradermal excision and skin grafting is the ideal treatment for the deep dermal burns. Advantages of this technique have been reported as shorter hospitalization, cost savings, better function, and fewer complications. Other surgeons have believed that because dermal elements are present in the majority of hand burns, conservatism is justified. In this approach, infection is prevented by topical antibacterial agents, and a vigorous physical therapy program is used to maintain function.

A variation on intradermal debridement and skin grafting has been suggested by some authors using an enzymatic debriding agent such to remove nonviable tissue and then applying a skin graft to the debrided wounds. Another alternative was suggested for patients who had not been excised early from proved reasons; for these patients being recommended delayed excision after 14 days and skin grafting (8, 9, 13, 15).

Many prospective studies have been performed comparing results of operative treatment versus nonoperative treatment founding no statistical differences in the functional results among them. So, for the deep dermal burns, the data clearly show that both operative and nonoperative techniques are satisfactory and can result in excellent function of the hand (12, 13, 14, 15).

Full thickness burns(III degree) of the hand do poorly with most any treatment. Some authors prefer early excision of nonviable tissue and skin grafting, another prefer delayed excision and skin grafting over granulating bed. Therefore, the literature is not clear on the best treatment for the full thickness burn, except that all treatments result in poorer function than for the more superficial injuries (14, 15, 16).

Full thickness burn (left), after delayed excision and skin grafting(right)





Deep III degree-full thickness burns exposing tendons and nerves(left), after reconstruction with skin flap(right)

This discussion has centered on the dorsal acute hand burn because of its prevalence. Volar or palmar burns are only rarely excised because most will heal spontaneously.

Principle 5: Preserve and regain motion

During the early postburn period, the major priority for the hand is proper positioning and splinting. Initially, the burned hand presents in an intrinsic-minus position with metacarpophalangeal joints hyperextended, interphalangeal joints hyperflexed, and the thumb adducted. This position, if initially left untreated, is almost impossible to correct secondarily; thus, the position of injury is the “position of comfort” that ultimately results in contracture. Splinting and adequate positioning contra position of comfort should be started as soon as possible after the burn injury to preserve function and prevent contracture. Elevation of the burned hand and gentle exercise will facilitate and maintain joint mobility. Gentle passive and active range of motion is encouraged two to four times daily, the continuous passive motion machines have been successfully used as an adjunct during this phase. When early excision and skin grafting have been chosen, the goal is to obtain uniform graft take before motion is attempted (17, 18).



Intrinsic “minus” position-position of comfort(left), after relaxing excision and skin grafting(right)

Principle 6: Obtain functional rehabilitation

The final management principle for the patient presenting with the acute hand burn is to obtain the best possible function. Rehabilitation goals include:

- ✓ obtaining adequate, stretched and durable skin coverage
- ✓ maintaining or regaining full joint range of motion
- ✓ preserving sensitive and motor skill coordination
- ✓ promoting functional independence
- ✓ maintaining or regaining muscular strength and endurance

To obtain the best functional recovery, one must evaluate the ability of the treated hand to perform its necessary professional, specific or domestic tasks. If these tasks cannot be performed, a



determination is made as to whether the deficit is temporary or permanent; may require job retraining to achieve the best functional rehabilitation (19, 20).

Functional rehabilitation of the burned hand, ability of writing(left), normal flexion of the fingers(right)

CONCLUSION

The goal of treatment of the burned hand is to make the hand functional at the conclusion of treatment. Function should ideally include both fine pinch and power grip but will ultimately be determined by the individual patient's needs. At no time, however, can the care of the burned hand be performed in a vacuum, losing sight of the patient as a whole. It must also be remembered that the hand functions as part of the upper extremity. Full hand motion is useless if significant contractures of the elbow or axilla prevent the patient from positioning the hand so that this motion can be utilized. Rehabilitation must render the entire extremity functional. Thus, it becomes obvious that a team effort is mandatory. This usually will include the following individuals: physician, nurse, occupational therapist, physical therapist, vocational rehabilitation counselor, and social worker.

A functional hand means that the goal must be to return patients to their preburn vocations and avocations. A clear understanding of job requirements and work habits will allow realistic goals to be established. However, when the goal of optimal function cannot be reached, early retraining will help to obtain optimal rehabilitation.

REFERENCES

1. American Burn Association: Guidelines for service standards and severity classification in the treatment of burn injury. *Bull Am Coll Surg*, 1984; 69:24
2. Brian B J. Burn Trauma. *Plastic and Reconstructive Surgery*. London. Springer. 2010; 15: 189- 205.
3. Baubak S. Burns:Initial Management and Resuscitation. *Practical Plastic Surgery*. Austin.Landes Bioscience. 2007; 28: 154:162.
4. Cartotto R.: The burned hand; optimizing long-term outcomes with a standardized approach to acute and subacute care. *Clin Plast Surg*.2005; 32(4): 515-527.
5. Tredget E E: Management of the acutely burned upper extremity. *Hand Clin* 2002; 16(2): 187-203.
6. Robson M C, Smith D J: Burned hand. In Jurkiewicz MJ, Krizek TJ, Mathes SJ, Ariyan S (eds): *Plastic Surgery: Principles and Practice*. St Louis, CV Mosby, 1990; 781-802
7. Salisbury R.E: Reconstruction of the burned hand. *Clin Plast Surg*, 2000;27: 65-9.
8. Synstegard T A, Wachtel T L, et al: Functional hand assessment after enzymatic debridement and early autografting, *J Burn Care Rehabil*, 1984; 5: 438
9. Robson M C, Smith D J, John V Z.: Making the burned hand functional, *Clinics in Plastic Surgery*, 1992,(19); 3: 663-670
10. Feldman M E, Evans J.: Early management of the burned pediatric hand. *J Craniofac Surg* 2008; 19(4): 942-950.
11. Knight S, John A D: Hand burns. *Principles and practice of burn management*. Settle: Churchill Livingstone; 1996.
12. Haslik W, Kamolz L-P, Lumenta D B, Hadik M, Beck H, Frey M: The treatment of deep dermal hand

- burns, *Burns*. 2010; 36(3): 329-34.
13. Sheridan R L, Hurley J, Smith M A et al: The acutely burned hand: management and outcome based on a ten-year experience with 1047 acute hand burns. *J Trauma* 1997; 38: 406-411
 14. Barillo D J, Paulsen S M: Management of the burns to the hand. *Wounds*. 2003; 15(1): 4-9
 15. Cuenca-Pardo J, Alvarez-Diaz C, Lujan-Olivar F: Precocious surgery on burned hand. A comparative study. *Cir Plast* 2002; 12(1): 18-24
 16. Fadaak H A : Experience with early tangential excision in the management of deep dermal burns on the dorsum of the hand. *Ann Burns Fire Dis* 2001; 1: 25-29
 17. Ganai A A, Garzi M A, Chowdri N A: Prospective randomized comparative study of surgical excision and conservative treatment for deep burns of the hand. *J-K Practitioner* 2002; 9(1): 24-27
 18. Van Zuijlen P P, Kreis R W, Vloemans A F et al: The prognostic factors regarding long-term functional outcome of full-thickness hand burns. *Burns*. 1999; 25(8): 709-714
 19. Maslauskas K, Rimedeika R, Rapoliene J et al: Analysis of burned hand function. *Medicina(Kaunas)*. 2005; 41(10): 846-851
 20. Illey W, McMahon S, Shukalak B: Rehabilitation of the burned upper extremity. *Hand Clin.* 2000; 16: 303-18.

РЕЗИМЕ

ЛЕКУВАЊЕ НА ИЗГОРЕНА ШАКА

- водич за млади доктори -

Ѓорѓе Џокиќ¹, Смиља Туцарова-Ѓоргова¹, Дика Артан¹, Идриз Орана¹, Марија Милошевска-Мијалковска¹

¹ЈЗУ Универзитетска Клиника за Пластична, реконструктивна и естетска хирургија, Медицински факултет, УКИМ, Скопје, Македонија

Тешките изгореници на шака може да предизвикаат губиток на функција на шака кај пациентите. Овие пациенти често пати ја губат својата професионална способност за работа, но, и што е уште полошо, тие може да бидат хендикепирани и во својот приватен живот заради неможноста да се грижат за себе. Од овие причини, целта на правовремено и правилното лекување на изгорениците на шака треба да биде оптималното функционално опоравување на изгорената шака со квалитетна кожна покривка. За да се постигне оваа цел потребно е поставување на точна дијагноза, како и познавање на патолошките промени кај изгорениците. Ако се работи за изолирана изгореница на шака тогаш можно е амбулантско лекување на пациентот, но, ако се изгорени обете шаки или се работи за поекстензивни изгореници и на останатите делови од телото тогаш е потребна хоспитализација. Во секој случај во лекувањето на изгорениците на шака мора да се запазат шесте основни принципи на правилниот хируршки третман: одржување на циркулација, внимателно работење без да се причини штета, спречување на инфекција, овозможување на квалитетна кожна покривка, по можност што поскора мобилизација и квалитетна функционална рехабилитација. Целта на третманот на изгорената шака е задршка на функционалноста на истата по завршетокот на лекувањето.

Клучни зборови: Изгореници, шака, хируршки принципи, лекување

MEDICUS

VĚSHTRIM / REVIEW **KIRURGJI PLASTIKE**

KĚMBA DIABETIKE: PATOGJENEZA DHE KLASIFIKIMI KLINIK

Argjent Muça¹, Artan Dika¹, Irfan Ahmeti², Gjorgje Xhokiq¹

¹Klinika Univerzitare e Kirurgjisë Plastike dhe Rekonstruktive, Shkup, Maqedoni



Argjent Muça, mjek
Rr. M. Ç. Filipovski, nr.180 Gostivar
Tel: 070883305
e-mail: argjent_muca85@hotmail.com

REZYME: Pjesët distale të ekstremiteteve të poshtme shpesh herë përbëjnë vendin e lokalizimit të komplikimeve nga diabeti. Këmba diabetike kërkon një kujdes të veçantë, në mënyrë që të parandalohen ndërlikime të shumta, trajtimi i të cilave është kompleks dhe përbën një sfidë për specialistët e degëve të ndryshme që merren me trajtimin e këtyre patologjive. Komplikimet e këmbës diabetike, si: ulçera, flegmona dhe gangrena, janë probleme të hasura në vazhdimësi në punën e përditshme, por trajtimi adekuat i tyre kërkon një qasje të specializuar mjekësore multidisiplinore. Zhvillimet e reja teknologjike dhe shtimi i mjeteve në disponim për trajtimin e këtyre komplikimeve e ka shtuar gamën e mundësive për arritjen e rezultateve optimal. Megjithatë, trajtimi më i mirë për të gjitha problemet që lidhen me këmbën diabetike është parandalimi i tyre. Për këtë qëllim po shfrytëzohen udhëzues të ndryshëm.

Fjalë kyç: Këmba diabetike, patogjeneza, ndërlikimet, parandalimi

Medicus 2012, Vol. XVII (1):

HYRJE

Ulçerat dhe infeksionet e këmbës diabetike janë komplikime të rënda, shërimi i të cilave shpesh është sfidues për kirurgët dhe internistët që merren me trajtimin e këtyre ndërlikimeve (kirurgun plastik, kirurgun vaskular, endokrinologun, neurologun, etj.). Këto patologji paraqiten te persona me çrregullime sistemike, të shkaktuara nga diabeti - çrregullime këto që rezultojnë me efekte kompromituese në shumë sisteme të trupit, duke përfshirë këtu sistemin nervor, vaskular, muskulo-skeletor dhe atë imunitar. Të gjitha këto çrregullime sistemike luajnë rol të rëndësishëm në shfaqjen dhe ecurinë e ulçerave dhe infeksioneve të këmba diabetike, - qoftë duke marrë natyrën e një problemi kronik, shërimi eventual apo humbje të këmbës, tek të sëmurët në fjalë. Patogjeneza e shfaqjes së ulçerave dhe infeksioneve pasuese te këmba diabetike, është e ndërlikuar dhe përmban 3 procese interaktive (shih diagramin nr. 1):

- *Angiopatia,*
- *Neuropatia,* dhe
- *Imunopatia.*

Kujdesi lokal i ulçerave te këmba diabetike përfshin: debridementin, mjekimet e shpeshta të plagëve dhe përdorimin e pajisjeve ndihmëse. Terapitë shtesë, si p.sh. përdorimi i oksigjenit nën presion (dhoma hiperbarike), duhet të konsiderohen si opsione trajtimi shtesë, te ulçerat të cilat nuk shërohen. Kërkimet e shumta të cilat bëhen si rezultat i teknologjisë bashkëkohore, na mundësojnë opsione të reja për trajtim e plagëve, shërimi i të cilave paraqet vështirësi. Infeksionet e komplikojnë trajtimin e plagëve te këmba diabetike dhe në këto raste është e nevojshme edhe terapia me antibiotikë, si dhe një qasje më agresive për shërimin e këtyre pacientëve. Natyra e diabetit si sëmundje kronike e cila përfshin një varg sistemesh të trupit të njeriut, kërkon qasje ekipore në trajtimin e ulçerave dhe infeksioneve të këmbës diabetike,


duke përfshirë këtu edhe përkujdesjen për plagët në kushte të specializuara. Sido që të jetë, parandalimi i paraqitjes së ulçerave është mënyra më e mirë e përkujdesit për këmbën diabetike.


PARANDALIMI

Kontrolli i rreptë i glikemisë si dhe edukimi i duhur i pacientëve, janë komponentet kryesore të programit për parandalim. Në mirëmbajtjen e kontrollit të glikemisë bëjnë pjesë: regjimi dietik, monitorimi i glikemisë në kushte shtëpiake, përdorimi adekuat i medikamenteve dhe trajtimi efektiv i hiperglikemisë. Gjithashtu, pacientët duhet të edukohen për problemet e mundshme, të cilat mund të paraqiten në këmbët e tyre si dhe teknikat themelore për përkujdesjen ndaj tyre. Faktor rreziku kryesor për paraqitjen e ulçerave të këmba diabetike është prania e neuropatisë, prandaj përkujdesi ndaj këmbës diabetike neuropatike është me rëndësi esenciale, me qëllim parandalues. *Pinzer* dhe bashkëpuntorët e tij kanë publikuan një udhëzues për kujdesin ndaj këmbës diabetike, të bazuar në rekomandimet e Shoqatës Ortopedike Amerikane, dhe si i tillë ky udhëzues është i pranuar në suaza botërore. Në këtë kontekst, në përkujdesjen për këmbën diabetike duhet të kemi parasysh:

- Inspeksionin e përditshëm të gishtërinjëve dhe këmbëve;
- Këshillimin e pacientëve që të veshin çorapë dhe këpucë të buta dhe të rehatshme;
- Mirëmbajtjen e thonjve;
- Larjen, tharjen dhe mbajtjen e ngrohtë të përditshme të këmbëve;
- Përdorimin e kremrave dhe losioneve;
- Ushtrimet, ushqyerjen adekuate dhe mospirjen e duhanit.

Diagrami nr. 1 – Kaskada e patogjenezës tek pacientët me *diabetes mellitus*





TEKNIKA TË PËRKUJDESJES PËR PLAGËT DIABETIKE

Trajtimi i këmbës diabetike po bëhet sfidë e madhe dhe kontradiktore, për shkak të rritjes së numrit të prodhimeve dhe mjeteve për trajtimin e plagëve, si dhe krijimin e protokoleve dhe algoritmeve të trajtimit

Tabela 1. Sistemi i klasifikimit sipas Vagnerit

Shkalla	Karakteristikat
0	Lëkura intakte (lezion preulçerativ), ulçera të shëruara, deformim kockor
1	Ulçera sipërfaqësorë pa përfshirjen e indit nënlëkuror
2	Depërtim në indin nënlëkuror (mund të jetë ekspozuar kocka, tendini, ligamenti ose kapsula e artikulacionit)
3	Osteit, absces ose osteomielit
4	Gangrenë e gishtit
5	Gangrenë e këmbës me nevojën për dezartikulim dhe amputim

diabetike, nga të cilët, njëri ndër më të njohurit është sistemi i klasifikimit sipas Vagnerit (Wagner classification system), i paraqitur në tabelën nr. 1. Një modifikim i këtij sistemi, është paraqitur në tabelën nr. 2. Trajtimi optimal i këmbës diabetike përfshin debridmentin e vazhdueshëm, mjekimin e shpeshtë të plagëve, marrjen e masave për zvogëlimin e shtypjes së këmbës së pacientit si dhe përdorimin e terapisë shtesë dhe teknologjive më të reja për plagët e pashërueshme.



Foto – Ulçerë diabetike e këmbës (shkalla e dytë sipas Vagnerit)




Foto – Ulçerë diabetike e këmbës (shkalla e tretë sipas Vagnerit)




Foto – Gangrenë/nekrozë e gishtit (shkalla e katërt sipas Vagnerit)



Foto – Gangrenë e këmbës (shkalla e pestë sipas Vagnerit)

Tabela nr. 2 - Llojet më të shpeshta të infeksioneve gjatë këmbës diabetike dhe trajtimet e tyre

Cellulitis (I) – skuqje lokale, ënjtje e dhimbshme, gjëndra limfatike të zmadhuara, ethe dhe dobësi trupore. Trajtimi në fazën fillestare: mjekim lokal dhe terapi antibiotike *per os*. Në fazat e avancuara mund të jetë i nevojshëm hospitalizimi, terapia me antibiotikë intravenoz dhe intervenimi kirurgjik.

Ulcus (II) – fluska, hiperkeratozë, ulçera sipërfaqësore ose të thella me përfshirjen e tendineve, kockave dhe artikulacioneve. Trajtimi: toalet dhe debridment i plagëve, mjekime të shpeshta, terapi me antibiotikë si dhe rekomandim për përdorim të këpucëve speciale.

Abscessus (III) – fluska të infektuara, abcese të mbushura me qelb në thellësi deri te fascia dhe tendinet. Trajtimi: incizion, drenazh, debridment, terapi me antibiotikë dhe rekonstrukcion kirurgjik sipas nevojës.

Osteomyelitis (III) – infeksion i indit kockor, funksion i çrregulluar. Trajtimi: incizion, drenazh, debridment, terapi me antibiotikë, rekonstrukcion kirurgjik sipas nevojës.

Necrosis, Gangrena (IV, V) – ind i vdekur i thatë ose i lagësht që përfshin edhe strukturat më të thella (tendinet, nervat, enët e gjakut, kockat, artikulacionet). Trajtimi: Nekrektomi, amputim, rekonstrukcion kirurgjik.

PËRFUNDIM

Robsoni thotë se: “Infeksioni i plagës, si dhe infeksionet tjera janë manifestim i çrregullimit të ekuilibrit njeri-bakterie, në favor të bakterieve ... që të parandalohet ose shërohet infeksioni i plagës duhet ditur se si funksionojnë procedurat profilaktike ose terapeutike që kanë për qëllim mbajtjen ose ripërtirjen e këtij ekuilibri. Vetëm atëherë kur ky ekuilibër është në baraspeshë, proceset normale të shërimit mund të vazhdojnë dhe të arrihet progresi i duhur.” Shërimi i ulçerave dhe infeksioneve të këmbës diabetike është një proces i komplikuar, si rrjedhojë e vet natyrës së diabetit. Trajtimi i këmbës diabetike dhe ndërlikimeve të saj është më efektiv nëse kryhet nga ana e një ekipi mjekësor me përbërje multidisiplinore, i cili përfshin endokrinolog, internist, edukator për diabetin, specialist për trajtimin e plagëve, kirurg dhe infektolog.

Një rëndësi të veçantë për përkujdesjen ndaj plagëve diabetike ka edhe angazhimi i punëtorëve të shëndetësisë pa trajnim të specializuar.

Gjatë trajtimit të këmbës diabetike duhet zbatuar gjithmonë teknikat më optimale për shërimin e plagëve dhe duhet synuar përfshirjen e metodave të reja që ofrojnë zhvillimet e reja teknologjike. Parandalimi i shfaqjes së plagëve të hapura te këmba diabetike është i mundur në shumicën e rasteve dhe përbën trajtimin më efikas, prandaj është edhe opsioni i rendit të parë.

LITERATURA

1. Anandev G., Michael A H. Dressings. *Practical Plastic Surgery*. Austin. Landes Bioscience. 2007; 1: 12-19.
2. Bauer JD., Mancoli J S., Linda G P. Pressure Sores. *Grabb and Smith's Plastic Surgery* - 6th ed. Lippincott, Williams & Wilkins. 2007; 74: 722-733.
3. Brem H., Tomic C M. Wound Healing in Diabetes. *JCI*. 2007; 117(5): 1218-1222.
4. Galiano R D., Thomas A M. Wound Care. *Grabb and Smith's Plastic Surgery* - 6th ed. Lippincott, Williams & Wilkins. 2007; 3: 23-32.
5. Hess C T. ed. *Clinical Guide: Wound Care*. Philadelphia: Lippincott, Williams & Wilkins; 2005.

6. Frykberg R G., Armstrong D G., Guirini J et al. Diabetic Foot Disorders: a Clinical practice Guideline. *J Foot Ankle Surg.* 2000; 39: SI-60.
7. Mustoe T. Understanding chronic Wounds. *Am J Surg.* 2004; 187-195
8. Oliver B., Ulrich K., Raymund E H. Principles of Wound Repair. *Plastic and Reconstructive Surgery.* London. Springer. 2010; 6: 57-65.
9. Raymund E H., Oliver B., Ulrich K. Physiology and Wound Healing. *Plastic and Reconstructive Surgery.* London. Springer. 2010; 1: 2-10.
10. Roberto F.L., Michael S M. Diabetic Wounds. *Practical Plastic Surgery.* Austin. Landes Bioscience. 2007; 16: 80-86.
11. Kevin J S., Philip S B. The Chronic Infected Wounds and Surgical Site Infections. *Practical Plastic Surgery.* Austin. Landes Bioscience. 2007; 15: 71-79.
12. Kevin J S., Robert T G. Wounds Due to Vascular Causes. *Practical Plastic Surgery.* Austin. Landes Bioscience. 2007; 17: 87-95.
13. Zol B.K., Victor L L. Pressure Ulcers. *Practical Plastic Surgery.* Austin. Landes Bioscience. 2007; 19: 100-110.
14. Wound Healing Treatment. *Oxford Text Book of Surgery.* Oxford press 2005.
15. Dzokic. Декубитуси - Основи во Пластична и реконструктивна хирургија. Учебно помагало. Skopje, 2004.

SUMMARY

DIABETIC FOOT: PATHOGENESIS AND CLINICAL CLASSIFICATION

Argjent Muça¹, Artan Dika¹, Irfan Ahmeti², Gjorgje Dzokic¹

¹University Clinic of Plastic and Reconstructive Surgery, Skopje, Macedonia

²University Clinic of Endocrinology, Skopje, Macedonia

Distal parts of the lower extremities are frequently the location of the complications seen from diabetes. Diabetic foot requires a special care, in order to prevent numerous complications, whose treatment is complex and presents a challenge for specialists of different branches, dealing with the treatment of these pathologies. Diabetic foot complications, such as: ulcer, phlegmona and gangrene, are common medical problems, encountered in continuity in our daily work, but their adequate treatment requires a multidisciplinary specialized medical approach. New technological developments and the increase of the available means for the treatment of these complications have increased the range of possibilities aiming at achieving optimal results. Nevertheless, the best treatment for all problems linked to the diabetic foot is their prevention. Different guidelines are now available for this purpose.

Key words: *Diabetic foot, pathogenesis, complications, prevention*



MEDICUS

VËSHTRIM / REVIEW OFTALMOLOGJI

EFEKTET E PADËSHIRUARA TË BISFOSFONATEVE NË SY, NJË RISHIKIM I LITERATURËS

Muhamed Troplini¹, Leonard Deda²

¹Spitali Rajonal Durrës, Shqipëri

²Sesioni i Farmakologjisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Tiranës, Shqipëri



Muhamed Troplini, mjek okulist
Lagja 4, Rruga "Skënderbeg", Durrës, Shqipëri

Tel.

e-mail: klinikatroplini@yahoo.com

REZYME: Rastet e efekteve të padëshiruara në sy në pacientët që marrin bisfosfonate janë raportuar që nga vitet 1990. Ato janë raportuar praktikisht për të gjitha bisfosfonatet (përfshirë alendronatin, klodronatin, ibandronatin, pamidronatin, risedronatin dhe acidin zoledronik). Mekanizmi i saktë i efekteve të padëshiruara në sy i bisfosfonateve, megjithëse mendohet të jetë kryesisht me origjinë inflamatore, nuk njihet mirë. Efektet e padëshiruara në sy të lidhur me trajtimin me bisfosfonate përfshijnë konjuktivitin, uveitin, episkleritin, skleritin, keratitin, dhe më rrallë, neuritin optik dhe edemën/inflamacionin orbital ose periorbital. Skleriti dhe keratiti paraqesin rrezik më të madh për dëmtimin e pamjes. Shpesh më shumë se një efekt i padëshiruar mund të shfaqet në të njëjtën kohë. Efektet e padëshiruara mund të prekin një ose të dy sytë njëkohësisht. Mjekët e familjes dhe ata specialistë duhet të jenë të vetëdijshëm për mundësinë e shfaqjes së efekteve të padëshiruara në sy të bisfosfonateve. Rastet e pandërlikuara, mund të trajtohen nga vetë mjekët e familjes. Në rastet më të rënda, është e nevojshme që pacienti të dërgohet tek mjeku okulist për një vlerësim dhe trajtim të mëtejshëm.

Fjalë kyç: Bisfosfonatet, efektet e padëshiruara në sy, uveiti, skleriti

Medicus 2012, Vol. XVII (1):

HYRJE

Mjekët e familjes dhe ata të specialiteteve të ndryshme jo rrallë nuk i japin rëndësi faktit që barna të ndryshëm mund të japin efekte të padëshiruara në sy. Më poshtë, trajtohen në mënyrë të përmbledhur disa nga faktorët që favorizojnë shfaqjen e efekteve të padëshiruara në sy, duke u fokusuar sidomos në efektet e padëshiruara okulare që shoqërojnë trajtimin me bisfosfonate. Bisfosfonatet janë një grup barnash që përdoren gjithnjë e më tepër për parandalimin dhe trajtimin e osteoporozës. Efektet e padëshiruara okulare të bisfosfonateve janë të rralla, por identifikimi i shpejtë dhe trajtimi i përshtatshëm i tyre është thelbësor në parandalimin e dëmtimeve serioze të funksioneve të syrit.

Faktorët që favorizojnë shfaqjen e efekteve të padëshiruara në sy

Furnizimi i pasur me gjak dhe masa relativisht e vogël e syrit e bëjnë atë veçanërisht të prirur ndaj efekteve të padëshiruara të barnave. Efektet e padëshiruara të barnave në sy janë të ndryshme. Molekulat e barnave të pranishme në sistem mund të depozitohen në mënyrë selektive në inde të tilla të syrit si kornea, kristalina apo retina, duke shkaktuar simptoma të ndryshme toksike. Për fat të mirë, në rast se kapen shpejt, shumica e efekteve të padëshiruara të barnave sistemikë në sy janë të rikthyeshme. Por, në rast se nuk kapen, efektet toksike mund të përparojnë deri në shkaktimin e dëmtimeve të parikthyeshme të syrit, që shpesh shoqërohen me pakësim të funksionit të vizual (1, 2).

Mundësia e shfaqjes së efekteve të padëshiruara në sy mund të rritet nga prania e disa faktorëve. Një ndër këta faktorë është trajtimi sistemik për periudha të gjata kohore, siç ndodh në mënyrë tipike në rastet e sëmundjeve kardiovaskulare apo reumatologjike. Jo rrallë, në disa pacientë,

Humbja, qoftë edhe fare pak në peshë, ka një efekt pozitiv të jashtëzakonshëm mbi shëndetin e njeriut. Mbipesha trupore tani quhet një sëmundje që prekë jo vetëm vendet e pasura, ashtu siç mund të thuhet se prej saj preken jo vetëm të rriturit, por edhe fëmijët. Gjithashtu kontribut në mbi peshë japin edhe reklamat që ndikojnë në sjelljen e fëmijëve ndaj ushqimit, duke i drejtuar nga fastfood-et (ushqimet e gatuar shpejt) apo atyre të paketuara, të mbushura me yndyrëra dhe sheqerëra të tepërta për dietën e fëmijëve. Për fund, ushqimi që konsumojnë njerëzit, ka shumë kalori dhe nëse sasia e kalorive të konsumuara është më e madhe se ajo e harxhuar, atëherë vjen deri te shtimi i peshës (celulitit).

LITERATURA

1. Bahtiri A. Dallimet ndermjet sportistëve dhe josportistëve ne disa ndryshore antropometrike, Reviste profesionale-shkencore Eurosporti, Prishtine, 2008.
2. Konicanin A, Tahiraj E. Značaj sporta i sportskih igara u prevenciji i korekciji deformiteta u korektivnoj gimnastici, IV Međunarodni simpozijum "sport i zdravlje", Tuzla.
3. Anderson B. Stretching, Zagreb, 2001.
4. Anderson B. Pearl B, Burke R.E. Fitness za sve, Zagreb, 2000.
5. Brian J. Sharkey – Steven E. Gaskill.; Vezbanje i Zdravlje, Beograd, 2008.
6. Tahiraj E. Rekreativni sportiv, Prishtinë, 2007.
7. Humolli I. Bodibildingu, Prishtinë, 1993.
8. Ticak K. Oblikovanje tijela za zene, Zagreb, 2003.

SUMMARY CELLULITE AND HIS CHARACTERISTICS

Enver Tahiraj¹, Abedin Bahtiri¹, Admira Konicanin², Afrim Shabani³, Arsim Thaqi⁴

¹Universe College -Prishtina,

²University of Novi Pazar,

³QKMF, Podujevo,

⁴Ministry of Sports, Prishtina.

Cellulite requires a professional medical treatment by associated with loss weight of this phenomenon. From our experience of many years as teachers of physical culture and sports, we present a rough picture of contemporary existence, development, operation of this phenomenon which is associated with the actual table from scientists and institutions on human health. Let's hope that this paper will try to reach to a information, development, and minimize this negative phenomenon in health.

Key Words: cellulite, cellulite types, advice, human health, recreational and sports activities.

MEDICUS

VËSHTRIM / REVIEW REUMATOLOGJI

DHIMBJET E RRITJES

Remzi Izairi¹

¹ESHIP "Rheuma", Çegan, Maqedoni



Remzi Izairi, mjek internist reumatolog profesor

1237 Çegan, Maqedoni

Tel. +389 (0)42 321 600 & 070 379 007

e-mail: shmshm@live.com

REZYME: Dhimbjet e rritjes janë gjendje beninje dhe nuk kanë origjinë organike. Manifestohen me dhimbje karakteristike në ekstremitete e jo në artikulacione. Zakonisht janë të përkohëshme dhe vetëvetiu zhduken në adoleshencë ose në moshën e rritur.

Fjalë kyç: Dhimbjet e rritjes, fëmijë

Medicus 2012, Vol. XVII (1):

DHIMBJET E RRITJES

Definicioni

Dhimbjet e rritjes janë gjendje beninje, e pa rrezikshme, që manifestohet me dhimbje karakteristike në ekstremitete. Zakonisht paraqitet te fëmijët nën moshën 10 vjeçare.

Epidemiologjia

Dhimbjet e rritjes në ekstremitete (këmbë dhe duar) janë një ndër shkaqet shumë të shpeshta që i detyron fëmijët të paraqiten te mjeku. Rreth 10-20% e fëmijëve në të gjitha anët e botës ndërmjet moshave 3 dhe 12 vjeç kanë dhimbje të rritjes. Pothuajse njëloj preken të dy gjinitë, vajzat dhe djemtë.

Shenjat klinike

Dhimbjet kryesisht shfaqen në anësitë e poshtme. Përqëndrohen më tepër gjatë fyejve të kockave se sa në artikulacione. Zakonisht lokalizohen në pulpë, në gropën popliteale ose në kofshë, kryesisht në të dy anët. Dhimbja është më e shprehur pas dite ose gjatë natës; ajo e zgjon fëmijën nga gjumi. Dhimbjet zakonisht i detyrohen më tepër qëndrimit në këmbë, ushtrimeve fizike, lodhjeve apo një emocion të forte, zgjasin 10-30 minuta, herë herë disa orë. Intensiteti i dhimbjes mund të jetë i dobët por edhe shumë i forte, dhe kjo është individuale. Dhimbjet paraqiten me ndërprerje, kohë pas kohe. Intervali ndërmjet dhimbjeve mund të jetë disa javë ose muaj. Te disa fëmijë dhimbja mund të jetë e përditëshme.

Diagnoza

Diagnoza e kësaj gjendjeje vihet në bazë të të dhënave anamnesike dhe ekzaminimit klinik normal. Analizat laboratorike dhe ekzaminimi radiologjik janë në kufijtë e normales.

Mjekimi

Prindërve të fëmijës duhet t'u sqarohet karakteri beninj dhe natyra e pa rrezikshme e kësaj gjendjeje. Prej barnave mund të përdoren analgjetikë dhe masazhi i ekstremiteteve. Te rastet me epizoda të shpeshta të dhimbjeve mund të përdoren tableta ose sirup ibuprofen (Brufen) në orët e mbrëmjes.

Prognoza

Dhimbjet e rritjes nuk kanë origjinë organike. Zakonisht janë tranzitore dhe spontanisht zhduken në adoleshencë ose në moshën e rritur te të gjitha rastet.

LITERATURA

1. <http://www.primo.it/pediatric-rheumatology/information/Serbia/12.htm>
2. Pilipovic N. Reumatologia. Zavod za udzbenike i nastavna sredstva. Beograd 2000: 219-27.
3. Izairi R. Doracak për diagnozën dhe mjekimin e sëmundjeve reumatike. Prishtinë, 1986: 24-54.
4. Poro K, Adhami J. Reumatologjia, "Mihal Duri", Tiranë, 1977: 89-90.

5. Vukotic D. Diferencijalna dijagnoza reumatske groznice në Konecni J. Klinicka reumatologija, Medicinska knjiga, Beograd-Zagreb, 1984: 382-86.

SUMMARY

PAIN OF GROWTH

Remzi Izairi¹

¹PHW "Rheuma", Cegran, Macedonia

The pain of growth are benign condition and they haven't organic etiology. They manifests by characteristic pain in extremities and not in articulations. Usually, they are for the time being and disappear in adolescence or in middle age.

Key words: Pain of growth, child.

MEDICUS

VËSHTRIM/REVIEW **GJINEKOLOGJI**

GJINJTË – GJËNDRAT MAMARE

Hasmije Izairi-Aliu¹

¹Spitali Gjinekologjik–Akusherik, Çair, Shkup, Maqedoni



Hasmije Izairi–Aliu, mjeke gjinekologe–osteter
Spitali Gjinekologjik–Akusherik, Çair, Shkup
Tel.+389(0)22 627-657 & +389(0)70 829 666
e-mail: preventiva21@yahoo.com

REZYME: Gjnjtë e femrave ndryshojnë për nga forma dhe madhësia. Nuk ekziston lidhshmëri mes madhësisë së gjirit dhe nivelit të intensitetit seksual të gruas ose aftësisë së saj për të ushqyer fëmijën. Ndodh shpesh që njëri gjë të jetë më i madh se tjetri. Madhësia e gjirit ndryshon sipas moshës, peshës trupore, shtatzënisë dhe faktorëve të tjerë. Kanceri i gjirit zë vendin e pare, sa i përket rasteve të reja të kancerit të femrat, dhe vendin e dytë në shkaqet e vdekjes së femrave prej kancerit. Kontrollimi i rregullt gjinekologjik dhe vetëkontrollimi mujor i gjinjve, janë mënyrat më të rëndësishme me të cilat femra mund të mbrojnë shëndetin e saj.

Fjalë kyç: Gjëndrat mamare, kanceri

Medicus 2012, Vol. XVII (1):

Të përgjithshme

Gjinjtë e femrës bëjnë pjesë në organet riprodhuese. Ato kanë funksion shumë të rëndësishëm në sigurimin e qumështit për foshnjën. Gjiri ndërtohet nga 4 struktura:

Gjëndrat qumështore: gjiri përmban 15 deri 25 gjëndra të vogla qumështi, të rrethuara nga indi fibrotik dhe yndyror.

Kanalet e qumështit: secila gjëndër qumështore ka kanal in ose duktusin, i cili e lidh atë me thimthin. Qumështi bartet përmes këtyre kanaleve.

Thimthi (mama): është maja e gjirit, në të cilën hapen kanalet e qumështit. Mama është shumë e pasur me fije nervore, të cilat e bëjnë atë sensitive. Thimthi përmban edhe fije muskulore, që e bëjnë ngritjen e tij gjatë ngacmimit seksual ose qëndrimit në të ftohtë.

Areola: është lëkura përreth thimthit me ngjyrë më të errët. Ajo përmban gjëndra që prodhojnë yndyrë, e cila e mbron sipërfaqen e saj prej tharjes, gjatë thithjes së foshnjës.

Kanceri i gjirit

Kanceri i gjirit zë vendin e parë, sa i përket rasteve të reja të kancerit të femrat, dhe vendin e dytë në shkaqet e vdekjes së femrave prej kancerit. Mirëpo, kur diagnostikohet dhe trajtohet herët, rastet e mbijetesës 5 vjeçare janë 96% (Shoqata Amerikane e Kancerit, 2002).

Kanceri i gjirit paraqitet te 1 nga 11 femra. Rreziku që femra të sëmuret nga kanceri i gjirit, rritet me rritjen e moshës.

Vetëkontrolli i gjirit

Një here në muaj, femra duhet t'i kontrollojë gjinjtë e saj. Koha më e mirë është menjëherë pas periodës menstruale. Sa më shumë që femra të dijë, se si duken dhe ndjehen normalisht gjinjtë e saj, aq më lehtë do të zbuloj çfarido ndryshimi.

“Në luftë kundër kancerit të gjirit, shikuar nga aspekti i të arriturave më të mëdha dobiprurëse, besohet se është shumë më e rëndësishme të mësohen gratë si t'i kontrollojnë vetë gjinjtë (me anë të vetëkontrollimit), sesa të mësohen mjekët për mënyrën e kontrollit të gjinjve, meqë duhet pasur parasysh se mbi 90% e ndryshimeve malinje në gji i zbulojnë vetë gratë.” Haagensen CD. Kirurg i famshëm amerikan (1900=1990).

Mënyrat e vetëkontrollit

Në banjë: vendos një rën dorë prapa kokës. Me gishta të shtrirë të dorës tjetër, me shumë kujdes prekë gjirin për të zbuluar se mos ka ndonjë kokërr ose fortësim. Me dorën e djathtë kontrollohet gjiri i majtë, ndërsa me dorën e majtë gjiri i djathtë.

Para pasqyrës: me duartë mbi kokë, vërej mos ka ndonjë ndryshim në madhësi ose në formën e gjinjve. me duar të vendosura në ije, pastaj me duar anash, dhe në fund, duke u përkulur lehtë përpara, vërej mos ka thellime, rrudhosje, ndryshime të ngjyrës së lëkurës ose të thimthave.

Në pozicion shtrirë: vendos një jastëk nën një rën shpatull. Me gishta të shtrirë dhe me lëvizje të vogla rrethore, shtyp lehtë gjirin e anës së njëjtë, duke filluar nga nënsqetulla dhe duke i lëvizur gishtat poshtë e lart mbi gji, në vija të drejta. Çfarëdo kokërr e re ose ndryshim tjetër duhet të kontrollohet nga mjeku.

Faktorët e rrezikut

Në faktorët e rrezikut bëjnë pjesë: prania e kancerit të gjirit te të afërmit e ngushtë (nëna, motra); periodat menstruale para moshës 12 vjeçe; kanceri i mëparshëm në një rën gji; fëmija i parë pas moshës 30 vjeçe ose mungesa e fëmijëve; mosha mbi 50 vjeçe dhe menopauza pas moshës 55 vjeçe.

Rekomandim

Në shumicën e rasteve, femrat vetë i zbulojnë ndryshimet në gjinj. Shumica e kokrrave nuk janë kancer, por nuk ka mundësi të dihet saktësisht pa ekzaminim të hollësishëm. Vetëkontrollimi i gjinjve për çdo muaj, mund t'u ndihmojë femrave që kokrrat në gjinjë t'i zbulojnë herët. Te gratë e moshës mbi 40 vjeçe dhe te ato në rrezik nga kanceri i gjirit, rekomandohet që për çdo vit të bëhet mamografia, një procedure e veçantë radiologjike. Femrat e moshës 20-39 vjeçe, çdo të tretin vit, duhet të bëjnë kontrollin e gjinjve te mjeku.

Përfundim

Kontrollimi i rregullt gjinekologjik dhe vetëkontrollimi mujor i gjinjve, janë mënyrat më të rëndësishme me të cilat femra mund të mbrojnë shëndetin e saj.

LITERATURA

1. Nora J. Kranzler, William M. Kane: Abstenenca. Sjelljet dhe rreziqet seksuale Health facta. Santa Crus, California, USA 2008: 15-19.
2. www.agi-usa.org
3. www~ashaweb.org
4. www.cdc.gov
5. www.goaskalice.columbia.edu
6. www.kff.org
7. <http://Tnteract.uoregon.edu/MediaLit/mlr/home>
8. www.teenpregnancy.org
9. 1-800-799-SAFE (7233) or 1-800-787-3224
10. www~ndvh.org
11. www.siecus.org
12. Shoqata Amerikane e Kancerit, 2002
13. Haagensen CD, kirurg i famshëm amerikan (1900-1990)

SUMMARY


BREASTS – MAMMARY GLANDS

Hasmije Izairi–Aliu¹

¹Hospital of Gynecology and Obstretic, Cair, Skopje, Macedonia

The female breasts are different in form and size. There is no relation between breast largeness and the woman level of sexual intensity or her ability in child feeding. Usually, it can happen one breast being larger than the other. The breast size varies according to the age, body mass, pregnancy and other factors. Breast cancer is ranked the first, due to the new cases with cancer in women, and also the second as a reason of mortality from cancer. Regular gynecological check-up and monthly self control of breasts are the most important ways whereby woman can protect her health.

Key words: mammary glands, cancer



HISTORI / HISTORY**A E DINI SE?**

Diatezën eksudative për here të parë e përmendën **Adalbert Czerny** në vitin 1905.
Elektroencefalografinë e promovoj **Hans Berger** në vitin 1931.
Elektroforezën e promovoj **Arne Tiselius** në vitin 1937.
Elektrokardiografinë e promovoj **Williem Einthoven** në vitin 1902.
Teorinë e disociacionit elektrolitik e ka themeluar **Svante Arrhenius** në vitin 1884.
Elektromagnetin në okulistikë i pari e aplikoj **Julius Hirschberg** në vitin 1885.
Teorinë elektronike e themeloj **Hendrik Anton Lorentz** në vitin 1883.
Mikroskopin elektronik i pari e konstruktoj **Hans Busch** në vitin 1926; e përsosën **Max Knoll** dhe **Ernst Ruska** në vitin 1931.
Elektroshok terapinë e promovoj **Lucio Bini** dhe **Ugo Cerletti** në vitin 1938.
Embolinë e definoj **Rudolf Virchow** në vitin 1846; operacionin e parë të embolisë e realizoj **Martin Kirchmer** në vitin 1924.
Emfizemën e mushkërive i pari e përshkruajti **Rene Theophile Hyacinthe Laennec** në vitin 1819.
Encefalografinë e promovoj **Walter Edward Dandy** në vitin 1918.
Encephalitis lethargica i pari e përshkruajti **Konstantin von Economo** në vitin 1917.
Endokarditin i pari e përshkruajti **Jean Fernel** në shekullin e XVI dhe **Matthew Baillie** në vitin 1795; prej **perikarditit** e ndajti **Jean Baptiste Bouillaud** në vitin 1834.
Endokarditis lenta e përshkruajti **William Osler** në vitin 1901.
Epilepsinë kortikale i pari e përshkruajti **L.F. Bravais** në vitin 1827; më vonë e përshkruajti **John Huglings Jackson** 1863.
Bromin në terapinë e **epilepsies** e aplikoj **Charles Locock** në vitin 1853; **luminalin** e aplikoj **Alfred Hauptmann** 1912.
Eritrocitet i zbuloj **Marcello Malpighi** në vitin 1665; saktësisht i definoj **Antony van Leeuwenhoek** në vitin 1673.
Ezofagoplastikën i pari e realizoj **Bricher** në vitin 1894.
Ezofagoskopin e promovoj **Adolf Kussmaul** në vitin 1868; e përsosi **Johann von Mikulicz-Radecki** në vitin 1881.
Paralizën e n. facialis i pari e përshkruajti **Charles Bell** në vitin 1812.
Fagocitozën e zbuloj **Ilija Iliç Meçnikov** në vitin 1883.
Shkaktarin e favusit e zbuloj **Johann Lukas Schönlein** në vitin 1839.
Fermentet e frymëmarrjes i studioj **Otto Warburg** në vitin 1908.
Fibrilacionin atrial i pari e përshkruajti **Jean Baptiste Bouillaud** në vitin 1835.
Fibrinogjenin e zbuloj **Alexander Schmidt** në vitin 1871.
Fiksacionin e komplementit e zbuluan **Jules Bordet** dhe **Octave Gengou** në vitin 1901.
Fluorografinë e promovoj **Manoel de Abreu** në vitin 1936.
Fokalozën i pari e kuptoj **Benjamin Rush** në vitin 1801; teorinë e përpunuan **Frank Billings** në vitin 1916 dhe **Edward Charles Rosenow** në vitin 1918/1921.
Folikulet ovariale i zbuloj **Regnier de Graaf** në vitin 1673.
Folikulinën e zbuloj **Edgar Allen** dhe **Edward A Doisy** në vitin 1923; e izoloi **Robert Marie Courrier** në vitin 1924.
Forcepsin e mendoj familja **Chamberlen** në fillim të shekullit XVII; në praktikë e promovoj **Jean Palfin** në vitin 1723.

(Vazhdon në numrin e ardhshëm)

Përgatiti: Prof. dr. sci. Remzi Izairi

RELAKSIM / RELAX


“Etika mjekësore i përgatit mjekët t’i dallojnë situatat e rënda dhe të ballafaqohen me ato në mënyrë racionale dhe parimore”

INJEKSIONET

***Injektio,-onis.f.** (in(j)icëre, pp. injectus, hedh brenda). Injektim, të futurit e një bari të lëngët nën lëkurë, në muskul, në venë, etj.*

***Injeksion;** gjendje e injektuar, e mbushur me gjak, hiperemike; kongestion.*


Mjekimi i sëmundjeve me injeksion edhe në të kaluarën ka pasur rëndësi të madhe. Në vitin 1853 **dr Charles Gabriel Pravaz** (1791 - 1853), mjek nga Lyoni, e konstruoi shiringën e parë për injeksion supkutan. Shiringa e parë, bashkë me gjilpërën, ishte e ndërtuar prej metali.



Shiringa prej metali

Në praktikën mjekësore injeksionin subkutan, në vitin 1853, për herë të parë e përdori **dr Aleksander Wood** (1818 - 1884), mjek nga Edinburg-u.

Shiringën e parë prej qelqi në vitin 1869 e konstruoi **Sir dr William Fergusson** (1808 - 1877), kirurg londinez.



Shiringa prej qelqi

Në vitin 1881 injeksionin intravenoz, për herë të parë në praktikën mjekësore, e përdori **dr Albert Landerer** (1854 - 1904). Ky mjek, në të njëjtin vit, i pari e aplikoi edhe infuzionin intravenoz të kripës së kuzhinës.

Sipas të dhënave të dokumentuara, injeksioni intravenoz është zbuluar qysh në shekullin e XVII-të. Në atë kohë, ky lloj i aplikimit të barërave ka hasur në rezistencë nga qarqet reaksionare dhe është lënë në harresë. Dyqind vjet më vonë, injeksioni i barërave përsëri futet në përdorim dhe sot është bërë lloj i pazëvendësueshëm i aplikimit të terapisë në punën e përditshme të çdo mjeku.

Sot, falë zhvillimeve tekniko-teknologjike, në përdorim janë shiringa të përsosura të plastikës për një përdorim, në forma dhe madhësi të ndryshme.

Përgatiti: Prof. dr sci. Remzi Izairi

**Provoni dijen tuaj?
Ç’është “Narkolepsia”?**

TAKIME MJEKËSORE / MEDICAL MEETINGS

RAPORT
PËR MBAJTJEN E KONFERENCËS IV TË LIDHJES SË PSIKIATRISË SHIPTARE (LPSH)
25-27.11.2011



Prej 25-27 Tetor në Prishtinë u mbajt Konferenca e IV Kombëtare e Lidhjes së Psikiatrisë Shqiptare (LPSH). Tema e konferencës ishte “Çregullimet psikotike: nga teoria në praktikë”.

Konferencën, në hapjen e saj, me telegram e përshëndeti Kryeministri i Kosovës, z.Hashim Thaçi ndërsa të hapur e shpalli Prof.Ferid Agani, Ministër i Shëndetësisë së Kosovës dhe njëkohësisht Kryetar i LPSH.

Pasoi pjesa punuese e Konferencës, në të cilën me punimet e tyre morën pjesë më se 20 psikiatra na Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia. Përfaqësuesit e Maqedonisë (Ass.Dr.Slavica Arsova, Prof.Dr.Vesna Gerazova Pejovska dhe Ass.Dr.Kadri Haxhihamza) u prezentuan me temën “Psychosocial functioning as quality of life in patients with schizophrenia on day hospital treatment” (Funksionimi psikosocial si cilësi e jetesës te pacientët me skizofreni në trajtim në spitalin ditor). Temat e konferencës zgjuan interes të madh të profesionistëve të profileve të ndryshëm në fushën e shëndetit mendor.

Në marginat e Konferencës u mbajtën edhe disa mbledhje në të cilat u rrahën pyetje operative të LPSH. Kështu, takim pati Këshilli Redaktues për pregaditjen e Udhërrëfyesit Kombëtar Psikiatrik, në të cilin u prezentuan rezultatet e punës së deritanishme dhe u morën detyrat e ardhshme.

Pjesa e punës së Konferencës u përmbyll më 26.11.2011. Organizimi i Konferencës ishte për çdo lëvdatë dhe falenderimet për këtë i shkojnë Këshillit Organizativ.

Të nesërmen, më 27.11.2011 u mbajt Kuvendi i III zgjedhor i LPSH në të cilin u zgjodhën anëtarët e Bordit të ri drejtues. Nga Maqedonia si anëtarë të Bordit u zgjodhën Dr.Idriz Nexhipi dhe Dr.Edip Sheji. Anetaret e ri te bordit jane: P. Maksuti (kryetar), J. Ulaj (nënkryetar), E. Sheji (nënkryetar), L. Sinani, A. Hashorva, G. Cala. Prof. A. Blyta, V. Saraqini, Sh. Statovci, I. Nexhipi dhe Fejzullah Shabani. Sekretare e bordit është Nazife Sylejmani.

Konferenca e V e LPSH do të mbahet vitin e ardhshëm në Maqedoni ndërsa vendi dhe data e mbajtjes së saj do të caktohen në takimin e ardhshëm të Bordit drejtues së LPSH.

Pregaditi: Ass. dr Kadri Haxhihamza

LETËR REDAKSISË / LETTER TO THE EDITORY

Pershendetje Profesor Remzi

Quhem Fiona Todhri, aktualisht jam pedagoge në Fakultetin e Shkencave Sociale, në Elbasan dhe Tiranë. Ne vitin 2005 kam kryer studimet Master në Shendet Publik pranë Fakultetit të Mjekësisë. Momentalisht jam ne proces doktore dhe fusha e studimit tim mbetet ajo e Shëndetit Publik. Në këte kuadër jam shumë e interesuar të botoj në revistën tuaj shkencore. Kam lexuar disa botime të revistës MEDICUS, dhe do isha shumë e nderuar nëse dhe botimi im do ishte pjesë e saj. Duke iu referuar afateve të dorëzimit i cili ishte me 1 Shtator, u mundova ta dorëzoj punimin tim brenda kohës. Ju lutem mund të më konfirmoni nëse punimi im ka ardhur në redaksinë tuaj, si dhe hapat që duhet të ndjek më tej.

Jam në pritje të përgjigjes suaj.

Me konsiderate

Fiona Todhri, pedagoge, Elbasan, Shqipëri

Mirëdita profesor,

Jjam Nereida Xhabija, mjeke kardiologe, prane Spitalit Amerikan në Tiranë. Në rradhë të parë ju përshëndes dhe ju përgëzoj për punën tuaj mjaft profesionale në lidhje me revistën. E nxitur nga konsiderata shumë të mira të kolegëve të mi të cilët kanë bashkëpunuar me ju si dhe nga dëshira ime që të kem një kontribut në revistën tuaj, po ju drejtohem me një kërkesë për botimin e një artikulli origjinal në lidhje me korrelacionin që ekziston mes sklero-kalcifikimeve kardio-vaskulare (më saktë ato te valvulës dhe/ose rrënjës aortale, kalcifikimit te unazës mitrale, etj.) dhe sëmundjes së arterieve koronare në popullatën shqiptare. Ky punim është pjesë e një studimi më të madh që jam duke e bërë në lidhje me Fakultetin e Mjekësisë dhe Spitalin tonë në kuadrin e disertacionit tim. Në qoftë se do të jeni i interesuar unë mund t'ju dërgoj një projekt të tij. Vetëm jeni i lutur të më njoftoni për kohën që do të kem në dispozicion për dërgimin e artikullit sipas kritereve tuaja. Me respekt, mbetem në pritje të përgjigjes tuaj.

Faleminderit!

Dr Nereida Ulqini Xhabija

Kardiologe, Specialiste ne fushen e Ekokardiografise

Univers-Alb sh.a.

American Hospital

Rr. "Lord BAJRON", prane S.U.Q.U.,Laprake,

Tiranë, Albania

Tel. ++355 42 35 75 35 ext.214

Fax ++355 42 357 634

Cel/Mob: ++355 684057269

e-mail : nxhabija@spitaliamerikan.com

www.spitaliamerikan.com

I nderuar Prof. Remzi

U gëzova shumë kur Dr Shenasiu më tregoi se Revista Medicus është me Impact faktor posaçërisht kur shumicën e njerëzve që e bënë këtë e njohë edhe personalisht. Të Enjten pata knaqësinë t'ju njoh edhe Juve personalisht ashtu që ardhja ime në Tetovë atë ditë mjafton me atë që u niftuam por shpresoj se do të bëjmë edhe ndonjë punë të mirë në të ardhmen.

I nderuar Prof. edhe pse Ju keni numër të mjaftueshëm të eksperteve botëror në bordin editorial nëse e shihni të arsyeshme në aspektin profesional unë Ju ofroj edhe dy emra në lëminë e pediatriisë dhe kardiologjisë pediatrike:

Njëri është Dr Kirk Millhoan , kardiopediatër nga ShBA, për të cilin nëse keni interes do t'ju shkruaj më gjërë dhe unë personalisht. Nëse e shihni të arsyeshme unë do t'ju dërgoj CV time dhe të dr Kirkut i cili deri tash ka qeë 12 herë në Kosovë, është studenti më i mirë i Universitetit të San Antonio

Texas, USA, kardiopediatër dhe ish Shefi i shëndetësisë së Marinës Amerikane. Për më tepër do të bisedojmë në Konferencën e Gostivarit.

Me dr Shenasin biseduam lidhur me Kongresin Maqedonas në Ohër dhe Konferencën në Gostivar Unë do të organizoj që në Ohër të marrin pjesë afër 100 pediatër nga Kosova dhe gjuha folëse në Metropol të jetë gjuha shqipe. Unë kam ftesë për ligjeratë (Invitation speaker) kurse në Gostivar shpresoj të vijëm afër 50 veta.

Për aktivitete do të bisedojmë në Gostivar.

Për shkak të diskriminimit i cili është bërë unë i ofrova dr Shenasisë sponsorimin e 4-6 mjekëve nga Maqedonia për në Kongres të Ohrit. Nëse jeni të interesuar ju lutem na i dergoni listën e mjekëve përfshirë edhe Juve.

Përshendetje të sinqerta

Dr Ramush Bejqi, MD, PhD, FACC, Prishtinë, Kosovë

Të nderuar kolege.

Ju uroj shëndet dhe punë të mbarë në misionin tuaj fisnik. Unë jam dr Robert Citozi, Pedagog prej 20 vitesh në Universitetin e Sporteve të Tiranës. Për më shumë se 6 vjet kam dhënë mësim dhe në Universitetin e Tetovës së fundmi tek studentët e parë të programit Master. Rastësisht nëpërmjet internetit u informova mbi revistën tuaj dhe jam i befasuar nga cilësia dhe temat e trajtuara të cilat janë vërtet me një impakt të ndjeshëm publik. Kam dëshirë të informohem mbi rregullat e botimit në revistën tuaj. Do ndjehesha vërtet i privilegjuar nëse do bashkëpunoja me stafin tuaj.

Me respekt

Dr Robert Citozi, Tiranë, Shqipëri

Pocituvan Professore Izairi,

Koleškata Flora Doko-Lumani me upati Vam da Vi gi ispratam trudovite za Vašeto spisanie.

Iskreno počestena sum što trudovite će bidat publikovani vo Medicus, bidejći spisanieto e edno od retkite, ako ne i edinstveno stručno-naučno medicinsko spisanie vo zemjata od ovoj tip.

Možam da Vi izrazam čestitki na Vašata ureduvačka politika, so nadež deka i vo idnina će sorabotuvame.

Srdečno

Dr sci. med. Emilija Jašović-Siveska, ginekolog-akuser, Bitola, Makedonija

I nderuar Profesor. dr Remzi ju përshëndes nga Korça .

Së pari urime për revistën tuaj prestigjioze! Urime për punën dhe përkushtimin tuaj! Ju keni meritën e madhe për bashkimin e profesionstëve shqiptarë të fushës së mjekësisë. Unë jam lexuese e rregullt e revistës tuaj. Është hera e parë që ju shkruaj dhe do të ndjehesha shumë e vlerësuar nëse punimi im i pabotuar ndonjëherë, do të bëheshe pjesë e revistës tuaj.

Tema: “Brucelozja dhe komplikacionet” në qarkun e Korçës për vitet e fundit . Korça njihet si rajon ku ka qenë dhe është e pranishme kjo zoonoze.

Nëse keni hapësirë botimi dhe bashkëpunimi më ktheni përgjigje ju lutem. Ndërkohë jam e interesuar për bashkëpunim të mëtejshëm.

Me respekt Lindita Terolli

Departamenti i Infermierisë Universiteti Fan.S.Noli

Korçe, Shqipëri

Lagjja 10. Blloku i Ri i Sportit. Korçe Shqipëri

e-mail: lindita.terolli@yahoo.com

I nderuari prof. Remzi,

Edhe njëherë një falënderim i veçantë për Ju, Prof. dr Remzi Izairi, për kujdesin e korrektesën maksimale në letërkembim, si dhe për stafin e bashkëpunetorët e revistës që ju drejtoni.

Ju uroj shëndet dhe Gëzuar Festat!

Me respekt Dr Admir Nake, Tiranë, Shqipëri

I nderuar Prof. Izairi!

Emri im është Dr. Albana Duni dhe jam mjeke gastrohepatologe në Poliklinikën e Specialiteteve Nr. 3 (ose Poliklinika Qendrore) në Tiranë. Jam lexuese e revistës suaj dhe admiruese e punës titanike që ju dhe stafi juaj bëni për ta mbajtur gjallë aktivitetin shkencor në rrethin e mjekëve shqipfolës në trevat tona.

Po ju dërgoj një artikull për tumoret biliare me shpresë që do të botohet në revistën tuaj.

Në pritje të përgjigjes suaj.

Me respekt.

Dr. Albana Duni

Gastro-Hepatologe

Poliklinika e Specialiteteve Nr.3

Tiranë, Shqipëri

Tel: +3555682144554

Përshendetje Prof. Remzi.

Këto ditë mora revisten Medicus të dhjetorit 2011. Revista më pëlqeu pa masë dhe e vlerësoj shumë punën tuaj.

Ju jam shumë mirënjohëse dhe ju falënderoj për ndihmën tuaj.

Ju urroj shumë suksese në punë e në jetë.

Me respekt Vjollca Koko, Gjirokastër, Shqipëri

Përshendetje Prof. Remzi

Quhem Mirela Alushllari dhe jam petagoge në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i shkencave Natyrore. Jam kërkuese shkencore në fushën e kimisë e analitike, në fushën e spektrometrisë së absorbimit atomik.

Jam e interesuar në lidhje me botimet në revistën Tuaj. Une kam punime të cilat dua t'i publikoj.

Nëse keni mundësi ju lutem më informoni.

Falemiderit.

Me respekt

Mirela Alushllari

Center of Applied Nuclear Physics

Faculty of Natural Science

University of Tirana

Mobile:+ 355 67 20 27 605

Prof. Dr. Remzi!

Uroj të jeni mirë familjarisht dhe të keni suksese në punën tuaj!

Dëshiroj të bashkëpunoj me revistën tuaj MEDICUS, të cilën e kam përcjellë vazhdimisht me shumë interes. si fillim të këtij bashkëpunimi mendoj të dërgoj për botim një punim mbi përdorimin e Paliperidonit në skizofreni. Shpresoj që të kem plotësuar mirë kërkesat e redaksisë suaj.

Ju përshendes dhe ju falënderoj për bashkëpunimin

Prof. Asc. dr. Vuksan Kola

Fakulteti i Mjekësisë, Shërbimi i Psikiatrisë, Tiranë, Shqipëri.

Pocituvan Prof. Remzi,

Posle odlicnoto iskustvo so objavuvanjeto na mojt trud vo Vaseto respektirano spisanie Medicus, jas povtorno bi sakala eden zaednicki trud so mladi koleski da objavam vo naredniot broj na Medicus.

Trudot go isprakam sega, a potsetnikot i potpisanite recenzioni mislenja ke gi ispratam denovive.

Koga go planirate sledniot broj na spisanieto?

Mnogu pozdrav i blagodaram na sorabotkata

Prof. dr Elizabeta Zisovska, MD gynecologist profesor

“Marshal Tito” 6-2/16; 1000 Skopje

Tel: +389 76 233 242;

e-mail: elizabeta.zisovska@ugd.edu.mk

Skopje, Makedonija



RECENZENTË

- Prof. dr. sci. Beti Zafirovska Ivanovska, Shkup, Maqedoni
 Prof. dr. sci. Remzi Izairi, Çegran, Maqedoni
 Prof. dr. sci. Aleksandra Stoilkovska, Shkup, Maqedoni
 Prof. dr. sci. Enver Roshi, Tiranë, Shqipëri
 Prof. dr. sci. Afrim Tabaku, Tiranë, Shqipëri
 Prof. dr. sci. Dhori Pojani, Tiranë, Shqipëri
 Prof. ass. dr. sci. Nikollaq Leka, Tiranë, Shqipëri
 Ass. dr. sci. Adem Haziri, Prishtinë, Kosovë
 MD PhD Vilma Mema, Tiranë, Shqipëri
 Prof. dr. sci. Vesna Gerazova, Shkup, Maqedoni
 Prof. dr. sci. Antonio Novotni, Shkup, Maqedoni
 Prof. dr. sci. Biljana Taushanova, Shkup, Maqedoni
 Prof. dr. sci. Elez Selimi, Tiranë, Shqipëri
 Prof. dr. sci. Hektor Cecoli, Tiranë, Shqipëri
 Prof. dr. sci. Nada Pop-Jordanova, Shkup, Maqedoni
 Prof. dr. sci. Stevka Grujovska, Shkup, Maqedoni
 Doc. dr. sci. Yllka Billushi, Vlorë, Shqipëri
 Prof. dr. sci. Ilija Mazniku, Tiranë, Shqipëri
 Prof. dr. sci. Gjergji Çausi, Tiranë, Shqipëri
 Prof. dr. sci. Nikola Jankulovski, Shkup, Maqedoni
 Doc. dr. sci. Gorgi Jota, Shkup, Maqedoni
 Prof. dr. sci. Verçe Bozhinovska, Shkup, Maqedoni
 Prof. dr. sci. Jovanka Tutevska, Shkup, Maqedoni
 Prof. dr. sci. Marija Krstevska, Shkup, Maqedoni
 Prof. dr. sci. Elena Kosevska, Shkup, Maqedoni
 Prof. dr. sci. Zoran Karadzov, Shkup, Maqedoni
 Prof. dr. sci. Milka Zdravkovska, Shkup, Maqedoni
 Prof. dr. sci. Leart Rama, Tiranë, Shqipëri
 Prof. dr. sci. Petrit Bara, Tiranë, Shqipëri
 Prof. dr. sci. Myrvete Kelmendi, Prishtinë, Kosovë,
 Prof. ass. dr. sci. Sylejman Rexhepi, Prishtinë, Kosovë
 Prof. dr. sci. Jusuf Telaku, Prishtinë, Kosovë
 Prof. dr. sci. Gjergji Cepa, Tiranë, Shqipëri
 Prof. dr. sci. Xheladin Çeka, Tiranë, Shqipëri
 Prof. ass. dr. sci. Donika Boçari, Tiranë, Shqipëri
 Prof. dr. sci. Afrim Tabaku, Tiranë, Shqipëri
 Prof. dr. sci. Anila Godo, Tiranë, Shqipëri
 Prof. Ass. dr. sci. Edmond Pistulli, Tiranë, Shqipëri
 Doc. Dr. sci. Igor Kaftanxhiev, Shkup, Maqedoni
 Prof. dr. sci. Gjergji Minga, Tiranë, Shqipëri
 Prof. As. dr. sci. Adriana Babameto, Tiranë, Shqipëri
 Prof. dr. sci. Vasilço Spirov, Shkup, Maqedoni
 Prof. dr. sci. Vesna Janevska, Shkup, Maqedoni
 Prof. dr. sci. Slobodan Ristovski, Shkup, Maqedoni
 Prof. dr. sci. Lumturi Markolaj, Tiranë, Shqipëri
 Prof. dr. sci. Jovica Gavrilovski, Shkup, Maqedoni
 Prof. ass. dr. sci. Myrvete Paçarada, Prishtinë, Kosovë
 Mr. sci. dr. Lena Jovanović, Manastir, Maqedoni
 Prof. dr. sci. Paskal Cullufi, Tiranë, Shqipëri
 Prof. dr. sci. Xhavit Bicaj, Prishtinë, Kosovë
 Bp. Shk. Irina Pavlovska, Shkup, Maqedoni
 Mr. sci. dr. Vllado Damevski, Manastir, Maqedoni
 Prof. dr. sci. Dragan Danilovski, Shkup, Maqedoni
 Prof. dr. sci. Bilal Shkurtaj, Vlorë, Shqipëri
 Prof. Ass. dr. sci. Mihal Kërci, Tiranë, Shqipëri
 Prof. dr. sci. Miroslav Gavrilovski, Shkup, Maqedoni
 Doc. dr. sci. Anita Arsovska, Shkup, Maqedoni
 Prof. As. dr. sci. Behar Shehi, Tiranë, Shqipëri
 Prof. As. dr. sci. Sotir Vangjeli, Vlorë, Shqipëri
 Prof. As. dr. sci. Mehmet Maxhuni, Prishtinë, Kosovë
 Prof. dr. sci. Arben Baboçi, Tiranë, Shqipëri
 Prof. dr. sci. Slavjanka Popovska, Shkup, Maqedoni
 Prof. As. dr. sci. Ilir Kajo, Tiranë, Shqipëri
 Prof. dr. sci. Mujë Shala, Prishtinë, Kosovë
 Prof. dr. sci. Ibrahim Behluli, Prishtinë, Kosovë
 Prof. dr. sci. Nikola Kamçev, Shkup, Maqedoni
 Prof. Ass. dr. sci. Pajtim Lutaj, Tiranë, Shqipëri
 Prof. dr. sci. Vllado Georgiev, Shkup, Maqedoni
 Doc. dr. sci. Gjergji Jota, Shkup, Maqedoni
 Prof. dr. sci. Milka Zdravkovska, Shkup, Maqedoni
 Prof. dr. sci. Spiro Çausi, Tiranë, Shqipëri
 Prof. dr. sci. Aleksandar Stojanovic, Shkup, Maqedoni
 Prof. dr. sci. Olivera Muratovska, Shkup, Maqedoni
 Prof. dr. sci. Jovica Gavrilovski, Shkup, Maqedoni
 Prof. Ass. dr. sci. Hysen Heta, Tiranë, Shqipëri
 Prof. As. dr. sci. Tatjana Cina, Tiranë, Shqipëri
 Prof. As. dr. sci. Agon Cuka, Tiranë, Shqipëri
 Prof. dr. sci. Jovan Basho, Tiranë, Shqipëri
 Prof. dr. sci. Jordan Çaloski, Shkup, Maqedoni
 Prof. dr. sci. Gjergji Gjokiq, Shkup, Maqedoni
 Prof. dr. sci. Pero Petrovski, Shkup, Maqedoni
 Prof. dr. sci. Mehmet Spahiu, Tiranë, Shqipëri
 Prof. dr. sci. Myftar Barbullushi, Tiranë, Shqipëri
 Prof. As. dr. sci. Arben Gjata, Tiranë, Shqipëri
 Prof. dr. sci. Halit Ymeri, Prishtinë, Kosovë
 Prim. dr. Menduh Egeni, Shkup, Maqedoni
 Prim. dr. Dragan Tanturovski, Shkup, Maqedoni
 Prof. dr. sci. Eli Foto, Tiranë, Shqipëri
 Prof. Ass. dr. sci. Ermira Kola, Tiranë, Shqipëri
 Prof. dr. sci. Irena Topuzovska, Shkup, Maqedoni
 Prof. As. dr. sci. Florion Toti, Tiranë, Shqipëri
 Prim. dr. Flora Doko-Lumani, Strugë, Maqedoni
 Prof. As. dr. sci. Naim Haliti, Prishtinë, Kosovë
 Prof. dr. sci. Olga Todorovska, Shkup, Maqedoni
 Prof. dr. sci. Sllavica Subevska, Shkup, Maqedoni
 Prof. dr. sci. Vladimír Mirçevski, Shkup, Maqedoni
 Ass. dr. sci. Arben Taravari, Shkup, Maqedoni
 Prof. Ass. dr. sci. Afrim Dangellia, Tiranë, Shqipëri
 Prof. Ass. dr. sci. Vuksan Kola, Tiranë, Shqipëri

Përgjigje në pyetjen e parashtruar?

Narkolepsia - Është një turbullim i gjumit në të cilin njerëzit i zë gjumi involuntar (pa dëshirën e tyre), indiferent nga vendi ku ndodhen. Ata që vuajnë nga kjo sëmundje nuk janë në gjendje të rinë zgjuar periudha të gjata kohe dhe as nuk mund të gëzohen nga efekti i shlodhjes që të ofron gjumi. Nuk dihet akoma se çfarë e shkakton sëmundjen, por supozohet që është autoimmune ose gjenetike.

Përgatiti: Prof. dr. sci. Remzi Izairi

NJOFTIM

Vëllimi XVIII (2) i Revistës "Medicus" do të del nga shtypi në Dhjetor, 2012.

Afati i dorëzimit të punimeve është deri më: **1 Shtator, 2012.**

UDHËZIME PËR AUTORË / GUIDELINES FOR AUTHORS

Medicus është revistë e mjekëve. Boton punime profesionale dhe shkencore të mjekësisë, prezantim rastesh, artikuj revyjal, vështrime, risi nga mjekësia, recensionë librash, raporte nga tubime shkencore dhe letra dërguar redaksisë. Pranohen vetëm punime origjinale dhe të pabotuara më parë diku tjetër. Punimet dhe shtesat tjera dërgohen në adresën e

Kryeredaktorit: Prof. dr Remzi Izairi. 1237 Çegran, Gostivar, e-mail: shmshm@live.com

Teksti i punimit dhe shtesave tjera

Punimet botohen në gjuhën shqipe ose në gjuhën angleze. **Autori, punimin e lekturuar bashkë me tabelat dhe fotografitë, si dhe një fotografi personale të formatit 3x4, është i obliguar ta dërgojë me postë elektronike në e-mail të Shoqatës.** Një autor mund të jetë bartës vetëm i një punimi, ndërsa bashkautor në më shumë tri punime. Punimi të shtypet në kompjuter, programi “Word for Windows” (Times New Roman, madhësia e shkronjave 12, me 1 lines, me marginë përreth 4cm, jo më tepër se 30 rreshta dhe 60 shenja në rend). Punimet origjinale shkencore, profesionale dhe revyale me të gjitha shtesat mund të kenë deri në 12 faqe të letrës së formatit A4; përshkrimi dhe prezantimi i rasteve 6 faqe, kurse raportit nga tubimet shkencore-profesionale, recensionë librash, risi nga mjekësia dhe letër redaksisë 1 deri 2 faqe. Punimi duhet të jetë i saktë, i qartë dhe pa përsëritje.

Përgatitja e punimit, manuskriptit

Fleta e parë përmban **titullin** sa më të saktë dhe informativ të punimit, emrin dhe mbiemrin e plotë të çdo autori, emrin e institucionit ku është kryer punimi dhe **rezymenë** në gjuhën shqipe. **Rezymeja** duhet të jetë e shkurtër, jo më shumë se 150 fjalë ose 15 rreshta. **Rezymeja** përmban vështrimin e përgjithshëm të temës, qëllimin e punimit, materialin dhe metodat e punës, rezultatet dhe përfundimet kryesore, pa citate nga literatura. **Rezymeja** duhet të jetë faktografike, jo përshkuese dhe të shkruhet në **vetën e tretë njëjës**. Shkurtesat, përveç këtyre standardeve të matjes, të mos përdoren. Nën rezyme shënohen **2-5 fjalë ose fraza të shkurtra kyç ose bosht**, që janë thelbësore për identifikimin dhe klasifikimin e përmbajtjes së punimit.

Fleta e dytë përmban **titullin e punimit, emrin e institucionit ku është kryer punimi dhe rezymenë** e punimit me **fjalët kyç** në gjuhën angleze.

Fleta e tretë fillon me **tekstin e punimit** i cili përmban: **hyrjen, materialin dhe metodat, rezultatet, diskutimin dhe përfundimin.**

Hyrja shkruhet në **kohën e tashme**. Duhet të jetë e shkurtër dhe të prezantojë në mënyrë të qartë e të saktë thelbin e problemit të studimit dhe qëllimin e punimit. Referencat që merren me këtë problem të përmenden në mënyrë telegrafike. Të dhënat nga literatura (autorët, citatet), kudo që përmenden në tekst të punimit, duhet të shënohen në kllapa (), me shifra arabe dhe duhet t’u përgjigjen atyre në regjistrin e **literaturës**.

Materiali dhe metodat e punës shkruhen në **kohën e kaluar**. Duhet të përmbajnë të dhënat se **çka dhe si, ku dhe kur** është bërë punimi. Metoda e punës duhet të përshkruhet qartë, kurse metodat e njohura nuk përshkruhen por përmenden nga cila literaturë. Barënat shkruhen me emrin e tyre gjenerik.

Rezultatet e punimit shkruhen në **kohën e kaluar**. Duhet të paraqiten në mënyrë të saktë dhe të qartë, të shënohen me njësi të SI ose në kllapa edhe me njësi matëse tradicionale. Rëndësi të veçantë ka përpunimi statistikor i rezultateve.

Diskutimi shkruhet në **kohën e tashme** dhe është interpretim i rezultateve të fituara dhe krahasimi i tyre me njohuritë e deritanishme e me të dhënat nga literatura.

Përfundimi del nga qëllimi i punimit dhe diskutimi. Duhet të jetë i thuktë. Në përfundim autori jep mendimet, sugjerimet dhe propozimet e veta.

Mirënjohje e shkurtër kushtuar atyre që e kanë ndihmuar autorin mund të shkruhet në fund të tekstit.

Tabelat, fotografitë dhe skicat

Çdo **tabelë, fotografi dhe skicë duhet të shtypet në tekst në vendin e paraparë**. Tabela, përveç numrit, duhet të përmbajë titullin dhe pjesën tekstuale në gjuhën shqipe. **Titulli** i shkurtër dhe i kuptueshëm shënohet në krye të tabelës, kurse shënimet shpjeguese nën tabelë. Shkurtesat e përdorura duhet të shpjegohen nën tabelë, sipas renditjes alfabetike. Të mos përdoren titujt vertikal. Shtyllat të shënohen me shifra romake ose me shkronja të mëdha siç sqarohen në legjendë.

Përshkrimi i fotografisë ose legjenda duhet të bëhet nën fotografi dhe të ketë numrin rendor. Preferohet që vendet e rëndësishme të fotografisë të shënohen me shigjeta. Të sëmurve gjatë fotografimit u mbyllen sytë me një shirit të zi për të mos u identifikuar. Marrja dhe riprodhimi i tabelave, fotografive dhe e skicave nga autorë të tjerë, duhet të bëhet me lejen e botuesit dhe të autorit.

Të gjitha shkrimet në ilustrim duhet të jenë në gjuhën shqipe.

Regjistri i literaturës. Autorët (referencat), të cilat përmenden me shifra arabe në kllapa () në tekstin e punimit, në regjistër të literaturës radhiten sikurse janë përmendur në tekst. Shënohet numri rendor arab, pastaj të gjithë autorët e referencës, përveç kur janë më shumë se 6 autorë, kur do të shkruhen 3 autorët e parë me shkurtesën bp. Pika nuk përdoret pas inicialeve të emrave të autorëve. Shkurtesat për revista shënohen sipas regjistrin në **Index medicus**.

Shembuj për regjistrin të literaturës nga:

Revista

Izairi R, Izairi-Aliu H, Izairi A. Përvojat tona në diagnozën dhe mjekimin e angjinës-faringitit streptokoksik. *Medicus* 2004; vol. 1 (1):5-9.

Libri dhe Monografia

Rexhepi J. Ekzamini klini i sëmundjeve të brendshme. Prishtinë, 1982:22-6..

Kapitulli i librit

Petani H. Hipertensionioni esencial. Në: Adhami JE. Traktati i sëmundjeve të brendshme. Tiranë: ”Mihal Duri”, 1974: 207-230.

Përmbledhje e punimeve

Izairi-Aliu H, Aliu B, Izairi H, Izairi R. Graviditeti dhe artriti reumatoid. Përmbledhje e punimeve. Takim Profesional Mjekësor 2003. Tetovë, 2003:173-8.

Disertacioni dhe Magjistratura

Rexhepi S. Veçoritë e artritis reumatoid në pleqëri. Tezë e disertacionit. Universiteti i Prishtinës. 1997,34.

Fleta e fundit. Për çdo autor, në fletë të veçantë, shkruhet shkalla e titullit akademik, fusha e specializimit, institucioni, adresa e punës dhe e banimit, si dhe numrat e telefonit dhe e-mail.

Udhëzimet për autorin janë adaptuar sipas rekomandimeve të **Uniform Requirements for Manuscripts Submitted To Biomedical Journals. N Engl J Med 1991: 324:424-8**

NJOFTIM. Të gjitha punimet shqyrtohen nga botuesi. Punimet që nuk i plotësojnë kriteret e udhëzimeve, si dhe ato që i refuzon redaksia, i kthehen autorit. Punimet i nënshtrohen recensionit dhe redaktuarës gjuhësore. Redaksia e Revistës e cakton renditjen e botimit të punimit, rezervon të drejtën, si për pakësimin e vëllimit dhe numrit të ilustrimeve, ashtu edhe për përshtatjen e tekstit të punimit në bashkëpunim me autorin. Punimet nuk paguhen. Autorit i jepen 2 ekzemplarë të revistës “Medicus”.

Verba volant, scripta manent” - “Fjalët fluturojnë, shkrimi mbetet”

DREJTUAR MJEKËVE DHE SHOQATAVE!

Nëse keni hasur në ndonjë risi mjekësore në literaturën botërore ose në sajtet e internetit që është interesante për lexuesit, ju lutemi që ta prezantoni në revistën “Medicus”. Tekstin e shkruar në kompjuter, në Times New Roman, në formatin “Word for Windows”, deri në 50 rreshta, bashkë me një fotografi Tuajën të formatit 3x4cm, mund ta dërgoni në e-mail adresën e Shoqatës: shmshm@live.com

Po ashtu, mund të dërgoni informacione për ndonjë aktivitet të shoqatës Tuaj. Ju lutemi na informoni për: ditën, muajin dhe vitin e mbajtjes, vendin dhe objektin, emrin oficial të takimit dhe temat, organizatorin dhe kontakt adresën.

e-mail: shmshm@live.com

Web faqja: www.medalb.com

LEXUES TË NDERUAR

Nëse jeni të interesuar që t’i keni numrat vijues të Revistës “Medicus”, atëherë drejtohuni në adresën e Kryetarit të Degës Tuaj dhe kërkoni numrin e revistës Tuaj.


Revista shpërndahet falas, kurse distribuimin e bën Kryesia e Degës Tuaj.

Nëse keni vërejtje në punën Tonë, Ju lutemi të gjitha vërejtjet dhe sygjerimet t’i drejtoni në adresën e Redaksisë.

Ju falënderit për bashkëpunimin dhe që jeni lexues të Revistës sonë.

Me respekt

Redaksia e Revistës “Medicus”.



MEDICUS

www.medalb.com

e-mail: shmshm@live.com